

BIBLIOTEKA

E

8J4-32

LILALHS

F79

GJIROKASTER

# FORTESA

## tregime

8 JH-32  
F79.

LIBRARY  
UNIVERSITY OF TORONTO LIBRARIES

# FORTESA

Tregime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## Ali Abdihoxha

### P E R M B Y S J A

1

Buzë rrugës, në këmbët e Tepes, që ngrihej si rojë përmbi urën e Zaranikës e përmbi qytetin e Elbasanit, komandanti dha shenjën e sulmit. Zeqos i takoi të ngrihej i pari. Shkrehu automatikun dhe thirri:

— Zulëm, ore, shokëni, zulëm! Yrrja-a! Berisha-aj!

Me kurriz nga qyteti e me fytyrë nga ullishta, u hodh si pa të keq në mes të rrugës, në mes të gjermanëve. Ushtoi faqja e kodrës, krisi 'pushka e mitralozi, u doli flaka makinave, njerëzit u ngjirën, u përgjakën, u kacafytën, u thyen kondakët e pushkëve. Tymi dhe era e barutit, si në çdo betejë të ashpër, mbuluan xhadënë dhe ullishtën. Krismat e gjëmimet tundën mbarë qytetin.

— Zeqo-o! — i briti rrëzë veshit komandanti. — Merr skuadrën dhe nisu për të rrethuar sarajet e beut të madh.

— Nuk i di! — ia ktheu Zeqoja dhe një damar, si fitil mavi, i kërceu në mes të ballit.

— Thirr, nuk tē dëgjoj! — briti sérish komandan-ti.

— Nuk e di, jo-o-o!

— Ja, ajo me shumë oxhakë. Arresto kë tē gjesh brenda.

— Si urdhëro-on!

Zeqoja u ngrit në këmbë, dëgjoi fishkëllimën e plumbave, tundi pushkën, thirri:

— Skuadra pas meje!

Si skifteri, që rrëmbejn gjahun, ashtu edhe skuadra u shkëput nga beteja e rrugës dhe fluturoi pas skuadërkomandantit. Zeqoja, që tashmë po vraponte përmes zallit tē Zaranikës, tek pa shokët rreth e rrotull, u mallëngjye nga ai gjëzim i njohur, nga ai gjëzim, që e kishte rrëmbyer shpateve, luginave, prozhmeve e grykave. Qëndroi një hop dhe, para se tē hidhej në breg, ngriti grushtin:

— Zulëm, ore shokëni, zulëm! Yrrja-a! Beriha-aj!

Por gjithë kjo britmë i shkoi kot Zeqos. Para tij shtriheshin kopshte e oborre tē heshtura, si tē mos donin t'ia dinin fare për betejën që jehonte rrëzë Tepes e në mes tē xhadesë.

Pa e ndalur vrapin, skuadra rrethoi shtëpinë e beut tē madh dhe Zeqoja hodhi bombën e parë në mes tē oborrit.

2

Atë mëngjes, para se tē pëlciste lufta në xhade e në ullishtë e para se tē pëlciste bomba e Zeqos në oborrin e madh tē sarajeve, hanëmja e vogël largoj jorganin prej atllasi, hapi perden e trashë dhe me kërcime valsi fluturoi drejt pasqyrës së tualetit. Lëshoi kokën prapa dhe pa qafën e gjatë e tē bardhë si bora. Pastaj u kthyte në profil, nga e majta e nga

e djathta. Më në fund u shikua drejt, me vetulla të ngrysura e me vështrim të mprehtë. Kjo ishte poza më e dashur e artistes që ajo kishte parë në kinema kohët e fundit. Elsës iu bë se nuk i mungonte asgjë për t'u dukur e bukur si një Greta Garbo. Ç'kishte Greta më tepër se ajo? «Grande amore! Eja, se po të pres!» — tha vajza me vete dhe buzëqeshi aq lehtë, sa mezi iu shqua çarku i bukur i dhëmbëve të bardhë si inxhi.

Vajza e beut të Elbasanit nuk i kishte kapërcyer të nëntëmbëdhjetat: në të dyja faqet i dukeshin ende burmat e fëmijërisë. Nga bukuria i kishte prerë kokën t'et: flokë-, sy- e vetullzezë, lëkurëbardhë, shtathedhur, me një palë këmbë të drejta, sì figurinë.

«Grande amore!» — tha sérish vajza me vete dhe u hodh mbi divan.

Heshtja e mëngjesit të nëntorit u prish nga të shtënët e një mitralozi buzë ullishtës. «Ah! — kli-thi Elsa dhe u kujtua se në periferi të qytetit bëhej luftë në mes të partizanëve dhe gjermanëve. — Ah, të mallkuarit!»

Elsë hanëmja, si vajzë beu e përkëdhelur, s'para e pati ndier erën e barutit. Kur u pushtua Shqipëria, ajo ndodhej në Itali. «U bëmë edhe ne mbretëri e madhe», — tha Elsa, duke përsëritur fjalët e letres që i shkruante i ati. Asokohe ajo ishte katërmëbëdhjetë vjeçe, nxënëse e klasës së dytë në një lice klasik të Romës. Pas një viti erdhi në Shqipëri për pushimet verore. I ati, që kishte gisht të madh në punët qeveritare, i tha Elsës se populli shqiptar ishte shumë i lumtur, se kurorën e shqiptarit të moçëm, që njihej me emrin Skënderbej, e kishte vënë Viktor Emanueli i Tretë. Elsa jetoi në mes të luksit, shëtitit nga Elbasani në Tiranë, u përkëdhel me langonjtë e të atit, dhe në shtator u kthyte përsëri në Romë për të vazhduar studimet. Kur kapitulloi Italia, i ati nisi një njeri të besuar për ta shpënë në Zvicër, por plot një vit më vonë, papritur e pakujtuar, qehajai u kthyte bashkë me Elsën në Shqipëri.

«— Si ndodhi? — pyeti beu.

— Gocën, bej, e kishte marrë malli pér ju. S'deshi tē shkonte nē Zvicér. Hoqa tē zit e ullirit derisa e solla këtu.

— Moj bijë, po këtu bëhet luftë! — iu kärcenua beu.

— Edhe nē Shqipëri bëhet luftë?! — u çudit Elsa dhe iu hodh tē atit nē qafë e përmalluar.»

Beu deshi tē largohej nga Shqipëria menjéherë bashkë me tē bijën, po komanda gjermane e mbajti, pasi gjendja paraqitej mjaft e rrezikshme nē Ballkan. Ushtria e Kuqe ishte futur nē tokën Jugosllave. Udhëtimi i familjeve qe bërë i pamundshëm. Shkurt: beu i Elbasanit, si bashkëpunëtor i ngushtë i nazistëve, vendosi tē largohej me forcat gjermane. Komandanti i garnizonit kishte marrë përsipër ta dërgonte shëndoshë e mirë bashkë me tē bijën nē Berlinin «e pamposhtur».

Vetëm gjatë këtyre dy muajve Elsë hanëmja ndjeu telashet e luftës dhe kuptoi se populli ishte ngritur dhe luftonte kundër gjermanëve. Para tri ditësh beu qe lajmëruar nga komanda e ushtrisë tē ishte gati pér udhëtim tē largët, drejt Berlinit.

...Trokiti gishtat mbi komodinë, «rënkoj» pér gjumin e ëmbël që kishte bërë gjatë natës dhe vrapoi te lavamani.

— Shpejt! Shpejt! — dëgjoi zërin e tē atit poshtë nē oborr. — Të poshtrit! Po ikin! Duan tē na lënë këtu. Të poshtrit!

Elsë hanëmja s'pati kohë tē lahej. Fshiu shkumën nga fytyra dhe nxori kokën nē dritare. Të gjitha dyert e shtëpive përdhese rrëth e rrotull ishin tē mbyllura. Nëpër rrugët e ngushta qenë rreshtuar njëshkolona tē gjata tē ushtrisë gjermane. Tek-tuk dëgjohej krisma e një mitralozi si nga Krasta, si nga Shkumbini, si nga ullishta.

— Ah, tē poshtrit! — murmuriti Elsë hanëmja sa pér tē imituar tē atin. Ç'është e vërteta, ajo ende nuk e kishte kuptuar, pse ishte kaq e domosdoshme tē ikin nē Berlinin «e pamposhtur», kurse e tërë pa-

suria e të atit ndodhej në Romën e bukur, pranë mureve të Koloseut. — Ç'do të thotë kjo? Partizanët! Bo-bo, sa të rrezikshëm këta partizanët!

Por, megjithëkëtë, Elsë hanëmja përsërithi:

— Të poshtrit, s'duan të na marrin në Berlin. Prisni. E dëgjuat! — iu kërcënuar gjermanëve të heshtur atje tej në rrugë dhe u lëshua drejt gardërobës për të veshur kostumin e udhëtimit.

Në saraje mbretëronte një rrëmujë e madhe, ku s'e merrte vesh i pari të dytin. Disa zbritnin shkallët, të tjerët ngjiteshin e pengonin njëri-tjetrin, ca valixhe ishin hedhur në mes të oborrit, njëri nga shërbëtorët mbushte bagazhin e veturës me ato pak sende të çmueshme që beu s'i pati nisur ende në Itali bashkë me shumicën e plaçkave. Qehallarët vërtiteshin lart e poshtë me pushkë në krah, pa bërë asgjë.

— Shpejt! Shpejt! — shfrynte inatin beu kundër shërbëtorëve.

Ndërsa Elsë hanëmja po vriste mendjen në dhomën e gjumit q'të merrte e q'të flakte, një gjëmim i fortë tundi themelet e sarajeve dhe asaj iu duk sikur u fundos i tërë qyteti. Klithi duke rënë përmbyss mbi krevat, e përpirë nga lotët e drithërimat...

3

Pas bombës që hodhi Zeqoja në oborr, u dorëzuan menjëherë gjithë sa vërtiteshin brenda në kullë e rreth veturës, me bej e me hanëme, me dado e me qehallarë, me laçkë e plaçkë, me kuç e me maç, me valixhe e me langonj.

Zeqoja veproi siç ia preu koka. Beun e mbylli në një dhomë, çupën nazelie, që s'i kishte mbetur pikë gjaku në fytyrë e që, me të dëgjuar gjëmin e bombës e me të parë partizanët, ra përmbyss pa ndjenja,

e ngriti peshë dhe e vuri mbi krevatin e saj. Qehallarë, shërbëtorë e dado, burra e gra, i ndau veç e veç dhe i mbylli në dy dhomat e poshtme, ca dhoma të vogla, plot lagështirë e shumica pa xhamë. Pastaj vuri roja rrëth shtëpisë, mori frymë i gliruar, mbajti vesh për të dëgjuar krismat që po largoheshin si nga Shëngjoni e rrëzë Kérrabës dhe tha:

— Po merr fund lufta. Së shpejti kthehet e tërë brigada.

Sipër rënkonte dyshemeja. Beu ecte lart e poshtë nëpër dhomë. Zeqoja përkëdheli tytën e pushkës.

— Do kemi edhe ca telashe me këta! — dhe ngriti sytë si për t'i treguar pushkës së vet beun atje lart. — Pastaj do t'i themi komunizmit: «Hajde këtu, lal, se kemi një çikë punë me ty...» — Zeqoja i ndërpreeu mendimet. Beu shkeli tamam mbi kokën e tij. Disa grimca pluhuri i ranë në fytyrë. «Çhë-ë-ë», teshiu Zeqoja. Kroj zverkun dhe tha:

— Gabim, gabim. Ata tërë jetën na kanë qëndruar mbi kokë. Sot mbaroi dita e tyre.

Gabimi duhej ndrecurr. Doli në 'mes të oborrit, hapi krahët dhe urdhëroi me zë të lartë:

— Mjaft, zbritni poshtë!

Partizanët s'lëvizën nga vendi. Nuk e kuptuan menjëherë.

Zeqoja:

— Klasat sunduese, në bodrum.

Heshtje

— Partizanët lart!

I thanë:

— Shoku Zeqo, kjo pjesë e sarajeve nuk paska bodrum.

Zeqos nuk i pëlqeu që partizanët s'e kuptuan menjëherë qëllimin e tij:

— S'ka rëndësi, — tha ai. — Puna është që ata të zbresin poshtë, ne të ngjitemi lart.

Pas pak beu, qehallarë, shërbëtorë e dado, zbritnin poshtë, partizanët me pushkë, çanta e batanije në krah, ngjiteshin lart.

Zeqos iu duk sikur njerëzit ecnin ngadalë. Briti:

— Yrrja-a-a!

Dhe secili u struk në vendin që i caktuan.

I thanë:

— Vajza e beat nuk dëshiron të zgresë.

Zeqoja ngriti dorën, si të largonte një mizë nga fytyra:

— Çdo gjë u përbys. Që sot e paskëtaj dëshirat e bejlerëve dhe të agallarëve nuk merren parasysh.

Zeqos i dhanë një copë letër të shkruar.

Pyeti:

— Ç'është kjo?

— Lutja e hanëmes së vogël!

— Pse?

— Proteston.

— Çfa-a-arë?

— Kundërshton. Nuk i pëlqen të zgresë poshtë.

Zeqoja e bëri letrën shuk në dorë.

— Lutjet e çifligarëve dhe të borgjezisë nuk pranojnë më. Fund!

Atje tej, krismat e betejës erdhën duke u shuar. E, kur u shua krisma e fundit, nuk vonoi shumë, e tërë brigada — si dhe batalioni ku bënte pjesë skuadra e Zeqos — vërvshuan nëpër rrugët e qytetit, zunë prefekturën, postë-telegrafin e gjithçka tjetër.

Kështu, qyteti u çlirua. Zeqoja mori urdhër t'i mbante njerëzit të arrestuar sa të rregullohej burgu i qytetit, ose të shumtën sa të çlirohej Tirana. Punë ditësh. Punë orësh. Kështu i thanë.

e mjaft të gëzuar. Pastaj shikonte qiellin e nëntorit, që lëshonte shi të imët, dhe drithërima të shpeshëta i përshkonin trupin. Në rrugë njerëzit shkonin e vinin të gëzuar. Setri, i mbyllur në qymezin e pulave, lehte me një të lehur të vajtueshëm, plot mallengjim. Elsës i erdhi keq:

— Alo-o! Alo-o! Mos më harroni Setrin pa bukë!  
Asnjë përgjigje.

— Ai ka zot! Nuk është qen rrugësh!

Nja tre partizanë kishin përveshur mëngët dhe po luanin me një rosë, që notonte në hauzin e shatërvanit. Rosa sulej drejt tyre: g-a-a! Partizanët e zhytتnin në ujë, por ajo, me ta nxjerrë kokën jashtë, lëshohej e gagariste përsëri.

Zeqoja, i rruar dhe i kruar, i veshur këmbë e kokë me kostumin e një koloneli gjerman, me një gjerdan kryq e tërthor mbi gioks, me automatik mbi sup, rrinte te porta e madhe dhe shikonte kalimtarët tërë lakmi e smirë. Ai s'kishte të drejtë të bridhte i lirë nëpër qytet, nëpër atë qytet, për të cilin kishte èndërruar prej kohësh. Tërë jetën e jetës Zeqoja kishte kullotur dhentë e lopët e agait të vet atje larg, majë Poroçanit të Zi, ku dimër e verë bora qëndronte si takije e bardhë. Andej kaluan partizanët, atje ai pu-thi të èmën e Balon dhe tha:

«Do shkoj me partizanët! Dhe shkoi.

Në mes të partizanëve kuptoi qëllimin e luftës, «klasat sunduese» dhe «të shtypurit», mprehu kalemin e mësoi shkronjat e shqipes dhe, kur iu duk se kishte mësuar shumë, i tha komandantit:

— Epo mjafton, o shok i dashur, se do thonë pastaj na u bë Zeqoja i ditur!

Me shokët fliste rrallë, rrallë e për mall. Sa për punën e «zulmit», shokët i thoshin:

— Fjala «berihaj» është e tepërt, duket sikur e merr punën me të tallur.

— Po si të them: zulëm, ore shokëni, zulëm!  
Yrr-ja... Hë pra, a s'të duket se e kërkon vetë goja të thuash edhe «berihaj»?

Dhe mbeti ashtu, siç deshi Zeqoja.

— Alo-o! Alo-o! Se mos më harroni Setrin pa bukë, — u dëgjua sërish zëri i ëmbël i Elsës.

— Jo-o! Jo-o! — u tallën më një gojë tre partizanët dhe, meqë u mërzitën me rosën, zunë të mërreshin me pëllumbat e beut, që të binin mbi supe sapo t'i ndillje.

Zeqoja, me të dëgjuar atë zë të ëmbël, ktheu kokën prapa dhe shtangu në vend. « O zot! — tha me vete dhe përplasi çizmet pas pragut të portës nga inati që kishte zënë zotin në gojë: — O zot, sa çupë e burkur! Shiko, ore qorr, brumin e beut të Elbasanit! — Dhe përsëri përplasi çizmet nga inati, që kishte mburrur burkinë e vajzës së beut.

— Ç'do, moj? — e pyeti, duke hedhur vështrimin gjetkë.

Vajza u tremb nga sjellja e rëndë e partizanit, kapsalliti sytë e zinj e të mëdhenj, ngriti vetullat e holla, maja e të cilave sa nuk çikte kaçurrelat pranë témthave dhe përpëliti buzët e vogla si të foshnjave:

— Zo-o-oti oficer! Mos harro, unë këtu jam në shtëpinë time! — u përkëdhel ajo.

Zeqoja ia ktheu me ton të zbutur:

— Hanëme, këtu jemi në burgun e pushtetit popullor!

— Oi-i-i! — klithi hanëmja e vogël, duke u zmbra-psur e llahtarisor. Por shpejt u duk prapë në dritare.

— Zoti oficer!

Zeqoja hiç.

— Zoti kolonel!

Zeqoja u ngrys!

— Ç'do? — shtiu si top Zeqoja, pa e kthyer kokën nga ajo.

— Dua babanë. Dua të ma sillni këtu. Dua dhe dru për të ndezur stufën.

Zeqoja u ngul si shtyllë para dritares dhe ktheu kokën nga hanëmja.

— Po bukë, a do?

Vajza, që kujtoi se «koloneli i ri» u tregua i gat-

shëm t'i plotësonte dëshirën, jo vetëm për t'u bashkuar me të atin e për ta ngrohur me zjarr, por t'i sillte edhe bukë, i buzëqeshi aq çiltër dhe ëmbël, sa për një çast Zeqo partizani harroi se ku ndodhej.

— Dreq o punë! — tha nëpër dhëmbë dhe i ktheu kurrizin.

Kur qe në mes të oborrit, urdhëroi partizanët:

— Jepini bukë!...

— Kujt?

— Asaj, de! — dhe u tregoi dritaren me dorë.

— Po babanë? — thirri hanëmja.

— Babanë, jo!

— Dru për t'u ngrohur?

— Dru, jo!

5

Pas një ore hanëmja doli në dritare, si gjithmonë, me fustanin kadife bojë trëndafili. Majë kokës i ndriste një krehër i bardhë, i tejdukshëm. Nën rrezet e diellit, që derdheshin mbi tokë nëpër të çarat e rëve, krehri shkëlpente e ndizej flakë. Baluket i harliseshin mbi ballin e bardhë e të lëmuar si mermer, ku fije të shkëputura talleshin me vetullat e saj të ngrysura e të menduara. Fytyra e merakosur, buzët e shtrënguara dhe sytë e picërruar, tregonin se ajo ishte e zhystur në mendime shumë-shumë të trishtueshme. Më në fund, Elsë hanëmja, që s'kishte njojur deri në atë ditë mjerime e halle, që s'kishte ditur ç'është politika e lufta, filloj të kuptonte se atë mëngjes, domethënë katër orë më parë, kishte ndodhur diçka e madhe, diçka e padëgjuar ndonjëherë, që ajo s'e merrte dot as me mend. Dhe vajza u tmerrua. U tmerrua për vetveten, për babanë, për studimet e ndërprera e për gjithçka tjeter që e priste në Romën e bukur.

Padashur, tërë jeta i kaloi para syve dhe pati përshtypjen se po shikonte një ëndërr të gjatë, të keqë e të pambaruar. Herë-herë vinte në vete. Hidhte vështrimin te partizanët që pastronin armët rrith që merit të shatërvanit. Midis hekurave të dritares Elsa shikonte shpatullat e gjera të Zegos dhe diç bluanë me vete, diç i lëvrinte në bebëzat e zeza të syve. «Ja, ai, ai i ka në dorë të gjithë... Atij... Atij!...» — mendonte vajza, duke e vështruar me djallëzi. Instinkti, një instikt i vagëlluar, që kishte lëshuar rrënje prej kohësh në zemrën e saj, instinkti i vajzës së bukur e të pasur, rritur në mes të bollëkut dhe florërit, i thoshtë se nuk i kishte mbetur veçse një rrugë për të shpëtuar veten, të atin, pasurinë... Por, ah!...

6

Pranë portës, bariu i Poroçanit të Zi mendonte: «Pa kur t'i shkoj nënokes në fshat... Asaj i kullojnë systë duke shikuar tatëpjetë shkëmbores. Gjallë jam, gjallë, nënoke! Dhe nuk jam më bariu i djeshëm. Kur të kthehem me leje, do të qëndroj te Guri i Bardhë dhe do të shkund pyll e grykë bashkë: «O-oj nënoke-e! Prit se të e-e-e-rdha, mo-oj!» Ah, nënokja është rënduar ca nga veshët, po Baloja do të më dëgjojë menjëherë.»

«Mor bir! — do të më thotë ajo, — më të lumtë, luftove dhe fitove. Tashti nuk do të ndahemi kurre më.»

«Ah, jo, nënoke! Unë jam ushtar i Partisë! Kur të më thotë Partia: «Zego Bodurri, kthehu në fshat dhe jepu dërrmën Selim e Kapllan beut», atëherë edhe unë do të kthehem. E, në mos më pastë harruar Nazja e Sullos, e mora, si një e një që bëjnë dy, e ta përplasa në kasolle. He-ej, si do të rrojmö paskëtaj, moj nëno-

ke! Klasat sunduese i mblozhëm kokë më kokë me mëngjes herët dhe vetë hipëm lart, në majë të kullës, kurse ata i zbritën poshtë, mu në fund fare. U thamë: «Ejani këtu, se kemi ca hesape të vjetra me ju!» Ata ulën kokën dhe u futën në qilar. Po kur të marr par mendën në dorë! Yrrja! Berihaj! Oha, Kazil, oha, Balo, o Murro qoftë... Nazja...»

— Zeqo! — e solli në vete zëri i një partizani.

— Çdo more?

— Letër nga komandanti i kompanisë.

Në qoftë se *nuk do* të *marrësh urdhër* të *dytë, me* të *aguar, liroj i* të *gjitha gratë, edhe hanëmen e vogël*. *Kujdes beun dhe qehallarët!*

— Jo, more! — u çudit Zeqoja dhe ngriti shpatullat në shenjë pakënaqësie. — Edhe të bijën e beut? E lexoi sérish letrën.

Pastaj, kur pati përforcuar rojat rrëth beut e qehallarëve, nguli sérish vështrimin në qoshën e rrugës. Atij i vinte plasja kur dëgjonte atje përtëj brohoritjet e turmës e të partizanëve, që festonin ditën e parë të çlirimt. Zeqos i pati ndodhur të zbriste në qytet, këtu e dymbëdhjetë vjet, bashkë me nënoken, për t'u vizituar te mjeku. Kjo kishte qenë hera e parë *dhe e fundit*. Dhe tashti *djalit nuk i durohej* sa të fitonte një orë liridalje e të *shikonte me sytë* e vet rrugët e shtëpitë e qytetit, që i kujtoheshin si një ëndërr e shkurtër, por e bukur fort.

«Ja, doli përsëri në dritarë e bija e beut... Moj budallaqe, mua më thërrret ashtu? Edhe më buzëqesh! Qysh, moj hanëme, ç'janë ato isharete? Të vij atje? Mjaft! Bukë të dhashë. Edhe Setrin ta ushqyem. Çfarë do më? — A-a, tashti e teprove. Prit, nesër në mëngjes do të të liroj bashkë me dadot se aq e pate, *nuk je* më klasë sunduese!...»

— Ç'do, moj gocë? — e pyeti Zeqoja *dhe u çudit* me zërin e tij, që i tingëlloi i ëmbël e i butë.

— *Eja pak, zoti oficer.*

*Pfu!* Më bëri oficer!

— Eja!

— Do të të vij, kur të më dojë qejfi! — ia preu shkurt, po në të vërtetë këmbët e djalit u vunë në lëvizje.

Zeqoja çapiti ngadalë, i menduar dhe i mërzitur. Rrotulloi çelësin në bravë dhe u ngul te pragu. Koka e tij vinte baras me derën.

— Ç'do? — e pyeti dhe kafshoi gjuhën me inat, që zëri i kishte dalë përsëri i ëmbël. Sa herë që hynte në dhomën e bukur të hanëmes, me krevat të gjerë, me qilim e plot kolltukë, sytë i visheshin e pothuaj nuk shquante gjë prej gjëje. «Përse vallë?» — pyeste veten Zeqo partizani.

— Hë de, bjeri shkurt. S'kam kohë të merrem me ty.

Elsa heshti e nemitur. Zeqoja e shikoi me ngulm dhe u çudit. Fytyra e njomë e vajzës ishte bërë lulëkuqe, lëkura i dukej aq e hollë dhe e tejdukshme, thuajse do të pëlciste gjaku mbi faqe. Zeqoja eci përparrë dhe padashur qëndroi fare pranë vajzës. Murmuriti me vete: «Dreq o punë!»

Pyeti:

— U sëmure, moj!

Elsa mezi pëshpëriti diçka të pakuptueshme, pastaj nxori nga gjiri një qeskë këdifeje, i zgjidhi grykën dhe futi brenda gishtërinjtë e hollë e të gjatë. Një tringëllimë e ëmbël jehoi në dhomën e heshtur. Vajza nxori një monedhë floriri dhe ia vuri Zeqos në dorë. Zeqoja u zembraps. Vajza u zverdh. Mbi ballë e në gropën e mjekrës i shkëlqyen bula djerse.

— Ç'është ky? — pyeti Zeqoja, pa kuptuar gjë.

— Flori, pesëbashkë! — iu përgjigj Elsa.

Zeqoja s'para e kuptoi fjalën «pesëbashkë».

Elsa, duke kujtar se partizani mbeti i kënaqur, i lëshoi tërë qeskën në dorë. Dhe Zeqoja, si pa të keq, u mbështet në parvazin e drithares dhe mezi nxori një tek flori nga gryka e ngushtë e qeskës. U çudit: sa shush-u-më verdhonte! E afro! te sytë, i mori erë, madje deshi ta kafshonte, por i erdhi turp nga vajza, që rrinte në këmbë para tij, krenare dhe buzagaze.

- Po ky q'është? — pyeti sérish.  
 — Napolon!  
 — A?!  
 — Napolon flori!  
 — Ua-a! — u kujtua Zeqoja më në fund. — Ky qenka napoloni? Kaq i vogël? Për këtë çikë gjel qenkan therur e vrarë agallarët e bejlerët e fshatit tonë? U ngrit Selim agai dhe e lëshoi top çunin e Kapllanit. U ngrit Kapllan beu dhe i ra në lule të ballit çunit të Selimit. Yrrja-a, lal! Për këtë çikë gjel! — Kështu foli Zeqoja dhe ngriti kokën për të parë Elsën, i shastisur që «napoloni» na qenkësh kaq i vogël.

— Liromë, pra, bashkë me babanë! — foli vajza nëpër dhëmbë dhe përsëri po ato isharete të dyshimta prej vajze të bukur e të përkëdhelur.

Zeqoja as i gjallë, as i vdekur. Këmbët e tij të gjata dukeshin sikur ishin ngulur thellë në dysheme. Buzët e trasha i dridheshin si në ethe, rrëmbla të kuq i qëndisnin të bardhën e syve. As cizmet nuk i përplasi, as zërin nuk e ngriti. Vetëm vuri gishtin në tëmth dhe tha:

— Cfarë? — pyeti i hutuar dhe e shtrëngoi qeskën në dorë, si të qe duke shtrënguar një limon.

E me të thënë këto fjalë, pa pritur përgjigje, Zeqo partizani u zmbraps në heshtje. Fytyra e tij dukej tepër e menduar, tepër e hutuar. Vërtitej nëpër oborr dhe diç bluante me vete. Grushtin nuk e hapte. Aty mban te qeskën e florinje.

## 7

Pasdite Zeqoja vendosi rojat në vendet e tyre, kaptoi pragun e portës së madhe dhe u sul drejt pazarit. Nuk mund të priste më. Ai donte të shikonte qytetin, atë qytet, për të cilin kishte ëndërruar vite me radhë.

Por shumica e dyqaneve qenë të mbyllura dhe vetëm kafenetë kishin mbetur të gjitha të hapurë. Pas xhamave të tyre të palarë dukej herë pas here ndonjë fytyrë e tronditur, e parruar dhe e drobitur, që shikonte me kureshtje në rrugë. «Mund të jetë armik!» — mendonte Zeqoja dhe ngadalësonte hapin. Te dera dukej kafexhiu me tavllën plot me filxhanë që nxirrin avull. Trokiste me mashë dhe therriste:

— Në havan, ore-e-e, në havan!

«Budalla! — thoshte Zeqoja me vete. — E kush ka nge sot të pijë kafe?» — dhe capitej më tej.

Ja dhe bakërinxhijtë, të kërrusur mbi kudhër. Zhurma ritmike e çekanëve i 'përkëdhelte veshët Zeqo partizanit. Sigurisht, kjo zhurmë ishte më e vogël se krisma e pushkëve. Fundja, nuk të vriste! Qëndroi. Para tij një goxha kusi. Kusi pér të valuar ujin. E shkreta nënoke! Sa kishte dashur të blinte një kusi të madhe! Të madhe sa kjo që shikonte Zeqoja.

— Sa kushton, usta? — pyeti padashur Zeqoja.

— Treqind lekë.

— E ku t'i gjej unë treqind lekët?

— Ahere mos pyet! — tha ustai me buzën në gaz.

Sakaq dora e Zeqo partizanit rrëmonte në xhepin e thellë të kilotave. Gishtërinjtë i kishin prekur qeskën. «U-u-u!» — u tmerrua Zeqoja. Ai paskesh marrë me vete qeskën e hanëmes së vogël. Qeska kishte njëqind napolona.

— Sa napolona flori kushton kjo kusi? — pyeti kot.

Ustai buzëqeshi sërih:

— Me një flori blen katër kusi si kjo! — iu përgjigj ai.

Zeqoja u kërrus si të kishte një peshë të rëndë në xhep. Domethënë, me atë qeskë të vogël mund të bliheshin katërqind kusi. Një kusi pér derë. Katërqind shtëpi. Sa gjithë Poroçani i Zi. Sa gjithë Shpati. Me një qeskë. Buzëqeshi i pikëlluar dhe u largua. U largua i kërrusur se i rëndonin katërqind kusitë që kishte në xhep.

Te Bezistani Zeqoja mbeti një copë herë i nemitur para dyqanit të madh të Bim Hirrës. E ç'nuk i panë sytë pas xhamave. Shami të kuqe, qëndisur me ar e terti, plot oja e xhufika; kuti me temina, që shkëlqenin si flori (e përsëri iu kujtua qeska e hanëmes së vogël); krejhra e vathë; karfica e jelekë; basma e jorganë mëndafshi; të gjitha, të gjitha sa i shikonin sytë, dukeshin sikur ishin prerë kallëp për Nazen e Sullos, për nusen e tij. E c'të blinte më parë Zeqo partizani! Përplasi këmbën pas trotuarit dhe u largua tërë inat. Një copë herë u end rrugëve, i shastisur pas gjithë asaj lëvizjeje të madhe nëpër qytet. Njerëz, njerëz dhe... njerëz pa hesap. Karrocat shkonin lart e poshtë. Disa të ngarkuara. Të tjera bosh. Edhe kuaj. Edhe gomarë të ngarkuar me batanije. — «U-a-a! Ç'do t'i bëjnë tërë këto batanije?» Dru për të djegur. Lakra për të ngrënë. Presh! Bukë. Bukë të mëdha, sa një tepsi, bukë gruri! «U-a-a!» — çuditej Zeqoja hap pas hapi.

Diku thërrisin:

— Mos u afroni. Depoja është e minuar!

Dhe Zeqoja nuk u afrua: nuk i pëlgente të vritej ditën e parë të çlirimit.

Tek po kthehej në shtëpinë e beut, rrugës i zuri syri një gjë, që e çuditit fort. Një plug prej hekuri me thikë të mprehtë, që ndriste e të merrte sytë. Me një tek rrotë të vogël, me bishtin si lastar, që ta kishte énda t'a mbaje në dorë. Këtia parmenta e drurit! Ku plugu i hekurt! Për këtë plug Zeqoja kishte dëgjuar komisarin t'u liste shpesh: «Do të vijë një kohë që parmandën e drurit do ta zhdukim me gjithsej. Fushën do ta punojmë me makina. Malësinë me plugje hekuri.» Dhe Zeqoja mbylli sytë. Endërrroi. Çfarë thua ti: dy nga qetë e Kapllan beut, që tërheqin plugun tërë shkumë e madhështi, ndërsa Zeqoja me hosten në dorë, me peshqir mbi kokë për t'u mbrojtur nga dielli, shtrëngon dorezën e bukur dhe shkel pas rrotës së vogël që vërtifitet e... vërti-i-itet pa pushim. Dhe, kur ai po thërriste me vete: «Oho, Kazil!» dëgjoi

aty pranë një zë të huaj, që jehoi i largët, si nga fundi i botës, por i qartë:

— Blije, shoku partizan!

Hapi sytë. Para tij qëndronte tregtari. Një thatim, me një kokë të vogël fare tullë e me dy sy që i regëtinin si flakë kashte.

— Është mall i rrallë. Në të gjithë Shqipërinë i gjen a s'i gjen pesë plugje, si ky. E solli Pasha nga Italia këtu e tre vjet më parë. Po të kesh, blije, se do të bëhesh pishman... Prej nga je?... Tamam...

— E shet?

— E shes, pra.

— Sa? — pyeti kot, si gjithmonë, Zeqoja.

— Sa? — Tregtari bëri një hap përpara dhe u ngrit në majë të këmbëve për t'i folur Zeqos në vesh. — E shes vetëm me flori. Ke?... Ju partizanët s'jeni pa florinj.

Heshtje.

— Sot tregtia bëhet vetëm në flori. Nuk e dimë si do të shkojnë punët!... Pse mendohesh? Katër napolona s'janë gjë hiç. Malli është i mirë! Katër. Vetëm katër napolona flori.

Zeqoja u shkund, si të kishte ardhur në vete. Katër napolona flori! Domethënë në qeskën e vogël të hanëmes ai kishte njëzet e pesë plugje, të hekurta! Sipas Zeqos, me njëzet e pesë plugje si ky, që shtrihej tërë madhështi në trotuar, mund të lërohej tërë Shqipëria!

— Katër napolona flori! — pëshpëriti zëri i huaj.

Zeqoja u zembraps dhe briti pa të keq:

— S'ke zë zotrote, që flet kaq ngadalë?

Tregtari vuri gishtin në buzë. Ç'deshi të thoshte me atë gisht bashkëfolësi? Zeqoja nuk e kuptoi.

— Fol, more! — i briti.

Tregtari u ngërdhesh:

— Floriri është i ndaluar, bir!

— I ndaluar! — u çudit Zeqoja dhe qeshi. Ai qeshi tërë inat dhe tërë inat u largua:

Kur arriti te porta e madhe e beut, Zeqoja që-

ndroi, u kthye prapë dhe, pa e vënë re as vetë, këm-bët e çuan përsëri para dyqanit, para plugut të hekurt. I erdhi rrëth e rrëtull, e mali me sy, i preku thikën e mprehtë, i përkëdheli dorezën dhe u nguros përsëri në këmbë, me sy të picërruar dhe ëndërrimtar... Dhe s'di-het sa do të qëndronte ashtu, po të mos kishte parë që përtej xhamave tullën e vogël të tregtarit me fytyrën thatime, tek i buzëqeshte e lumtur e plot dinakëri.

«S'je më klasë sunduese, jo!» — foli Zeqoja me vete dhe i ktheu kurrizin tërë neveri.

\* \* \*

Ja se g'ndodhi ndaj të ngrysur në oborrin e shtë-pisë së beut:

— A doni të shikoni napolona? — thirri një partizan.

— Ehu! Sa kam parë unë, aq të mira qofshin!  
— tha njëri syresh dhe u largua.

Por dy të tjerët rrëmbyen qeskën nga duart e partizanit dhe e kthyen kokëposhtë. Florinjtë tringëllinë në pëllëmbët e dy partizanëve. Në hapësirën ngjyrë hiri të nëntorit, ata verdhonin e regëtinin.

— Florinjtë që kam parë unë ishin më të vegjël!  
— foli njëri.

— Jo, more! Njësoj janë këta dreqër. Një fabrikë i ka prerë. Fabrika e borgjezisë!

— Or po kështu të them unë, ka edhe më të vegjël!

— Ej!

Disa pëllumbë u ngriten nga buza e çatisë dhe fër-fëllinë mbi kokën e partizanëve. Rosat gagaritën duke llapashitur ujin e shatërvanit. Setri lehu, me të lehur-rën e tij plot vajtim. Partizanë të tjerë erdhën nga porta e nga rruga.

Atje tej Elsë hanëmja ishte aq e nemitur, aq e pikëlluar, thuajse nuk i kishte mbetur gjak në fytyrë.

Çapëlente sytë nëpër oborr dhe shikonte partizanët e napolonat tek vërtiteshin nëpër ato duar të ashpra e të shkujdesura.

— Duhet t'ia dorëzojmë pushtetit popullor! — tha njëri.

— Mirë thotë! Mos ia ktheni më hanëmës!

— Mendje! Ik, ore, me gjithë florintjtë e bajlerëve! Pushteti ynë do të bëjë kallëpë të tjerë e do të nxjerrë floririn e vet. Ja, do ta shikoni.

Një partizan me kasketë mbi sy e me një zinxhir të gjatë pas rripit të kilotave, majë të cilit tundej një goxha biçak, i dha fund bisedës me zërin e tij të pakenaqur.

— Shokë partizanë! Ç'bëni kështu? Unë sapo e fshiva oborrin, kurse ju më sollët tërë baltovinat e rrugës!

Zeqos, si më i madhi, skuadërkomandanti, i përkiste ta merrte fajin mbi vete. Kroi zverkun dhe tha:

— Ke të drejtë, ta bëmë pis!

Dhe, duke u kthyer nga partizanët, urdhëroi t'i futnin napolonat në qeskë.

Pas pak Zeqoja e tundi qeskën në dorë dhe, gjithë i menduar e i ngrysur, u nis drejt Elsës, që mezi mbahej në këmbë te parvazi i drıtares.

— Merri, moj shoqe, napolonat me gjithë gjel. Mbaji edhe ca kohë në qafë. Se mos të mbushet mendja t'i prishësh! Në këtë qeskë ka njëzet e pesë plugje hekuri. Njëzet e pesë! Kur të ngremë zyrat, kur të shkruajmë ligjet e të gdhendim vulat tona, atëherë ti do të na i dorëzosh, kurse ne do të të lëshojmë një dëftesë.

Elsa, që e ndjeu përsëri veten të vëtmuar, qau një copë herë me lot e me zë. Ajo s'para i kuptoi fjalët që i tha Zeqo partizani, por kuptoi edhe një herë se atë mëngjes në Shqipëri kishte ndodhur diçka e madhe, një përblysje e plotë, që ajo ende s'ishte në gjendje ta merrte me 'mend.

# Anastas Kondo

## TE PAPRITURAT E QIELLIT

Kur isha fëmijë, aeroplanët i urreja shumë. Me siguri, kjo m'u fut në gjak qysh me bombardimet dhe mitralimet e Luftës Italo-Greke, kur matej italiani me grekun e shqiptari kishte kusur të vritej në vend të vet nga ushtritë e botës... Pastaj qenë alarmet e jrore të Tiranës, kur në lagjen tonë shtepitë me bodrum, për t'u mbrojtur nga bombardimet, mungonin. Ishte lagje përdhese. Sirenat ulerinin si të çmendura, dhe ne vraponim të tromaksur, si fëmijë që ishim, midis alarmeve ajrore dhe thirrjeve të nënave tona. Vraponim për të arritur sa më parë të vetmin strehim, që ishte tutje, larg nesh, andej nga kisha katolike. Ai ishte i vogël dhe nuk i nxinte gjithë njerëzit e lagjes sonë të varfër. Me qindra njerëz mbeteshin ja-shtë... Dhe atëherë kam parë se si njerëzit e mirë të lagjes sonë u vranë nga bombat e u kositën nga plumbat, dhe qysh atëherë, ende i mitur, i kam urryer armikun dhe aeroplanët e tij.

Një vit më vonë m'u vra babai. Edhe atë e mitraluan aeroplanët. Dhe kështu përfundimisht u rrënjos në ndërgjegjen time prej fëmije urrejtja e madhe për aeroplanët. Sa herë sjell ndërmend fëmijërinë, kujtoj edhe mërinë time për aeroplanët armiq, por edhe një dëshirë të madhe që kisha: «Si s'kanë partizanët një aeroplan», 'mendoja asokohe.

Po ieta është shumë më e madhe nga ç'e mendoi-më shvesh. Një ditë lufta mbaroi. Fituan ne. Dhe erdhi koha aë jo vetëm t'i shoh aeroplanët tanë tek fluturoinë qillit të Shqipërisë, por dhe të fluturoi vettë me ta, madie edhe të shërbej në Forcat Airore shqiptare (në stërvitjen ushtarake)...

Dëshira për të shkruar diçka për aviatorët më lindi kur nioha komandantin e tvre, Fahriun, mie-shtrin e airif, nië noa njerëzit më të kënduar aë kam niohur, i cili, megjithëse «banor» i aiellit, i nich ad mirë hallet dhe nevoiat e tokës. Apo ndoshta kur nioha Seon dhe Bardhylin, Kushedi si më lindi kjo dëshirë... Mbase qysh atëherë fëmijië, kur doia aë partizanët të kishin aeroplanë e ta bënin fërtele gjermanin aë më vrou babanë! Kushedi...

Nuk po e mundoj më veten duke kërkuar shkakun dhe castin që më shtynë të shkruai këtë aë dua të tre-goj. Dhe, pa dyshim, nuk qenë shkaktarë për këtë as veterani i Luftës, Samiu, dhe as komisari i ri, djaloshi Hazbi Serani,<sup>1)</sup> që më takuan atë ditë të ftohtë marsi dhe m'u lutën të dëgjoja për një rast të rrallë në praktikën e fluturimeve tonë, për një ndodhi të shokut të tyre... Jo, kurrsesi nuk qenë ata shkaktarë. Ata vec bënë të mbushet kupa e mbresave dhe e kujtimeve të mia e të derdhen në letër.

---

1) Më vonë vdiq në krye të detyrës.

Komisari i vjetër, Samiu, dhe komisari i ri, Hazbiu, më takuan një ditë rrugës dhe më thanë se në aerodrom kishte ndodhur diçka e rrallë. Aviatori Harilla, shok i tyre, kishte ulur në kushte shumë të vështira, pothuajse të jashtëzakonshme, aeroplanin e rënëdë reaktiv. Se ç'ishin këto kushte të vështira dhe si kishte ndodhur, ata më thanë se do të ishte mirë ta bisedonim pasdite, në mënyrë që të bëhej një shkrim i tillë e që rasti i rrallë i Harillës t'u viente edhe shokëve të tjerë. Nga ato pak fjalë që më thanë, nuk kuptova ndonjë gjë që të më trondiste ose të më habiste. Megjithatë, meqenëse ata premtion se do të mësoja diçka interesante, u dhashë fjalën të takoheshim të nesërmen.

— Do të jetë më mirë të vijë me ju edhe ai shoku që uli aeroplanin, që të na ndihmojë të sqarojmë më mirë se ç'ndodhi me të, — shtova unë tek po ndahehim.

— Mirë do të jetë, — tha Hazbiu, — por ç'e do se është zor t'i mbushet mendja. E njoh mirë Harillën unë. Ka frikë se mos e bëjmë Mizën buall.

Për një çast dyshova se mos vërtet këta do të më bënin Mizën buall, por shpejt u kujtova që njerëzit e mirë rrallë flasin për të mirat e veta, që zakonisht trimat nuk i tregojnë plagët e veta.

Të nesërmen, tek përpinqesha të rregulloja rrrotat e aeroplanit-lodër prej llamarine të djalit tim motak, erdhë Hazbiu dhe një djalë tjetër, i gjatë, sa s'kishte nevojë të ngrinte kokën e të shihte se ç'kishte mbi bufenë tonë.

Ata u ulën dhe gruaja bëri adetet e vendit: nxori kafen e bluar taze, llokumet dhe pijet qytetare, likerin kurse ne po përpinqeshim t'i dilnim bisedës në vâ të cekët. Sa për të ngarë muhabetin më shtruar, i thashë gruas të shkonte me traditën dhe t'u shtronte aviatorëve rakinë, qepën dhe ullinjtë, që m'i kishin dërr

guar nga fshati. E dija që edhe ata nuk do të ishin kundër rakisë.

Detyrën për të më treguar se ç'kishte ndodhur në aerodromin e tyre, e kishte marrë përsipër Hazbiu. Dhe ja ç'tregoi ai:

— Dhjetë marsi ishte ditë që plotësonte kushtet për fluturim të vështirë. Puna është që të tilla kushte neve na vlejnë, se përgatitemi për të qenë në gjendje të luftojmë në çdo kohë e në çdo rrëthanë. Dhjetë marsi ishte ditë e shkëlqyer për stërvitje të fortë. Ishte ditë me re dhe deri në fluturimin e katërt të Harillës nuk kishte shkarkime elektrike.

Harilla fluturoi tri herë dhe çdo gjë shkoi mirë fare. Herën e katërt, kur po kthehej, ndodhi diçka që ngjet rrallë te ne: u pre për disa minuta energjia elektrike në aerodrom. Pra, as prurësi, as pelengatori nuk jepnin sinjal fare.

Hazbiu e ndien që unë nuk e kuptoj se ç'është pelengatori, megjithëse e bëj stërvitjen atje, dhe sqaroi se pelengatori qenka aparatura jashtë aerodromit, që shërben për orientimin e pilotit nga toka. Pastaj vazhdoi:

— Pelengatori nuk jepte sinjal. Retë ishin të dendura e të errëta. Harrilla nuk shihte dot asgjë nga fanari i kabinës. Terr. Natë fare. Kur e uli aeroplanin fare poshtë, atëherë mundi të shihte diçka. Fluturonte vetëm njëqind metra lart dhe përpara nuk dallonte asgjë. Tani shihte nën vete lumin, fshatrat, rrugët, gjithçka që parakalonte me shpejtësi reaktive në aeroplan, por aerodromin nuk e dallonte dot. Aerodromi ishte ende përpara dhe nuk dukej, si puna e...

— Si kuajt që s'shohin dot as majtas, as djathtas, — ndërhyra unë.

— Përkundrazi jo si kuajt. Se ata shohin përpara, kurse Harrilla pikërisht përpara, nga duhej të shihte që të dinte ku është aerodromi, nuk dallonte dot asgjë. Binte shi me shtamba. Dhe moti sa vinte e pri-shej. Kurse ne nuk kishim energji elektrike. Mbetëm pa energji, tamam atëherë kur po kthehej Harrilla. Dhe

aparatet tona sinjalizuese nuk punonin. Natyrisht, ne dhamë komandën dhe ushtarët e fushës filluan të vinin në përdorim shpejt, rrufe fare, aggregatet rezervë, që i përdorim për raste avarie si ky. Por aeroplani fluturonte me 900 kilometra në orë dhe ishte vetëm pesë-gjashtë kilometra larg fushës. U krijuar një situatë tepër e vështirë për pilotin. E kishte pisk, sa s'ka ku të vejë. Rrezikun e vdekjes e mbante në bark vetë aeroplani...

... Unë shoh se ç'përshtypje i bëjnë fjalët e Hazbiut atij tjetrit, që është vetë piloti me «vdekjen në barkun e aeroplanit». Më duket se ai çuditet sa dramatike e bën ngjarjen shoku i vet, komisar Hazbiu. Mua më duket kështu, po Harilla ndoshta mund të jetë i hutuar edhe nga vetë ngjarja e tij, rrezikun e së cilës, vetëm tani, nëpër gojën e tjeterit, mund ta marrë tërësisht me mend. Ndodh dhe kështu me njeriun... Kurse Hazbiu vazhdon:

— Kemi atë kontradiktën e thellë të ajrit në mot të keq: midis shikimit të dobët dhe shpejtësisë së madhe. Ai nuk kishte kohë të bënte gjë, të bënte ndonjë çudi manovrimi. Le që nuk shihte gjë fare.

— Tersi më i madh ishte që ato çaste nuk më punitonte as radiokomasti. Ishte çorientuar nga ndikimi i reve. S'punonte as në marrje as në dhënie. Nuk më jepte asnjë sinjal të radiostacionit tonë, — tha Harilla.

— Ç'bëre ti kur e pe veten kaq ngushtë? — pyeta unë.

— Si gjithë shokët. U përpoqa të orientohesha me shikimin vertikal. E ula aeroplanin poshtë sa hante, ndonja njëqind metra mbi tokë, siç tha Hazbiu, dhe u përpoqa të gjeja pikat e njohura të orientimit: lumin, bërrylin e madh të tij, urën, qytetin, me një fjalë, pikat e asaj pak mundësie kapjeje që kisha nën vete.

— C'janë këto kapje? — pyeta unë.

— Kështu u themi ne, aviatorët, disa pikave kyçë të terrenit, që na orientojnë në fluturim, por që nuk japidin sinjale, — shpjegoi Hazbiu.

— Dhe, kur kalova në atë pjesën ku unë mendoja

se do të ulesha mbi aerodrom, vura re se pistën e kisha lënë në krahun e djathtë. Unë fluturoja përbri saj, pa pasur mundësi të ulesha. Aty e pata pisk, — thotë me turp Harilla.

— Dhe pikërisht këtu u tregua burrë i zoti Harilla, shumë i shkathët dhe tamam gjakftohtë. Dikush tjetër, në vend të tij, edhe mund ta humbiste toruan. Me atë shpejtësi që kishte dhe me drejtimin që kishte marrë, aeroplani mund të përplasej diku në kodrat pranë e, mbase, edhe në malin përballë. Këtu e tregoi mjeshterinë Harilla, — përsërit i kënaqur Hazbiu, sikur kjo t'i kishte ndodhur atij vetë dhe jo shokut. Ai është nga ata njerëz që gëzohen nga gëzimet dhe hidhërohen nga gabimet e shokëve.

— Çfarë bëri atëherë Harilla? U hodh me katapultë? — pyeta unë, duke kujtar një shokun tim të fëmijërisë, që u hodh një herë me katapultë, por nuk u bë më aviator, paçka se ai ishte i pari në Republikë që u hodh me katapultë.

— Jo, — qeshi Hazbiu. — Jo. Harilla nuk e la aeroplanin dhe as me katapultë nuk u hodh! Ai bëri një kthesë të jashtëzakonshme, tmerrësisht të vështirë; bëri një rreth të ngushtë fare, një rreth energjik mbi pistë, vetëm njëqind metra mbi kokat tona dhe e detyroi avionin e rëndë, nëntëtonësh, që të merrte drejtimin e pistës si kalë i urtë. Këtu po, këtu ai tregoi aftësi të madhe fluturimi dhe përgatitje të lartë ideo-politike, natyrisht, edhe gjakftohtësi.

Këtë fjalë, «gjakftohtësi», ai e shqiptoi gati si me zili dhe mua më futi në mendim: «Thua, Hazbiu të mos ishte gjakftohtë?» Kurse ai dukej aq i qetë...

— Dhe, kur e pamë aeroplanin në pistë, u çliruam nga një ankth i madh, — vazhdoi Hazbiu tregimin për Harillën. — Se të thashë, që vetëm disa çaste më parë ne e pamë të fluturonte përbri saj dhe na tronditi drejtimi që kishte marrë: ku do të shkonte kështu, ku do të përfundonte vallë? Ne e kishim ndjekur gjithë këtë pjesë të vogël fluturimi (kur e dallonim nën retë) me nerva të tendosura dhe prisnim si do të dilte nga

kjo situatë e vështirë, si do të zbriste në pistë. Ato çastë shumëkujt nga ne i vajti mendja, si dhe juve tani, te katapulta. Dukej sikur nuk kishte shteg tjetër.

— Kur ngrita fanarin, një nga ushtarët më puthi. Me sa duket, që shpëtova gjallë. Mua më erdhi për të qeshur, se e kuptova që do të ishte ushtar i ri, i pamësuar me të papriturat tonë, — tha Harilla.

— Jo. Ushtari mbasë kishte të drejtë, se kaq të papritura gjatë një fluturimi nuk para ndodhin shpesh, — tha Hazbiu.

... Ne vazhdonim bisedën. Unë mora vesh që Harilla është komunist, bir punëtori, njëzet e nëntë vjeç dhe ka tetë vjet aviator. Vajza ime, që nuk shkon ende në shkollë, e pyeti:

— Xhaxhi, po kur ishte i vogël, ke dashur të bë-hesh pilot? Apo i prishje aeroplanët si Adi?

(Adi është djali im i vogël, që nuk rri dot pa i prishur lodrat.)

— Kam dashur, — tha Harilla seriozisht. — Po për t'i prishur, nuk i kam prishur. Së nuk kisha.

— Po tani që i ke, a i prish? — pyeti rishtas ajo.

— Rri, moj budallaqe, — i thotë e ëma, — ç'pyet ashtu! Ndaj po bisedon sot babi me të, se xhaxhi i ruan aeroplanët si sytë e ballit.

— Vërtet?! — u çudit vajza, që gjithë kohën e bisedës ishte marrë me vëllanë e saj.

— Ashtu! — tha Hazbiu.

Pata frikë se mos vajza pyeste se ç'do të thotë: «I ruan si sytë e ballit». «Sytë nuk i ruan njeri», më kishte thënë ajo njëherë. Pa vajza nuk pyeti më.

Unë pashë orën. Atë mbrëmje në orën shtatë kisha leksion. Ora ishte nëntë. Studentët e filialit të natës mbeten pa e dëgjuar leksionin për lindjen e njeriut në tokë, për llojin e homosapiensit, qenies së mençur. Dhe mua për një çast më erdhi keq që nuk e bëra dot leksionin. Por, kur kujtova që mund të shkruaja për Harillën dhe Hazbi Seranin, që e tregon aktin heroik të shokut si të vëllait të vet, për këta njerëz me zemër të artë, të zotë të punës dhe të men-

çur shumë, që vënë në zap shpejtësinë reaktive dhe makinat e rënda fluturuese, i thashë vetes se vërtet kisha humbur një leksion, por po bëja diçka që gjithashtu u vlenë shumë studentëve. Ky shkrim për njerëzit e gjallë, të sotshëm, të Republikës sonë, patjetër që e vlen një leksion të humbur. Le ta lexojnë këtë histori për «homosapiensin» shqiptar dhe le të më falin që nuk u vajta dot në leksion atë mbrëmje...

1982

# Betim Muço

## KAPERCIMI I MADH

Partizani Xhelo Merdani kishte ditë që ndiente një si angushti të madhe në zemër. Neteve thua jse nuk fliste fare dhe, edhe kur e zinte gjumi, shih te copëra ëndrrash sikur plagosej, vritej, ndiqej, zihej rob. Kishte kohë që batalioni s'kishte rënë në përpjekje. Flitej se gjermanët po përgatitnin një operacion të madh. Në kompani kishin ardhur shokë nga komanda e brigadës dhe u kishin folur partizanëve për situatën, ku është armiku, ç'forca grumbullon, ç'bën reaksiuni etj. Partizani Xhelo Merdani kishte katër muaj e gjysmë në mal. Ai kishte qenë pjesëmarrës aktiv i Lëvizjes në qytet dhe në celulë. Meqenëse ishte i shkolluar, u komenton shokëve ngjarje e situata, u tregonte lajmet e jashtme që dëgjonte italisht në stacionet e huaja. Ai kishte shpërndarë trakte e kishte propaganduar idetë e Lëvizjes në popull, po kurre s'i kishte rastisur të merre pjesë në aksione me armë. Dhe ja, puna e deshi që të dilte partizan.

Shqetësimi që e kishte pushtuar nuk ishte i bëfasishëm. Ky shqetësim po e shoqëronte që nga dita e parë që ndodhej aty. Partizani Xhelo Merdani kishte frikë. Kjo ishte e gjitha. Por ai kishte dhjetë herë më tepër frikë t'ia pranonte vetes këtë gjë. Askush në kompani nuk mund të thoshte që ai, Xhelo Merdani, ishte frikacak. E megjithatë, frika ishte, e fshehur diku thellë shpirtit, por ishte e gjallë dhe tmerruese. Vetëm ai e dinte atë ndjenjë të dridhshme, që ngulte kthethrat në krejt qenien e tij, apo fillonte bëteja. Me gjermanin s'ishte e lehtë të luftoje e ta shkulje nga pozicioni. Veshët të shungullonin nga gjëmimet dhe krismat krijonin një zinxhir të paprerë, sikur një teh i mprehtë brisku të griste me dhembje timpanet. Përreth bëhej luftë. Nga çasti në çast mund të të kafshente një nga ato grerat e nashka të saj me emrin njerokësh ~~plumb~~. Ai mund të vinte nga edo anë, ~~nga edo armi~~ armiku, mund t'ë zinte në kokë, në gjoks, në bark, mund të të mberthente ijeve, brinjeve, të të thyente kockat, kafkën, të të shperthente muskujt e të të zhaviste enët e gjakut. Njeriut i shuhej motori i jetës dhe binte i këputur. Kjo ishte vdekja. Atij i vinin në kokë të gjitha këto sa herë që batalioni nisej në luftë.

Partizanin Xhelo Merdani nuk e kishin nxjerrë me zor partizan. Madje këmbëngulja e tij kishte qenë e madhe deri atë ditë që Qarkori vendosi, dhe njëkohësisht plotësoi edhe dëshirën e tij, që ai të shkonte në mal. Atëherë ç'qe kjo? Shpeshherë pyeste veten: «Ç'është frika? Pse njeriu ka frikë? A kanë të gjithë njerëzit, në të gjitha rastet, frikë nga vdekja?» Duke menduar këto, ndodhë që ai hynte thellë e ngatërhohej në lloj-lloj fragmente teorish psikologjike që ai i kishte lexuar lart e poshtë nëpër shtypin e kohës. Ndonjëherë mendonte se të gjithë njerëzit kanë frikë nga vdekja, po të gjithë e fshehin këtë gjë. Mirëpo ky mendim s'i qëndronte, kur shihte Ali Mytarin, Fahredin Lokën e ndonjë tjetër, që mes flakës së betejës vërtiteshin si të tërbuar, a thua se shko-

nin jo mes plumbash por mes një shiu që freskonte tērbimin dhe dufin e tyre të brendshëm. Kur ishte ende në shkollë, ai kishte lexuar teorinë e profesorit Franc Konig, i cili thoshte se njeriu është një kafshë me arsyen. Veç arsyes, thoshte ai, njeriu në asgjë tjetër nuk ndryshon nga kafsha, ai ndodhet i rrethuar nga instinktet e veta, kërkon të ushqehet, vret që të mos e vrashin dhe rigjeneron fisin vetëm pse ky rigjenerim i plotëson një kënaqësi fizike. Frika lind bashkë me të dhe, ashtu si qdo instinkt tjetër, njeriu nuk është në gjendje ta mposhtë: frika dhe të tjera instinkte bëjnë jetën e tij. Xhelo Merdani e kishte diskutuar me shokët në qytet këtë teori 'dhe bashkë me ta kishte qenë i bindur se ajo është antishkencore, anti-humanitare e reaksionare. Atij tani i erdhia turp kur mendoi se, i humbur mes arsyetimeve të tij të brendshme, qëllonte që gjente strehim pikërisht nëpër fragmente të kësaj teorie.

E gjithë kjo ishte një peshë e rëndë, që ai mezi e mbante. Fakti që këtë ndjenjë i duhej ta mbante fshehur nga shokët, skuadra, kompania, madje fshehur edhe nga vetja (sa e çuditshme i tingëllonte kjo: fshehur nga vetja), ia bënte këtë vuajtje shumë herë më të rëndë. Ndryshe do të ishte puna sikur ai ta shprehte: «O shokë, më falni, por unë kam 'frikë, kam frikë, ju lutem më ndihmoni!» Ndoshata atëherë do ta kishte më të lehtë. Vërtet më të lehtë?! Po pse, a duroheshin përbuzja ndaj frikacakut, talljet, mosbesimi, shikimet e vëngra? Jeta partizane, më pak se të gjitha, friken duronte. Jo, edhe ashtu nuk do të ishte më e lehtë. Po prapë partizanit Xhelo Merdani ndiente një shtypje të tillë brenda kraharorit, saqë i dukej sikur s'do të duronte dot më, ashtu siç nuk duron dot një tra i drunjë mbingarkesën pér një kohë të gjatë por «lodhët», lodhet dhe vjen çasti që thyhet. Mos vallë do ta kishte Xhelo Merdani atë çast? Më shumë ishte ligur e tretur nga kjo ndjenjë, sesa nga mundimi ejeta e malit.

I dukej se i vetmi që ia dinte ankthin e tij ishte

zëvendëskomandanti i kompanisë. Ai sikur e shihte në një mënyrë të veçantë, me një lloj buzëqeshjeje që atij i dukej sikur Asimi e shfaqte vetëm për ta mëshiruar atë, Xhelo Merdanin. Kur u ndesheshin sytë, Xhelo Merdani i shkëpuste ata menjëherë, sikur sytë e zëvendëskomandant Asimit të ishin dy copa çeliku inkandeshente. Kurse komisari, gjithmonë në mbledhje e analiza betejash në kompani, vlerësonte kujdesin dhe gjakftohtësinë e tij, të Xhelo Merdanit në luftë, «sepse Partia na do të gjallë, — thoshte ai, — që të vrasim e të mos vritemi». Por ajo gjakftohtësi që kishte ai në betejë, nuk ishte normale, ajo ishte gjakftohtësia e një njeriu mendjehumbur, të paralizuar nga frika, që e ruan më shumë se ç'duhet veten. Dhe kaq herë, partizani Xhelo Merdani e kishte përbajtjur me zor veten që të mos shpërthente gulçin e mundimshëm dhe aty, tek ishin të gjithë, të thërriste: «Shoku komisar! Shokë! Nuk meritoj asnjë lavdërim. Unë, Xhelo Merdani, jam një frikacak... Ja kjo është!»

Batalioni që mbronte rrugën e Përmetit nga ana e Leskovikut, pas dy betejash të shkurtra, mori urdhër të lëvizte në drejtim të Qafës së Bimilit. Kongresi i kishte përfunduar punimet dhe te të gjithë partizanët mbretëronte një gjësim i madh. Një frymë e re, e veçantë lëvizte tani pas Kongresit në batalion. Këtë frymë e shprehnin urdhërat e udhëzimet nga brigada, sjelljet e shokëve të shtabit, fjalët në popull.

Kishte ditë që kishte filluar Operacioni i Qershoret. Ushtarët e fanterisë gjermane, me pantallona të shkurtra e automatikët krahaqafë, dukeshin nga larg si gjarpërinj të gjelbër, që zvarriten me shpejtësi. Reaksiuni i atyre zonave mori gjallëri. Venin e vinin njerëz të ikur nga fshatrat që digjte gjermani. Xhelo Mer-

danit iu afrua një plakë me dy fëmijë të vegjël që s'ia lëshonin kindat e leshtë të fustanit. Plaka zgjati dorën dhe preku faqen e tij.

«Trimi i nënës, — tha plaka, — sa më ngjan me tim bir, o të keqen! Na dogji gjermani, të keqen nëna, na dogji e na shkretoi, i mallkuari. Plakun me të vëllanë e tij m'i muarr. Kur u vunë flakën shtëpive, plasën xhephanetë që kish fshehur plaku kur iku greku e që ruante për djemtë e maleve. Ata po, u xhindosën dhe e hoqën osh, të ziun plak. Thonë që i shpien në Korçë, ku di unë e zeza. Këta i kam të djalit, janë trembur zogjtë e nënës.» Xhelol Merdani shkoi dorën mbi kokat e fëmijëve. Në fytyrat e tyre të pluhurosura nga udha dukeshin gjurmët e lotëve.

«Mos u mërzit, moj nënë!» — tha ai sikur t'i fliste yetes.

«Jo, të keqen! Ju ka ju nëna, trimat e nënës!» Plaka përsëri preku me gishtérinjtë që i dridheshin faqet dhe qafën e tij. Xhelol Merdanit i dhembti shpirti. «A mendohet vdekja kur sheh këtë pamje, — tha ai. — Prej çfarë lloj materieje je bërë ti, Xhelol Merdani, që paska gjetur tokë të mirë te ti gjembi i frikës?!» Plaka futi dorën në torbë dhe i zgjati një copë kulaç. Kulaçi u end disa herë nëpër duart e të dyve.

«Jo, — tha plaka, — merre, të keqen, ka tjetër nëna, merre, se jeni për udhë e për luftë.» Pas pak partizani rendi pas kompanisë ashtu i hutuar e i vraprë në shpirt.

Befas kompania u gjend e rrethuar. Ajo ra në përpjekje në tri anë dhe u zmbraps në thellësi të luginës. Gjermanët, të ndihmuar nga kallauzë të reaktionit, zunë grykën e lumit. Lufta vazhdoi gjithë ditën.

Natën, komanda e kompanisë dhe komunistët bënë mbledhje dhe vendosën të sulmonin nga verilindja, pa-si në atë drejtim duhej të ndodhej dhe pjesa tjetër e batalionit. Përleshja zgjati rrëth një orë. Kompania nuk çau dot. Në përleshje, nga partizanët u plagosën Ali Myftari dhe Ollga, një nga çupat e kompanisë. Ashtu nëpër natë, kompania rrëshqiti në pyll gjer rrë-zë Nemërçkës. Partizanët u futën nëpër shpella. U gdhi. Gjermanët filluan të hidhnin mortaja më kot në-për pyll. Tymi ngrihej gjer lart përmbi ahet. Degë të rënda thyheshin me zhurmë. Komandanti i kompanisë shtrëngonte nofullën me dorë. Komisari rrinte pranë Ollgës, që ishte në kllapi. Ajo kërkonte ujë, kërkonte nënën, pastaj përsëri ujë. Në heshtje e gjithë kompania kërkonte ujë. Shkëmbi i shpellës ishte i thatë e i zhuritur. Partizanin Xhelo Merdani e thirrën te komandanti.

«Do shkoni la, — tha ai, — ti, Xhelo, me Hasanë, ngjituni la, kërkoni skërkat, kanë dëborë skërkat. Ti, Isuf, jepu thasë. Mbushini thasët me dëborë. Muarrtë vesh? Me kujdes! Mos u vrini, se vritet e gjithë kompania. Muarrtë vesh? Hajde, oburra!» — Komisari u buzëqeshi.

«Sa më shpejt, shokë!» — tha ai dhe ngriti grush-tin. Ata u nisën të dy. Lart, përmbi shpellat, krisën sharset. Ciflat e gurëve kërcenin përpjetë, sikur i gërryente dikush me dhëmbë. «Tani mori fund», — tha Xhelo Merdani. Hasani shkiste përpara si kunadhe. «Kush mori fund, ti, frikacak? Ec përpara dhe hiqe mendjen andej.» Partizani Xhelo Merdani grindej më veten. U deshën tri orë të ngjiteshin lart. U gjakosën në pëllëmbët, dhe poturet e të dyve u bënë pér ibret. Ata u kthyen pasdreke. Erdhën dhe hodhën në shesh të shpellës thasët e dëborës. Xhelo Merdani lëshoi the-sin dhe u ul rrëzë shkëmbit. Ai buzëqeshi i lodhur. Partizanët lëvizën drejt dëborës.

«Ndal, — thirri komandanti, — asnjë të mos hajë dëborë si i babëzitur! Isuf, ndaju nga një copë sa të shuajnë etjen!» Partizanët shtrydhnin dëborën në bu-

zët e zhuritura. Te thesi i Xhelo Merdanit u gjetën dy plumbë.

«Urime, — tha zëvendëskomandant Asimi, — e shko-ve radhën, Xhelo. Tani s'të zë më plumbi ty.» Xhelo Merdani buzëqeshte si nëpër ëndërr. Në darkë Ollga vdiq. E varrosën përpara shpellave. Pastaj u dëgjuan krisma. Batalioni kishte hyrë në luftë, në verilindje. Kompania u ngrit dhe lëvizti. Në mesnatë ajo u bashkua më forcën kryesore të batalionit, që kishte pushuar luftimet e së bashku me të ajo përparoi drejt Qafës së Bimlit.

Tempi i lëvizjes qe i shpejtë dhe partizanët ndi-heshin të lodhur. Kompanitë zhvendoseshin jo shumë larg njëra-tjetrës. Në ndalesën e fundit komanda e batalionit nisi një pararojë të avancuar, e cila tani ishte shkëputur mjaft. Po ngrysej. Xhelo Merdanit iu kujtua Zara. Mos ka dalë partizane dhe ajo? Ai ka thellë në një xhep shaminë e saj. Ka katër muaj e gjysmë që e ka atë shami. Kur erdhë në mal nuk mundi të ndahej vetëm për vetëm me të. Megjithatë, çastin e fundit i tha: «Zarë, harrove shaminë.» Ajo e pa në sy. «Mbaje, — ia ktheu, — ndoshta të duhet. Ma jep kur të takohemi.» Dhe bëri me shenjë lart nga mali. Ka dalë partizanë ajo, vallë? Ai nuk ka asnjë lajm. Xhelo Merdani shkund kokën që të mos e zérë gjumi. Pse s'e caktuan atë më pararojën? Ai kishte kérkuar të shkonte. Po komisari i buzëqeshi e i rrahu krahët. «Rri ti, Xhelo, — tha ai, — duhesh këtu. Ti di të përbash mirë veten dhe shokët në betejë.» Xhelo Merdanit i erdhë ligsht. Sigurisht që me pararojën shkuan të zgjedhurit. Rreziku aty ishte i madh. Ata mund të ndesheshin çdo çast me gjermanët, që kérkonin të zinin të parët Qafën e Bimlit. Shkuan dhe Aliu, Fahredini, Merzo Osmani me gjithë të birin 16-vjeçar, Dalipin. Merzo Osmani i thoshte djalit: «Pa shih se mos merr ndonjë plumb në vend të lig, se do të t'i bëj veshët opingë, ta dish.» Ishte shakaxhi dhe, ku ngulej ai, ngjallëj gazë. Atë djalë të rritur kishte. E kishte lënë gruan me tre vocërrakët dhe plakun e tij. «E kam kapedane gruan, — thoshte. — Mos

kisha ata këlyshërit, do dilja në mal familisht.» Këto vërtiste në kokë Xhelo Merdani dhe shtrëngonte pushkën pas shpine. Dy ditë më parë, në një bisedë me një rrëth partizanësh, komisar Veliu kishte thënë: «Trim është ai që e di pse e bën trimërinë, ai që e do jetën sa s'bëhet dhe e jep pjesën e tij nga kjo jetë, përtatë bërë dhjetë herë më të mirë përtatë ata që vijnë më pas. Ky është trimi. Dhe komisari kishte parë shokët në sy e sytë i kishte pushuar më gjatë te Xhelo Merdani. Pse i kishte mbajtur sytë tek ai komisar Veliu? «Trim është ai që e do jetën....» «Edhe unë e dua jetën. Çdo qenie e gjallë...» Atij iu kujtua profesor Konigji. «Në dreq!» — shau me vete partizani Xhelo Merdani. Po të kishte pas shpine pushkën e tij ai profesor me gjyzlykë (atij i dukej se patjetër ai duhej të kishte gjyzlykë), dhe të kishte ecur dy ditë kështu, me dy orë gjumë dhe të kishte përpara një ditë luftë të përgjakshme, atëherë të shihnin si do ta bënte teorinë. Xhelo Merdani shau përsëri. Pastaj u pengua pas një guri në errësirë e desh ra.

«Të zuri gjumi, o Xhelo?» Krah tij u afrua Asimi.

«Jo, shoku Asim,... ja ashtu...» Nga përpara erdhë urdhri përtë ecur më shpejt dhe në heshtje.

«Kemi kohë të mirë nesër», — pëshpëriti Asimi.

«Të mirë,» — foli Xheloja dhe pa vilet e yjeve që vareshin nga qielli. Yjet kishin nisur të zbeheshin. Dalëngadalë po zbardhë. Batalioni bëri një pushim të shkurtër dhe u nis përsëri. Tej u dukën konturet e maleve. Qafa e Bimlit ishte fare pranë. Befas u dëgjuan armë. Komandanti e ndau kompaninë më dysh, ai doli në krye me një mauzer të shkurtër në dorë.

«O burra, — tha, — atje po vriten shokët. Po u mbyll Qafa e Bimlit, rrezikohet gjithë brigada.» Xhelo Merdani vrapi pas Hajredinit, komandantit të skuadrës. Qafa e Bimlit ishte e ngushtë, me një luginë të sheshtë në krye. Shokët e pararojës ishin përplasur aty me armikun. Xhelo Merdani nuk kishte kohë të mendonte. Kjo nuk ishte një betejë ku mund të zije një pozicion e të qëlloje qetë e qetë. Ai shqoi për-

para Fahredin Ickën tek vraponte gjysmë i përkulur me automatikun si një lodër në duart e tij të mëdha. «Oho, hoho!» — bëri Hajredini dhe mori yrysh. Një mitraloz gjerman mbi si kërpudhë në krah të sulmit. Merzo Osmani u kthye dhe u vërvit drejt tij. Gjermani e pa dhe i ktheu mitralozin. Diçka i kishte ngecur dhe lëvizte duart me nervozizëm. «Baba!» — briti Dalipi dhe u hodh edhe ai. Gjermani shkrepri mitralozin. Merzo Osmani, i madh e i rëndë, dhe Dalipi i vogël ranë në një kohë mbi të. Xhelo Merdani e pa gjithë skenën me dimensionet e vërteta. Ajo u zhvillua para tij sa hap e mbyll sytë. Xhelo Merdani u drodh. Ai priti që ata të dy të ngriheshin, por nga gropat ku ishte mitralozi gjerman nuk u ngrit njeri. Ai vrapoi atje. Dora e Dalipit kishte mbetur e shtrënguar mbi krahun e të atit. Partizani Xhelo Merdani ndjeu t'i mjegulloheshin sytë. Ai mbylli kapakët e tyre dhe lotët i shkanë poshtë si rruaza. Rrëmbeu mitralozin gjerman nga duart pa jetë të mitraljerit dhe bëri poshtë. Shiriti i fishekëve varej pas tij.

«Oo... oo!» — thirri Xhelo Merdani dhe e bëri vëtëtimë përpara vetes. Në gojë kishte shijen e kripur të lotëve. Ai kishte mbledhur nofullat sikur bluanë dhëmbët dhe ndiente vetëm krismat e mitralozit të tij. Hajredini shikonte i shtangur vrapin e tij të zjarrtë.

«Xhelo! — thirri dikush. Asimi vraponte pas tij dhe shtinte me ndalesa. — Kujdes, Xheloo!»

«Oo... oo! — bëri përsëri Xhelo Merdani. — Përpara, ore, me dorë, ore, me dorë!» Ndiente ajrin që i fishkëllente në vesh. Po plumbat ku ishin? Ku janë krismat e luftës? «Do t'ju vras, — tha ai, — do t'ju vras, o bisha, në emër të jetës. Po të jeni ju gjallë, unë vdekur se vdekur jam, edhe Zara e nëna vdesin, mëngjeset bëhen blozë dhe diellin do ta kemi me zinxhirë. Unë, Xhelo Merdani, do t'ju vras! Gjermanët u zmbrapsën përpara tij. Thirrja partizane ushtoi mbi qafën. Befas ai ndjeu se u lodh. Jo, tha, nuk do të lodhem kurrë nga ky vrap. Shtiu përsëri dhe përsëri gjithçka përpara tij u përflik. Dora mbi

tytën e mitralozit i dogji. Ai u mundua të thërriste, por zéri s'i bindej më. E kuptoi se s'mund të ecte më, madje se s'mund të qëndronte as në këmbë. Gjermanët ishin thyer në të gjithë qafën dhe po tërhiqeshin po-shtë. Partizani Xhelio Merdani preku gjoksin dhe dora iu njom. «Gjak, — tha ai, — ja dhe gjaku im.» Për këtë gjak ishte trembur aq shumë ai? Ai deshi të bu-zëqeshte. Hapësira përpara iu tret. Gjithçka u bë flu-ide dhe atij iu duk sikur s'peshonte fare. Ecte dhe mitralozin s'e lëshonte nga duart. Pastaj, tek rrëzohej, ndjeu përsëri t'i endej në kokë diçka e papërcaktuar, diçka pér jetën dhe vdekjen. Dhe ra ashtu, me sytë të hapur. Fytyra e zëvendëskomandant Asimit iu drodh mbi vete. Ai deshi t'i thoshte diçka atij, diçka, që ta falte, se kishte qenë frikacak. Por s'mundi. Shokët e gjetën të mbytur në gjak, në krahët e Asim Korabit.

Partizani Xhelio Merdani ndenji tri javë në spital. E kishte marrë veten por ende nuk ngrihej dot nga shtrati. «Eshtë i dobët, — thoshte mjeku, — ka derdhur shumë gjak.» Një mëngjes tek rrinte me kokën mbësh-tetur mbi jastëkët e lartë dhe vështronë nga dritarja elbin, që e lëpinte një erë e hollë, erdhë komisar Veliu. Xhelaja u drodh kur e pa dhe zemra i rrahu me vrull. Komisari e përqafoi dhe e guthi në buzë.

«Trimi i kompanisë», — tha ai.

— «Jo», — pëshpëriti Xhelio Merdani dhe u shkë-put nga përqafimi i tij. «Jo, — tha pastaj më fort, — unë nuk jam trim, o komisar, trima ishin Merzo Osmani, Fahredini... unë jo, kam genë frikacak. Ti nuk e di çfrikë kam pasur.» Komisari e tërhoqi nga vetja. Dora e tij e fortë shkau nëpër flokët e Xhelos.

«E di, — foli ai dhe i ngriti kokën e i pa sytë partizanit, — e di, të gjitha i di.»

«Si... ti...», — Xhelo Merdanit po i mbahet goja.  
«Po, o Xhelo, — tha Komisari dhe i shrëngoi flokët, — e kisha kuptuar, siç kisha kuptuar se ti do të bëheshe trim ashtu thjesht, duke e përbuzur vdekjen.» Të dy u panë në sy për një kohë të gjatë. Pastaj Xhelo Merdani ra mbi jastëkët dhe vështroi jashtë dritares. Ndoshta vërtet ai ishte trim. Ku ishin ata vargonj, që ia bënин aq të rendë kafazin e kraharorit? Në dreq ai profesori me syze, Konig, me gjithë pseudoteorinë e tij. Jo, njeriu nuk është si kafsha, që i bindet forcës nën instinktin e frikës. Njeriu i vërtetë është pse lufton e përpinqet. Nëse vritet, kjo do të thotë se ato çaste ai ka derdhur gjithë karburantin e jetës që i mbetej dhe nga kjo ka ndezur një zjarr të pashuar lavdie dhe nderi, zjarr që zbardh mëngjeset e populilit të tij. Po, ai ishte bërë trim. Komisari e shikonte me buzë në gaz.

«C'mendon?» — pyeti ai.

«Mendoj se sa bukur është të jesh trim», — foli Xhelo Merdani ashtu si nëpër èndërr. Komisari i shtrëngoi dorën.

«Po, bir, — tha ai, — e bukur është të jesh trim për luftën tonë.» Xhelo Merdani buzëqeshte. Sa e vështirë kishte qenë e gjithë kjo. Kishte kapërcyer një luftë, kishte duruar vuajtjet e vështirësitë. Po, ky luftë, kishte madh. Ai kishte kapërcyer vështirësitë.

Ata u panë përsëri në sy. Përpara kishin ende ditë luftë e betejash. Po partizani Xhelo Merdani i shikonte të gjitha i qetë dhe me buzëqeshje.

1978

## Dritëro Agolli

### FYTYRA E NJË USHTARI TË PËRJETSHËM

1

— Po ky dru, që nuk e kemi parë ndonjëherë të zhveshur, si e ka emrin? — e ngacmonin ushtarët Abazin, tetarin e postës kufitare, në afërsi të fshatit N.

Abazi e merrete me gjithë mend pyetjen e shokëve dhe fillonte t'u përgjigjej si një njohës i rrallë i bimëve dhe i drurëve:

— Ju nuk e dini se çfarë dru të këndshëm ka kjo kaçubë. Ky është i verdhë, i fortë, i bukur. Këtij i thonë bush. Gjyshi im bënte prej tij çibukë, lugë, kërraba. Gdhendte në të bile edhe cjepl e desh kurse unë di të gdhend jo vetëm kafshë, por edhe njerëz. Për shembull, mund të gdhend një njeri që t'i ngajnjë Kolë Gjonit.

Abazi e shikoi me bisht të syrit ushtarin që e quanin Kolë. Ushtarët e tjerë qeshën dhe iu lutën të gdhendte një njeri që t'i ngjantë Kolës.

— O, kjo është një punë e gjatë! — tha Abazi.

— Këtu ne jemi ushtarë. Gjithmonë e kemi mendjen të ngritur dhe s'mund të merremi me gdhendje.

Në postën kufitare u përhap fjala se Abaz Shkoza mund të gdhendte prej bushit fytyra njerëzish. Ata thoshin se së shpejti do të shihnin të vënë në tryezë bustin e vogël të Kolë Gjonit.

Kolë Gjoni ishte një ushtar i qetë, me hundë të madhe e me nofulla të gjera. Abaz Shkoza e donte atë dhe ngaherë rrinin bashkë, madje edhe në patrullë tătëpjetë vijës së kufirit dilnin të dy.

— A ke me më skalitë me të vërtetë në dru, a? — i tha një ditë ai Abazit.

— Dhe ç'të skalitur! Më pëlqen fytyra jote, se është e lehtë për ta gdhendur në dru, — e ngacmoi Abazi.

— Vërtet? — qeshi Kolë Gjoni dhe e mylli me pëllëmbën e dorës gojën e madhe, që të mos i duke-shin dhëmbët kataroshë si copa stralli të radhitur pa rregull.

## 2

Kaluan ditë e javë që atëherë. Historia e drurit të bushit dhe e fytyrës së Kolë Gjonit thua jse ishte harruar, kur një mëngjes një nga ushtarët, duke u kthyer nga shërbimi, solli me vete një copë të vogël bushi. Abazi e mori ngadalë në dorë, e vërtiti nga dy-tri herë, si një mjeshtër me përvojë, dhe, duke u kthyer nga shokët, ngriti gishtin sikur të deklaronte ndonjë lajm me rëndësi:

— Këtë copë bushi do ta bëjmë të flasë. Kjo tanimë nuk do të quhet dru, por bësti i ushtar Kolë Gjonit, i cili, sipas fjalëve të Suvorovit, ka të drejtë të ëndërrrojë për t'u bërë gjeneral. Dhe kur të ndodhë kjo, njerëzit, duke e parë bustin, do të thonë: «Gjeneral Kolë Gjoni kur ishte ushtar!»

Ata që ishin rrëth e rrotull, qeshën me të madhe dhe nisën ta ngacmonin gjeneralin e ardhshëm. Po «gje-

nerali» e kishte mbuluar gojën e gjerë me pëllëmbën e dorës dhe gajasej.

Që të nesërmen Abaz Shkoza filloi të gdhendte fytyrën e gjerë të Kolës. «More, e nisëm si me të qeshur, por më duket se po na del një punë serioze», thoshte me vete Abazi. Gjer tani ai e njihte mirë fytyrën e Kolës dhe do ta kujtonte ndofta edhe me vite të tëra, por, kur filloi ta gdhendte në bush, e kuptoi se sa pak e kishte vërejtur. Një mëngjes, duke punuar, e vërejti tinëz Kolën, që qëndronte me kokë të kthyer nga mali, me vetulla të ngrysura, me buzë të mbyllura. Shapka i rrinte rëndë mbi ballin me rrudha. Abazi kishte vënë re se, kur Kolë Gjoni mërzitej, në mes të dy vetullave mbi hundë, i formoheshin tri vija të thella dhe sytë sikur i zvogëlohen. Ai atëherë nuk fliste, por qëndronte i veçuar nga shokët, afër ndonjë shkëmbi, duke shikuar larg. Është e pamundur ta tregojë mërzinë dhe shkakun e saj. Abazi atë mëngjes i tha:

— Do të të gdhend në këtë pozë. Kështu më pëlqen më shumë. Dua të dalësh serioz dhe jo gazmor. Shprehja e fytyrës sate anon nga tragjikja. Ti je tragjik. Gazmor mundohesh të bëhesh me zor.

Nga gjithë ky lumë fjalësh Kolë Gjoni nuk kuptoi asgjë. Por edhe sikur t'i merrte vesh, prapë do të heshtte, pasi, siç dukej, do të ishte zënë me dikë.

### 3

Në postën kufitare nëntori fluturoi. Kolë Gjoni përgatitej të shkonte në shtëpi. Urdhri i lirimt i kishte ardhur. Edhe një natë do të flinte buzë kufirit dhe të nesërmen në mëngjes e priste rruga. Ai ishte ndarë me automatikun dhe dylbinë. Të gjitha ia kishte dorëzuar kapterit pa folur dhe me mall në fy-

tyrë. Kola e kishte vështirë të ndahej me Abazin, mi kunkun e tij të ngushtë, rrëfyesin e rrallë të historive zbatitëse, gdhendësin e bushit e të arrës! «Ende nuk e ka mbarue fytirën time», mendonte ai duke futur ndonjë gjë në trastë. Abazi flinte. Nën jastëk kishte copën e bushit, fytirën e pambaruar të Kolë Gjonit. Ai u vërtit në krahun tjetër dhe diçka tha nëpër éndërr. Pastaj i hapi sytë dhe ngriti kryet:

— Dreqi ta marrë. Më dhemb koka. Kolë, sillmë pak termometrin!

Kola la trastën dhe doli.

Me të vërtetë, Abazi kishte të nxehëse ishte, ende pëngjes, termometri shënonë 38 gradë.

— Domethënë nesër, ti, Kolë, na lë jetimë! — tha Abazi ende i shtrirë.

— Kanë me ardhë të tjerë, — u mundua të fliste Kola.

— Ah, more Kolë! Po unë ende nuk e kam mbaruar fytirën tënde. Vetëm hundën dhe ballin të kam bërë. Kisha qejf të ta jepja ta merrje me vete e t'ia tregojë së dashurës, po g'e do, — tha Abazi.

Kola qeshi me zërin e tij të trashë si bori, me atë zë, që Abazi e njihte mirë gjatë një viti e ca, mes këtyre maleve që binin erë çaj të egër.

— Kështu, kështu. Sonte unë nuk do të bëj patrullë me ty! A e di që më vjen keq? — foli Abazi nga krevati.

Kola e pa me vëmendje. Fytyra e shokut të tij ishte e kuqërrëme nga temperatura. «Ç'patrullë ke me batë sonte!» — mendoi ai.

— Ti duhet të flesh! Unë po dal. Ti je sëmurë! — tha Kola dhe. mbylli derën e dhomës, që shëmbellente më shumë me një sallë.

«I vjen keq të ndahet», mendoi Abazi dhe mori nën jastëk copën e bushit dhe thikën. Pa u ngritur ende, ashtu gjysmë i shtrirë, filloi të gdhendte. Hunga, me të vërtetë, ishte tamam si e Kolës. Por kjo nuk tregonte ndonjë meritë të madhe, se një hundë të tillë kushdo mund ta gdhendte me lehtësi. Puna

ishte gjetkë. «Të gdhendësh shpirtin e Kolës», mendoi Abazi, siç mendojnë zakonisht skulptorët, megjithëse ky nuk ishte i tillë.

4

Kolë Gjoni doli jashtë. Era e lagët fshikullonte. Maja ve zvarritej mjegulla. Në rrugicën për te çeza ai u takua me komandantin e postës N.

— Shoku kapiten, — tha, — megjithëse automatikun e dorëzova, unë jam prapë ush-ush-ushtar. Abazi ash-ash-asht i smunjë. Mund ta baj unë shër-shërbim sonte në vend të tij? Për të fundit herë.

Komandanti i postës ishte njeri i urtë dhe i donte ushtarët e ndershëm si Kolë Gjonin, por nuk di pse kundërshtoi.

— Ti nuk je më ushtar. Për mua je civili Kolë Gjoni.

— Jam ushtar, — u zemërua ai.

Të dy bënë një copë rrugë bashkë. Kolë Gjoni, me duar e me gojë, mundohej t'ia mbushte mendjen komandantit se ai ende ishte ushtar dhe se nuk ishte e drejtë që të mos merrej parasysh kërkesa e tij, e vëtmja kërkësë për gjithë kohën e shërbimit. Më në fund, komandanti e lejoi që atë natë të bënte patrullë në vend të Abazit.

Kola hyri në dhomën e ftohtë, ku ishte shtrirë shoku i tij. Abazi ishte mbështetur në krah dhe në një dorë mbante copën e bushit.

— Më duket se druri po fillon të të ngjajë, — tha ai dhe ia zgjati Kolës.

Kola e mori, e ktheu në profil e në front dhe zuri të qeshte.

— Hundën ma ke bërë të madhe si të Adenauerit.

Dhe Abazin e mori gazi. Dera ishte e hapur dhe

frynte erë. Abazi shikoi jashtë dhe, duke u mbështjetë llë me jorgan, tha:

— Sonte do ta kem pak pisk me patrullën. Ftohtë. Erë. Koka më dhemb.

Kola ia preu:

— Sonte jam unë patrullë në vendin tand. — Abazi e hoqi jorganin. Ai kërkoj me këmbë këpucët nën krevat.

— Falemnderit, por unë nuk jam në buzë të vrrit. Ti ke zemër të madhe, Kolë, por në ushtrinë tonë nuk shkojnë bedelë...

Fjala e fundit e dëshpëroi. Ai uli kokën dhe filloj të tërhiqte me dorë një tufë flokësh. Kështu bënte kur zemërohej.

— Komandanti më lejoi. Unë i thashë të të zëvendësoj!

Abazi nuk i mbathi këpucët. Atij iu morën mendtë dhe u shtri përsëri në krevat.

— Falemnderit, Kolë! — tha ai i prekur, me një buzëqeshje të hapët.

Atë natë Kola përsëri u bë ushtar. Me automatikun në qafë u nis për patrullë, duke e lënë Abazin në shtrat. Në strehë vërvhellente era dhe në xhamat trokiste shiu. Një llambë me vajguri hidhte një dritë të dobët në dysheme. Gryka e trastës së Kolë Gjonit ishte ende e zgjidhur. Kishte kaluar një orë, kur, në mes vërvhellimës së erës, papritur, u dëgjuan krisma të shurdhra automatiku. Abazi u ngrit. Sipas zhurmës, krismat nuk ishin aq larg nga kjo dhomë gjysmë e errët. E gjithë posta ishte në alarm.

Abazi u vesh dhe doli. Në oborr e takoi komandanit dhe e shau pse ishte ngritur e kishte dalë në erë duke pasur ethe. Ata që ishin në oborr, mendonin se kjo do të ishte një përpjekje e zakonshme me ndonjë shkelës kufiri, ose...

Pas pak krismat heshtën. Dëgjoheshin vetëm era, shiu dhe të lehurat e qenve. Mes errësirës u rritën trupat e heshtur të katër ushtarëve. Ata diçka sillnin në krahë.

— U vra Kolë Gjoni, — u dëgjuan fjalë, që ishte vështirë t'i besoje. Por çfarë nuk ndodh në mes të maleve, në kufi, ku era kërcet dhëmbët nëpër gurë...

Kolë Gjonin e vunë në krevatin e tij. Ishte ende i ngrohtë dhe fytyra nuk e kishte humbur ngjyrën e zakonshme. Ushtarët me kapota ngjyrë dheu ishin mbledhur rrëth tij. Llamba vazhdonte të hidhët tu-fën e rrezeve të dobëta mbi krevatin e Kolës, ushtari të përjetshëm. Trasta ishte si më parë, me grykë të hapur. Ai e kishte lënë ta lidhët në mëngjes, kur të nisej për udhë.

— Kush shtiu? — pyeti një ushtar i futur në kaptë.

— Dy të panjohur. Njërin e zumë, tjetri u plagos, por nuk e kemi gjetur, — tha ai që ishte mbi kokë të Kolës.

Kola heshtte. Nga një cep i gojës së madhe kishte ngrirë një rrëke gjaku. Abazi ishët i tronditur e krejtësisht i hutuar.

... Rrodhën ditë pa Kolën në atë qafë mali. Mëngjeseve frynte po ajo erë, mbrëmjeve ndriste po ajo llambë. Abazi rrallë queshte. Tani shakatë i kishte lënë dhe cigaret i kishte dendësuar. Ditën, sidomos në drekkë, kur gjente kohë të lirë, ulej në ndonjë rrëzë dhe gdhendte copën e bushit. Dalëngadalë bushi mori jetë. Ai nuk ishte më një copë dru, por një bust i vogël njeriu, një figurë.

Një ditë këtë figurë ushtarët ia gjetën nën jastëk Abazit, kur ai prehej në drekkë. Në fund të saj ishte shkruar: *Ushtari i përjetshëm Kolë Gjoni, gdhendur nga tetar Abaz Shkoza.*

# Dhimitër S. Shuteriqi

## NATE SHTATORI

Ata kishin luftuar gjithë javën dhe kishte qenë ajo një javë lëvizjesh e marshimesh të pandërprera. Ar-miku përpinqej ta merrete veten nga goditjet e rënda, kishte sjellë përforcime dhe ata duhej ta goditnin prapë. Por komanda e Brigadës për batalionin III vendosi që doemos të pushonte nja dy ditë e dha urdhër të qëndronte në prapavijén e luftimeve, në disa lartësi të veshura me pyje, ku ishin edhe nja dy fshatra të vogla.

Partizanët ato orët e fundit të marshimit po i bënin në një pasdreke shumë të nxehjtë shtatori. Dielli i kishte përcëlluar dhe, kur u futën në pyll, thanë se hynë në një lumë që me rrjedhën e tij do t'u lante djersën e pisllékun, do t'u bënte edhe një masazh të mirë gjymtyrëve dhe çdo muskuli. Po kishin uri të madhe. Tërë kapitjen e tyre s'e hiqnin dot nga trupi me atë banjë freskie që bënë për më shumë se një orë. Uria nuk u mundonte vetëm lukthin, po sikur u bluan te kockat. U dukej se, të ngrënë, do të mund

të bënин edhe një ditë marshim nëpër diell; të pangrë-në, edhe midis hijes e njomështisë, u dukej se nuk do të mund të bënин asnje orë udhë më shumë.

Kur dolën nga 'pylli, patën një si vegim që i shastisi. Dielli kishte rënë. Qielli në përendim ishte mbushur gjithë trëndafila të mëdhenj në të kuq të errët, që kush ishte çelur plotësisht e po i shkëputeshin fletët, kush do të çelte gonxhen. Jo një tufë me trëndafila, po një shtrojë e tërë lulesh e petalesh, në një kupë të thellë horizonti, midis maleve. Dhe mbi këtë sfond, aty pranë, as një gjysmë ore larg, një çukë e lartë me nja tetë a nëntë kulla, të ngritura njëra përmbi tjetren, si një kështjellë e bardhë, që ia spërkaste qelli muret me të kuq. Më e larta kullë, anash shoqeve nga e djathta, ishte si një pirg, që i kishte ploqat e çatisë të reja e ato vezullonin me nuanca të kaltëruara.

Ata u futën në një udhishtë midis muresh që mbronin arat, mure të trasha, nëpër të cilat lëviznin zhabinjtë dhe prej ku nxirrin krye xhumba drizash të harlisura. Gurët lëshonin një afsh përvëlues, drizat njëfarë trishtimi të nervozuar. Këmbët troshitnin gurët e rrugës dhe e bënин zhurmën t'u ngacmonte kapitjen.

Pastaj morën një të tatëpjetë e dolën te shtëpia e parë e fshatit, në krye të lagjes së përtejme të tij. Një pëllëmbë arë e një pëllëmbë vreshë dhe në mes një shtëpi sa një kuti shkrepëse. Misri nuk ishte i rritur, po me kallinj të plotë. Vreshtit i verdhonin veshulët. 'Cfarë rrushi!

Asnjërit nuk i vajti mendja te kallinjtë, që mund t'i kishin shpërvjelur e pjekur menjëherë, por u mbetën sytë të veshulët që rëndonin nga lastarët e hardhi-vë e mend këputeshin. Zogjtë çuçuritnin nëpër hardhi, edhe ata mospërfillës ndaj kallinjeve.

Dy skuadra të asaj kompanie të batalionit ndoqën udhën për në lagjen tjeter të fshatit, dy të tjerat qëndruan aty. Komisari me njëren skuadër iu drejtuani shtëpisë së vogël pranë.

I priti një mesoburrë, që dukej edhe ai më i loddhur se ata e që po milte dhinë pranë pusit. U nxori shpejt një kovë ujë, që të shpëlaheshin e të pinin dhe, kur komisari i tha që t'u nxirrte një copë bukë, makar edhe thatë, po shpejt, ai rendi e erdhë bashkë me të shoqen, me nga një tepsi secili e me një sofër. Partizanët u shtruau rrëzë pusit.

Fshatari i shihte si hanin me uri të madhe e si e gjerbnin dhallin me aq shije. Kishte qejf t'i shihte dhe përsëriste «ju bëftë mirë». Gruaja qëndronte e përgjëruar pranë tyre, me një qyp në duar, e u hidhte herë pas here përsëri dhallë në çanakun e madh prej balte, që ata e boshatisnin shpejt me lugë. Si hëngrën kështu një copë herë, komisari nisi të thërrmonte bukë e ashtu bënë të gjithë; gruaja shtiu mbi bukë dhallin që kishte tepruar, ata e përzien e u bë një përshest me kapul, tërë pluska të bardhë, me një aromë të athët që të freskonte mushkëritë.

— Bukuri e bëtë, — foli për herë të parë gruaja dhe vështroi nga i shoqi, duke i bërë një shenjë me sy.

— Bukuri, — tha i shoqi e vështroi gruan, pastaj ktheu kokën e vështroi nga vreshti.

Andej kishte filluar të shinte sytë edhe ndonjë partizan.

T'u jepet nga një veshul rrush kaq vetave, gjysma e vreshtit bëhej na!... Aq ishte ai vresht, — vresht i thënçin, — as njëzet kërcunj. C'do t'i mbetej për një gjikë pekmez për vete e për një bulë raki për mikun?

Fshatari shtrëngoi buzët, e vështroi me keqardhje të shoqen, i bëri shenjë për «jo», gruaja uli kokën dhe, me qypin bosh në duar, vajti u fut në shtëpi.

Partizanët u ngritën të ngopur e sekush të pinte edhe një herë ujë në kovën që nxitoi e e mbushi përsëri fshatari. Ata u grumbulluan pastaj nën një carac, te rrëza e shëpisë, u shtrinë pranë e pranë e ia nisën një këngë, — «ato maja rripa-rripa se c'gjëmojnë», — komisari nxori veglat nga çanta dhe u rrua aty për aty. Rruhej e, në pasqyrën e vogël që kishte vendosur te pragu i

pusit, ia bënët me sy bistakët si të kaltëra të rrushit, njëri më i bukur se tjetri.

Fshatarit i vinte keq që nuk i jepte dot nga një veshul secilit partizan. Atij i vinte turp që të ndante nga një veshul për dy-tre veta. Kurse ky komisari po rruhej e s'dukej ta kishte mendjen te rrushi fare, partizanët po këndonin ende e po u fikej kënga dhe ja, do t'i kapiste gjumi të gjithë.

Komisari u rrua, fshatari pati qejf ta shihte si iu zbulurua çehrja, dhe i tha të urdhëronte në shtëpi brenda për të fjetur, se një vend për të e për dy-tre shokë e kishte në dhomën e tij të vetme. Ai vetë me të shoqen do të flinin jashtë, — «që të ruajmë vreshtin», i shpëtoi fjala fshatarit.

Komisari qeshi e tha:

— Mos u bëj merak, se vreshtin ta ruajmë ne, — dhe i thirri një shoqje me emrin Sofi, që të merrte edhe shoqet e tjera dhe të futeshin brenda për të fjetur.

Sofia s'bëri zë: ajo tundi pa qejf shoqet rrëzë gardhit ku kishin rënë dhe partizanët u ngritën e u futën në shtëpi të përgjumura. Komisari vetë i tha natën e mirë fshatarit dhe vajti u shtri te vendi që lanë shoqet.

Tërë natën fshatari nuk fjeti: nuk e zinte gjumi.

«Këta njerëz, si nuk bënë fjalë përrush fare? Po si s'u hodhën makar një sy! Rrushi aty, kërcunjtë të ngarkuar me veshulë, veshulët të mbushur, që nga njëri të shtrydhësh një okë musht!»

Gjumi e mundonte, se ishte vrarë në punë atë ditë; kishte vajtur edhe në nulli dhe mullirin e kishin poshtë, shumë thellë, në një përrua, dhe ai s'kishte kafshë e e mbante thesin me njëzet okë një orë tatëpjetë e më shumë përpjetë. Po shqyr që kishte vajtur në nulli e s'e kishin gjetur pa bukë, se një ditë më parë s'kishte pasur të gatuante as një sahan miell.

E mundonte gjumi, por e mundonte më shumë ky vresht, — se vresht e quante, — që s'kishte as njëzet

kërcunj e që s'ia prishte dot rrushtë, se një çikë pek-mez e një bulë raki duhej, e t'u jepte nga një veshul partizanëve, ç'do t'i mbetej? Po këta njerëz, si nuk e bënë rrushin hiç për fjalë, po ranë me këngë në go-jë e po flinin?

Bëri të flinte dhe nuk fjeti dot. Hapte sytë se mos ndonjë partizan po ngrihej e po shkonte të kë-puste një veshul. S'kishte as përse të ngrihej, mjaft të zgjaste dorën dhe veshulët, që u rëndonte mushti, do të binin sikur vuanin edhe ata e s'duronin. Të zgjaste njeriu dorën e të këpuste makar një, kurse njeriu s'i kishte përfillur fare, po kishte rënë e bënte rehat, me fytyrën nga qielli plot yje, nga hëna si një mollë e madhe, sikur të ngopej duke parë ata veshulë drite dhe atë mollë të artë, që vareshin në qiell.

Makar të kishte këputur ai vetë nga një veshul për ato shoqet, që po flinin atje brenda. Të vinte e të kë-puste tani nga një veshul për to, t'u vinte pranë te vatrat dhe, kur të zgjoheshin, vajzat të hapnin sytë të çuditura:

«Po këta rrush nga ranë, prej qielli?»

Po, po, kështu do të bënte, se ai nuk ishte koprac; ai kishte dashur me gjithë shpirt t'u bënte ndër e t'i gostiste, po si të bënte?. As njëzet kërcunj nuk kishte në vresht. Fukarallëk, maskarallëk!

I ra me bërryl së shoqes dhe e zgjoi.

— Moj, dëgjo këtu, — i pëshpëriti. — Merr e me këput tre veshulë, ama të m'i zgjedhësh të mirë, dhe ec e vërvjua atyre shoqeve te vatrat.

— Nesër, nesër, — bërbëliti e shoqja me inat, ca se dhe në ëndërr i ishte fanitur burri, që s'u jepte nga një veshul rrush partizanëve, ca se i prishi gjumin.

— Jo nesër, po tanë. Mund që ndonjëra zgjohet e sheh rrushin e i pëlqen të njomë gojën.

— U kam vënë stominë pranë.

— Unë të them për rrush, ti më flet për ujë!

— Ec e shpjerua vetë! — u mërzit gruaja..

Si t'ua shpinte vetë? Kjo grua! Kur i hipte, hajt e ta urdhëroje!

U ngrit vetë, vajti e këputi tre veshulë rrush, që i kishte zgjedhur me kohë në mendje, dhe iu mbushën plot duart e mëdha. Hëna binte mbi duart plot rrush, kokrrat ndriçonin si disa sy të mëdhenj me dritë, mushti lëshonte erën e tij të ëmbël nëpër kokrrat që s'e mbanin dot e kishin plasur. Ato vajzat, po të zgjoheshin natën, do të bënin çudi nga këta veshulë të bukur që të vështronin me ca sy të mëdhenj, do t'u guduliste kraharorin era e mushtit, që do t'i zgjonte.

I vështroi me kënaqësi veshulët, u mat të hynte në shtëpi, por u prapësua. Si të futej atje vetëm, midis femrave? Dreq o punë! Dhe gruan s'e kishte urdhëruar dot. I mbetën rrushtë në duart e tij të mëdha, që sikur ia shtrinte hënës t'i shihte dhe hëna lozta e qeshte me të, se vërtet kokrrat e rrushit ndriçonin si ca sy të mëdhenj e të kaltër, me vezullime të arta.

Ngadalë-ngadalë bëri disa hapa të lehtë e vajti ia vuri rrushtë komisarit pranë, përmbi bar, e u kthye u shtri përkrah Hatijes, me duart e me zemrën të lehtësuar. Po gjumi s'deshi ta zinte.

Ja ai komisari nuk lëvizte fare, po bënte gjumë. Mushti nuk ia ngacmonte hundën. E! sikur të zgjohej e të shihte rrushtë, e makar të zgjaste dorën për njëzë kokërr, të ëmbëlsonte gojën e të mbyllte sytë prapë, me një mendim pak më të mirë për këtë fshatar, që njëzet kërcunj me rrush ka në vresht vërtet, po katër-pesë veshulë makar t'i kishte këputur, një për dy-tre partizanë bashkë, apo makar tre veshulë dhe hiç më shumë, për ato tri çupat që s'e kanë këtë luftë siç e kanë djemtë, po kushedi sa më të rëndë. Po komisari flinte, me fytyrë nga veshulët e yjeve dhe nga molla e artë e hënës, e kushedi ç'ëndërr bënte me ato bukuri përsipër, sa nuk ia ngiste gjumin as ai kundërmimi i mushtit, që kishte plasur rrushin e kullonte gjak i kuq.

Flinte komisari, flinin partizanët dhe asnjëri prej këtyre nuk kishte zgjatur dorën, jo më një veshul të

këpuste në degë, por asnje kokërr. Të kishte qenë ai vetë, gjer tanë do të kishte plasur e nuk do të kishte duruar, gjumi nuk do ta kishte zënë pa ëmbëlsuar gjënjë me një rrush. Dhe ja, gjumi nuk po e zinte, se këta djem e ato çupa nuk i ëmbëlsoi me një rrush. Pthu! Farmak t'i bëhej pekmezi! Ujë t'i bëhej rakia!

U ngrit, këputi veshulë aq sa mbushi krahët dhe vajti, me kujdes të madh se mos i zgjonte, e ua vuri partizanëve pranë atje te caraci, mbi një fron të vogël që ishte aty. Mos kishte këputur pak? Vajti këputi edhe të tjerë dhe bëri tërë një kapicë veshulësh përmbi fron. Po për çupat, si të bënte? Vajti dhe këputi edhe për to dhe në shtëpi nuk hyri, por i la veshulët përtokë, pas pragut, përbrenda. Kur të binte drita e të zgjoheshin, partizanët do të shikonin rrushin te pragu, dhe ç'bukuri e madhe!

U mbante erë tanë duarve të tij dhe sikur u deh nga mushti që kishte rrjedhur nëpër to, vështroi në qìell veshulët me dritë dhe mollën e artë të hënës, iu mbyllën sytë dhe fjeti.

1972

## Fadil Zeqiri

### PROVIMI

Lokali i dytë ishte i heshtur. Jaku e mbështeti me mundim shpatullën mbi jastëkun e ndenjëses, i ndihmuar prej ndihmësmjekut, dhe vështroi lart. Ishte një vështrim në të perënduar. Duke gjykuar nga fashat rrotull gjoksit të zhveshur, nga fytyra e zverdhur mbushur me bula djerse, të cilat tjetri nxitonte t'ia fshinte me një shuk cope të bardhë e nga ndonjë rënkim i rrallë, bindeshe se dhimbja i kalonte kufijtë e durimit. Ndryshe nuk do të duhej përsëri gjilpëra pér ta nxjerrë nga kllapia e pér ta sjellë në vete pér të dytën herë. Megjithatë qafa e shëndetshme prej një detari në moshën djaloshare, ashtu e mbushur me rrëke djerësht që i rridhnin tatëpjetë kraharorit të gjerë dhe merrnin vezullime nën dritën elektrike, dukej si trung lisi që përcjell në tokë ujin e shkrirë të borës.

Sipas ndihmësmjekut, detari i plagosur aty pranë u përkiste atyre njerëzve që dhimbjet e plagëve i durojnë, po turpin jo. Të dyja këto dhimbje rëndo-nin në zemrën e djaloshit, vec më e forta ishte ajo

e turpit. Ndihmësmjeku nuk e dinte se ç'gabim kishtë bërë pacienti i tij, pasi, si dhimbjet e plagës ashtu dhe atë «dicka tjetër», Jaku mundohej t'i fshihte, siç bën me dallgët deti në sipërfaqe, paçka se ato i japid lë-kundje të fuqishme anijes. Ndihmësmjeku mbante mend se, pasi i bëri gjilpërën dhe e solli në vete, pacienti vuri dorën te vendi ku duhej të ndodhej xhepi i xhaketës së pambuktë e, meqë atë ia kishin nxjerrë nga ai krah, dora i shkonte në plagë. Plaga dhimbte e ai rënkoj fort. Kur u kuptua se detari kérkonte ndonjë send 'të vyer në atë vend, iu tregua astari i nxjerrë i xhepit të zberthyer, por atje nuk kishte asgjë. Kjo e bëri të plagosurin të rënkonte më fort dhe 'të shtrëngontenofullat sérishmi. Më pas ai e shpinte dendur dorën atje ku duhej të ishte xhepi i xhaketës së punës. Vinte në vete e pastaj prapë vështrimi i mijegullohej.

«Fjala e ngrrohtë e shokut bën punë këtu» mendoi ndihmësmjeku dhe...

— Mibahu, Jak vëllai! Ti veprove si në luftë të vërtetë. Sa të mbarojë verifikimi i defektit, do të dëlim mbi ujë. Ne të dy në agim do të nisemi për në spital. Edhe pak, vëlla...

Detari Jak Lisi sikur nuk e shihte fare fytyrën e shokut të përkulur mbi të që po i thante djersët me pambuk e fasho. Në ndonjë rast gëlltiste kombin që i mblidhej në fyt dhe fliste disa shprehje që labi nuk ia shkoqiste dot, se dialekti i Veriut ishte i thellë: «... Nuk mujta, kornisar. Më ka mbetë në krye mbrapshtia e Ivanit... Mandej tubi... E hupa, bre burrë i dheut. Ma ban hallall... Zarfin me dokumente... Ai... u fika, bre burrë...»

Këto gjysma fjalesh ishin pa lidhje, veç shprehja «... zarfi me dokumente» e bëri ndihmësmjekun ta dëgjonte me vëmendje.

Nëndetësja ende mbante brenda guaskës së çelikëtë dy lloj efektivash, shqiptar dhe rus. Dihej se zot të vërtetë të anijes ishin shqiptarët, megjithatë, kur ke tjetrin brenda...

Ai moskoviti i qethur i oficer Petrovit, Ivani, që provokoi defektin, mund t'i kishte vjedhur edhe dokumentet e Jakut, ashtu siç ka mundësi t'i ketë tretur dhe nxjerrë jashtë bashkë me ujin, pas avarisë. Dhe përsëri faji i mbetet Jakut.

Ndihmësmjeku ia kaloi shukun e lagur edhe mbi huzët e thara, ku dukeshin grimcat e kripës së mbetur nga uji i detit. Kishte përpara një djalosh trim, i cili i kishte vënë gjoksin atij defekti, që rrezikonte jetën e shokëve dhe të «shtëpisë» së tij, një djalosh të gjakosur e të goditur rëndë, por jo të térhequr. Edhe kur e kishin lënë forcat e kishte humbur ndjenjat, vështrimin e fundit e pati hedhur mbi fytyrën e shokut të armës, dhe mundi t'i bënte atij me shenjë nga rusi Ivan, në mënyrë që, po të vdiste, e vërteta të dilte në sipërfaqë, si vaji pas avarisë së nëndetëses. Veç dokumentin sekret nuk kishte mundur ta ruante dot. C'përbante ky «zarf me dokumente...»? E si i ra në dorë detarit Jak Lisi? Ndihmësmjeku nuk dinte gjë, veç indiferent nuk mund të rrinte.

U përkul përsëri mbi shtrat.

— Jak, të dhëmb? Duro dhe ca, hë, vëlla! — Pas pak shtoi me zë tjetër: — Ore, për ç'zarf me dokumente flisje?

— Oh, — u dëgjua sérishmi rënkim i shokut dhe vetiu i shkoi prapë dora mbi plagë. Nuk foli dot më tej.

Ndihmësmjeku shkoi dhe hapi lugun, atë derë rrethore që shërbente për komunikim midis lokalit të dytë dhe të tretë, se mos shihte aty sekretarin e organizatës-bazë, shokun Sazan, ose komisarin e nëndetëses, që t'u thoshte për dokumentin.

— Ku a Sazani... Ku a sekretari i partisë? — u dëgjua zëri i Jakut, që bëri një përpjekje të dëshpërur për t'u ngritur në bërryla, por ata nuk e mbajtën dhe ai ra në krahët e tjetrit. Ndihmësmjeku u gëzua. Jaku tani po fliste. Kujdesi i atij që i rrinte te koka po e bënte mirë punën. I bëri me shenjë të mos fliste. Jo vetëm se nuk i bënte mirë, por edhe se donte të dëgjonte atë dialog që vinte nga lokali i dytë.

... ← Defekti. Po të mos ndodheshin në atë çast detarët sovjetikë, që u hodhën si luanë dhe e eliminuan në kohë, me kufomat tona peshkaqenët do të hanin drekën, — u dëgjua zëri i Petrovit, që e fliste rusishten me akcent të veçantë.

— Sikur të mos ndodheshit ju në anije, asnje defekt nuk do të kishte ndodhur. Për sa ndodhi, shkaqet ne i kemi të qarta. Detari shqiptar Jak Lisi, para se ta mundte dhimbja e plagës dhe të binte në kllapi, e tregoi fajtorin. Ivani duhet të shkojë në gjyq ushtarak, se e hapi me kast farfallën,<sup>1)</sup> por jo vetëm ai, sepse, natyrisht, nuk mund ta ndërmerrte detari, një hap kaq të rrezikshëm, me kokën e tij, — tha komisari i nëndetëses, një malësor trupgjatë i ardhur këtu që në ditët e Çlirimit.

— Protestoj! Ju i besoni një buzëqumështi. Jaku ka folur nga frika. Kërkoj kthimin e nëndetëses në bazë dhe verifikimin e defektit atje.

— Për ne shkaku i «defektit» është i qartë, — e ndërpren komisari.

— Ndërsa për ne, jo, — kundërshtoi Petrovi. — Për ekuipazhin sovjetik nuk ka asnje garanci jete duke lundruar në një anije me detarë të pazotë, si detarët shqiptarë. Këmbëngul, të kthehem i në bazë.

— Hollë e paskeni menduar, shoku Petrov, — tha komisari shqiptar. — Shkaktuat një defekt artificial ku u plagos rëndë një nga detarët tanë, krijuat panik në radhët tuaja e tani, që ujku duket sa një ujk, bërtitni: «hajdeni të kérkojmë gjurmët». Ja ku po jua them: nëndetësja do të vazhdojë lundrimin sipas planit të aprovar. Do të kryejmë edhe qitje me armët e nënüşhme. Sa për «garancinë», ne shqiptarët kemi një thënie popullore: *kush ka frikë nga peshkaqenët, të mos lundrojë. në det.* Kemi dhe një lanxhë. Frikacakët mund të zbrësin, se bregu është afër.

---

1) një rubinet që lejon futjen e ujit nga tubat e ajrimit

— Shoku... kjo është marrëzi. Shoku komisar, ju keni njeri të plagosur rëndë. Unë... ne...

— Jaku ndihet më mirë, megjithatë, kur je në det, në lundrime, je si në luftë e në luftë ndodhin gjëra të tillë, aq më tepër kur ke në krahë «shokë të tillë besnikë», apo jo, shoku Petrov?

Jaku, që dëgjonte me vëmendje dialogun e dy njerëzve me gjakra të ndezura, por që e mbanin veten, siç ndodh me kapedanët kur janë në furtunë, e kuptoi komisarin dhe iu duk sikur një fllad i lehtë i pérthau djersët e ballit. Edhe plaga sikur po i dhimbte më pak.

Komisari ishte kërrusur për të hyrë në atë portë të ngushtë rrethore, për në lokalin ku ndodhej i sëmuiri. Nga pas vinte zëri i ngjirur i Petrovit:

— Këta nuk duan as njerëzit e tyre. Detar Jaku heq e vuan, këta... duan...

Po komisari sikur nuk dëgjonte nga ai vesh. Ai u përkul i téri mbi shtratin e Jakut dhe i vuri dorën e madhe mbi ballë, pasi i dha shenjë ndihmës-mjekut të mos ngrihej në këmbë.

— Si ndihet, — pyeti komisari, pa ia ndarë sytë fytyrës së djersitur të detarit.

— Më mirë, shoku komisar. Sa erdhi në vete, pyeti për shokun Sazan. Ndoshta se ka atë «provimin» për të dhënë, por të shohim se mos...

— Ivani më koriti, — u dëgjua zëri i mekur i Jakut, që u përpinq të ngrihej se, si dukej, kishte ndier dhe njobur zérin e épriorit. — Zarfin e vulosun ma dha sekretari... për Sazanin, ku a ai? U korita, o komisar.

— Ti, Jak, jo vetëm s'ke asnë faj, por veprove si detar i vërtetë. U tregove edhe të huajve si duhet mbrojturjeta e shokëve dhe shtëpia e arma jonë, nën-detësja.

Këto fjalë të thëna aq ngrohtë nga komisari, nuk sollën asgjë të re në fytyrën e malësorit të plagosur. Të paktën kështu iu duk komisarit. Ndofta se ai nuk mundi t'ia shihte mirë tiparet në ato caste, mbasi në lokal kishte hyrë oficeri rus Petrovi, hija e stërmadhe e të cilit i mbuloi fytyrën Jakut, apo se turpi kishte

peshë më të rëndë për malësorin sesa fjalët e thëna prej eprorit. Pás pak erdhi edhe kryemekaniku i anijes, Sazani. Atë komunistët e nënëdetëses e kishin zgjedhur sekretar të organizatës-bazë. Jaku në qast, sa pa sekretarin, e gjelltiti një «oh», për të mos ia ndier i huaji.

— Me sa shoh unë, heroi ynë ndihet më mirë dhe është gati të japë dhe një provim tjetër, — tha Sazani, duke parë me dashamirësi nga Jaku. Sytë e sekretarit shkëlqenin.

— Duhet të qëndrojë, pastaj, po qe nevoja, e nisim për spital, — tha ai.

— Natyrisht, detari nuk e braktis pozicionin pa kryer deri më një detyrën, — tha komisari duke buzëqeshur, pa ia hedhur sytë fare Petrovit.

— Ashtu është, ndryshe do të na duhet ta shtyjmë një muaj pranimin në Parti, — tha Sazani duke vështruar edhe nga ndihmësmjeku, si për të marrë pëlqimin e tij.

— Nuk e di çfarë thotë medicina, — foli komisari, — se Jaku është dakord.

— Mund të qëndrojë, — tha ndihmësmjeku. — Më të vështirën e kaloi. — Ai deshi të përmendte çështjen e zarfit me dokumentet sekrete, por i përbajti fjalët kur pa hijen e trupit të Petrovit mbi shtratin e Jakut dhe sytë e mëdhenj të të plagosurit që u lëngështuan.

— Shoku Sazan, unë u korita... Zarfi i sekretarit të byrosë...

— Ato që ke për të thënë, mbaji, t'ua tregosh edhe shokëve në mbledhje, — e ndërpren komisari. Ishte qasti kur Sazani sa doli të lajmëronte komunistët për t'u mbledhur.

Komunistët shqiptarë nisen të mbushnin lokalin e dytë. Nga ai lokal dolën Petrovi dhe rusët e tjerë, siç del uji i tepërt nga cisternat, kur shfryhen ballastrat. Ata, nëpërmjet Petrovit, bënë edhe një orvajtje tjetër për të mos lejuar qëndrimin e mëtejshëm të anijes në det, aq më tepër kur morën me mend rëndësinë e kësaj

mbledhjeje. Ata e dinin se vendasit do të dilnin nga kjo mbledhje partie me mendim unanim, për ta vazhduar lundrimin deri në fund, sipas programit stërvitor. Po komisari nuk ia zgjati prapë Petrovit. Ai u mjaftua me atë shprehjen që i tha më parë: «Doni të dilni, ja ku është lanxha dhe ja ku është bregu. Nuk doni? Mirë, rrini, vetëm mos na pengoni, se ne do të zhvillojmë dhe mbledhjen dhe qitjen me silur.» Ai i tha rusit se, pas qitjes, që përbënte fazën e fundit të kësaj stërvitjeje, anija kalonte tërësisht në një ekui-pazh, në atë të zotërve të vërtetë të saj, shqiptarëve.

U ndje një tronditje e lehtë. Nëndetësja u ul këmbë-kryq në fund të detit.

Në lokalini e dytë po mblidheshin komunistët. Hyri edhe komandanti, që kërkoi me sy Jakun, dhe shkoi e u ul në cep të krevatit tij.

— Fillojmö, shokë, — tha Sazani. — Sipas planit të punës, këtë mbledhje do ta zhvillonim në bazë, po pengesat e sjella dhe rr Ethanat që dihen, prunë shtyrjen e plotësimit të detyrës stërvitore dhe zgjatën kohën e qëndrimit në det. Ne nuk mund ta shtyjmë mbledhjen e partisë. Do të analizojmë në rend të ditës dy çështje: shqyrtimin e dokumenteve të shokut Jak Lisi, për ta pranuar si kandidat për anëtar partie dhe intensifikimin e punës...

— Shoku Sazan, unë... — Zëri i Jakut i bëri të gjithë të vështronin nga ai. Ky zë e bëri edhe Sazanin ta ndërpriste fjalën.

— Me leje. Mos shoku Jak nuk ndihet mirë dhe do të qe e udhës ta shtynim pranimin e të vazhdonim me çështjen e dytë të rendit të ditës? — tha një komunist nga ata të lokalit të motorëve.

— Unë nuk jam për ta shtyrë, — tha Sazani. — Gjatë Luftës pranimi në parti bëhej, në raste të veçanta, edhe në mungesë, madje edhe pas vdekjes, kurse ne Jak Lisi n e kemi të fortë si lis. Fundi i fundit le të flasë dhe vëtë Jaku.

— Ndihem bash mir, po kam hupë zarfin... Më pati dhanë sekretari i byrosë së partisë për shokun Sa-

zap. Unë... nuk e meritoj se... Po njaj Ivani... — Jaku nuk mundi ta mbaronte mendimin, se u mbulua në djersë.

— A për dokumentet e tua e ke fjalën? — pyeti Sazani dhe vuri buzën në gaz. Ai u hodhi një vështrim kuptimplotë shokëve dhe nxori zafirin e zhübrosur e të tkurrur nga uji i kripur. — Në kohën që rusët, natyrish jo pa qëllim, provokuan avarinë nëpërmjet Ivanit, për ta shtyrë edhe për një kohë tjetër të pacaktuar dorëzimin e nëndetëseve, meqë lokal i im ndodhet afër tuajit, isha ndër të parët që hyra atje. Vështrova me vëmendje fytyrat e njerëzve, detarin tonë, Ivanin, dhe... Bashkë me zafirin e hapur në dorë të sekretarit të organizatës ndodhej dhe tesera e rinisë e detarit Jak Lisi. Edhe ajo ishte gjakosur.

— E dija që Jaku i kishte këto dokumente. Unë vetë e kisha dérguar atë te sekretari i byrosë për ato. Kjo ishte dhe një nga arsyet që u sula ndër të parët drejt lokalit të avarisë. Në këto dokumente është mendimi i Komitetit të Partisë të rrëthit, mendim që shprehet pozitivisht për këtë pranim, janë rekomandimet e shokëve komunistë për Jakun, të cilat e sigurojnë Partinë për ta pranuar shokun Jak dhe disa dokumente të tjera, të cilat, në sajë të vetë Jakut, nuk ranë në duart e të huajve. Siç e shihni, hymë në çështjen e parë të rendit të ditës. Kush do të diskutojë tanë për shokun Jak, që ta pranojmë në gjirin tonë?

Kur dëgjoi këto fjalë, Jak Lisit iu gjallëruan sytë dhe i erdhi fytyra në vend. Eh, ç'gëzim dhe krenari pasqyronin ata sy malësori.

— Unë jam një nga ata që rekomandojnë shokun Jak për t'u pranuar në Parti, — tha një hambarist me shenja grasoje në duar. — Jaku është shtresë e varfër, familje e lidhur me Lëvizjen. Isha një nga dëshmitarët e aktit të tij trimëror. Shok i sakrificës! Duke njobur dhe vlerësuar mirë situatën, kam bindjen se njerëz si Jaku e forcojnë Partinë tonë.

— Kam shëruar shumë plagë shokësh, — tha ndihmësmjeku. — Më e vështirë për zanatin tonë është shë-

rimi i pacientëve kur kanë nga dy plagë. Turpi se mos kishte humbur zarfi e binte në dorë të të huajit, lufta e brendshme e shokut tonë Jak, të ngjallin respekt të thellë. Kam mendimin se shokë së Jaku i forcojnë radhët tona.

— Edhe unë jam dakort me shokët që folën këtu, — tha Sazani. — Siç e shihni, këto dokumente janë vulosur edhe me gjak. Mendoj t'ia japim fjalën shokut Jak dhe të kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

— S'kam çà me thanë, shokë, — nisi Jaku, duke u munduar të ngrihej. — Për malësorin gjanat ma të shtrenjta janë, siç dhe kanë qenë, syni dhe gishti i pushkës. Të jem komunist, pa të mos e kem një sy, se kam me mësue me shti me synin tjetër. — Ai priti ca, sa mbushi prapë kraharorin me frymë, dhe vazhdoi: — Vetëm me ba vaki me më nxjerrë në breg e me më nisë pér spital pa e ndje atë tutjen e korpusit nga qitja me silur, ka me më dhamë plaga, vëllazën. Tash ndihem si kokrra e mollës, apo jo, doktor?

Ndihmësmjeku pohoi me kokë.

Kështu vazhdoi ajo mbledhje atje, në llogoren detare, ulur këmbëkryq në fund të detit, në lokalin e tretë, që është «salla» më e preferuar e nënujësve.

Sa mbaroi edhe pika e dytë e rendit të ditës e u nxorën vendimet përkatëse, komandanti shkoi në lokalin e dytë dhe thirri bocmanin, të cilin e urdhëroi ta nxirrte nëndetësen në sipërfaqe. Pastaj udhëzoi radiometristin dhe radistin të merrnin kontakt me shenjën dhe të niseshin drejt saj pér qitje me silur.

I nervozuar, Petrovi nxori «Diamantin» dhe u bë gati ta ndizte në lokalin e tretë. Kur dikush e kujtoi se atje ishte rreptësisht e ndaluar pirja e cigares, oficeri i huaj e mblohdhi shuk tërë paketën. Mandej ai nisi të ngjiste shkallët e lugut pér të dalë në kuvertë. Për këtë ai kaloi nëpër lokalin e dytë, ku ndodheshin komisari dhe komandanti shqiptar. Ata e panë, u panë dhe vetë sy më sy.

— Mos u vononi shumë se, sa të marrim kontakt

me shenjën, do të zhytemi dhe do të biem në kurs luftarak për qitje, — tha komisari.

— Çto skazall on?<sup>1)</sup> — foli Petrovi sikur të mos kishte dëgjuar mirë atë që i tha komisari shqiptar. Pastaj u kujtua apo ia sqaroi oficeri që e shoqëronte nëpër shkallë. Petrovit iu morën mendtë dhe shtrenëgoi edhe më fort në pëllëmbë paketën «Diamant», që e kishte futur ashtu shuk në xhep.

— Shoku komandant, distanca 50. Pelengu 270, një objekt i madh lundron me kurs për në lindje, — raportoi radiometristi pa i hequr sytë nga ekranin.

— Eshtë shenja jonë e qitjes, — tha komandanti i nënëdetëses. — Kursi 270, — urdhëroi pas pak komandanti duke e ngritur zérin. Pranë kishte dhe dy shokë të tjerë. Nga lugu i hapur i dëgjonte këto komanda edhe detar Jaku më atë gjoksin e tij të fashuar, që i hidhej nga gëzimi. Kishte dhënë një nga provimet më të rëndësishme të jetës. Tani, bashkë me shokët, shkonte me tërë forcën e motorëve para, për të dhënë provimin tjetër, atë kolektiv, për të cilin kishte besim se do ta jepnin me sukses.

1980

---

1) Çfarë tha ai? (rusisht)

## Fahri Balliu

### USHTARI I LIRUAR

Ushtari i liruar ka një gëzim në shpirt. E ky gëzim çikëron e çekëron si piklat e kthjellëta të ujit që, kur mblidhen, vërshojnë me gurgullimë. Ai ndien kënaqësi kur sheh se e vështrojnë të tjerët. Këtë kënaqësi ua fsheh të rriturve, por ua shfaq fëmijëve. Edhe Tanushi është i gëzuar.

Ai vjen i gjatë dhe është fytyrëmadh. Si çdo ushtar i liruar, edhe ai nxiton shumë, ndaj, nga ato që i kap syri rrëth e rrrotull, ai vetëm rrugës i kushton vëmendje. Nuk e ka në natyrë dhe s'ka as kohë të shohë qielin e natës së nëntorit, që po mbarset me re të errëta, si vetë nata. Nuk i bie ndër mend të kërkojë me sy hënën e yjet, që përpëliten me një drithë verdha-cuke gjersa mbyten në tallazin e stuhiqë, që po i afrohet tokës. Jo, ai, madje as që nuk pyet dhe, për më tepër, e di mirë që natyra do t'i tretë fenomenet e saj nën një quell të kaltër, prandaj, këtij ushtari të liruar, i vjen edhe për të qeshur nga ky inat fëmijësh.

Veç të tjerash, Tanushi është fshatar dhe di të

flasë me natyrën. Atij i vjen keq që pikërisht atë ditë ajo po shungullonte pa pushim. Megjithatë ai kurrë nuk e mallkon, por e mund. Që ta mundë atë, kjo për Tashushin nuk është e vështirë. Sepse ai plagën përvëluesë të plumbit e ka krahasuar me një qëndismë. E nuk e ka thënë këtë ashtu kot, në erë. Tanushi e kishte parë atë plagë në trupin e vet. Si e ku ishte plagosur, që sekret. Çdo ushtar i liruar ruan është tilla, po, një ushtar që ka shërbyer në kufi, ruan ca më shumë. Vërtet, Tanushit, plaga që ia kishte përgjakur krahun, i ishte dukur si lulëkuqe, si ato lulet që qëndiste e motra me penj të kuq, të ndezur... Qëndroi dhe pa sa rrugë kishte bërë. Nga qyteti që nisur vonë dhe nata e kishte zënë më të dalë të tij. Nuk kishte ecur keq, por në një natë të tillë duhet ecur revan, që t'i lësh prapa krahëve retë e ngarkuara me shi. Ai e harroi rrugën që duhej të bënte. U ul për një çast mbi një gur, ndanë rrugës së ngushtë, që kalonte nën ara e mbi ara, gjersa soste në fshatin e tij.

Një mendim i kaloi vetëtimthi në kokë dhe e ligështoi. Të ligështohej një ushtar! Tanushi nuk do ta tregonte kurrë, por, për çudi, nuk i erdhi inat me veten, sepse...

Ai kishte ikur larg dhe përgjithmonë nga posta... Ndjeu mallin e parë për të. Ky mall që gatuar në heshtje, nën zhurmat e gjëzimit të asaj dite. Mbështetje ai mall kishte nisur tek ai që nga çasti i heqjes së kapelës dhe të ripit, mbështetje, dhe më parë, mbështetje, kur komisari Mehdiu u tha:

— Kështu, djema, po shkoni në një front tjeter...

Me siguri atë çast duhej të kishte nisur ai mall, që po e pushtonte ca e nga ca.

«Ja, edhe gjëzimi paska dhimbje!» Dhe shokët e tij, kudo që ishin, me siguri ndienin mall. Dhe posta, atje larg, ndien mall dhe fizarmonika e Vasos, që rri në heshtje, ndien mall...

— Hë, Tano, pse hesht, fol! — i thoshte komisari.

— Tanua ndaj është i vetmi për zbulim, se e ka të vështirë të flasë, — thoshte Vasoja.

— Hë, Tano; g'thua për këtë? — e pyeste duke buzëqeshur komisari.

— Eshtë vetë njeriu ashtu, domethënë, jam unë, — ia kthente Tanushi. Atë kohë Vasoja ia kristë së qeshurës.

— Mos u bëj llafazan, Tano! — i thoshte dhe niste t'i binte fizarmonikës. Jonet eëmbla që dilnin prej saj përkundeshin me një jehonë të zgjatur dhe Tanushi e mbante vesh tingullin gjersa shuhej. Ky cast i pëlqente shumë dhe atëherë ai mendonte gjëra të ndryshme, të largëta e të afërtë, por të gjitha të mira e të bukurë. Pastaj... ë... kishtë ardhur gushti. Ditë të nxehta dhe gryka e automatikut të përvëlonte duart. Në një nga këto ditë Vasoja shkroi mbi një letër të bardhë:

U ringjall Rusia e carit dhe e careshës... Më vonë, në pikat e vrojtimit, mësuani edhe lajmin e daljes së vendit nga Traktati i Varshavës. Gjithçka e shihni nëpërmjet thepit të pushkës. E çuditshime, Vasoja ratë kohë do të martohej. Ai deshi t'i njoftonte njerëzit e shtëpisë ta shtyin, dasmën, po komisar Mehdiu nuk e lejoi. Komanda i miratoi lejën e zakonshme. I uruan të gjithë «jetë të lumtur» dhe ai, në të ikur, duke qeshur, tha:

— Pra, më urdhëruat të martohemi.

— Po! — i që përgjigjur Tanushi.

— Urdhri juaj do të zbatohet; — kishtë thirrur ai dhe që lëshuar më vrapi tatëpjetë, duke mbajtur me një dorë kapelen, që të mos i binte.

Tanushi u ngrit dhe zuri të ecter. Pika shiu i ranë në kokën e qethur, pastaj në fytyrë, e ai i fshiu me kurizim e dorës, duke ecur nëpër natën e nëntorit, që priste shtërgatën. Vështroi andej nga ishin arat me misër. Më pas rruga erdhë e u bë malore dhe ai përkuli pak shpinën. Mendimet nuk i reshtnin. «Ushtria në jetën e njeriut qénka si ai brezi që vihet në mür e për të cilin do të flasësh sa herë që flet përndertesën.» Dhe ky brez eshtë një kufiq që nuq ndan vetëm ca vite nga të tjerat, jo, ai ndan diçka shumë të madhe dhe i bën njerëzit ta kuptojnë më mirë jetën. Tanushi atje

kishte parë forcën e madhe të vendit dhe të tijën. Nisi të fërshellente një melodi. Në fillim ia mori nën buzë e pastaj fort:

... *Muzgu bie, krismat s'ndihen,  
zjarri i luftës perëndon...*

Melodja dhe ritmi i dridheshin brenda vetes dhe nuk i ndiente purtekat e shiut oë e fshikullonin. La prapa arën e gjerë të Perivolit dhe mori rrugën anës kanalit ujites. Ai uturinte me një zhurmë tanku. Ky kanal, mi kilometra i gjatë, ishte ringjallja e fshatrave të asaj ane. Qe gati gjashtë metra i gjerë, por atë natë dukej si lumë. Ishte tërbuar e hedhur keqas, duke gërryer me sa mundte anët e tij të pambrojtura. Ky kanal qe hapur para se Tanushi të ikte ushtar dhe, si fshatar i asaj ane, ai kishte punuar madje në kilometrat e fundit...

Anës kanalit qenë mbjellë fidanë plepash. Nëpërtat kalonte edhe rruga e ngushtë që zbardhë pak. Tanushi vështroi plepat, që u qe trashur trungu gati dy grushte. Pastaj hodhi sytë më tutje dhe mezi shqoi dritën e shtëpisë së parë të Zejmenit. Pas këtij fshati, shtëpia e parë ishte e tij. Zejmeni kishte pak shtëpi dhe ato larg njëra-tjetrës. Tanushi ndjeu t'i llokoçitej uji rrëpër këmbë dhe kérceu pak. Atë kohë, 5-6 metra më tutje, atje ku faqja e kanalit vinte si e ngrënë, shpërtheu uji, që me potere u derdh poshtë, drejt arës, ku kapicat e misrit qenë mbuluar me plastmase, që ndritnin.

Tanushi lëvizzi menjëherë dhe filloi të shqyente degë km të mundte. Por uji i thyente, i mblidhët shuk e i flakta jashtë asaj së çare. Ai zuri të zgjidhët degë më të trasha, i thyente me zor e duart po i përgjakeshin. U zhvesh dhe i futi rrrobat diku që të mbroheshin sado pak nga shiu. Trupin tejembanë ia përshkoi një e dridhur. I thuri sa mundi ato degë që kishte mbledhur dhe i fut në ujin e ftohtë brisk. Mundi t'i vendoste disi ato qëndruan. I futi nën këmbë dhe i ngjeshti në

fund tē kanalit. Uii e mbuloi dhe ai u zhyt. Kur doli, pa ndanë rrugës, dy veta me fenerë, që po afroheshin. Nuk dukeshin mirë. Tanushi doli nga uji dhe njerëzit me fener iu afroan.

— Cili je ti? — e pyeti i pari duke i bërtitur fort.  
— Nië ushtar i liruar, po shkoja në shtëpi.

— Unë jam Rexhua me gjithë time bijë. Dëgjova kanalin që uturinte dhe e mora me mend se do tē jenë bllokuar shkarkuesit e nivitet. S'qen kam gabuar edhe pér tē çarën, — tha burri, duke vështruar aty.

— Baba, shih, shih, në arë gati po rrriedh një kanal më vete, — tha vajza dhe zëri i dobët i saj u mbyt nga zhurma e ujit.

— Do tē shkoi tē hap shkarkuesit. Katina, ndihmoji ushtarit! — i tha Rexhoja vajzës dhe vetë bëri pér nga shkarkuesit. Degët i mblidhnin bashkë dhe ajo ia jepte kur ai futej brenda. Ishte nja shtatëmbëdhietë vjeçë. Fustani iu quall nga shiu e iu ngjit ad shumë pas trunit sa e pengonte tē lëvizte dhe e bënte tē skuqeji. Flokët e gjatë e tē lagur i rrinin mbi supe dhe nga lëvizjet e sai bënin një valle tē lodhur. Në fytvrë ishte bardhoshe, ndaj ushtari i liruar e shihte mirë. Katinës ushtari i dukej i fortë dhe, kur ai zhvtej, priste me ankth tē dilte. E pastaj tē dv shiheshin pér një çast në sy. Kur doli një herë nga uji, ajo e pyeti:

— U lodhe?

— Jo! — tha ai dhe i buzëqeshi. Ndërsa ajo, e turpëruar, nisi tē shqvente degë pemësh. Tanushi u mundua tē zvarriste një trung tē prerë. E ndihmoi dhe Katina, giersa e afroan buzë kanalit. Atëherë ai u fut brenda dhe e tërhoqi trungun pas vetes. Krahu, ku kishte plagë, iu mpi dhe ndieu ca vickime tē forta.

«Dhemb lulëkuqja», — tha me vete. Nga dhimbja shtrembëroi fytvrén. Katina ia nguli sytë e zinj.

— U vrave?

Ai tundi pak kokën dhe, kur e mbështeti trungun pas së çarës, pa se niveli i ujit ra shumë dhe rrjedhja e tij u dobësua. Ata vështruan andej nga iku Rexho-

ja. Jo shumë larg dëgjohej zhurma e vrundujve të ujit, që dilnin në kanalet anësore.

Ata hodhën edhe të tjera shkurre aty, gjersa nga e çara po dilte pérherë e më pak ujë. Rexhoja i thirri të zbritnin poshtë, në arën me misër. Tanushi ndjeu një marrament hënë lehtë nga lodhja. U hodh në arën me misër dhe vështroi rrugën që kishte marrë uji mes pér mes misrave. Katinës ara iu duk si një qenie e plagosur. E kishte punuar me duart e saj dhe që ara më e madhe dhe më pjellore e fshatit.

— Të nxjerrim misrin e t'i hapim ujit rrugë pér të kulluar — foli i ati që tutje.

Tanushi kishte ngulur duart në baltë e gati me thonj hapte një viië kulluese. Ishte keq sa të hynte uji, se pastaj ai e zgjeronte vetë. Rexhoja iu afrua ta ndihmonte dhe i tha:

— Të mbahemi sa të viinë ata të fshatit. Kam dérguar djalin t'i thérresë. Eshtë i vogël po... vjen ai, vjen.

Tanushi e pa tek tundte kokën me besim pér ato që thoshte dhe shtëngoi duart pas baltës. Në ujin verdhash të kanalit notonin kallinitë. Tanushi e kuptoi se muskujt po i kapitëshin, ngaqë krahët po i rëndoheshin. Edhe në kokë nuk ndiente kthjellësinë e mëparshme. Vështroi nga Katina. Ajo, e thyer në mes, mblidhët kallinitë e rënduar nga uji. Ai, pa e kuptuar, dhe vetë zuri të mblidhët kallinitë e asaj ane. Kur u afrua, vuri re se ajo me një dorë i mblidhët dhe me tjetrën i mbante pas gjoksit, si një fëmijë. Tanushit i lindi një mendim i guximshëm. Edhe Katina do të kishte fëmijë një ditë. Si do të ishin ata?... Ajo mblidhët kallini dhe qante. Supet i dridheshin nga ngashërimi.

— Përse qan? — e pyeti Tanushi.

— Për misrin... pér arën e plagosur...

Tanushi u têrhoq mënjanë dhe nuk deshi ta pyeste më. Ai thellë-thellë vetes kishte dëshirë ta dëgjonte atë që qante pér misrin. Ai donte të shihte edhe lotët. Këta lot që derdheshin pér... Si ishin këta lot? A ishin si lotët e çdo dashurie që ndien njeriu? Ai deshi

të pyeste edhe Katinën, po nuk guxoi. Tanushi, nëpër atë kapitje të rëndë, mendoi se një nuse e tillë, që qante për misrin, i duhej atij.

Këto mendime ia ndërprenë zërat e fshatarëve. Fenerët e tyre mbinë nëpër arë papritmas. Ata kishin marrë me vete thasë e mushamara. Nuk flisnin, ndonëse donin të dinin si e ku. E aq më tepër ua nxiste kureshtjen fytyra e njojur dhe e panjohur e ushtarit të liruar. Kur nata zuri të trembej prej agut, mbaruan, dhe Rexhoja nisi t'u tregonte. Ata i dhanë dorën Tanushit. Rexhoja s'ia lëshonte krahun Tanushit. dhe vazhdonte ta tërhiqte për në shtëpi, po tjetri kundërshtonte duke thënë se i duhej të ikte patjetër, sepse e prisnin në shtëpi. Ashtu menduan edhe fshatarët kur thanë:

— Lëre, Rexho, e pret nëna.

— Unë do të vij përsëri, — tha Tanushi. Këtë e dëgjoi edhe Katina, që ende kishte në fytyrë vragën e lotëve:

Drita e parë, e zbehtë e mëngjesit, e zuri përsëri në rrugë. Vërtet qe vonuar ca, po tani mund të mendonte jo vetëm pér komisar Méhdien apo Vason, por edhe pér Rexhon, pér fshatarët, pér fenerët si yje dhe... pér Katinën, me vragën e lotëve mbi faqet bardhoshë. Kur u dukën shtëpitë e para të fshatit të tij, ai përsëri ndjeu brenda vetes ato meloditë e dashura dhe mendoi se vërtet një ushtar i liruar nxiton shumë, po nxiton aq sa mund të nxitohet në llogore...

1980

# Faik Ballanca

## KY ZHEG QË PËRVELON

Ai dukej sikur nuk e vinte re fare shijen e rakisë. Ishte një raki frutash që mua më digje në qie llzë e në gurmaz. Ishim shtruar mbi postiqe pranë sobës. I zoti i shtëpisë na i mbushte gotat.

— Do t'ju kisha ftuar në shtëpinë, por s'kam asnjë kërcu dru, — tha kryetari i kooperativës, duke mbajtur gotën e rakisë në dorën e tij të madhe. — E kuptoni? Jemi keq për dru. Kur vijnë njerëzit nga puna, shkulin kërcunj, i vënë mbi shpinë dhe i sjellin në shtëpi. Ja ç'do të thotë, kur s'ke pyllin tënd.

Ai fliste më shumë se të gjithë ne. Fytyna e tij e mbushur shkëlqente nga sinqueriteti.

— Prandaj u vonove? — e pyeti instruktori i komitetit të partisë duke buzëqeshur. — Po si ia bën? Tërë dimrin pa dru rri?

Kryetari i kooperativës e zbrazi gotën e rakisë dhe përplasi buzët.

— Po, — foli ai, — prandaj u vonova. Mbase i fton ndonjë tjetër në shtëpi, thashë me vete. Dhe ja ku

më doli mësuesi përpara. Sa për të mërdhirë, unë s'ndiej kurrë të ftohtë. Zhegun po, atë e kam frikë.

Ai e ngriti përsëri gotën.

— S'është e mundur që të mos e ndiesh të ftohtët, — thashë unë.

— E ndiej, e ndiej, — tha ai, — por s'çaj kokën për të. Më vjen ca keq për nënën. Mblidhet tërë ditën me batanije krahëve dhe thotë: «sillna dru». Por s'më del koha, bre vëllezër. Pastaj, dhe harroj. Si i thonë: po s'të dogji lëkura vetë, edhe s'të kruhet.

— E çuditshme! — tha mësuesi. — S'ndien vërtet të ftohtë. Kur isha njëherë në kampin e Razmës, njo-ha një shofer që kishte një rrufë të tmerrshme. Sesi i thoshte, rrufë alergjike më duket. Tërë pranverën me rrufë, se e ngacmonte poleni i luleve. Në qytet bënte vapë, por lart në male pranvera vonohet. Çelnin bari e lulet. E kapi rrufa që në makinë dhe tërë kohën ndenji me shami në dorë. Pesëmbëdhjetë ditë me radhë, e besoni? Sa erdhëm në qytet, i pushuan dhe hundët.

— Kurse mua s'më ngacmojnë fare lulet, — tha kryetari i kooperativës. — Më pëlqeijnë. Sikur të mos vinte vapa pas tyre, do të ma kishte qejfi të merresha me to.

— Ty të ngacmojnë njerëzit, Besim, — tha instruktori i komitetit të partisë. — Të kujtohet atëherë? Ama, na mërzite me ato letrat e tua.

Besimi i mbërtheu sytë mbi gotën e rakisë. Në anë të ballit iu formuan ca vija të prera. Ai e vërtiti gotën midis gishtérinjve të trashë e të fryrë.

— Të nxeh të që kam ndier atëherë! — tha ai duke tundur kokën ngadalë. — Thashë se po më digej tokë nën këmbë. Nuk e bëja dot atë punë unë. Do të merresha më qafë.

— Na dërgonte letra, — tha instruktori i komitetit të partisë. — Cdo dy-tri ditë vinte një letër në komitet. Lëre sa do t'i ketë mërzitur ata të ministri-së dhe të degës. Nuk donte të rrinte në kufi.

— Në kufi? Përse nuk doje të rrije? — e pyeta unë.

Ai tundi përsëri kokën dhe tha sikur të mos e kishte dëgjuar fare pyetjen time.

— Po të rrija edhe ca, do t'i vrisja të téré ata që do të kapja. Nuk e kuption ti. Nuk ke qenë andej gjatë Luftës kur bridhite Isai fshatrave.

— Pse?

— S'kishte burrë më të poshtër, — tha Besimi. Në përpjekje thyhej. Por ishte i vetmi, ama, që turrej pas grave. Ptu! Nuk e kuption ti.

Besimi piu përsëri raki, sikur donte ta shuanet etjen me ato gllénjka përvëluese.

— E di, — tha instruktori. — Pasi e vranë Isanë në Fier, e zumë edhe Fasliun. Unë isha në gjyq bille. Çfarë s'u tha atje. Pleq të masakruar, gra të përdhunuara e të vrarë, bile një fëmije ia kishte prerë këmbën me sharrë. Kam marrë pjesë në sulmin mbi Luar. Fasliun e pushkatuam buzë lumi.

— Po ç'ka të bëjë kjo me largimin tënd nga kufiri? — e pyeta unë kryetarin e kooperativës.

— Pse, nuk e di ç'më ndodhi? — tha Besimi.

— Jo.

Kryetari i kooperativës u shtrua mirë mbi postime dhe hapi sytë me mosbesim:

— Ah! — tha ai duke u kthyer përsëri nga inspektori i komitetit të partisë. — Të kisha qenë unë atëherë buzë lumi! Ç'e do. Më kaluan në Veri. Pastaj mbeta kufirit dhjetë vjet me radhë. Po dëgjoni, dëgjoni!

E shtyu gotën e rakisë mbi sofër dhe i mblođhi këmbët kryq.

— T'émën, — tha. — Desh më mori më qafë maskarai.

Ai kroi faqen, sikur do të nxirrte gjak.

— Isha komandant poste, — tha. — Dhe isha mësuar me këtë punë. Téré kohën rrija me ushtarët dhe vetëm një herë në dy-tri javë shkoja në shtëpi.

«Ti s'je njeri, — më thoshtë nëna. — Po si i lë pleqtë vetëm? As që të bie ndër mend për ne.»

Plaku më rrojti 90 e kusur vjet. Dhe sa qe ai, nuk kisha merak për shtëpinë. Se qe i këmbës dhe i dorës. Derisa i doli shpirti, punoi im atë. Dhe kur vdiq, më erdhi çudi, lajmi më ra si bëombë. Më bëhej sikur nuk do të vdiste kurrë, aq i fortë dukej. Ra për të fjetur në darkë vonë dhe nuk u ngrit më. Nejse.

Nuk isha martuar dhe nuk jam martuar edhe sot e kësaj ditë. Rrjaja në postë. Haja e pijë mirë. Bridhja tërë ditën në këmbë, se më duheshin tri orë që t'i kontrolloja të gjitha vendrojat.

Ama ushtarët copë bëheshin për mua. Nejse.

Një ditë po rrjaja shtrirë përparrë postës. Atje ishte një lëndinë e vogël me bár, që kishte filluar të thahej. Ne e nxirrnim ujin nga pusi dhe nuk e ujitnim dot të tërë lëndinën me kova. Mirë do të qe ta ujtinim, por ushtarët lôdheshin. Pastaj kishim, edhe ekonominë ndihmëse.

Tre plepa, jo shumë të mëdhenj, nga ata që e kanë kurorën të mbledhur, e mbulonin me hije të tërë fushën përparrë postës. Plepat as që fëshférinin, dhe unë shikoja qielin pa re. Bënte nxehjtë. Aq nxehjtë, sa zogjtë dhe pëllumbat e postës kishin hapur sqepin dhe u dridhej gusha.

Po mendoja ta futja kokën në një kovë me ujë, por ora ishte ende nëntë paradreke dhe të nxehjtët do të shtohej. Ishte gusht. Dhe vec atyre plepave, rrëth e qark nuk shihje asnjë pemë tjetër. Tutje, larg, ngriheshin kodra të zhveshura, yetëm gur e shtuf. Atje kalonte kufiri.

Kisha myllur sytë dhe më dukej sikur mezi rrjaja frymë, kur ra më forcë zilja e telefonit. U ngrita me vrapi dhe u futai në postë. Brenda mezi u mësova me mungesën e drithës, se jashtë të vërbonte dielli. E kapa telefonin dhe thirra:

— Alo! Alo! Çfarë?

— Alarm!, — u dëgjuua matanë zëri i kryetarit të Degës.

Ai fliste nga qyleti, dhe zëri vinte i dobët. Filli i gjatë i telefonit fushor, që shtrihej kodrave e fushës, bënte një zhurmë si fishkëllimë gjarpri, apo si një shufër që pret erën.

«Ku u gjet ky alarm tashti!» — thashë me vete.

— Merrni të gjitha masat! — tha kryetari i Degës së Punëve të Brendshme. — Zini vendet e caktuarra dhe blokon kufirin! Dy të rinj i kanë zbritur autobusit në B. Sipas të dhënave që kemi, duan të kalojnë kufirin. Kanë marrë drejtim pér në sektorin tuaj.

— Si urdhëron! — thashë dhe e lashë receptorin në vend.

Për dy minuta ushtarët ishin rreshtuar përpara postës me automatikët në krah.

— Me vrap! — u thirra. — Për në pozicione!

Ata e dinin vetë se si duhej vepruar në të tilla raste.

Ne nisëm vrapin, ndërsa dielli na binte në fytyrë. Dëgjoja përplasjet e armëve, frymëmarrjet e vështira dhe mbë të gjitha llokoçitjen e ujit nëpër pagurë. Duhej gjysmë ore, që të arrinim të gjithë në pozicione.

Rruga ishte tërë zall e gurë, me të përpjeta dhe gropat, ku shpesh ushtarët shkisnin. Gurët e reflektoranë të tërë nxehtinë. Përpara syve tanë dridheshin avuj.

Kur ramë përdhe, në gjoks m'u ngjit bältë. Mezi e ngrita kokën. Dhe pasqë se të gjithë ushtarët po i zbraznin pagurët. Dëgjohej zhurma e mbytur e gurmazeve të etura: gët, gët, gët.

E piva edhe unë tërë ujin. Ushtarët kishin vënë armët përpara dhe prisnën.

Ndërlidhësi e shtriu telin dhe vuri telefonin fushor pranë meje, pas një shkurreje të tharë.

Dielli vazhdonte të digjite. Në qìell u shfaqën çare të rimta, por ato ishin shumë larg dhe dukej sikur nuk lëviznin fare. Dhe armët na digjnin nëpër duar.

Kaloi kohë. Shkoja në mend se shkelësit do të kishin marrë drejtim tjetër. Ndoshta mund t'i kishin zënë dhe nuk na kishin lajmëruar ende. Ndoshta ishte ndonjë alarm prove. Na kishte ndodhur disa herë të rrnim me orë të tëra nëpër pozicione, për shkaqe të ndryshme, sepse alarmi jepej edhe për dyshimin më të vogël.

Kaloi mesdita. Toka digjte gjithmonë si saç. Kaluan edhe dy orë të tjera. Në qill u shtuan retë e rimta. E bëra me mend se, kur retë do ta mbërrinin diellin do të binte telefon i dhe do të jepej urdhri që të kthehet kohët e postë. Retë e mbërritën dhe e kaluan dieillin, por telefon i nuk ra.

Kishim plot gjashtë orë që po rrnim në pritë, dhe vapa nuk po fashitej ende. Gjashtë orë që po dëgjonim këngën e gjinkallës, që s'reshtë shkurreve. Na mbiu në vesh.

Ushtarët nuk kishin ngrënë që në shtatë të niën-gjesit. Mendova të merrja telefonin dhe të lajmëroja në postë që të na sillnin të paktën nga një pikë ujë, (kazanët e gjellës nuk kishin si t'i binin aty). Po zilja ra më përpara se unë të kapja telefonin.

Kishim gjashtë orë në përgjim me shqisat të impre-hura, dhe zilja më tmerrroi si një rrymë elektrike që ta përshkon fund e krye trupin.

— Alo! — thirra duke u munduar të gëlltitja pësh-tymën, që më ishte bërë lëmsh në grykë.

— Ja unë, — tha kryetari i Degës matanë fillit.

— Ka gjë andej?

— Asgjë, — iu përgjigja.

— Jemi të sigurt se janë në sektorin tuaj. Ora po shkon pesë. Mbështetje janë fshehur shkurreve dhe presin natën. Merr tre-katër veta dhe kontrollo pyllin!

E lashë telefonin dhe pasqë tokën. Djersa formonte konturet e plota, të trupit tim. Avullonte.

Mora tre veta dhe u nisëm drejt pyllit të shku-reve. Shkurret na mbërrinin deri në gjoks. Kishte mjaft drunj të tharë që kërcitnin. Prapa nesh ishte kloni. Përpara tij shtrihej brezi i butë. Ne i kishim

prerë atje tërë shkurret dhe e kishim punuar tokën me par mendë. Megjithatë plisat ishin forcuar aq shumë, sa ishin bërë si shtuf, ku s'mbetej asnjë gjurmë.

Dërsa po kontrollohej gjithë zona dhe kishte ardhur vetë kryetari i Degës, informata duhej të ishte e sigurt. Dhe, përvëç kësaj, ata duhej të ishin shumë të rrezikshëm. Kështu mendoja.

Shkurret m'i bënин gjak krahët e djersitur. Shikoja vetëm kokat e tre ushtarëve që bënин me kujdes përpara.

«Duhet të jenë fshehur diku këtu» thashë me vete dhe një e dredhur më përshkoi shtyllën e kurrit.

Ne, ishim krejtësisht të zbuluar. Ata mund të na sulmonin papritmas nga një distance e afërt dhe mund të na vritnin lehtë edhe sikur vetëm një thikë të kishin im vete.

Ecnim...

Një zog u ngrit lart duke e mbajtur sqepin hapur. Po shikoja zogun, që u tret pas kodrave, kur ndjeva një zhurmë të befasishme pranë meje. Një masë e kuqe më kaloi vetëtimthi përpara. Pa pasur kohë të mendoja, thirra padashur:

— Ndal! — dhe arma m'u shkreh vetvetiu në ajër.

U hodha përpara dhe u mbërtheva trup me trup me dikë. Ai nuk bëri rezistencë, por mbeti në vend. Kur erdhën ushtarët, po dridhej.

— Lidheni! — thirra dhe nisa të vrapoja midis shkurreve.

Degët më çirrin dhe më gërvishtnin. Arma më pengojë pas tyre dhe unë si kisha duart të lira, që të vrapoja me të gjitha forcat.

— Ndal! — thirra përsëri, duke e ndier se po më merrej fryma. — Ndal!

Njeriu me këmishë të kuqe, që më kaloi vetëtimthi përpara syve, vraponte si i marrë, duke shkelur mbi shkurre dhe duke kërcyer mbi gropë. Ai vraponte më shpejt se unë dhe bënte zigzage nga frika se mos e qëllonim.

Ai iu afrua brezit tē butē dhe unë ndjeva tē mē binin djersë tē ftohta.

«Ç'bëjnë ushtarët? — thashë me vete. — Përse nuk e ndalojnë?»

E kuptova se asnjë nga ne nuk mund ta arrinte nē vrap. U ula nē gjunjë dhe i drejtova automatikun.

— Ndal!

— Ndal!

— Ndal!

Thirrën me radhi gjithë ushtarët. Njeriu me kë-mishë tē kuqe e pa telin me gjemba, i mblođhi tërë forcat dhe u sul si i tèrbuar në drejtim tē tij. Po ta kalonite klónin, kishte pak mundësi që ta kapnim.

— Ndal! — thirra pér herë tē fundit dhe mora shenjë.

Ai bëri një kërcim prej atleti dhe u ngjit me thonj mbi telin me gjemba. Nuk kishte ndër mend tē ndalej. Kacavirrej tamam si një fiacë e eger.

Gjëmuani disa tē shtëna hutuese. Ai mbeti një çast majë klonit me gishterinjtë tē mbledhur fort, sikur t'ia kishte zënë ngërci. Pastaj u duk sikur u rëndua. Gishterinjtë u hapën, dhe ai ra në anën tonë.

Vrapuan atjë. Ishte një djalë njëzet e pesë-njëzet e gjashtë vjeç. I hollë, me trupin tërë muskuj, që dukeshin edhe nën bluzën e kuqe. Kishte marrë dy plumba në këmbë dhe një në shpatull. Përdhe derdhej gjak, por plagët ishtin tē ngrohta, dhe ai nuk ndiente ende dhembje tē forta.

Kishte sy tē hirtë, tē vegjël. Ai buzëqeshitë pak ose i kishte përveshur buzët, aq sa i dukeshin dhëmbët e qenit; tē gjatë e tē mprehtë.

— Bëni një vig! — u thashë ushtarëve. Ata sollën edhe shkelësin tjetër dhe filluan tē prisin dru.

Njeriu që shtrihej përpara këmbëve tē mia, po më vështronte me përbuzje dhe urrejtje.

— Hë, qen! — thashë unë. — Ku doje tē veje? Sikuri s'ke lindur në këtë tokë. Kërkon krodhën e tjetrit.

I picërroi edhe më tepër sytë e tij të vegjël, të hirtë dhe tha, tërë përbuzje, duke zbuluar më shumë dhëmbët anësorë:

— Çfarë? Mos do të më mbushësh mendjen se këto dy pëllëmbë dhé, që zënë vetëm një pikë në hartë, janë e téré bota?...

— Qen! — thashë unë dhe kisha dëshirë ta qëllaja me shkelm. — Qen!

Ai tjetri po dridhej. Ishte ca më i ri dhe kishte frikë.

Ushtarët po e mbaronin vigun.

Edhe unë po dridhesha nga inati. Nxora letrat nga canta dhe nisa të plotësoja procesverbalin e kapjes në krim e sipër.

Pasi e plotësova të parin dhe e firmosi vetë shkelësi, iu drejtova atij me këmishë të kuqe, që shtrihej nën këmbët e mia:

— Emri? — e pyeta.

— Demlush.

— Mbiemri?

— Toska.

— Emri i babait?

— Isa.

Erdhi e m'u mblodh një lëmsh në fyt. Sytë m'u veshën dhe përsëri desha ta qëllaja me shkelm.

— Farë krimineli! — thirra duke kërcitur dhëmbët.

— Qen bir qeni!

Ai nuk lëvizi fare. Vetëm më shikonte me ata sytë e tij të vegjël, të hirtë.

— Ím atë ka qenë burrë, — tha. — Dhe ia kishin frikën të gjithë.

Unë e shava. Ai mori me dorën e majtë procesverbalin dhe e pa me vëmendje.

Dridhesha i téri dhe mezi përbahesha që të mos e shkelja.

— Ke harruar diçka, — tha ai. — Atë që e the edhe vetë: farë krimineli. Kam lindur kriminel dhe dua të vdes si kriminel. Kriminel, por burrë, ama.

Atëherë nuk pashë më asgjë. Tërë ajo nxehësi m'u duk sikur më ra në kokë e m'i përvëloj bebzat e syrit.

E kapa automatikun, e tërroqë dorezën e rimbu-shjes dhe do ta kisha vrarë në vend, sikur të mos më kishin mbajtur ushtarët.

— Largohuni! — klitha. — Lërmëni ta vras qenin!

Ata më mbërthyen fort dhe unë erdha dalëngadalë në vete.

Ai po humbiste gjak. E vumë mbi vig dhe u nisëm pér në postë.

Ndërlidhësi ynë lajmëroi se dy shkelësit ishin zë-në: njëri u dorëzua, kurse tjetri ishte plagosur dy herë në këmbë dhe një herë në shpatull.

Ai tjetri vinte pas si mëz i zbutur. Sapo bëmë dhjetë hapa, Demlushi zuri të thërriste. Dielli na lë-shonte shigjeta. Vigu lëkundej. Ushtarët fshinin djer-sën dhe dihatnin.

— Ujë! Ujë! Ujë! — thërriste Demlushi nga vigu.

E shikoja se si i vente koka nga një anë në tjetrën, dhe e tërë kjo më dukej pa kuptim. Ta mbartnim,.. ta shëronim... Kë?

— Ujë! Ujë! Ujë!

E thirrura e tij më binte si çekan në kokë. Po pëlcitnim pér vete.

Ai i shqeu fashat, me të cilat ia kishim lidhur hëpërhcë plagët. E ulëm vigun dhe ia lidhëm duart.

— Ujë! — tha ai përsëri. — Ujë, se vdiqa!

— Ujë s'kemi pér vete, — i thashë. — Vdiqëm edhe ne.

Dielli të verbonte. Ai kishte etjen e gjakut që i rridhëte.

— Shurrën! — tha ai. — Nëm shurrën. Aman!

Kishte hapur gojën dhe nofulla e buzët e nxira i lëkundeshin si krah i thyer sorre.

— Nuk ta jap, — i thashë duke shtrënguar dhëm-bët. — Nuk ta jap.

Ai hapi sytë e tij të vegjël dhe ra pa forcë në vig. Shoku i tij zuri të qante. Qeni!

Tërë rrugës thirri dhe m'u lut, por as që e dëgjoja më,

Erdhi dhe e mori ambulanca, sapo mbërritëm në postë.

Më minte mendja gjithmonë atje. Kujtoja Isanë dhe më dukej sikur ishte ngjallur.

«Si nuk e vrava! — thosha me vete, — Si nuk e vrava, qenin!»

Ç'zheg! Ç'vapë! Kurse ti më thua si nuk kam të ftohtë!...

E dini? E takova para pesë vjetësh në burg. Ishte shëndoshë si molla, por pa një këmbë. Nuk e njohë në fillim. Po më shikonte me tèrbim me ata sytë e tij tè vegjël, tè hirtë. Dhe unë ndjeva përsëri po atë vapë, po atë zheg.

1973



## Fatmir Gjata

### ZEMER SHQIPTARE

Ishte vjeshtë, vjeshtë e verdhë me shi e me baltë. Im shoq, Kasemi, kishte shkuar në Opar e që andej ishte hedhur në Mokër pér të përcjellë ca kafshë me armë pér partizanët. Kur u nis, më tha se do të kthehej të shtunën, por iku edhe e diela e s'u duk në shtëpi. U bëra merak, se ishte luftë e dyfeku kërciste kudo.

— Si u bë kjo punë? S'u kthyte që s'u kthyte, — pyesja veten me duar në zemër.

Por një fshatar, që kishte qenë në Mokër dhe e kishte takuar Kasemin, erdhi aty ndajnatëherë e më thirri që nga pragu i derës:

— Moj grua! Mirë e ke atë, moj, mirë. Do të të vijë pasnesër. Mos u bëj merak.

Kur dola në oborr pér t'u fjalosur më shtruar, se m'u duk sikur më gënjeu, fshatari kishte i kur. Po, gënjeu apo s'gënjeu, mua sikur m'u lehtësua zemra.

Në oborr, im bir (e kisha të vogël, dhjetë vjeç) kishte hyrë në një pellg me ujë e lahej si rosat. Ishte bëre qull fund e krye.

— Do të ftohesh, mor bir, — i thashë. — Hajde brenda.

Po më dëgjoi? Krisi e doli jashtë. E ndoqa dhe mezi, e arrita te gardhi. E futa brenda me zor dhe e ndërrovat.

— Ti, Petrit, nuk bën mirë kështu, — e këshilloja duke e ndërruar. — Pa shiko si je bërë, qull. Do të ftohesh. Kur bie shi, njerëzit rrinë brenda.

— Po partizanët, — m'u përgjigj, — pse nuk ftohen? Edhe ata jashtë rrinë. Nuk janë njerëz ata?

— Njerëz janë, por janë të rritur.

— Pse unë i vogël jam?

— Edhe ti i madh je. Të ka, nëna burrë. Po, kur bie shi, më mirë është të rrish brënda.

Atë natë erdhi në fshat një batalion. Mua më sllën tre partizanë. U ndeza një zjarr që të thaheshin, se ishin bërë qull e u dhashë të hanin ç'm'u ndodh në shtëpi. Isha mësuar me ta dhe i doja si Petritin tim. Vinin tek unë nga Mokra, nga Opari, nga Devollia, për të marrë një hop frymë e për të pirë ndonjë lagjin me dhallë a me ujë. Dy vjet të kaluar, kur i pashë për të parën herë, m'u dukën fare të vegjël dhe u habita më tim shoq që merrej me ta. Një ditë i thashë:

— C'té duhet ty të ngatérrohesh me këta fëmijë? Por ai ma preu shkurt!

— Mbylle gojën ti, grua! Ata kanë dalë maleve që tē na çlironjnë.

Dhe vërtet, ç'ta mësoja unë Kasemin? Ai ishte i mendshëm vetë. Dhe kishte pasur të drejtë. Pas një javë u bë një luftë këtu në fshat. Vetë, me këta sy, i pashë italianët si u thyen. Që prej asaj dite partizanët më janë dukur burra të pjekur që s'u trembet syri kurrë dhe më janë futur në zemër si Petriti im.

Të tre partizanët që më erdhën atë natë ishin të muhabitetit, por sidomos njëri, një Sotir nga Mokra, një djale nja njëzet vjeç, me ca sy si të shqiponjës. Ai kishte një mot e ca që bridhte maleve. Kishte luftuar në Voskopojë, në Pojskë e në Lëskovik, në Gram e në Përmet. Kishte një zë si bilbil. Ku e kishin gjetur një-

ri-tjetrin? Kaq mirë i ujdisnin zérat e kaq mirë i kur-disnin fjalët, sa unë u mahnit! Sotiri ia merrte, të tjerët ia mbanin. Petriti im ziente.

Ranë të flinin, të veshur, siç ishin. Petriti im nuk deshi të flinte atë natë me mua. U bë shok i ngushtë me Sotirin. Pashë, ç'pashë e i vura të dy në një dyshek. Sa ranë, gjumi ua mylli sytë menjéherë.

Unë mbulova zjarrin me hi, shova kandilin e rasshë. Po gjumi nuk më mori menjéherë. Që kur kishte filluar lufta e kisha humbur gjumin. Kasemi më shante gjithnjë:

— Po fli, moj grua, — më thosh, — se gjermani s'ka atë nge që të vijë natën këtej. Edhe atij i dhemb koka.

Unë s'kisha frikë nga gjermani. Po kisha merak pér djemtë e pér vatanin që po përvëlohej. Prandaj edhe gjumin e bëja me hope.

Mirë thonë: «C'sjell mëngjesi, nuk sjell nata.» Pér atë të zezë të atij mëngjesi! U zgjova nga të trokiturat e forta në derë. M'u duk sikur shtinte njëri me top te pragu i shtëpisë. Dola në oborr pa u veshur e pyeta:

— Kush është?

Dëgjova hapat e njerëzve që rendnin para shtëpisë. Dikush trokiti përséri në derë me kondak e thirri.

— Shpejt, Sotir, shpejt, gjermanët!

U derdhë e mezi hapa derën. Por ai që trokiti s'ishte më. Sa u mata të hyja brenda, një batare pushkësh plasi mu në mes të fshatit. Pas pak m'u duk sikur po bëhej luftë jo vetëm poshtë, te mulliri, por edhe lart, mbi fshat, tek Uji i Ftohtë. Mos kanë dalë gjermanët edhe sipër? Mos kanë rrëthuar fshatin? Dhe vërtet ashtu kishte ngjarë. Më vonë mora vesh se katërqind gjermanë e ballistë e kishin rrëthuar fshatin si në një çark. Komandanti i partizanëve kishte dhënë urdhër që shtegu të çuhej lart tek Uji i Ftohtë, gjallë a vdekur, po duhej çarë. Ishte punë e zorshme, po tjetër rrugë s'kishte. Një pjesë të partizanëve e kishte dërguar te mulliri dhe i kishte urdhëruar që të që-

ndronin gjersa të çuhej rrithimi e pastaj të têrhiqëshin duke luftuar.

Sotiri doli i pari në rrugë. Pas tij dolën edhe dy shokët e tjera. U çudita se si u bënë gati aq shpejt. Ata s'patën kohë as të më përshtendetnë. Vetëm Sotiri, pasi u dha urdhër shokëve që të ngjiteshin- sipër, më tha:

— Shko brenda, nënë! Mos u bëj merak, se shtegun do ta çajmë, — dhe vetë zbriti tatëpjetë, te mulliri, ku bëhej luftë.

Dy plumbë fishkëllyen mbi kokën time dhe u përplasën në murin e shtëpisë. Rrëmbeva tim bir në krahe ë hyra brenda. Derën e lashë hapur, se s'patë kohë t'i vija llozin. Nga dritarja ë vogël shikoja Sotirin që luftonte prapa një çakëlli. Zemra më rrihte. Nuk dija ç'të bëja. Të kisha dyfek, do të shtija edhe unë. Po dyfekun e kishte marrë me vete Kasemi.

Kaloi një orë, a dy, ndoshta edhe tri, nuk e mbaj mend, dhe partizanët e çanë shtegun tek Uji i Ftohtë. Vetëm Sotiri mbeti afër mullirit, në mes të zjarrit. Gjer në një kohë ai përdori dyfekun, pastaj e la atë mënjanë dhe, duke u têrhequr zvarrë, luftoi me nagant. Një herë u ngrit më këmbë dhe hodhi dy bomba që plasën pas pak me zhurmë të madhe. E pashë kur kapérceu një gardh dhe u ndodh para shtëpisë sime. I thirrë nga dritarja që të kishte mendjen. Por ai, si dukej, nuk më dégjoi. C'më panë sytë aty? Një alamet gjermani, i gjatë si hollovar, i doli përpëra papritur dhe i shtiu me automatik. Sotiri u mblodh shuk e ra përdhe. Duke rënë, ai zbrazi katër herë nagantin dhe gjermani u rrokullis në hendek. Do la shpejt në oborr dhe e gjeta Sotirin te pragu i derës, mbytur në gjak. Ishte plagosur në këmbë e në shpatull. E futa brenda dhe i vura llozin derës. Po tanë?! Gjermanët me siguri e kanë parë që hyri këtu. Me një copë çarçafi i lidha shpejt plagët.

— A ke fishekë, nënë? — më pyeti.

— E ku i gjeta unë fishekët? Të kisha, do t'i kisha zbrazur vetë.

— Po bombë?

— Jo, as bombë.

Ai hapi nagantin dhe unë pashë në të vetëm një fishek. E vështrova Sotirin në sy dhe e kuptova ç'kishte ndër mend të bënte.

— Sidoqoftë, të gjallë nuk do të më zënë, — tha duke u munduar të ngrihej.

U mundova t'ia merrja nagantin, por ai nuk më la.

Në rrugë dëgjova këmbë njerëzish dhe fjalë që unë nuk i kuptoja. Gjermanët kalonin para shtëpisë.

— Nënë, — më tha Sotiri, — shko brenda. Ata zemrën nuk do të ma marrin dot, — dhe u ngrit më këmbë, duke u mbështetur pas murit, me gishtin në këmbëzën e nagantit.

Nuk i fola më. E rrëmbeva në krahë dhe e fsheha në një qoshe të plevicës duke e mbuluar me kashtë. Kur dola në oborr, pashë tim bir që përgjonte prapa derës.

— Këtu janë, — më tha ai me gjysmë zëri e m'u derdh në prehër.

— S'ka gjë, xhan, s'ka gjë, Petriti i nënës! — i thashë duke i përkëdhelur flokët. — Ty të ka nëna trim! Ti vetëm mos u trevo atyre asnjë fjalë...

Nuk mbaj mend q'i thashë më, vetëm e lëshova nga duart dhe e ndjeva si m'u ngjesh pas këmbëve duke më shtrënguar fort.

Gjermanët e shkallmuani derën, se unë llozin s'e hoqa që s'e hoqa. Ca shtinë me dyfek nëpër dritare, ca e bënë derën shoshë me automatik. Për të parën herë shikoja gjermanë me sy. Oh! Të kisha një bombe e t'i hidhja në erë!

Fjaloseshin me zë të lartë, por unë nuk i kuptoja. Vetëm njëri prej tyre më foli shqip. Ishte një ballist, që mos ju dëgjoftë nami kurrë.

E bënë shtëpinë rrëmujë, por nuk gjetën gjë. Kërkuan nëpër oborr e nëpër bahçë, por nuk gjetën gjë. Një gjerman, me një kaskë të madhe në kokë, zbuloi pusin dhë shikoi në të. Asgjë nuk dukej në atë errë-

sirë. Ai pështyu në pus dhe shtiu më automatik. Një tjetër hyri në plevicë. E pashë me bishtin e syrit kur qëndroi te pragu i derës me këmbët të hapura. Më rrahu zemra, më rrahu si e marrë, sikur donte të shpërtheonte jashtë krahatarit. Prisja të dëgjoja krismën e thatë të nagantit. U mata të bëja një hap, po ndjeva se këmbët e mia i shtrëngonte fort Petriti im. Një krismë automatiku u dëgjuat në plevicë. Klithma më mbeti në grykë. Mbulova fytyrën me duar dhe nëpërmjet gishterinxhje pashë gjermanin që doli nga plevica duke mbledhur supet. Nuk e kishte gjetur Sotirin.

Më rrëthuan në mes. Njëri më mbështeti dyfekun në gjoks dhe unë ndjeva nxehësinë e armës. Ballisti më pyeti me zë të lartë:

— Fol, ku e fshehe?

Nuk mbaj mend si u përgjigja, vetëm më kujtohet se dikush më goditi në kokë. Im bir m'u hodh në qafë për të më mbrojtur. Ata ma shkëputën nga krahët dhe e mbështetën pas murit. Unë kujtova se po ma pushkatonin. Nuk mbaj mend, vetëm se u derdhia mbi të dhe e mbulova me trupin tim. Atëherë zbërtiveva gjoksin e u thirra:

— Bjermëni mua!

Dikush u bë gati të shtinte. Po një tjetër e ndaloj dhe bëri një shenjë me dorë.

U derdhën përsëri mbi mua e ma rrëmbyen djalin riga duart, e shtynë dhe e nxorën jashtë. Nuk kuptova ç'po ngjiste. Vetëm ndjeva sikur dikush më shkuli zemrën nga krahatori e ma shkeli me çizme. Ngrieva në vend, e mbështetur pas murit. Mezi dëgjova fjalët e tim biri që thërriste në rrugë:

— Në-nëë!...

M'u morën mendtë dhe për pak rashë, por e mbajta veten. U turra jashtë dhe iu derdha në grykë gjermanit që deshi të më ndalonte. E shkunda me forcë dhe e rrëzova përdhe. Ku u gjend tek unë ajo forcë, nuk e di!

— Ku ma shpini fëmijën, ku?

Dikush më goditi në shpatull dhe më rrëzoi. Ndjeva faqen që m'u lag në një gropë me ujë.

— Trego!

M'u kujtua Sotiri. Ai ishte në plevicë, gjallë a vdekur, nuk e di, se i shtinë me automatik. Por ishte në plevicë. Ja këtu afër, fare afër. Gjermanët atë kërkonin. Mjaftonte një fjalë, vetëm një fjalë, dhe im bir do të kthehej përsëri në shtëpi e unë do ta përkëdhelja si më parë e do t'i thosha: «Të ka nëna trim, të ka nëna burrë të rritur!»

Por jo! Ajo s'kishte për të ndodhur kurrë!

Gjermanët u larguan, por unë akoma e kësaj ditë dëgjoj zérin e tim biri që më thërrret:

— Në-nëë!

Sotirin e gjeta të gjallë, po të tretur, se kishte humbur shumë gjak. Ai shtriu duart me mundim e më përqafoi e unë ndjeva sikur ato duar ishin duart e tim biri.

1953

## Fuat Çeliku

### TAKIM PAS NJË NGJARJEJE

«Atëherë isha komandant poste në kufi. Thoni vetë ju, i duhet gjë tjetër kufitarit po s'pati vigjilencë e trimëri? E di si thonë? Në qoftë se disciplina është rregull numër një i ushtrisë, vigjilanca është rregull numër një i disiplinës. Dhe ta dish, e them mirë, sa s'ka ku të vejë më. E pra, te vigjilanca e kisha llafin. Llaparniku, hedh thumba si pa të keq, gjoja, e ku ta di unë, e ti e qep gojën. Të kalon armiku nën mustaqe, e ti fle, a dremit, a zbythesha prapa. Të kalon, e ti s'i hidhesh në grykë, kjo s'mund të quhet vigjilencë. Dikur na ka bërë përshtypje një djalë, Elham Qatipi e quanini. Të merrte gjak në vetull. Elhami, edhe gjethen kur binte, e ndiente.

Ishite një natë korriku. E bukur sa s'ka më. Si tani më kujtohet. Atë natë, pranë pyllit me boriga, të mëdha sa s'mbërtheje dot një me të dyja duart, bënte rojë ky Elhami, që thoni ju. Nuk ishte ndonjë vend-rojë kushedi se çë, ja, aty afër ndërtëses së postës ishte, por kjo gjumosje na mori më qafë. Ku ka, ore,

vendrojë tē klasës së parë apo tē dytë e tē tretë. Nuk janë kabina trëni vendroat e kufirit. Kështu mendoja unë, por Elhami nuk mendonte kështu. Nuk mendonte. «Bam», atë natë një krismë nga vendroja e Elhamit. Alarm, Vrapuam atje tē armatosur, me qen e me punë.

— Ç'pate, Elham? — e pyeta.

— Dikush kaloi këtej, komandant, — më tha. — I thirrë tē ndalonte, po...

— Nga vinte, — ia preva unë.

— Nga vija e kufirit dukej, — u përgjigj ai.

«Ç'ia këpüte kot, o Elham vëllai», thashë me vete.

— E pe me sý? — e pyeta pas pak.

— Jo, jo, po dëgjova këmbë. S'mund ta lija vendrojën.

Unë qesha si më ironi, si më qesëndi, si tē tē them, qesha kur s'duhej tē qeshja. Kështu e fyeja kufitarin:

— Ama edhe ti, s'e sheh, mbeti shkelësi tē vijë këtu te ti. E ç'do këtu ai, rri, pér kokën tënde, se, kaq vjet u bëra, s'ka ardhur këtu njeri ndonjëherë. Po atë para teje, mo lumëzi, baltë hanë atje?

Deshi tē më thoshte diçka Elhami, por unë ia' preva shkurt:

— Të kanë bërë veshët.

— Jo, s'më kanë bërë, — nguli këmbë si mushika Elhami.

— Të kanë bërë, tē kanë bërë, po mos e zgjat më, i thashë unë.

— Po, po, — sa s'qante kufitari.

Më erdhi keq, se ishte kufitar i mirë. Po kushedi si rastis njeriu, thashë, i sigurt në veten time që ai kishte gabuar. Bëmë një kontroll rrëth e rrötull, sa pér tē thënë, sa pér t'i mbushur mendjen Elhamit. Pastaj, e ndërrrova me një kufitar tjetër dhe u nisëm pér një postë. Por ai një e dy e në vesh:

— Shoku komandant, tē kërkojnë, njëherë se nuk më bënë veshët, jo...

Më hipi inati, se isha i ri atë kohë dhe merrja flakë menjëherë, si pisha. U ktheva e i thashë:

— Rri, ore, ke pasur frikë dhe qëllove në ndonjë hije borigë.

— Unë frikë?! — u mek ai dhe sytë iu hapën sa një filxhan. Kur them sa një filxhan kështu është, nuk e shtoj. Dhe sa folët ju që s'ishit atje, aq foli pastaj edhe Elhami.

Të nesërmen ata të shërbimit të fietores më raportuan se tërë natën Elhami s'kishte mbyllur sy. Përpëlitu këtej e përpëlitu andej. I ri, ore, djalë në vahitit 18 vjeç. Më dhembi xhani për Elhamin, se prapa asaj nate pa gjumë unë i kuptova një brengë të madhe. E kisha shok Elhamin, e kisha vëlla, se kështu jemi nje, kufitarët. Po këtë radhë e kisha prishur fare, e kisha rënduar, i kisha thënë frikacak. Rrëzoja shqiptarit çatinë e shtëpisë mbi kokë më mirë, po mos i thuaj frikacak. U ngrita e u nisa drejt e në brezin e butë. Asnjë gjurmë. Edhe nga njësitet e shërbimit të asaj nate s'pati gjë të re. I thashë edhe Elhamit për këtë, por ai e kishte kyçur. «E po ç'të bëj, mendova. Ti vetë lajthit e vetë mërzitesh». I thashë të më falte, se nuk kisha dashur ta fyeja, por ai prapë nuk foli. Drejt e te komisari i postës unë, se ai të gatuante mirë, jo vëtëm se ishte komisar e më i moshuar, por edhe se ishte i regjur në kufi. Kështu e kështu, i thashë, e qelba me kufitar Elhamin.

Pas një ore vaita drejt e në shtëpinë e Zeqirit, një mesoburrë, që ma kishte qafën si të demit damaz. S'më pëlqente fare ky Zeqiri: «Po pse vajte atëherë», do të thoni ju. Vajta se më thanë që aty ishin forcat e ndjekjes.

Kishte konakë të mirë, të mëdheni Zeqiri e katin e dytë kishte kërkuar t'uа lëshonte forcave të ndjekjes. E dini pse s'më pëlqente Zeqiri? Se nuk përzihet në asnjë punë të fshatit. Ziente fshati pér turli gjérash, të mira e të liga, si e ka fshati, varr shtëpia e Zeqos, si fshat më vete. Më të tërë mundohei ta kishte mirë, me asnjë nuk këmbente fjalë. Edhe sikur «olaç» t'i thoshe, «pege» ta kthente. Kështu Zeqoja. Po përderisa aty do të rrinin forcat e ndjekjes, çoc

do të ishte ky Zeqiri, do të ishte një i besuar, me gjithëse në luftë një pushkë s'e kishte hedhur. Ama, as me italianë, e gjermanë, e ballistë, e qafirë nuk kisha dëgjuar të ishte lëmshitur.

Kur hyra në shtëpi të Zeqirit, një gjiel goxha i madh me pendë të ndritshme, të kuqe flakë, përpëlitez pa kokë nëpër oborr. Gjaku pizgë. «Hajde, hajde, c'mish ka, mendova, do t'ua vrasë barkun shokëve». Dhe u gëlltita. Zeqiri më doli përpara.

— Urdhëro, shoku komandant, urdhëro! Të kthejmë një plloçë, — më tha me temena.

— E paske therur kot, — thashë duke i treguar gielin pa kokë që vazhdonte të përpëlitez. Ato fjalë më erdhën në mendje atë minutë, ato i thashë, se ç'do ti thosha tjetër Zeqirit unë.

Ai qeshi pa kuptim «hi, hi, hi», duke zbuluar ca dhëmbë të krimbur. Tërë udha e shtruar me gurë e plloca, nga porta e madhe e oborrit e deri tek ajo e shtëpisë, ishte mbushur me gjak. Edhe në hajat kishte ca pika. «Bre, c'gjak vaska pasur», thashë unë. Zeqiri, si duket, e kapi vështrimin tim. Ai kishte edhe një huq, që të bënte ta merrje inat. Të ndiqte çdo lëvizje e të shikonte me përulje drejt e në sy, tamam sic bën një konkë me të zotin.

— Hvri edhe brenda i flamësuri, — më shpjegoi ai Pastaj, duke më ardhur nga vrapa, zgjati qafën mbi supin tim, — se ishte një pëllëmbë më i gjatë se unë, — sa më ciku me faqet e tij si gjemba faqet e mia të buta brej njëzetediyvjeçari.

— Po do t'ia ujdisim qeifin sonte këtij kuqaloshi, me një cikë raki kumbulle të zier dy herë, hi, hi, hi... Gjelin më të majmë pendëkuq e rakinë më të mirë pér miq kaq të rrallë...

E kur unë s'fola, ai përsëri vazhdoi:

— Ngiitu lart zotrote. Shyqyr që na erdhe një herë. Duku, bre, duku edhe nga unë, se s'ke dynjanë mbi kokë, të tërë e mbroimi kufirin. Apo ke zënë ndonië thëllëzë këtej nga fshati e i shpupurit foleçkën, hi, hi, hi...

Po më kot i prita shokët atë natë dhe bëra q'bë-ra ika nga shtëpia e Zeqirit, pa e provuar as gjelin dhe i penduar që kisha shkelur.

Iku ajo natë me gjelin që kishte skuqur dynjanë, ikën edhe shumë të tjera; iku në shtëpi të tij edhe El-hami. Ika edhe unë një ditë nga ajo postë në një tjetër e historia gati u harrua. Por një natë ramë në përpjekje dhe zumë tre dykëmbësh. Kështu u thoshim me gjuhën tonë diversantëve, se njerëz tamam nuk janë ata. I mbërthyem mirë, sa as çak as bam s'bënë dot. I dërguan ku e kishin vendin, po pas ca kohe pata rastin të dëgjoja deponimin e tyre. E atëherë, çakërrita sytë, kur foli njëri nga ata. E dini ç'tha?

«Në korrik të vitit 195... natën, — tha, — kam kluar kufirin në sektorin filan, pa prekur brezin e butë, si këtë radhë. Kur pandeha se kisha shpëtar, — tha, — dëgjova të më thérresin «ndal». Unë ika, — tha, — por më qëlluan. Më plagosën në shpatull, rëndë më plagosën. Po pér çudi, — tha, — njëri nuk më ndoqi. Erdhën rrötull një copë herë e në një vend sa një lëmë e pastaj u larguan. I mballosa një copë këmishë plagës që të mos rridhte gjaku përdhe, e shtrëngova fort, dhe pa shpresë është zvarrita deri në oborrin e mikut tonë Zeqir K, në anë të fshatit. Zeqiri, — tha, — priste atë natë miq të rrallë, forcat e ndjekjes. «Si cjadi te kasapi», thashë, duke dyshuar se mos Zeqiri kishte tradhtuar. Mund të ishte ndonjë lojë nga ato që na kanë kurdisur gjithnjë komunistët. Po fuqi s'kisha më, dhashë sinjalin e u plasa në oborr. Gjaku im pikoi nëpër oborr, — tha, — mirëpo Zeqiri, që pa gdhirë mirë, theri një dy pula, më vonë theri edhe gjelin më të madh dhe gjaku im u bashkua me atë të tyre. I kalova një katër ditë në bodrumet e Zeqirit, — tha, — me frikë se mos vinin forcat e ndjekjes. Por ato kurrë s'e pranuan ftesën e tij... Vetëm komandanti erdhi një copë herë, dhe kështu shpëtova...»

— Po fundin këtu do ta kishit, si çdo armik tjetër, — i foli njëri nga hetuesit.

E kisha dëgjuar diversantin pa mend në kokë e i thashë vetes: «Hajde, truthorë, hajde».

— Paskeni qenë vigjilentë të mëdhenj, — më foli shefi im, që u ndodh aty.

Sikur më ra pika. Më vajti mendja tek Elhami e ua tregova historinë shokëve.

— T'i dërgojmë një fletë lavdërimi, — tha shefi.

— Zeqoja s'i paska treguar të gjitha, drejtësia paska ende punë me të. Tradhtari mbetet gjithnjë tradhtar.

Kérkova të shkoja vetë tek Elhami. Ishte bërë goxha burrë, me fëmijë. Më priti me krahë hapur. Ma kujtoi edhe historinë e vjetër të asaj nate. Fort e bukur natë paskësh qenë!

— Aty më rri, — i thashë, — se për këtë kam ardhur. Dhe ia shkoqita një më një téré historinë. Ai më dëgjoi duke më parë në bebzëza të syrit. Pastaj u ngrit dhe e ngjiti fletén e lavdërimit në mur, pranë shumë fotografive të tjera të shtëpisë. E pa mirë e mirë nga e djathta e nga e majta, nga afér e nga larg dhe ia mori asaj këngës sonë të kufitarëve. Gruaja e fëmijët, e më pas edhe unë, e shoqëruam.

Ai kishte mbetur kufitar me shpirt e me gjak.

1982

## **Idriz Ponari**

### **ÇDO PELLËMBË E TOKËS SONE**

Qendra e kooperativës bujqësore përhapej rreth një sheshi me një copë asfalt e gurë kalldrëmi ku derdheshin njerëzit sa herë, që dilnin nga kryesia e nga zyrat e tjera, nga dyqanet, nga klub, nga libraria. Vetëm spitali e shkolla ishin pak mënjanë, sikur donin t'u shpëtonin zhurmave dhe pluhurit që ngrinin kamionët e shumtë që kalonin aty me shpejtësi. Ata vinin të ngarkuar me lëndë drusore apo sillnin qysh tanë nga qyteti furnizimet për dimrin. Tej lumit dhe urës së ngushtë prej dërrashash bredhi, ishin hidrocentrali dhe sharra. Në anë të sheshit prej guri e asfalti ishte një çezmë ku mblidheshin gjatë ditës shumë njerëz që të freskoheshin e të pinin ujin e saj të ftohtë që stërpikte në heshtje gurët përreth. Vetëm shoferët hynin paradhë, duke u folur të gjithëve në emër, e pastaj përshtëdeteshin e makina shkiste diku pas një kthese duke lënë pas zhurmat e zgjatura. Të gjitha këto i jepnin

gjallérinë e zakontë kësaj qyteze të largët në mes të maleve.

Në njëren prej këtyre ditëve të nxehta të gushtit nga porta e repartit, që është në mes të një lëndine të rrëthuar me shkëmbinj e kurora të blerta pishash, doli ushtar Altin Grezda dhe mori rrugën poshtë, duke shikuar nga larg fshatin. Altini është pak i vrenjtur në fytyrë dhe sytë i mban gjithnjë të mbërthyer në një pikë. Duke e shikuar kështu, askush veç atij nuk mund ta dijë se ajo pikë ku vështron gjithnjë ushtar Altini të çon në një kullë të bardhë me dy kate e ballkon, me një tendë të gjerë hardhie në oborrin e gurtë. Aty janë një palë shkallë të gurta ku ngjitet e zbret sa herë në ditë një vajzë e këtyre anëve që ia ka rrëmbyer zemrën ushtarit me emrin Altin.

Altini qëndroi në vend dhe vrojtoi rrëth vetes sikur ta kishte thirrur njeri. Por gjithandej sundonte qetësia. I bëhej sikur dégjonte zërin e saj: «Më kanë thënë diçka, Altin. Ju do të liroheni këto ditë.» Kaq. Pastaj fytyra e saj qe skuqur papritur e dukej si luleshtrydhe bjeshke. Altini i kishte thënë po, e ajo ishte zhdukur me vrap si një sorkadhe e trembur.

Ai bëri edhe disa hapa, si të donte ta takonte atë çast e t'i thoshte diçka, të sqaronte atë ose veten e tij. Kohët e fundit jo vetëm që nuk e takonte, por edhe dinte pak gjëra për të. Gjithë kjo kishte nisur një ditë në brigadën e arave, kur po punonin.

Atë ditë Katrina kishte munguar dhe shokët ishin çuditur, sepse ajo kishte qenë gjithnjë ndër më të mirët. Po bëheshin gati të nisin në shtëpi që ta pyesnin për shëndetin, kur ajo kishte ardhur e shoqëruar nga njërezit e saj. Të gjithë qenë habitur, madje edhe vëtë brigadier Kola.

«Do të jetë gjë sëmurë», kishte thënë njëri.

«Mundet...»

«Po të qe e sëmurë, nuk vinte në punë», kishte shtuar një tjetër.

«Pse bëni sikur nuk dini, — ia kishte kthyer një burrë i thatë qimekuq me një hundë të mprehtë si

sqep zogu. — Kjo Katrina e Prekës i ka ngatërruar keq telat me një ushtar...»

Fjalët e Kuqos kishin shtangur të tjerët.

«Si the?»

«Nuk është e mundur...»

«Nuk të kanë hije këto fjalë... Jemi burra». —

«Këto janë thashetheme...»

«Prisni burra, — foli Kuqoja, i fyter. — Këto që po jua them janë aq të vërteta, sa është e vërtetë se Preka e ka bërë zap të bijën që atë ditë që i ka shkuar fjala në vesh. Prandaj Katrina nuk vjen vetëm sot në punë, por e shoqëruar nga njerëzit e shtëpisë.

«Mos do të shoqërohet me ty, more qyq, që u plake beqar?...»

«Ti prit, he dreq, e mos ma qaj hallin mua, se di vetë unë ç'bëj...»

«Më ngadalë, shokë, — tha brigadier Kola. — Këto që dëgjojmë, s'janë as të pjekura, as të hijshme për ne. A mund të merren nëpër gojë ushtarët tanë që i kemi vëllezër, të merren nëpër gojë shoqet e brigadës sonë? Ta mbyllim këtë bisedë, ose të ulemi këmbëkryq për të gjykuar ata që merren me llafe.»

Kuqoja e ndjeu veten ngsushtë pas këtyre fjalëve, por, si gjithnjë ai ishte kokëfortë për të mbrojtur atë që thoshte, ndaj foli përsëri:

«Ti, më kadalë, he burrë, se, në daçi me e ditë, unë Altinin e dua si vëllanë e sa për Katrinën ju e dini vetë... Më vjen keq vetëm për Prekën.»

«E pse të vjen keq?»

«Altini është prej Sarande, ti a e marton vajzën kaq larg?»

«Ik, he dreq, ç'na përrallis...»

Të tjerët qeshën me të madhe.

Pas kësaj dite fjala ishte hapur gjithandej. Shokët e kishin pyetur Altinin e ai, që nuk dinte të fshihte gjë, ua kishte treguar të gjitha.

E pra, në njérën nga këto ditë gushti ushtar Altini kaloi afër brigadës së arave me shpresë se do ta shikonte nga larg Katrinën, por s'e pa as atë dhe as

brigadier Kolën. Donte të fliste shumë me të. Ata ishin njohur e miqësuar netve të alarmit, kur të dy tok kishin zënë llogoret, kishin pritur agimet me sy në shënjestër, kishin ngrënë me një lugë, edhe zemrat ia kishin hapur njëri-tjetrit.

Kur shkoi në qendër të kooperativës, e gjeti brigadier Kolën duke dalë nga kryesia. Sigurisht që do të merrte rrugën për në ara, ndaj Altini nxitoi që ta kapte.

Ata u përqafuan.

— Mezi të gjeta, bre Kolë.

— Këtë tha Altini, e tjetri, që s'po ia ndante sytë, e pyeti:

— Fol, Altin, çfarë kërkon?

Altini e pa me dashamirësi shokun e foli:

— Asgjë nuk duam, shoku Kolë. Shokët thonë se duhet ta kalojmë natën e fundit së bashku e më kanë ngarkuar mua t'ju lajmëroj...

— Ooo, bukur fort! Do të vijmë, bre Altin, do të vijmë, e në gëzime ju ardhshim, — uroi Kola. Të dy qeshën dhe i shtrënguan dorën njëri-tjetrit duke lëvizur ngadalë në sheshin e vogël.

— Nesër do të niseni, Altin? Nesër do të na ikësh? Heu, bre, si ikën koha. Për besë, më duket sikur jemi njohur bashkë dje.

— Nuk e di a do të shkoj a jo...

— Pse, s'ka ardhur makina?

— Makina erdhi, por unë nuk di ç'të bëj? Dua të rri këtu me ju.

— Vërtet thua?

— Po, Kolë, vërtet... Ti si mendon për këtë punë?

— Ti e di më mirë punën tënde, o Altin...

— Po ti si thua?

Kola e pa shokun drejt në sy e foli:

— Për besë, mua nuk ma ka ënda ndarjen, as me ty e as me shokët e tjerë, por duam që të jetë edhe për të mirën tënde e të prindërve të tu... Ti do të punosh këtu, ose diku tjetër. Ku të jetë më mirë... Këtu është vend i izoluar, gjashë muaj dimër i ashpër, larg fshatit tënd.

Altini ia shtrëngoi krahun dhe i tha:

— Falemnderit Kolë!

— Për çfarë po më falënderon, Altin?

— Ti, si gjithnjë, më flet me zemër të havur. Unë kam nevojë për mendimet e shokëve. Kam kaq ditë që luhatem, por tani që po afron ora e nisjes, e beson sa të vështirë, në mos të pamundur, e kam të ndahem me ju, të ndahem me këto vende? Çdo pëllëmbë e kësaj toke është e dashur bash sa jeta, thotë kënga e tani po e ndiej sa e vërtetë është kjo.

— Ti, mendohu mirë, Altin, dhe vendos... Sa për ne, ku ta giejmë të na rrish, u mësuam me ty, u bëmë shokë... Hajde, bre Altin, e të vimë një kafe...

— Të falem nderit Kolë... Të gjitha do t'i pimë në darkë... Ju presim. — tha ai.

— More, si nuk të pyeta një gjë. A thua ka vend për ty në postën tuaj si nënëficer?

— Mirë bëre që më pyete, Kolë... Sot po vendos të mos ndahem me këto male dhe me ju. Sa për punën, nuk mendoj shumë... A më pranoni në kooperativë?

— Në kooperativë? E si jo, more, si nuk të pranojmë ne tv?

Altini vuri buzën në gaz dhe mori udhën përpjjetë malit për në repart.

— Haide, *djalë*, hajde, — tha me zemër të sufuar brigadier Kola ndërsa rë vesh i vinin fjalët e Kudos: «Ai do të grabitë Katrinën... E ku ka shoqe Katrina si veten.»

\* \* \*

Rrugës pér në repart ai mendoi pér Katrinën: Ah, sikur të vinte në mbrëmjen e tyre ajo. Jo, ore! Ku e lë i ati atë të dalë natën nga shtëpia. Dhe i erdhi keq. Të nesërmen do të niseshin shokët. Mbështetje do t'ë nisej edhe ai, kushedi si bëhej puna. Vallë, do ta shih-

te më Katrinën? Kush i hapi ato fjalët në fshat e që i shkuan të atit aq mirë në vesh? Altinit sepse iu kujtua një mëngjes kur ishte takuar me Katrinën. Ai shkonte me shërbim lart në vendrojë, ndërsa Katrina nё punë:

«Mirëmëngjesi Altin!»  
«Mirëmëngjesi Katrinë!»  
«Si keni njeh andej?»  
«Shumë mirë, po ju?»  
«Mirë»

«Mirë qofshi!» — Dhe ishin vështruar gjatë nё sytë që u ndritnin. Bjeshkët rreth tyre kishin qeshur si ata, dhe lumi ujëkaltër sikur ia kishte marrë këngës atë çast.

«Mbrëmë kenduat deri vonë, Katrinë, ju dëgjuam,»  
«Na pushtoi kënga e gëzimi, bre Altin.»  
«Sa mirë, o Katrinë, sa mirë,» — kishte thënë Al-tini duke marrë rrugën drejt monopatit të ngushtë.  
«A po shkon, Altin, a?»  
«Po, Katrinë, jam me shërbim.»  
«Ani, shko, dhe të priftë e mbara.»

E ishin ndarë pa ditur se ky do të ishte takimi i tyre i fundit, ku mund t'i flisnin njëri-tjetrit pa zgjatur kokën njeri e pa pëshpëritur vesh më vesh. Po atë ditë Preka e bëri «çka kish mendjen». Katrina e uli pak kokën dhe shaminë e bardhë mbi ballë sikur donte të mbrohej nga dielli i nxeh të i verës. E prapë Altinin e kishte parë çdo ditë e i kishte buzëqeshur, po babait nuk ia kishte thyer zemrën, ama. Pak ditë më vonë kishte kenduar dikush një këngë të re. Kënga ishte hapur nëpër gjithë fshatin më shpejt se fjala. Preka e kishte bërë zap të bijën nga frika se po ia grabit dikush. Kënga thoshte:

*Gëzimi im ortek i bardhë,  
edhe kënga lumë i kaltër,  
po flet cuca me një djale  
me zemër të pastër.*

Ichte buzëmbrëmje. Altin Grezda jetonte në fjalët e kësaj këngë të bukur. Vështron tejt maleve, atje ku po fashitej ngadalë ajo ngjyrë e kuqe që e bënte çdo ditë të përflakej qelli majë kreshtave të larta.

Në rrugë u dëgjuan zëra. Komandanti doli nga zyra.

— Ejani t'i presim shokët, — u thirri ai kufitareve dhe priu i pari drejt tyre, duke i zgjatur dorën sekretarit të partisë që vinte i rrethuar nga malësorët.

Dhoma e kulturës ishte mbushur aq shumë, sa të dukej sikur gjëzimi dhe kënga do të çanin muret. Ia kishin marrë të gjithë, ndërsa Altini me fizarmonikë. Xani me dajre, Prenga me çifteli e Sotiri me gërmëtë përbënë orkestrën e tyre të vogël.

Dhe tek i binte fizarmonikës e këndonte. Altin Grezda donte të ishte tanë në shërbim qoftë edhe përpak caste, donte të bisedonte me malet dhe me çdo kullë malësori, ku ai dhe shokët kishin gjetur dyert të hapura, donte të fliste me Katrinën, donte...

E kur ia mori këngës me çifteli Prenga, ai u shkëput nga mendimet:

*Çdo pëllëmbë e tokës sonë  
është e dashur bash sa jetë*

.....

Dhe ata po i dehte kënga të gjithë sa qenë.

\* \* \*

Mëngjesi ishte i vrenjtur e frynte një erë e ftohtë. Mjegulla, si çdo ditë tjetër vjeshte, ishte varur deri poshtë në lugina. Asgjë s'pipëtinte dhe të dukej sikur ajo mjegull e dendur i kishte vënë në gjumë nierëzit dhe malet. Ishte ende herët, kur në qendër të kooperativës u dëgjuan tingujt e zgjatur të një borie e

malet që kthenin jehonën. Nisën të lehnin qentë. Shoferi dëshironte të shkonte sa më shpejt me ushtarët e liruar e t'i çonte të gjithë atë natë nëpër shtëpitë e tyre. Por ende rrinte i habitur në kabinën e tij të ngrohtë. Asnjeri nuk dukej, ndaj u mërzit. Mori rrugën pér në repart.

Atë kohë Altin Grezda ishte ngritur e kishte vrapuar deri te gurra e madhe, ku uji buronte i akullt nga shkëmbi. Aty ai e ndiente se si mbushej me jetë e ngazëllim dhe i hidhte ftyrës e trupit ujë të kulluar, borën e shkrirë të maleve.

Tek kthehej, sytë i shkuar te kolibja e qenit. Si e kishte harruar ai qenin e tij të dashur! Kur i kaloi afër, qeni nisi të angullinte. Zëri i tij dukej ankues. Ai shkoi e hapi derën sikur të donte të përshëndetet me të. Qeni nxori kokën e madhe, hapi sytë e qelqtej tej mase, pastaj nisi të skërmitej e ta kafshonte lehtë.

Ai e përkëdheli dhe pastaj mbylli derën.

Mjegulla kishte nisur të çuhej dhe malet po zbuloheshin ngadale. Altini kishte qëndruar përballë një dritatereje e sytë i depërtuan përtëj, ku qe varur në mur çiftelia e Prengës, pranë dajres, gënetës, ndërsa fizarmonika rrinte e harruar prapa një dollapi. Dukej sikur pas asaj dite nuk do t'i binte dot asnjë njeri siç i binte Altin Grezda.

Ai u largua prej andej. Komandanti doli nga zyra me një dosje në dorë. Si dukej, ishin dokumentet e ushtarëve të liruar. Ai kishte qëndruar pa gjumë gjithë natën, ishte i lodhur.

— Shoku komandant!

— Urdhëro, Altin!

— Unë... shoku komandant...

— Fol, Altin.

— Shoku komandant, e shikoj se e kam të vështirë të ndahem...

— Ta besoj, Altin, ta besoj... Se mos e kemi ne të lehtë të ndahemi me ju, se mos je ti i pari?

— Unë, shoku komandant, do të rri këtu. Mos ma hiqni emrin nga ky repart, shoku komandant, ju lutem!

Edhe po nuk pati vend pune për mua këtu, mos u bëni merak, unë do të punoj në kooperativë... ku të jetë nevoja.

- Shko njëherë në shtëpi, Altin, ne këtu jemi...
- Shoku komandant, ju lutem, unë kam vendosur...
- Mirë, Altin, — tha komandanti duke i shtrënguar dorën. Shko ca ditë te prindërit, ne të presim...

Pas pak ushtarët e liruar hipën në makinë.

Makinë nisi të ecët ngadalë, duke ngritur pas një re të vogël pluhuri:

— Mirë ardhsh, Altin Grezda, mirë ardhsh! — thirrën shokët, thirrën malësorët dhe zërat e tyre i dëgjuan rrugët, malet, piramidat e bardha. I dëgjoi edhe Katrina, që ishte ngjitur mbi një shkëmb dhe tundte në ajër shaminë dhe përsërise e përsërise: «Mirë ardhsh, o Altin Grezda, mirë ardhsh!»

1982

## **Isuf Baça**

### **NJË TRIM LARGOHET NGA RADHËT**

Martini e vërente ashtu siç e vërenin të tjerët se si ikte koha e ditët rendnin njëra pas tjetrës pa u ndalur askund. Të palodhura ato vëtëm ecnin dhe humbisnin siç humbasin edhe gjurmët. Ai shihte se si çdo ditë fëmijët e tij rriteshin dhe shkonin drejt pje-kurisë. Edhe pse përpinqej që t'i përfytyronte ashtu të vegjël, ata përsëri rriteshin. Martini e dinte fare mirë që ligji i jetës është i tillë. Lindje, zhvillim, vdekje. Rriteshin fëmijët, punonin, e transformonin botën aq sa mundnin dhe largoheshin më në fund. Pastaj vinnin të tjerë, të tjerë, të tjerë. Kështu jeta vazhdonte deri në pafundësi. Njeriu është i vdekshëm, ndërsa jeta e pavdekshme. Dhe kush vinte në jetë, duhej të bënte diçka pér të ardhmen. Ky mendim e shqetësonte vazhdimit Martinin. Ai kishte shumë vjet që rrinte në kufi dhe kishte shërbyer me ndershmëri. Megjithatë mund të bënte edhe më shumë...

Do të vinte një ditë, kur ai do të dilte në pension dhe do të largohej nga kufiri, nga malet, nga vështi-

rësitë, nga rinia. (Kufiri gjithnjë lidhej me rininë.) Do të bashkohej me pensionistë të tjerë, do të bënte debat me ta, do të aktivizohej në punët shoqërore të lagjes (ai nuk mund të rrinte kurrë pa punë, pa u marrë, në fund të fundit, me diçka), ose do t'i kërkonin kujtëme (ai kishte kaq vjet në kufi) për t'i botuar diku në ndonjë gazetë a revistë. Do ta ftonin të fliste nëpër takime me të rinxjtë. Dhe në këto takime ai do të ishte si veteran. Të tregonte, të tregonte, të tregonte. Derisa një ditë dhe ai do të largohej ngajeta si të tjerët më parë. Ndaj duhej bërë diçka e mirë në jetë, që t'i shërbente së ardhmes, t'u shërbente brezave që do të vinin. Duhej të mbante ditar. Le t'i hidhte ngjarjet e një jete të tërë në kufi ballë për ballë armikut e në ndeshje me të ashtu siç kishin ndodhur e aq sa i mbante mend ai, ato më të largëtat...

Tej xhameve, tutje, dukej pylli, i zverdhur e tek-tuk me njolla të gjelbra. Ai i përqendroi sytë diku, në një pikë, larg, aty ku mbaronte pylli i ahut e majat ngriheshin të egra, të prera thikë, të zhveshura krejtësisht, por megjithatë têrheqëse, madje të mahnitshme. Pikërisht aty ku mbaronte pylli i ahut e nisin ngjitjen drejt qiellit shpatet e zhveshura, ishte një shpellë. Atë shpellë e quanin Shpella e Ariut. Mallet që ngriheshin drejt qiellit e që dukeshin sikur me majat e tyre të mprehta e shponin atë, ai i njihete pëllëmbë për pëllëmbë. Kur kishte ardhur për herë të parë në këto anë, flokët i kishte pasur të zinj e të dendur. Njëzet e pesë vjet që jetonte me kufirin. Një çerek shekulli! Dhe koha mbi flokë i kishte hedhur dëborë e në ballë i kishte hapur brazda. Një çerek shekulli!...

Pa e kuptuar as ai vetë, ngjarjet e regjistruara në kujtesë nisen të lëviznin, po zgjoheshin, po gjallërosheshin e po merrnin jetë.

...Duart nuk i ndienin nga të ftohtët. Pas dhjetë orësh zvarrë nëpër dëborën poshtë tyre e në atë që binte sipër tyre, ata kishin arritur në Shpellën e

Ariut. Drutë nuk ndizeshin. Duart e tyre të ngrira nuk ndienin asgjë. Ato u dukeshin të huaja e të rënda. Dhe po të mos ishin gjethet e rëna nga pemët, ata mbasë nuk do ta kishin ndezur zjarrin kurrë. E ç'mund të ndodhët më vonë?! Çfarë muaji ishte atëherë? Dhjetor, janar a shkurt? Ja nga duhej ta niste shkrimin e kujtimeve ai. E hapi blokun dhe në të shkroi fjalën e parë:

«Dimër i vitit 195...»

Gjithçka iu qartësua e iu kthjellua. Zvarritja, mjegulla, tymi, dëbora e thatë e me erë që të merrete frymën, kapotat që i shtronin mbi dëborë, si hiqeshin zvarrë mbi to, se ndryshe nuk bëje dot një hap përpara; shoku i sëmurë që e tërhinqnin me mundim, përpjekjet e tyre për ta mposhtur motin e egër, shfryrja e natyrës, forca e madhe e njeriut dhe së fundi shpella. Pas fjalisë së parë ai hodhi të dytën:

«Kishim marrë urdhër që me çdo kusht të zinim shtegun.»

Fjalinë e tretë nuk e nisi dot, se trokiti dera dhe brenda hyri një ushtar.

— Hë Agim, çfarë ka ndodhur? — e pyeti ai qetë.

— Erdhi posta, shoku komandant. Një telegram.

Ushtari e la telegramin mbi tryezë, mori leje dhe doli. Dera u mbyll lehtë pas tij. Kush ia çonte Martin Pejës këtë telegram? Zakonisht atij i vinin vetëm letra. Kufitarët e liruar nuk e harronin as komandantin e tyre e as kufirin. E mori në dorë me atë kureshtje për ta mësuar sa më parë të panjohurën që fshihej në letrën e ngjitur me zamkë. E grisi ngjitésen dhe telegrami me një cep të shqitur u hap. Paras syve të tij shkronjat e vogla u zmadhuin, u nxinë, u nxinë, dhe ai e largoi telegramin. E afroi përsëri, e rilexoi dhe pastaj e la mënjanë. Ato shkronja të vogla, shkruar pa rregull, pa pikë e presje, formonin një lajm dëshpérues. «*Fuati na la. Altini*».

Telegrami i hapur qëndronte mënjanë, mospërfi-

llës e i zhubravitur. Martini e pa dhe një herë pjerrtazi.

«Domethënë ai paska...» — dhe mendimet e push-tuan të tèrin. Diçka e shpejtë i përshkoi trurin dhe kufitarët e rreshtuar nisën t'i ringjallen. Kujtimet zgjeroreshin; vinin me forcë të çuditshme, të papërmbar-tshme, kërkonin vend, hapësirë. Dhe i la të rriddhnin... Para tij parakalonin tashmë ditët e kaluara, ashtu siç kishin qenë dikur, të plota e të qarta...

...Një ditë më parë kishte rënë shi me rrebesh. Tani retë që kishin pushtuar qiellin kishin zbritur deri poshtë. Rrebeshi kishte pushuar dhe shiu vetëm sa rigonte. Trupi të rrëqetë dhe ftohtësia e përshkon-te me lehtësi veshjen verore. Në darkë shiu reshti fare, ndërsa retë e mjegulla ashtu të copëtuara, me forma nga më të çuditshmet, rendnin, vraponin, përplaseshin shkrepave e luginave, derisa humbisnin diku. Pas shiut që ra e pas të ftohtit që zbriti krejt papritur, edhe yjet dukeshin sikur ndriçonin më shumë.

Fuat Alites i bëri përshtypje se si vjeshta kishte zbritur njéherësh. Po pylli kështu do 'të zhvishej? Një pyll i zhveshur në pak ditë duhej të dukej i shëmtuar, fatkeq dhe si i vëtmuar. Tek shkonte këto gjëra në mendje, ndjeu keqardhje. Keqardhjen e tij po ia thoshte komandanti, Martinit. Atyre u pëlqente komandanti i tyre i thjeshtë, i shkathët, i dashur dhe që ende nuk i kishte dirsur mirë qimja në faqe. Vetëm mustaqet e holla e tregonin atë pak më të madh në moshë se kufitarët.

— Në male vjeshta vjen shpejt dhe papritur, Fuat. Vetëm kur në një mëngjes sheh në oborr e përqark se ajo ka zbritur fare pa trokitur.

— Ashtu! — Fjalën «ashtu!» ai e përdorte shpesh kur fliste dhe ajo ishte bërë për shokët e Fuatit si një pjesëz dalluese e tij, siç ishin sytë, fytyra, trupi i gjatë, të ecurit.

— Po, po, ashtu, — qeshi Martini. Atë vit e kishte të katërtin në postën e largët kufitare. Katër vjet!

Đitët e mbushura me plot ngjarje e plot tension, kishin ikur si pa u vënë re. Në fytyrën e komandantit ato kishin lënë vetëm mustaqet e zeza dhe të holla. Por ishte bërë edhe më i menduar. Para se të fliste, matej më shumë dhe nuk i hidhte fjalët në tym. Kishte depërtuar në të fshehtat e punës dhe e ndiente veten zot të detyrës.

Heshtjen që ra midis tyre, e theu komandanti. Ai i tha diçka ushtarit. Pas pak Fuati shkoi të hante drekë. Një orë më vonë njësiti i tij nisej për të marrë shërbimin.

Para se të niseshin, komandanti i porositi edhe një herë se si duhej të vepronin gjatë shërbimit dhe, kur u bind se kufitarët e kishin të qartë detyrën, u uroi shërbim dhe rrugë të mbarë.

Pas një gjysmë ore, njësiti e kishte kaluar luginen dhe ngjitte të përpjetën. Fuati, si përgjegjës që ishte, ecte përpara, në krye. Pas tij vinin dy të tjerët. Rruja gjarpëruese, vende-vende tepër e ngushtë, përshkontë të përpjetën derisa humbiste në pyll, në pyllin me ahe të larta. Në postë do të ktheheshin pas dy ditësh. Ata ngjiteshin drejt majës ku ishte një piketë. Në atë piketë, që kontrollonte lartësitë, rojat e kufirit ndërroneshin çdo dy ditë. Dy ditë e dy net me radhë ato qëndronin në lartësitë.

Poshtë tyre shtriheshin luginat, pyjet, fshatrat; lart qelli dukej më i kaltër dhe mushkëritë e tyre kërkoin më shumë ajër. Dy ditë e dy net shikimi i tyre hiqte vijën imagjinare midis piramidave dhe e kontrollonte atë vijë që të mos e shkelte kush. Të huajt vinin defi afër piramidave, seç bënin ca lëvizje pa kuptim, flisnin në gjuhën e tyre fjalë që tingëllonin si të shurdhëta, dhe, pasi rrinin ca, largoheshin. Kufitarët ishin mësuar me vajtje-ardhje e lëvizje të tillë, me të folurën e tyre të rëndë dhe e merrnin me mend se ç'mund të thurnin ata. Ndaj nuk e mbyllnin kurrë syrin. Që nga piketa, shikimi i tyre endej në çdo pëllëmbë kufiri që ruanin.

Fuat Alitja ecte para shokëve. Prapa tyre, poshtë

në luginë, kishin ngelur posta dhe shokët. Ata ndalën në këmbë, u mbushën me ajër të freskët dhe kthyen kokën nga lugina. Si një gjarpër e përgjysmonte luginen lumi me ujë të ftohtë. Vende-vende ai fshihej, për të dalë pak më poshtë e për të humbur në ndonjë kthesë, për t'u futur grykave e për t'u derdhur pastaj diku në një lumë tjetër më të madh se ai. Në të dyja anët e luginës bënin rojë shtëpitë e bardha e me çati të pjerrëta të fshatit malor. Fshati mbante emrin e një luftëtarit që ishte vrarë në qafën e malit në përpjekje me ushtritë e Turgut Pashës. Te vendi i rënies së tij nuk ngrivej ndonjë lapidar, por grumbulli i gurëve të zinj e thepa-thepa, si të vënë pa kujdes njëri mbi tjetrin, formonte një monument të çuditshëm, njëkohësisht madhështor.

Pamja i thithi të tre kufitarët sikur për herë të parë ta shihnin luginën nga ajo pikë. Të ngjiteshe në atë pikë e të mos i hidhje sytë pamjes që hapej përrpara teje, nuk mundje. Ndoshta kjo vinte edhe ngaqë pak më tej rruga humbiste për t'u futur në pyll e pastaj për t'u ngjitur drejt majës, ku, e veimuar, pranë piramidave të bardha e stoike, ngrivej piketa, piketa ku ata ruanin kufirin.

- Nisemi? — u tha Fuati shokëve.
- Nuk do të pushojmë ndokund? — pyeti Dashi.
- Ndalem i te çezma më mirë.

Dy të tjerët e aprovuan në heshtje. Pak më tej rruga u fut në pyll dhe ata i fshehën drurët. Udhë u bë më e butë dhe ajri më i freskët. Gjethet e zverdhu-ra para kohe, tek rrëzoheshin nga pemët, lëshonin një zhurmë të lehtë, fare të lehtë, kur çiknin tokën. Uji që derdhej nga lëfyti i gdhendur i çezmës e mbushte përrroin me nanurimën e tij të ëmbël.

Ata u afruan te burimi dhe ndalën të pushonin pak. Kënga e burimit të ngallte një gëzim të brendshëm. Ndoshta dhe ai që e kishte gdhendur aq bukur lëfytin e gurtë të çezmës, atë gëzim kishte dashur të shprehte. Dashi u çua nga vendi ku ishte ulur për

të pushuar, u përkul mbi gjunjë dhe i mbështeti buzët te lëfyti i gurtë.

— Mos pi shumë, se të bën dëm uji pas udhëtimit, — i tha Fuati.

Tjetri e dëgjoi, por buzët nuk i largoi nga çezma. Një erë e lehtë tundte majat e aheve, këpuste prej tyre gjethet e zverdhura para kohe dhe i rrëzonte përtokë. Njëra prej tyre, duke u vërtitur në ajër, po ulej drejt çezmës.

— Vë bast se do të bjerë mbi kokën e Dashit, — tha Berti.

— Kurse unë... — por Fuati nuk arriti ta mbaronte fjalën, sepse një krismë e thatë cau pyllin. Dashi, që kishte mbaruar së piri ujë dhe që e kishte drejtuar trupin, nuk po mbahej dot në këmbë. Bertit dhe Fuatit u zienin veshët nga krisma. Kishin qëlluar nga afër.

— Dashi! Dashi! — thirri Fuati dhe rrëmbimthi lëvizi nga vendi. Andej, nga erdhi krisma e pushkës, qëlloi Berti.

Dashi pa nga shokët, por vështrimi i tij po humbiste tutje në largësi, po shuhej... Gjaku nisi t'i pikonte në ujin e burimit dhe bashkë me të rridhte në përrua. Fuati u sul te burimi, e rrëmbeu shokun që po rrëzohej dhe e mbështeti ngadalë në tokën e butë e pak si të lagësht. Dashi i hapi sytë përgjysmë, ia nguli bebëzat që po i shuheshin shokut dhe me mundim, sikur t'i nxirrte fjalët nga një hon i thellë, tha:

— Më vjen... keq... që nuk e... zbraza një... pushkë kundër... tyre. A... ta... — dhe bebëzat iu mbyllën e zëri iu shua. Ndoshta ai deshi të shtonte dhe diçka tjetër, por nuk mundi. Atë diçka e plotësoi Fuati duke murmurit urtë dhëmbë tërë urrejtje: «Do t'i zhdukim! Të premtoj se do t'i zhdukim!» Dhe e la shokun shtrirë mbi tokën e butë e pak si të lagësht, rrëmbeu armën dhe zuri pozicion pas një guri. Åsnjë krismë tjetër. As zhurmë. Nga kishte ardhur ai plumb? Ku ishin ata që kishin qëlluar?

— Të pabesë, pse nuk qëlloni? Dilni! Ku jeni?

— Thirrjeve të Fuatit u përgjigjej vetëm jehona e zërit të tij. Ai u mat të thërriste përséri, por dikush iu përgjigj:

— Nuk qëllojmë më, or këlyshë të kuq, jo. Jo se na dhimbseni, por se do t'ju kapim të gjallë. Pastaj do t'ju rrjepim si keca. Ne dhe mund të mos ju rrjepim, xhanëm, po qe se dorëzoheni vëtë. Këtu ndryshon puna. Ka kushte të tjera. E ç'mendime keni ju? — Zëri i atij që fliste ishte si i gërvishtur dhe tingëllonte shumë keq.

Dy krisma e çanë pyllin. Ngaqë qenë njëherësh, ato u dukën si një. Mbi kokën e atij që fliste me atë zë gërvishtës, vërvhellyen plumbat.

— Ky është mendimi ynë, o të pabesë si qentë e rrugëve! — shfryu Fuati.

Tjetri e ngriti përséri kokën.

— Atëherë edhe të vdekur do t'ju rrjepim! Po ju na duheni të gjallë, të gjallë, për të tjerat do të kemi kohë pastaj! — dhe ai që ulërinte, me një kërcim të shpejtë, u hodh përpara e zuri pozicion të ri. Të njëjtin veprim bënë edhe të tjerët. Ata ishin pesë veta, që kishin katër orë që rrinin fshehur në ato pozicione e prisin njiçtin të ngjitej në piketë. Të pestë të armatosur, me dy bomba varur në brez, me thika, me automatikë dhe me urrejtje. Kishin për detyrë të shpinin të gjallë matanë kufirit qoftë dhe vetëm njërin nga kufitarët e njësitit shqiptar. Pylli ku ecnin kufitarët pak më parë dhe që dukej aq i qetë, nuk paskësh qenë i tillë.

Ata të pestë bënë përséri edhe nga një kërcim tjetër. Kërcimi ishte i shpejtë, i menjëhershëm dhe i befasishëm. As Berti e as Fuati nuk arriten t'i shkrehnin armët. Në pyll nuk cicërinte asnje zog. Ku kishin shkuar zogjtë?! Dëgjohej vetëm nanuritja monotone e burimit. Ata u matën të bënин kërcimin e tretë. Me atë kërcim do të afroheshin shumë dhe atëherë... Ata ishin pesë. Të armatosur, të egër, agresorë. Sytë e kufitarëve prisin. Prisin gishtërinjtë e tyre në këmbëz.

Kaluan ca minuta në heshtje. Dhe ata të pestë.

pas heshtjes së shkurtër, u hodhën përsëri përpara, por nuk arritën të zinin vend pas drurëve, se të shtënat e kufitarëve sikur e stepën vrullin e tyre. Dy rënkime u shndërruan në ulërima. Në ulërima të zvargura, gatigati si kuisje qensh të plagosur për vdekje. Pastaj përreth ra përsëri heshtja, një heshtje e mbarsur me tension.

— Qëlloni mbi këlyshët, se na vranë! — klithi ai që duhej të ishte kreu i tyre. — Qëlloni, derisa t'i zhdukim!

— Ndërro pozicionin! Shpejt! — e urdhëroi Fuati Bertin. Po Berti nuk pati kohë të ndërronte pozicionin, se dy plumbë e morën në trup. Toka u rrötulla e iu duk sikur gjithçka po shembej. U përpoq të hapte sytë, por nuk mundi. Me dorën e djathtë shtrëngonte fort pushkën, sikur e ruante të mos ia rrëmbenin. Dhe ndjenjat i humbën...

— Të plagosën. Ah, mor Berti, të plagosën! Rëndë!? — Zëri i Fuatit ishte aq i ulët, sa Berti, edhe sikur të mos i kishte humbur ndjenjat, nuk do ta dëgjonte. Në të vërtetë më shumë sesa shokun, ai pyeti veten. E tundi kokën fort, dhe e mbështeti syrin te shënjestra e armës. Një nga ata të tre (aq kishin mbetur), ai i cepit, po mundohej që tinëzisht t'i afrohej Bertit. Fuati me kujdes e vuri në shënjestër. Nuk e dëgjoi fare krismën e armës. E kishte mendjen gjetkë. Ai, sikur ta kishte zënë papritur gjumi, nuk bëri asnjë hap më tej. Plumbi e kishte marrë në kokë. Fuat Alitja mori fryshtë i lehtësuar. Rimbushi armën dhe priti. Ata të dy dy heshtnin. Çfarë kishin ndër mend të bënin?! Pse nuk fliste më ai që do t'i rripte si keca? Fuatit i hipi në kokë që ta dëgjonte dhe një herë atë zë të gërvishtur. Çfarë toni do të kishte tanë? Përsëri po ajo heshtje plot tension. Pastaj si një zog i zi sterërë, pa kokë, pa fletë, me katrорë të ndarë si të kurrizit të breshkës, pa të vinte drejt tij bombën. Ja pse pas-këshin heshtur ata! Po të lëvizte, armiqtë do ta qëllonin të dy njëherësh, me zjarr të kryqëzuar. Ndaj e fshehu kokën pas gurit, dhe... priti. Iu duk një pritje e

gjatë, shumë e gjatë. Ndoshta pritja më e gjatë në jetën e tij. Mendimet iu topiten dhe në kokë si çekan e godiste vetëm një pyetje: «Kur, kur, kur?...» Pastaj vendi përqark iu drodh, i shungulluan veshët, gati-gati iu shurdhuan dhe mbi trup ndjeu t'i binin copërat e dheut. Buçima e plasjes përhapej tutje dhe veshët e tij gumëzhanin. Ishte një gumëzhimë çoroditëse. Priti të humbte ndjenjat, të mos dëgjonte gjë më, të ndiente diçka si humbëtirë, por asgjë nga këto nuk po ndodhët. Mendjen e kishte të kthjellët. Vetëm se i zienin veshët dhe dora e majtë iu ngroh. Gjaku i vakët i njomi xhaketën. Dora e djathët iu rëndua. Ngriti ngadalë kokën pas gurit (ai gur i kishte shpëtuar jetën) dhe pa andej nga ishin ata. I erdhi si çudi kur i pa që u çuan të dy dhe u kthyen andej nga kishin ardhur. «Pa shih, pa shih, po ikin qentë!» — tha me vete dhe i mblodhi forcat që të lëvizte dorën e djathët, por e pa se çdo përpjekje ishte e kotë. Nga e majta vazhdonte t'i ecte gjak, gjak i vakët dhe i trashë. Mori frymë thellë, rimblodhi forcat dhe bëri të ngruhej. Kur u ngrit në këmbë, fytyra i qeshi. Ai ende kishte forca për të fituar mbi armikun. Dhe u nis pas tyre. Në fillim më hapa të çrrëgullt, të mëdhenj e duke u lëkundur. Para tij ecnin si në tym ata të dy, të pezmatuar, të drobitur, të dërrmuar. Përpiqeshin të nxitonin, por nuk mundnin. Ecnin dhe kryet nuk e kthenin prapa. Pas tyre Fuati, me kokë pakëz të turbulluar e që i zhuzhinte si koshere bletësh, hidhët hapat si somnambul. Në çdo qelizë të trupit të tij pulsonte urrejtja. Të dyja palët i linin drurët njërin pas tjetrit, prapa. Ah, ky pyll që nuk kishte të mbaruar! Në çdo pesë hapa ata të dy i fshihnin drurët.

- Tre me tre, — tha me gjysmë zëri ai që printe.
- Raport i drejtë, — iu përgjigj tjetri.
- Megjithatë nuk e kryem plotësisht detyrën, — tha prapë i pari.
- S'kishim ç'të bënëm.
- Nuk i bëmë mirë llogaritë. Që t'i kapnim të gjallë, duhej të ishim të paktën dhjetë.

Ai që vinte pas nuk foli më. Prapa tyre, me hapa tē çrregullt, i mbushur me urrejtje, ecte kufitari. Dora e djathtë vazhdimisht, pas qđo hapi tē mundimshëm që hidhte, i rëndohej. Pérplaste qepallat dhe shtrëngonte dhëmbët. Nuk duhej ta mposhitte dhimbja. C'ishte ajo peshë e rëndë që i varej në supin e djathtë e ai me vështirësi po e mbartte? Para tij ata tē dy. Po pylli dhe sa do tē vazhdonte ende? A i kishin dëgjuar tē shtenat e tyre në postë? Pylli ua kishte përcjellë shpatave oshëtimën e tyre, shpatet grykave e ato luginës. Ata duhej t'i kishin dëgjuar patjetër. «Tani shokët janë në rrugë e sipër», tha me vete. Por, sa tē vinin shokët, ata tē dy mund tē hidheshin përtej kufirit. Ndaj ai duhej t'i mblidhte forcat, t'i ndiqte armiqtë e t'i asgjëson. Drurët e pyllit zunë tē rralloheshin. Ai vazhdonte ndjekjen. Ishte një ndjekje e mundimshme. Ata tē dy para tij merrnin trajta tē ndryshme. Herë i dukeshin si dy hunj, herë si dy trungje që çapiteshin e herë i dukeshin si qenie tē habitshme, pa fytyra, tē egër dhe tē zinj. Më në fund edhe pyllin e kaluan. Ata tē dy kishin pér tē ngjitur edhe një kodër tē butë e pastaj do tē ishin matanë, në tokën e shtetit tjetër. Fuat Alite i shpejtoi hapat. Se nga i erdhi ajo forcë, as ai vetë nuk po e kuptonte. Iu kujtuq se në shkollë i kishin folur dikur pér një njeri që e merrete forcën nga toka. Pa tokën ai nuk mund tē jetonte. Dhe atij sikur ia dha toka që ruante, ato forca. Te druri i fundit që shënonte dhe mbarimin e pyllit, u ndal. Pastaj me mundim u shtri. Ata po ngjiteshin kodrës. Tërhoqi këmbëzën e armës, por... ajo ishte bosh. Si do ta mbushte tan? Kurse ata largoheshin, largoheshin... Atëherë mbështeti kokën mbi shulin e armës, kapi dorezën e shulit me dhëmbë, e tërhoqi prapa, e lëshoi me forcë para dhe mori frymë i lehtësuar. Arma ishëtë mbushur. Vuri në shenjë atë që ecte pas tē parit dhe me tē majtën e plagosur zbrazi armën. Dhe pa se si qenia e egër e pafytyrë u këput e ra mbi barin e bjeshkës. E përsëri u dëgjua krisma e armës. Dhe prapë nga e para po ai veprim. Mekanikisht ai përkulte kokën mbi armë,

tërhiqte prapa me dhëmbë shulin dhe e lëshonte me forcë përpara. Katër herë e kreua atë veprim. Derisa fishekët iu mbaruan. Pas së shtënës së fundit, ai që ngjiste kodrën, mblodhi forcat që të hidhte dhe një hap, vetëm një, por u lëkund, u lëkund, u përpoq të mbahej, por nuk mundi. E humbi ekuilibrin dhe ra në një gropë. Në Lufën e Parë Botërore ajo gropë kishte shërbyer si llogore. Pak më tej saj, ku vendi vinte si i ngritur, ishte varreza e ushtarëve të Turgut Pashës. Varri i tyre ishte i përbashkët.

Fuat Alitja mbështeti kokën mbi armë dhe dora e djathët iu rëndua, iu rëndua pa fund... I dukej sikur po e tërhiqte poshtë në një humnerë të errët. Por shpejt humnera iu shndërrua në një luginë. Si një gjarpër, atë e ndante në mes lumi që buronte nga malat. Ishte lugina me shtëpi të bardha e çati të pjerrëta. Fare afër dallonte monumentin e çuditshëm të luftëtarit që ishte ndeshur me armikun, me ushtritë e Turgut Pashës. Pastaj monumenti i gurtë u kthye në një lapidar të bardhë. Pranë lapidarit rriddhë burimi. Ishte lapidari në vendin ku ra Dashi. Pesha e rëndë e tërhiqte poshtë e më poshtë dhe ai ndjeu se po binte. Kështu derisa ra në luginë, fare pranë postës, pa pësuar gjë. Që nga oborri i saj pa të vraponin drejt tij shokët...



Që nga ajo ditë, kishin rrjedhur kaq vite!...

Në zyrën e Martin Pejës vinte jehona e këngës që këndonin barinjtë në bjeshkë. Te piketa në majë tani shërbenin djem të tjerë. Në cep të tryezës së tij, telegrami. Ajo copë letër e zhübavitur dhe mospërfillëse mbartte mbi vete peshën e një hidhërimi.

*Fuati na la. Altini*

— Eh, mor Fuat Alite! Ajo ditë qe shumë e rëndë për mua e për shokët e tu. Dashi i vrarë e ti me Bertin tē plagosur rëndë e pa ndjenja. Të gjetëm me kokën tē mbështetur mbi armë e me gishtin në këmbëzë... — Dhe Martini psherëtiu thellë. Shkoi dorën ngadalë mbi flokë. Po thinjej. Le të thinjej. Ai nuk kishte qenë parazit në jetë. Dhe Fuat Alitja nuk kishte qenë parazit.

— Ishe trim, o Fuat! Dhe për trimat populli ka respekt e nderim. — Nga bjeshka vinin tingujt e fundit të jehonës së këngës. Ishte një «hej, more, hej» i zgjatur, që të jepte idenë e pafundësisë së këngës.

Martini u çua, mori nga tryeza telegramin, e mblodhi shuk dhe e futi në xhep. Vendosi që të nesërmen të bënte një bisedë me kufitarët për Fuat Aliten. Ata dinin gjithçka për heroizmin e tij, se komandanti u kishte folur shpesh për të, — por le ta mësonin se trimi ishte larguar nga radhët. Edhe ata duhej ta dinin këtë. Mbi tryezë mbeti blloku i hapur te faqja e parë. Në të ishte shkruar bukur:

*Kishim marrë urdhër që të zinim me çdo kusht shtegun...*

Në bjeshkë barinjtë kishin nisur një këngë tjetër trimërie.

1975

## Koço Kosta

### DHEMBJA E GUÇE GËRBIT

Shikova në ndenjësen përbri, tek ishte ulur gjyshja. Ajo s'e ngrinte kokën, e kishte lëshuar veten krejt. Autobusi atë kohë u kthyte për të ndaluar.

Zura gjyshen për krahu dhe zbritëm. Kjo është tepër e moshuar dhe në fshat i thérresin Mëmëlale. Një çast ndaluam te sheshi i asfaltuar, përparrë hyrjes së autobusit. Pak më lart fillonte udha e shtruar me kalldrëm. Kalldrëmi dukej i bërë me kurriz. Mëmëla-lja qëndronte si mbi gjemba e s'donte të shikonte as gjë përqark.

— Të ikim, — tha.

Kërkonte të mbërrinte sa më shpejt në fshat.

— Gjej një nga ato verveletë e xhindosura dhe të ikim, — tha përséri.

— Prit, — mërmërita, — ndoshta gjejmë taksi.

Unë thashë ashtu dhe u kujtova menjëherë se ajo vvervelé i thoshte taksisë.

— Hë, de, pa në më pafsh më!

— Të pimë nga një kafe, — i thashë.

— S'i vë në buzë lëngrat e qytetit unë.

Dolëm në një vend më tej, nën hijen e një muri të lartë me gurë të gdhendur. Atje ishte vendqëndrimi i talksive dhe pas pak erdhi një makimë. Shoferi zbriti dhe tha:

— Jam i zënë me të tjerë, më pritni pas një ore. Ja, rrini atje te kafja.

— Mirë, — belbëzoi gjyshja.

— Po eja të pimë diçka, — i thashë.

— Unë pres këtu, ti, në daç, bridh këtë sahat, — foli ajo dhe s'më shikoi në sy. Tha ashtu dhe u kthye me kujdes të madh, sikur të trembej se mos i thyhej trupi kaba. U ul pa të keq te një bordurë, nën hijen e murit dhe më ktheu kurrizin. Kurrizin e kishte të gjatë, të përkultur dhe këmbët të shkurtra.

— Të të sjell diçka pér të ngrënë, — i thashë.

Ktheu pak kokën, ngriti mjekrën lart dhe më shikoi me sytë e përbardhur. Buzët e mbledhura e të shkurtra i lëvizën.

— Kam shtëpi, — tha. — Po të mos gënjejë e të kthehet pas një sahati ky burri i aftoqinit të vogël, sosëm në shtëpi.

Kështu kishte vendosur: të hante kur të mbërrinte në shtëpi...

Me mundim të madh e bindëm që, më në fund, ta merrja në Tiranë dhe ta mbanim atje dy muaj. Por erdhi dhe, apo hyri në pallat, u tërbua nga mëria. Tetë ditë ndenji, po na shqetësoi seriozisht. U bë grindavece, e padurueshme. Kështu që ditën e tetë vendosëm ta kthenim në fshat.

«I bukur ë qyteti, por i bukur ë dhe fshati im», thoshte.

Ajo trembej që ndodhej jashtë trojeve të fshatit. Se atje kishte jetuar mbi 90 vjet. Vetëm atje. Dhe

tani kujtimi i fshatit, qdo çast, i fliste për një jetë të gjatë e të paturbulluar. Atje s'kishte pleqëri për të. Ndërsa, qyteti e trembte.

«Këtu plakem», thoshte...

— Eee! — thirra befas.

Para meje, në shëtitore, ecte i vetëm Guçe Gërbi i fshatit tim. Ai ishte i hutuar dhe lëvizte me plogëشتë.

— O xha Guçe! — thirra përsëri sikur të kisha frikë se do të më zhdukej e do ta humbisja. Prania e tij atje në qytet më gëzoi pa masë. Po sepse m'u dhimbis!

U takuam. Ai diçka mërmëriti ngadalë. E kapa nga bërrylat dhe e shikova, drejt. Sytë shprehnin mërzi. Dhe buzët i kishte të vrerosura. Tërë pamja e tij shprehte lodhje dhe përhapte një hidhërim therës. Unë u preva dhe përnjëherësh m'u krijua një boshllëk i madh. Isha i lodhur nga udha e gjatë dhe kisha nevojë për pak gaz, për pak argëtim. Po Guçja qe i mjerë dhe mjerimi gjithmonë ka nevojë për ngushëllim. Ai nuk po qante, po diç donte të thoshte, se buzët i lëviznin. Kisha, përpara njeriun e dashur të fshatit tim. Pati qenë i varfër, pati qenë partizan, kishte lindur nëntë fëmijë dhe tani punonte si rojë në zyrat e kooperativës. Është fjälëpак dhe i ndershëm. Ende s'po fliste.

— Hé! — Vetëm kaq tha. Në gojë i luhatej bishti i zi i llullës.

— Ç'të ka ndodhur, — i thashë dhe shikova përqark se mos shihja fshatarë të tjerë. «Pse krejt i vetëm, Guçe Gërbi?! I vetëm dhe kaq i mjerë?!!»

— Mirë je me fëmijë, mirë?

— Shumë mirë, — i thashë.

S'foli më. Buzët iu drodhën përsëri. Kishte dhembje të madhe.

E shikova drejt. Ajo dhembje sikur e lartësonte edhe më. Siç lartësohet një vigan i plagosur.

Nga plaga, mustaqet karakteristike atë ditë sikur

i qenë fishkur. Po zverdhej dhe sytë vazhdonin t'i fundoseshim.

— Hyjmë në kafe, — i thashë dhe e tërroqa me kujdes nga bërryli.

Ai u çapit hapazvarrë.

— Humbi edhe një, — murmuriti i trishtuar.

Guçe Gérbi dukej sikur vinte nga një gjëmë. Kishte parë edhe një që kishte humbur.

Unë i thashë kamerieres të na sillte nga një kri-këll me birrë dhe pak më vonë nga një kafe.

— Për mua dy kafe, — tha Guçe Gérbi. — Vetëm dy kafe. Me pak.

Nuk fola. Porosita edhe unë vetëm kafe. Ai i piu njérën pas tjetrës dhe ngatërroi gishterinjtë e duarve. Më shikoi drejt. Buzët donin të thoshin diçka.

— Varrosëm një shok, — tha ai më në fund. — Një shok nga tanët.

— Këtej ishte, nga qyteti?

— Këtu punonte, — tha Guçe Gérbi. — Qe komunist që në ballë e gjer para dy sahatësh, kur e mbuluam. Eh!

Guçe Gérbi nisi të fliste përvite të shkuara. Dëshpërimi dhe dhembja i shpien mendimet në të kaluarën.

Ai erdhë fare i vogël në batalion. Katërmëbëdhjetë vjeç qe. Sot që e varrosëm, i pashë pëllëmbët e verduha të ulura mbi bark, në kërthizë të tij. Më ra varomë për pak, o djali. Atje te kyçi i dorës së majtë kishte sahatin. Një sahat që vetëtinte. Ndenja, tërë natën pranë tij dhe piva shumë duhan, dhe e pashë në fytyrë ashtu të vdekur. E shikoja që ta besoja se kishte vdekur. Se s'më besohej. Po atë minutë që hapëm kapakun e sëndukut të kuq, para se ta futnim në dhë, sytë më ranë te pëllëmbët dhe shikuam sahatin. Sahatin e

verdhë që vetëtinte. Ai send akoma që gjallë. Dhe m'u duk sikur u ngrit Qebiri. U ngrit ashtu me 14 vjeçët e vegjël, me ata, 14 vjeç që erdhi në batalion.

Njëri nga shokët përgjegjës këtu në rrëth lexoi një letër plot fjalë të mira për Qebirin, po mendja ime fliste për atë natë të 1944-ës. Ja, këtu ishte qyteti, këtu. Këtu ishin gjermanët dhe ballistët. Ne do të bënim luftë. Duhej ta merrnim qytetin, pastaj të iknim më tej. Urdhér.

Kishim zbritur atje përtej lumi, te Balta e Bardhë. Flini, tha komandanti i batalionit. Flini, se pa gdhirë do bëjmë luftë.

Fjetëm ca. Pa vajtur sahati 12 i natës, më zgjuan. Gati, thanë. Mbathëm opingat dhe i lidhëm në mes. Qe behar. Fund behari apo fillim i vjeshtës së parë, më duket.

Në qytet kishte shumë ballistë dhe gjermanë. Nuk vemi në dasmë, tha komandanti. Komandanti rron akoma. Rroftë! Po Qebiri iku. E mori një sëmundje e ligë... Kështu, nuk vemi në dasmë, tha komandanti. Ashtu thoshte ai para sulmit.

Në mesin e natës nisëm sulmin. Lufta vazhdoi gjer në mëngjes, kur zbardhi dita. Luftonim në katër pilka të qytetit. Edhe ballistët luftonin si qena dhe s'hiqeshin. Hakçë! Po në mëngjes hymë në qytet. Mua më kishin trembur dy plumbë. Njëri në sup dhe tjetri në shpatull. E, atë gërvishtje atëherë e mora. Cuk, më do-gji një çikë. Pak gjak rrodhi, por e vulosa me duhan dhe s'pikoi më. Zumë dyqind ballistë, i çarmatosëm dhe i bëmë grumbull si lopët. Oburran, përpara! thirri përsëri komandanti i batalionit. Po gjermanët u treguan dinakë; ata qenë ngjitur në kala dhe qenë mbyllur benda. Kështu që duhej ta mendonim mirë atë punën e k拉斯ë. Numëruam shokët. Na qenë vrarë ca. Rrethuan prefekturën dhe e hodhëm edhe atë në dorë. Tamam në atë kohë u dha urdhri që të tërhiqeshim. Të tërhiqeshim, se nga kufiri në jug po hynte një autokolonë gjermane.

U kthyem te kodra e Baltës së Bardhë. Atje pris-

nim dbe u përgatitëm përsëri. Me ne ishte edhe Qebiri, ky Qebir që të llafos. Qebir trimi, 14 vjeç! Ka kërryer trima me okë kjo baltë.

Dy ditë përballë qytetit që e sundonin prapë armiqëtë. S'na rrihej. Më në fund u vendos dhe pas mbrëmjes, kur gjermanët qenë grumbulluar në kala, sulmuam. Dy kompani nxituan dhe hynë brenda në kala. E unë isha komandant i kompanisë së dytë. Qebiri qe partizan në kompaninë tjetër. Qe i vogël. Erdhi në batalion dhe s'e përzunë.

Nejse, në mëngjes, i tërë qyteti ishte yni. E fituam. Na mblozhën komandanti e komisari dhe na pyetën. Edhe mua më pyetën për plagët. M'i zbuloi e m'i pa komandanti. Të t'i mjekojnë, tha. Më shëron duhani, i thashë. Ai iku më tei, sec bisedoi me komisarin dhe erdhi përsëri. Nxori një orë të florinjtë dhe ma dha. Merre, tha, se je komandant kompanie dhe të duhet. Merre, tha, se s'është malli im dhe s'ta dhashë me mendjen time. Hë, e mira është që të tërë të kemi orë.

Ai sahat vetëtinte.

Qe hapur dielli dhe sahati shkruante nëntë. Nuk e mbajta të lidhur te kallami i dorës, po më pëlqeu. E shikoja fshehura. Të tregonte sahatin e ditës dhe të natës. Shpikje e njeriut!

Kur u hap dielli dhe filloi të nxehjtët, zbritëm në fund të qytetit. Atje, një cikë më tej, ishte një spital i vjetër. Ne po treshtoheshim te sheshi. Nga dera e spitalit u dha një infermiere. Vinte drejt nesh. Vinte me një frymë. Ajo i mbajti këmbët pak më tej dhe kërkoi komandantin. Kur komandanti nisi të llafosej me infermieren, unë dhe një partizan shikoni sahatin e florinjtë. Na dukej si i gjallë. Qe me shkronja dhe me numra. Tani sahati është dhjetë e një cikë mbi të, tha partizani. Sikur e dëgjoj zërin e tij edhe pas kaq kohe. Ehë.

Komandanti u kthye nga ne. Thirri dy partizanë dhe i dërgoi bashkë me infermieren. Neve na tha se brenda në spital, te shtretërit e të sëmurëve, ishin fu-

tur katër kapterë. Qenë shtrirë e mbuluar për t'u fshehur.

Pas pak dolën kapterët, me duart lart. Përqark, ca nga ca, u mblodhën banorë nga mëhallat e qytetit. Ata i njihnin të katër kapterët dhe folën për ta. Kishin bërë maskarallëqe dhe kishin vrarë njerëz të mirë, kishin plaçkitur. Ah, kapterët! Njëri nga banorët e qytetit, që kishte zbritur atje, s'përmbahei nga zemërimi. Ai u zgjaste një shkop të gjatë, në majë të të cilit kishte një gjilpërë, si hosteni ynë, që të shponte kapterin e gjatë. Ah, qëni, ia bënte ai. Ah, qëni, c'na ka punuar! Ka hequr babanë tim osh, e shpuri prapa kalasë dhe e pushkatoi. Pastaj i rropi xhepat. Dhe u kthyte e piu në kabarë. Ah, qëni, lërmani t'i pi gjakun!

Ulërinin banorët dhe donin t'i shqyjenin. S'përmbaheshin. Po foli komisari ynë dhe tha se atë kohë do të bëhei gjyqi partizan e do t'u jepet dënimin e merituar. Dakord? i pyeti më në fund ai. Dakord, thirrëm të gjithë.

U bë gjyqi atje në shesh. Folën shumë njerëz. Ata qenë tradhtarë, të poshtër e brashnjare.

Gjyqi vendosi t'i pushkatonte. I nxoren më tej, të katër, përparrë skuadrës së pushkatarëve. Po atëherë, tamam atë sahat, doli nga treshti edhe Qebiri i vogël. Ai shkoi te komandanti i batalionit, i qëndroi përballë dhe... Fol, i tha komandanti. Qebiri foli diçka sikur cicëriu. Po komandanti e mori vesh mirë se ç'kérkon-te.

— Dëgjoni! — tha komandanti. Ne heshtëm. — Dëgjoni! — tha përsëri. — Qebiri që vështronit këtu, lutet që ta lejojmë të pushkatojë njërin nga kapterët.

Komandanti dhe komisari diç thanë me njëri-tjetrin. Pastaj komandanti ktheu kokën nga të dënuarit. Qebiri ngriti krahun dhe tregoi me gisht kapterin e gjatë me trupin e madh si lis. Ai e shikoi ftohtë Qebirin. E shikoi si qen i rrahuar.

— Atë dua ta pushkatoj vetë, — tha Qebiri.

Komandanti qeshi dhe e gézoi në majë të kokës.

I trazoi leshrat dhe i rregulloi mirë kapelën e madhe.  
— Po pse, o shpirt, — i tha, — pse?! Ti luftove si trim dhe të pashtë me këta sy që vravë armiq.

— Aman, komandant! — iu lut me të përtypur Qebiri.

— Aman! — bëri edhe komandanti me zë të lartë dhe e mbështolli me krahët e gjatë. E puthi në ballë. Qebiri dukej foshnjë para tij. Foshnjë qe.

— Ta pushkatojë Qebiri, — thirrën partizanët.

U llafosën prapë me zë të ulët komandanti e komisari.

E nxorën kapterin e gjatë e të bëshëm vec. Iu afroa Qebiri. Ndaloj çapet dhe e shikoi drejt. Fytyra e tij e vogël si kopsht i lulëzuar u err dhe buzët iu drodhën. Iu holluan e iu zbardhën. Kapteri s'e shikonte në sv. Na dukej vërtet cudi! Kapteri dv metra i lartë. I gjjerë e si i shtrembëruar nga shëndeti i tepërt. Dhe Qebiri një pëllëmbë fëmiji. Dhe s'di pse. Vo donim t'i shikonim të dy ashtu në këmbë, ballë njëri-tjetrit. Dhe heshtnim. Eh, Qebir diali! Qebiri pastaj kontrolloi dyfekun dhe i vuri fishekë. E kaloi armën në dorën e dia-thëtë. Ne prisnim ta nörinte e të qëllonte, por ai e shikonte mu në surrat. Pastai eci përvara drejt kapterit. Iu qas një cap afër. Ngriti lart mjekrën. e shikoi, u ngrit në majë të gishterinjve dhe e pështyu.

Komandanti ynë u qudit po menjëherë i ulériu kapterit. që të mos lëvizte e të mos bënte gëk. Thirrëm të gjithë. Si në shfaqje. Kapteri lëvizi vetëm qafën. shikoi shtrembër dhe u mundua të fshinte nështvmën me bërryl. Qebiri u tërheq me të shpejtë dhe ngriti dyfekun. Qëlloi dy herë. Një plumb i prishi surranë kapterit dhe tjetri i hapi një vërë në zverk. Ai u kthye dhe ra. Qebiri ia pa surranë të prishur dhe u kthye nga ne.

Pasi skuadra e pushkatarëve lau hesapet edhe me ata të tre që kishin mbetur dhe si i mbuluam me baltë, ikëm. Ashtu qe urdhri.

Nata na pllakosi te Pylli i Mullirit, atje në të shkarën e malit. Me natën erdhi edhe shiu. Qe një shi i shtruar, që të ndillte gjumë. I tërë batalioni do të flinte në pyll. U ula. Pranë më erdhi ai partizani sevdali dhe tha të shihnim sa qe sahati. E kërreva nga xhepi. Ai ndezi shkrepësen. Po sahati vetëtinte vetë. Shkronjat e numrat dukeshin si zjarre të vogla dhe fusha e tij si jonxhishtë. U bëra fare si i vogël atë minutë dhe m'u kujtua fshati, dhe m'u fanit fëmijëria. Në behar, në netët e verës, ne djemtë e më-hallës u hipnim kuajve dhe zbritnim anës lumit, në-për luadhe, që t'i kullotnim. Bëheshim në grupe dhe ndiznim zjarre, dhe përralloshim me fjalët e me mendjen tonë gjer në të thyer të natës së thellë.

Ja, këto kujtova atë natë, kur shihja atë sahat të huaj, atë fushë, ata numra dhe ato shkronja. Ndërsa partizani merakçi vazhdonte edhe ai të shikonte i humbur. Ku di unë ç'i thoshte mendja atij atë kohë! Mbështetje... Pas bërryilit tim zgjati kokën Qebiri.

— E shikon? — i thashë.

Unë e Qebiri u mbështollëm bashkë me një gu-në të vjetër. Mua më lidhte gjumi menjëherë. Edhe sot e kësaj dite, po i thashë vetes fli, hop bie në gjumë.

Po Qebiri rrrotullohej e s'gjente rehat.

— C'ke? — i thashë. Por ai nuk foli. Heshitte. Pastaj gërg u rrrotullua përsëri.

U menduaç me vete.

— O Qebir! — i fola. Ai, pas pak, zbuloi kokën.

— Pse ngule këmbë sot që ta vritje atë kapterin e gjatë? — i thashë.

— Se qe tradhtar, — tha.

— Po edhe ata të tre tradhtarë qenë!

— Ai qe më tradhtar, — tha.

— Pse?!... Ë?!

U ndodha ngushtë në atë muhabet me atë djalë dhe s'dija si të bëja. E ai gulçonte. Kur, papritur, nisi

të qante. Qante fshetur, me kokën mbuluar nën gunë.  
U shqetësova shumë.

— Pse qan?! — i thashë. — Pse??

— Ai qe dajkua im, — mërmëriti djali.

— Qysh?! Dajkua yt?!

— Ehë!

— Dhe... tani të vjen keq, të dhimbset??

— Jo, — thirri ai. — Jo. Më vjen ligjht që s'mundem ta vrash dy herë. A kupton? Qe tradhtar. E, q'flisnin dhe q'bënin njerëzit e mirë për të! Donin ta shqyenin, ta shponin me gjilpëra. Se ka bërë keq, ka vrarë e ka plaçkitur. Pse... pse s'erdhi me udhën e popullit, pse s'doli partizan?... Ah!

Hungëriu djali sikur të këpuste mishtë e vet. Edhe unë qava, djalo. Qava. E urren tradhtinë njeriu i mirë. S'ka më keq. «Që s'e vrash dot dy herë», tha Qebiri. Dhe kështu m'u bë edhe më i dashur e më i mirë Qebiri.

E mbështolla në gjoks, sikur doja ta futja brenda në xhan atë djalë. Ta mbushja xhanin me ndershëmëri nga e tija. Dhe ashtu dremitëm. Sa herë, natën në gjumë, ai kërciti nofullat.

U zgjova shpejt. Vajta te komandanti dhe ia thashë, por ata e dinin. U ktheva. Po flinte. I tërroqa dorën e mëngjér dhe ia lidha sahatin sipër kyçit. Plaçkë e huaj, po hynte në punë. Populli kudo i bën gjërat të bukur. Edhe ai sahat qe i bukur. Edhe Qebiri qe stiur i bukur.

Luftoi një luftë të téré dhe plumbi s'e mori. Cuk. Tani që kërceu në të dyzetetat i ra sëmundja e ligë dhe e mori. Ç'ti bësh natyrës! Ç'ti bësh, o djalë!

Po rrojti mirë, s'llojti. Aaa, për kokën e Qebirit qe. Më dhanë lajmin se mbaroi Qebiri. Erdha mbrëmë këtu.

Sot e mbuluam.

Kur hapën kapakun e sëndukut të kuq, para se ta futnin në dhé, sytë e mi të vjetër ranë, si për shejtan, te pëllëmbët e verdha të ulura mbi kërrthizë. Te kyçi i dorës ishte sahati. Sahati i florinjtë i Luftës. M'u

duk sikur lëvizi Qebiri atje në fushën e sahatit. Qebiri 14 vjeç. Dhe mendja nisi të fliste për atë ditë dhe atë natë të 1944-ës. Dhe shikoja ashtu i humbur lëvizjet, luftën dhe dëgjoja zërin e Qebirit... U plakç, djalo! C'e bëre Mëmälalen? Na ka ndihur në Luftë. Dha edhe burrin për vatan! Dha. U plakëm! Dhe sikur s'kam fuqi të harroj Qebirin. Qe me nder. Harrohet nderi? E harrove, ikje rrrokullimë, të mori lumi pa kuptuar. Nën këtë qìll ka të mira, po Qebiri s'është. S'është... Epo, natyra...

Guçe Gérbi mbushi llullën dhe e ndezi. Në gojë nisi përsëri t'i luhatej bishti i zi i llullës dhe lart fytyra dhe koka iu bënë me tym. Deshi të fliste edhe diçka tjetër:

— Eh, Qebir, — mërmëriti Guçe Gérbi dhe iu drodhën nogkat e gishtit tregues.

Dikush trokiti te xhami i kafes. Përjashta, u vizatua koka e një burri.

Ishte shoferi i taksisë.

Dolëm. Dielli po binte. Në qìll u dukën ca re të ulëta të shpupurishura. Nga perëndimi nxitonte një re e madhe, e cila duhej të kishte derdhur një pjesë të shiut në ara e pyje të tjera, diku gjetkë.

Pranë Mëmälales kishte ndaluar taksia. Mëmälalja na pa dhe ndoshta, ngaqë atje në qytet shikoi Guçe Gérbin e fshatit të saj, fytyra i shprehu padurim. Kërkonte diçka me sy, me fytyrë, me tërë qenien.

Brenda në makinë ajo i zgjati përsëri dorën Guçe Gérbit. Nisi ta pyeste me fjalë të ngrohta dhe, duke folur, i shndriste një dashuri e veçantë dhe një buzëqeshje e gëzueshme.

Po shkonim në fshat. Kur arritëm, Mëmälalja thirri:

— Ja!

Ajo e ngriti buzën si sqep dhe më në fund iu duk buzëqeshja. Sikur për të fillonte dita.

Këtë po, këtë mund ta arrijë njeriu ynë: të dojë vendlindjen. Kjo s'është dashuri primitive. Përkundrazi.

— Ja! — thirri përsëri ajo.

Ata u kthyen të dy njëherësh. Dielli i kuq, i dalë

për një çast nga retë, shtangu në degën e njomë të një lofate. Në udhë cicërinte një fëmijë i bukur kokëkuq.

E humbëm edhe Qebirrin, — mërmëriti me vete Guçe Gérbi.

Tani nën këmbët e tij ishte balta e dashur që e gjëzonte dhe ai ngazëllim i kujtoi njeriun e dashur.

— E humbëm! — mërmëriti përsëri fshehur, me dhembje.

Ky ishte një zakon i lashtë: E humbëm, thoshin luftëtarët e gardës së vjetër.

Guçe Gérbi zbriti dhe flokët iu trazuan sikur t'i kujtonin lodhjen e luftërave.

Tani, sigurisht, ky do të qetësohet, mendova. Sepse këtu, mes njerëzve të tjera, këtu, midis këtyre çative dhe kopshteve, do të gjejë ngjarje më të gëzueshme në jetë dhe në kujtimet e tij e do ta shuajë dhëmbjen.

1979

# Llazar Çuç*i*

## PËRBALLË ERES<sup>1)</sup>

*Ia kushtoj heroizmit të pilotit Bilal Sina*

1.

— Kush raportoi? Kush raportoi?...

Udhëheqësi i fluturimeve shikonte duke rrrotulluar kokën nga të katër anët e horizontit ku nuk dukej gjë. Vetëm bedenat e maleve rrrotulloheshin në vështrimin e tij.

— Kush raportoi për shuarjen e turbinës në lartësinë gjashtë mijë metra?...

Heshtje. Ishite një heshtje e plotë. Edhe natyra sikur kishte ngelur pa frymë. Edhe ajo sikur priste përgjigje. Në ato çaste kështu iu dëk komisarit.

---

1) — Botohet me shkurttime.

Aty nga mbarimi i shkollës skënderbegasit morën në dorë anketat. S'qe edhe aq e lehtë t'i plotësoje ato: duhej menduar çfarë dege të zgjidhje, për të vazhduar më tutje studimet, që të dilje e të punoje në jetë atje ku mund të jepje më shumë.

Pati nga ata që kruanin kokën e mendonin gjatë për këtë. pyesnin njëri-tjetrin, qeshnin, ngrysnin vetullat: «Ç'të bëhem?»

Vetëm për niërin nga ata kjo cështje kaq e rëndësishme qe plotësisht e zgjidhur. Ai e kishte vendosur prej kohe dhe i qe bërë mendja top.

Në trup vinte i dobët, kishte fytyrë të mprehtë dhe vetulla kaleshe që i binin përmbi sy. Vërtet ishte i dobët, po giymtyrët i kishte të zhvilluara e të forta. «Forca, e tij fshihet nën lëkurë», thoshin shokët. Atij as që i shikonte në mend se fiziku i dobët mund të ngallte dyshime për degën që dëshironte dhe plotësoi pa frikë të tria degët: Aviacion, aviacion, aviacion.

Një ditë erdhën në shkollë dy oficerë të aviacionit. Të gjithë s'u ndanin sytë. Sokoli çëndronte në rresht si i habitur. Oficerët e aviacionit kalonin para tyre dhe i shikonin me vëmendje nga koka te këmbët. Njëri prej tyre, që e cte sikur të kishte susta te thembrat e këmbëve, trupmadh, pyeste dendur për çdo gjë që i nevojitej. Tregohej i qeshur dhe i dashur. Ndërsa ai tjetri qëndronte si mënjanë.

— Sa i dobët! — tha ai duke parë Sokolin dhe pastaj qeshi. — Do të forcoheni, do të rriteni, djema!

Sokoli ndjeu për një çast një nxehësi që i ra në fytyrë; ai ndoqi me kujdes çdo lëvizje të oficerëve, që diç biseduan. Sokolit i zuri veshi që thanë: «Po mirë, i shkathët...»

Pedagogët qenë të rinj, edhe klasat me pajisjet e tyre fare të reja. Madje dukej sikur edhe komandanti e komisari i shkollës, që dikur kishin luftuar malit, ishin të rinj në moshë. Komisari qe një burrë i rrallë. Vinte rrondokop në shtat. Ekte me hap të shpejtë e të sigurt. Fliste pak nxituar, por qartë. Në të folur e sipër, dendur e mbledhët dorën grusht dhe e ngrinte në ajër, përmbi kokë. Ishte shumë energjik dhe i pre-rë në veprime. Ai ruante shumë gjëra nga ato që kishte mbledhur e futur në torbën partizane... Këngët ia kishte ëndë.

«Merrjani asaj, — thoshte, — asaj këngës partizane... Dhe niste vetë:

*Përpara një flamur të kuq në duar,  
dhe një torbë me fyshek' e një dyfek,  
të sfilitur prej fashizmit, të coptuar,  
turren trimat dhe luftojnë shteg më shteg.*

Fletoret mbusheshin njëra pas tjetrës. Po t'i shfletoje ato, do të gjeje figura aeroplanësh të vizatuar bulkur. Aeroplani kishin nisur ta bënë mirë edhe ata që s'dinin të vizatonin. Aeroplani vizatonin kudo, aeroplani dhe quell me re. Aeroplani të qelli po hynin pa u vënë re në jetën e kursantëve, pilotëve të rinj.

Sokoli rrinte shumë i kredhur në mendime dhe herë-herë dukej sikur nuk dëgjonte as mësimin. Kalonte lapsin përmbi ndonjë shkronjë dhjetëra herë, saqë ajo trashei e nxihej sikur të qe shkruar me thëngjill! Një ditë, aty para klasave, u duk ai oficeri i shëndoshë e i shkathët, që ekte sikur kishte susta te thembrat e këmbëve. Sokoli ndjeu në ato çaste një të dridhur...

«Shumë i dobët... Po mirë... i shkathët...»

— i kishte zënë veshi Sokolit atëherë dhe oficeri tjetër kishte shënuar në një copë kartë.

Ai prapë ashtu ishte: i dobët, i thatë. Luante futboll, edhe ushtrime gjimnastikore bënte me sa mundte. Po prapë trupi i tij ruante një pamje të jashtme pa ndonjë paraqitje të atillë, siç mund t'i përfytyrojnë pilotët.

Ende pa mbaruar përgatitjen teorike në tokë, u bëndarja e kursantëve. Sokoli u caktua në grup me një pilot — instruktor të ri. Ishte një djalë i shkathët, fiskulturist i mirë, nga Labëria. Në fillim ai u tregua si tepër i prerë, nuk i zgjaste bisedat e lira, po ky që vetëm fillimi. Kursantët e shikonin me habi. Kérkonin të gjenin tek ai ndonjë gjë të veçantë dhe mendonin: «Ky fluturon... Ky do të na mësojë që t'i ngjitemi qillit përpjetë!»

«Mos kujtoni se me kaq mori fund teoria dhe fletoret nuk lipsen më, Gaboheni, nëse mendoni kështu. Piloti mëson njëqind herë në tokë dhe vepron vetëm një herë në ajër. Vetëm në disa sekonda ai bën dhjetëra veprime. Mos u çuditni hic. Ja kështu...» u kishte thënë njëherë instruktori dhe seç kishte bërë ca lëvizje të çuditshme me duar, me këmbë, me gishterinj, duke marrë një pamje serioze.

Kursantët kuptuan diçka, por mbetën të habitur: «Përse tërë këto lëvizje?!»

— Ne s'do të bëjmë asgjë më tepër, veçse do t'i kthejmë në shprehi ato që janë zërthyer nëpër klasa, — kishte shtuar instruktori.

Sokoli rrinte dhe mendonte. Përgjigjej vetëm kur e pyesnim. Ishte i qetë, i përqendruar. I dilte para syve mësuesja që i thoshte përherë: «Akoma më mirë duhet të mësohet!» I dilte para syve komisari që e kishte rritur dhe edukuar, atje, në shkollën «Skënderbej», dhe dëgjonte fjalët e tij: «Teknika e sotme kérkon dije.»

Ata nisën të çapiteshin së bashku në drejtim të portës, andej nga i solli autobusi. Kishte kaluar mjaft kohë qysh nga ajo ditë. Kokën e kishin qethur për së

dyti. Së shpejti do të fillonin fluturimet me këtë instruktor, që po e përcillnin gjer aty, tek ajo porta e bukur e shkollës.

#### 4.

Udhëheqësi i fluturimeve rrinte ulur, me mikrofon në dorë. Ai shpërndante në lartësi komanda të ndryshme, njërën pas tjetrës. Ato komanda të prera, të rru mbullakosura, shkonin kabinë më kabinë dhe vini në lëvizje aeroplanët e gjelbër mësimorë, që dukeshin sikur qëndronin në ca këmbë të gjata si ato të lejlekëve.

Sokoli qëndronte në kabinën e myllur dhe s'dinte ç'të bënte. Për një çast harroi fare se një vit të téré kishte mësuar pikërisht pér këtë ditë. Ah, sikur t'i kishte këtu fletoret e t'i shfletonte! Zhurma e motorit, që hynte me dridhje gjer brenda në kabinë, ia çakërdiste mendimet. Komandat e udhëheqësit të fluturimeve nuk i shkoqiste dot dhe as që kuptonte se kujt i përkisnin.

Instruktori qëndronte prapa, në kabinën e tij. Ai nuk fliste më siç bënte përjashta.

Sokoli ndieu se i lëvizën këmbët dhe duart. Motori zhurmoi më shumë. Në fillim ndenji si i ngrirë, pastaj mbërtheu më mirë dorezën e drejimit dhe atë të gazit. Ndieu një dridhje aë iu duk se i erdhi nga rrrotat e aeroplanit dhe i mbështolli téré trupin.

— Nisemi, — tha instruktori.

Aeroplani mori përpara. Zhurmonte, troshitej, lëkundej në krah.

Sokolit iu mbështet kurizi pas ndenjëses. Sytë sikur iu zvogëluan dhe dorën e majtë, që i shpëtoi nga doreza e gazit, mezi e ngriti që ta conte përsëri në

vend. Toka rrëshqiste nën të. Ajo sa vinte largohej, largohej. Para syve të kursantit ngeli vetëm koka e aeroplani, që ngjitej e ngjitej. Vetëm qielli dhe koka e aeroplani.

— Sa e ke shpejtësinë?

Kursanti u drodh. «Kush më foli?! Nga më vjen ky zë?... Aha, instruktori...» — mendoi. Dhe atë kohë ndjeu dorezën e drejtimit që lëvizi anash. Aeroplani u lëkund nga krahu në krah.

— Sa e ke shpejtësinë? — pyeti instruktori përsëri.

Sokoli uli kokën, ajo iu var e rëndë. Shikimi rrëshqiti nëpër dërrasën e instrumenteve, po shpejtësia nuk gjendej. Ai hante inat me veten. Mblidhte tërë fuqitë, po prapë njësoj. Edhe kur e gjeti instrumentin e shpejtësisë, mezi e shkoqiti shkallëzimin.

— Lëre! Shiko përpara horizontin. Ja, kështu duhet... — vazhdoi të dëgjohej nën kokoren e lëkurtë zëri i instruktorit, që vinte ca si i ngjirur.

«Hej, bela!» — mendoi Sokoli. Gjendja në ajër e turbulloi. Ato që ke dëgjuar e mësuar me vëmendje nëpër klasa, atje në tokë, këtu lart qenka zor t'i sjellësh në mendje atëherë kur të duhen. Dhe kujtoi fjalët e instruktorit. «Duhet njobur çdo gjë shkëlqyeshëm në tokë, që pastaj të punosh mirë në ajër.»

## 5.

Ditët kalonin pa u vënë re. Fluturimet u bënë jetë e dytë për kursantët. Kur ndodhë që të prishej moti, ata ngryseshin dhe mezi prisnin që të hipnin në kabinë. Kishin hyrë në një garë të heshtur në mes njërit-tjetrit. Tashti ishin në gjendje të përcaktonin ku kishin mungesa, ku nuk u ecte. Dhe qeshnin me vete, kur

kujtonin ditën e parë të fluturimeve. Edhe atë ditë ata ishin veçuar në grupe dhe rrinin në heshtje e të ngryrur.

«Aha, — kishte nisur njëri, një kursant leshverdhë, që fliste dhe tundte kokën, — më mirë të heqim dorë vetë. Pse të djegim benzinë kot?»

Në këto e sipër i gjeti instruktori, që vinte drejt tyre tërë gjallëri. Ata tashti u besojnë me tërë mend fjalëve të tij.

«Ohu, — u kishte thënë ai, — mos u mërzitni hiç. Kështu e ka hera e parë. Keni për të parë sa lirshëm do të fluturon. Unë e kam ndier veten më ligsht se ju. Ju qenkeni goxha të fortë, pér fjalë të nderit!»

Instruktori fliste ciltër. Ata rrinin në heshtje. Sokoli nisi të buzëqeshte dhe tundte kokën me kënaqësi.

Kishin kaluar shumë ditë që nga fluturimet e para. Vapa qe bërë e rëndë. Nën kokoret e lëkurta djerësa rriddhët çurg. Krahët e kursantëve, që më fillim ngjalin si pupla të buta, me muskuj të njomë, tashti qenë forcuar. Po sa duhej bërë alkoma?!

«S'kam pse ta fsheh...», mendonte Sokoli dhe shfaqte haptazi dobësinë e tij para instrukturit.

— Pér nder, atë këndin në planerim s'para e kup-toj... Si ta ruaj shpejtësinë konstante? Edhe «T» e uljes s'më duket se lëviz...

Instruktori, pasi ia shpjegonte një pér një, qeshte dhe e pyeste:

- Po shpejtësinë e gjen dot, apo jo?
- Po, po, — përgjigjej kursanti pa të keq.

## 6.

Më kuption, apo jo, Sokol? Ja kështu, mos e lër gabimin të marrë udhë... Më kuption?...

— Si urdhëron, shoku!...

— Dhe mos u druaj, më pyet sa herë e për çfarë të duash. Kemi detyrë të rendë. Duhet ti arrijmë shokët.

— Si urdhëron!

Instruktori fshinte djersën e ballit dhe kalonte shqiminë prapa qafës, gjer te shpatullat. Ndërsa kursanti qëndronte në këmbë para tij me kominoshet e ngjeshura fort pas mesit dhe me kokoren e lëkurtë përmbi ballë.

— Hajde shkojmë, aeroplani është gati, — i tha instruktori dhe pyeti aty për aty: — Sa kemi bërë?

— Pesë, shoku instruktor, kjo është e gjashta.

«Gjashtë zona. Gjashtë herë jemi ngritur e kemi bërë pilotazh të plotë dhe ky s'u dëgjua të thotë një herë së paqku: «Oh, u lodha!» — mendoi instruktori dhe e shikoi me vëmendje nga koka te këmbët Sokolin, që e cte pakëz kërrusur pranë tij.

Edhe kursanti e pa dhe sikur kuptoi diçka: «Eh, ç'po hiqni me mua!...»

— Dëgjova sikur do të të vijë babai.

— Po, ashtu më shkruajnë.

— Gjersa të vijë ai, do të kesh flutuar vetëm.

Sokoli sikur psherëtiu.

— Mirë do të jetë...

— Ngjitu në kabinë, — tha instruktori dhe i ra shpatullave.

— Si urdhëron!

U bënë gati të ngriheshin.

— Për ikthesën luftarake, ke më nevojë?

— Për ndër, sikur të ma tregoni edhe një herë...

— tha Sokoli duke mbledhur shpatullat.

Instruktori qeshi. Ai kishte pasur të bënte me karaktere të ndryshme. Dhe në kësot rastesh nuk ndiente lodihe, përkundrazi, i bëhej qejfi.

— Do të ta tregoj, sa herë të kesh nevojë.

Kur zbritën dhe e lanë aeroplanin në vendqëndrim, dielli përvëlonë, por era e detit, që nuk kishte ku të përbalhej në atë fushë, e freskonte ajrin. U duk sikur,

me t'u ndarë nga aeroplani, u shkëputën edhe nga hallet e preokupimet e fluturimeve. Por kjo nuk zgjati shumë.

— Harrova të të pyes, — tha instruktori. — Kam menduar të fluturojmë edhe ditën e diel, që të arrijmë shokët. Si thua?

— Unë, q'të të them. Unë jam gati...

— Këshfu do të bëjmë. E kam biseduar edhe me komisarin.

## 7.

Në repart arritën pasdite vonë. Takuan oficerin e shërbimit, që i shoqëroi vetë gjer te zyrat e komandës.

Ata ecnin dy e nga dy, njëri pas tjetrit, fllsnin me zë të ulët, kënaqeshin me këtë mjedis të ri. U shkon të mendja edhe te shokët që ishin emëruar në vende të tjera.

Oficeri i shërbimit fliste shumë. Tregohej i përzemërt, kërkonte t'i njihte me shumë gjëra njëherësh. Përmendte edhe emra që ata s'i kishin dëgjuar, dhe përsëriti kushedi sa herë se në këtë orë aty nuk gjen njeri. Ai i solli rrighth e përqark zyrave të komandës, që ishin të fshehura në një korije të dendur, pastaj i nxori andej nga i pruri.

— Dale, — i tha njëri nga pilotët e rind, — ku na çon? E humbëm orientimin.

Sokoli qeshi.

— Ku të vemi? — pyetën njëherësh dhe vërejtën në sy oficerin e shërbimit që vazhdonte të fliste pa ndërpërje.

— Po të dëshironi, ecni kësaj rruge dhe dilni atje tej, tek ata plepat e vegjël, — tha ai. — Atje do të takoni pilotët e gatishmërisë.

Të porsaardhurit e falënderuan oficerin e shërbimit

dhe morën udhën e re që u rrëfeu ai. Ecnin njëri pas tjetrit, siç bëjnë njerëzit kur kalojnë në rrugë të panojura.

Të nesërmen, kur erdhën sérishmi në repart, ata e ndien veten më të lirë. Tashti kishin plot të njojur. Zyrat i dinin, rrugët i dinin, pistën e fluturimeve të gjurmë rrotash dhe vendqëndrimin e aeroplana e dinin. Ishin bërë si miq të vjetër me oficerin e shërbimit dhe me pilotët e gatishmërisë. Atë ditë u njohen edhe me shumë pilotë e teknikë të tjerë, dhe u përzien me ta.

Kur shkëputeshin, qoftë edhe për disa minuta, dëgjoheshin pyetje: «Ku janë pilotët e rinj?»

«Pilotë të rinj», kështu do t'i quanin gjersa në repart të vinin të tjerë.

Komisari dhe komandanti i këtushëm dallonin nga ata të shkollës. I pari ishte një burrë i gjatë, pakëz i kërrusur, me fytyrë të imprehtë e të rrathur nga era e aeroplana e dhe nga vitet. Kur bisedonte, të shikonte në sy me ngulm. Dukej sikur më shumë mësonte nga shikimi sesa nga fjalët. Për vete fliste pak. Ama, kur niste të rrëfente për të tjerët, s'kishte të mbaruar. Aty, në zyrën plot drithë të komisarit, pilotët e rinj mësuan shumë gjëra: Në këtë aerodrom kishte shërbyer një pilot ish-partizan, që disa vite të shkuara kishte rrëzuar një balonë spiune të imperialisteve. Nuk qe i lehtë sulmi kundër atij objekti të stërmadh, që lëvizte ngadalë për në juglindje, në lartësinë pesëmbëdhjetë mijë metra.

Në këtë aerodrom qenqesh ulur edhe ai aeroplani anglez, që shkeli hapësirën ajrore të Republikës. Pilotët e këtij reparti e detyruan, në vigjilje të Vtitit të Ri, që ai të zbriste i turpëruar në aerodromin e rrethuar nga male të larta.

Ndërsa komisari tregonte për këto, komandanti thithë llullën dhe dëgjonte. Më të rrallë thoshte: «Po, Po...!» Ai nuk fluturonte më, shëndeti s'e lejonte dhe ndoshta prandaj kishte nisur të thithë llullën.

Në oborr takuan zëvendëskomandantin. Ai e kishte ulur strehën e kapelës gjer mbi hundë dhe sytë mezi i dukeshin. Qëndronte me duar prapa dhe, për të shikuar, e kishte ngritur shumë kokën. Fliste me hundë.

— Ku shkoni?

Ata u gjendën bosh.

— Këtu... Këtej... — thanë.

— Pa dale... Ç'më rrini kështu kokëvarur?

— Jo, po... ja...

— Shkunduni! Jeni pilotë, apo jo? Këtu është repart luftarak.

— Dita e parë, — tha njëri, — kështu e ka dita e parë.

— E, ashtu... Po ja, ti atje, pse rri i habitur?

S'foli njéri, pastaj përsëri ai i pari:

— Kështu ka natyrën.

— Ehë, natyrën e zotëron njériu.

— Si urdhëron, shoku!...

— Si e ke emrin?

— Sokol.

— Shumë bukur! Është kështu, apo jo, Sokol?

— Si urdhëron, shoku!...

Biseda nisi të merrte zjarr.

— Shoku zëvendëskomandant, ju kërkon komisari,

— tha një ushtar që u paraqit me nxitim.

Pilotët e rinj morën qëndrim gatitu dhe nderuan.

— Ika. Më falni!

Megjithëse nga pamja e jashtme ai ngjante i ngadalshëm, vrapi me shkathësi në drejtim të zyrave.

— Ky paska qenë zëvendëskomandanti dhe ne folém q'na erdhi pér mbarë... — tha ai që nisi i pari.

8.

Fluturimet në repartin luftarak nisen të bëheshin të zakonta. Dalëngadalë ai emocioni i pafre i ditëve të

para u shua. Pilotët e rinj e ndienin veten më të qetë kur dilnin në betonkë për t'u ngritur dhe kur venin drejt atij brezi me pllaka për t'u ulur.

... Ca xhufka resh s'donin të iknin nga kurrizi i malit atë ditë marsi.

Aeroplani ngriheshin e uteshin sipas radhës. Turbinat reaktive herë uturinin me tërsellëm, herë gjysmë të heshtura, me zhurmë të mbytur, zbritnin në pistë.

Udhëheqësi rrinte ndenjur në kullën e komandimit dhe që andej dërgonte me radio nëpër kabina komandat e rrumbullakosura. Turbinat punojnë mirë. Kjo është e tëra. Por edhe turbinat i zënka skleroza. Skleroza?!

Brof! u dëgjua në lartësinë gjashtë mijë metra dhe zhurma pushoi... U fik turbina... Sklerozë!

Pilotit iu duk sikur u shurdhua. Shurdh?! E tmerrshme kjo për pilotin! Ai tundi kokën me forcë.

Si përcart u çakërdisën akrepata para syve të tij. Si shkonte kurëtët në mend. Turbina e tradhtoi, e la vetëm, atje lart, ajo turbinë e ftohtë, si grerëz. Aeroplani u lëkund i pafuqishëm nga krahu në krahp.

«Ku shkon?! — tha piloti. — Jam unë këtu!...»

E rrrotulloi aeroplalin, që po rrëshqiste me hundë tatëpjetë.

«Një... tha me vete dhe foli me tokën:

— M'u fik turbina; lartësia gjashtë mijë...

«Fikje e vërtetë, apo imitim?» — mendoi dhe para syve i doli ajo fletorja, që e mbante në xhep ngado që shkonte, atje në aerodromin fushor të shkollës. Rreshqat i rrëshqitnin para syve. Iu kujtuan shpejt fytyra e komisarit të shkollës, e instruktorit të parë, e nënës, e babait, e Ferhatit...

«Më ngadalë», tha me vete dhe u përqendrua e zuri vend si copë shkëmbi në kabinë.

Kulla e komandimit u drodh. Një raketë — shenjë e kuqe — u vërvit që andej dhe flakëroi në qiell.

Zëvendëskomandanti mbërtheu fort në duar mikrofonin.

— Kush raportoi? Kush raportoi?...

Shikonte duke rrrotulluar kokén nga të katër anët e horizontit. Dhe mbi to nuk dukej gjë. Vetëm bedenat e maleve rrrotulloheshin nën vështrimin e tij të kujdeshshém.

— Kush raportoi pér shuarjen në gjashtë mijë?...

Uf, sa të gjata iu dukën ato sekonda pritjeje udhëheqësit të fluturimit.

— Ashtu? — tha pasi mori përgjigje. — Drejtohu pér në aerodrom... Bëj provë ta lëshosh turbinët në ajër. Nuk lëshohet?... Nuk do që të punojet?... Edhe një herë!

— Po, po. Do ta provoj... — Trak-truk, shkraf-tik, bënë çelësat, sustat e dorezat. Zhurmë, ja. Rrëshqitje tatëpjetë. Shushuritje erërash të forta...

Të téré sa ishin, kur morën vesh atë të papritur, u mblohdhën përqark kullës së komandimit. Veshët imbanin gati pér të kapur qoftë edhe një fjalë nga ato që zbritnin si rrufe nga lart, ndërsa kokën e kishin drejtuar nga veriliindja. Zgjateshin, lëviznin të ngathët. Prisnin, prisnin. Iu lodhën sytë, u shfaqeshin iluzioni, bëheshin gati të thërritnin: «Ja, ku është!...» por më kot.

Prisnin, dhe, ndërsa Sokoli provonte forcat në atë gjendje të vështirë, ata luftonin me mendje përkrah tij. Dhe, afër mendsh, nervat e tyre qenë tendosur së tepërmë.

Vetëm njëri ishte fare pranë Sokolit. Zëre se qe futur në kabinë, si në një llogore, dhe ky qe udhëheqësi i fluturimit, zëvendëskomandanti.

Sokoli ishte kredihur i téri në punë. Zëri që i futej nën kokoren e lëkurtë iu bë shok i vërtetë. Por edhe ai sa vinte e dobësohej, dobësohej...

— Ku ndodhesh? — dëgjoi mbytur.

Vetëm atëherë u kujtua të hidhëtë sytë përreth: male, lumë, tutje iu duk aeroplani fushor «X» i shkollës.

«Aerodromi ynë!... Të ulem atje?! Jo. «Merr një vendim dhe atë çoje gjer në fund...»

Prapa male, ca re ia zunë shikimin. Zëri i udhëheqësit u mek, u shua.

— «... katapultën!» — i zunë veshët. Ç'do të thotë kjo? Për pilotin s'ka asnjë hezitim, asnjë mëdyshje në këso rastesh. Kjo do të thotë: Lëre aeroplanin, lëre atë turbinë të prapë, braktise atë metal... Hidhu me parashutë, se ti je kapitali ynë! Ç'pret? Heshtje e rëndë. Shushuritje erërash të forta. Rrëshqitje tatëpjete. Zëri nën kokoren e lëkurtë nuk vinte më... U shkar kuan bateritë...

Malet afroheshin, ngjitheshin lart, sikur zgjatnin ballin plot rrudha, për të parë në kabinë atë copë shkëmbi që kishte zënë vend e s'tundej: kishte zënë pozicion.

«Ja, aerodromi: Të ulem atje. Patjetër atje.»

Sokoli e ktheu aeroplanin në krah. Bëri rrëshqitje të shpejtuar tatëpjetë. «Jam lart, — mendoi. — Mos kaloj aerodromin...» Rrëshqitje. Rrotullohet përsëri majtas. Para syve i del aerodromi. Ja, erdhi aerodromi... Aeroplani rrëshqet drejt e atje.

Ai tërroqi ganxhën për të hapur rrotat. E tërroqi me forcë. Ndjeu troshitje. Shikon: «S'qenka hapur rrota e parë! Edhe kjo mungonte. «Aerodromi u shpalos tejetej para syve të tij. Ai ngjante si qilim i butë e i gjelbër nën malet rrëth e qark, që prisnin në heshtje.

Rrota e parë s'u hap, kjo nganjëherë të kushton jetën.

«Katapultë?!... — mendoi. — Erdhe gjer këtu!... Vendim i prerë»...

Një zë së brendshmi: «Mbahu!...»

Sokoli e ndjeu me téré qenien e tij këtë zë. Dy pikë lot i rrëshqitën në faqe.

«Do ta mësoj këtë turbinë si të më shërbejë...»

Toka afrohej, afrohej, si një prehër i butë i gjelbër.

Udhëheqësi fliste pareshtur. Nuk i besohej që piloti prej kohësh s'e dëgjonte më. Nuk ia donte zemra këtë.

Komisari qëndronte i qetë, pakëz i kërrusur dhe fliste me vete;

— «Shumë mirë që u drejtovë në bar... Mos e rrit shpejtësinë... Nxirre... Nxirre... Mbaje. Shumë mirë».

Komandanti shkundi llullën.

Udhëheqësi la mikrofonin menjëherë dhe doli nga kulla.

Aeroplani rrëshqiti ca me të shpejtë në bar dhe mbeti. Kabina u hap; nga larg u duk trupi i gjatë e i hollë i Sokolit, që u ngrit dhe pastaj kërceu përdhe.

— Tokë!

9.

Aerodromet zgjohen shpejt në mëngjes. Ajri dridhet përqark nga uturima e motorëve reaktivë. Aviatorët do të dëshironin që kjo gumëzhimë të qëndronte pezull, të mos përhapej e të shkonte gjer në qytet. Por s'ke ç'i bën ajrit, ai lëkundet.

«Mos u merakosni. Jemi mësuar me këtë zhurmë. Ne flemë të qetë këtu përposh...» — thoshin pumëtoret e porsakthyer nga ndërrresat e natës.

Pilotët zbresin nga autobusi dhe marrin rrugën përt te vendqëndrimi. Para syve u del ajo që ndodhi. Buzëqeshin.

Sokoli ecën në mes tyre me kokoren e lëkurtë në dorë. Shikon për së largu aeroplanin e tij të mbuluar nga rrrezet e para të diellit. Vë dorën mbi ballë dhe capitjet më tutje... Hipën në kabinë. Llidhet në parashutë e në rripa. Hap çelësat trak-truk dhe turbina vërshëllen, uturin, nis simfoninë e saj...

Banorët e qytetit u zgjuan herët atë ditë. U zgjuan me aviatorët. Kishte diçka të veçantë ajo ditë: ngjitej sërisht në quell ai që zbriti pa motor... Ai që fitoi kundër erërave të forta.

# Moisi Zaloshnja

## XHIXHEJA JONË

Në ditët e para të qershoret çatia e kopshtit të fëmijëve ku shpinte xhixhe Zakia të nipin u bë gati në të rrëzuar, sepse u thyen krejt papritur ca mahi dhe dy trarë. Prandaj fëmijët i shpérndanë përkohësisht nëpër kopshtet e tjera të lagjes dhe ndërtuesit filluan menjëherë të hidhnin çati të re. Meqenëse kopshtet ku u shpérndanë fëmijët qenë ca larg, xhixhe Zakia u tha nuses e djalit: «Ma lini mua Gimini këto ditë sa të rregullohet kopshti.» Dhe kështu u vendos. Si mbaronte ndonjë punë shtëpie që kishte për të bërë, plaka e merrte djalin për dore mëngjes e mbrëmje dhe e nxirrte për shëtitje nga fusha që e ka afër shtëpisë.

Në ato ditë fusha qe mbushur me vajza e djem ushtarë që bënин stërvitje ushtarakë.

Kënaqej Gimi i vogël tek e sodiste atë pamje madhështore, por ca më shumë kënaqej e ngazëllejë xhixheja. Që ditën e parë ajo u miqësua me djemtë e vajzat ushtare. Asaj nuk i pritej gjersa të merrte dja-

lin e të shkonte në fushë, por edhe djemtë e vajzat ushtare, një çikë të kalonte orari i zakonshëm kur vinte plaka, i thoshin shoqi-shoqit: «Na u vonua xhixhe Zakia» dhe u mbeteshin sytë nga rruga.

Djemtë e vajzat stërviteshin grupe-grupe, herë-hërë parakalonin aty pranë xhixhesë e pastaj vinin duke fshirë djersët, që u kullonin çurg në fytyrat e nxira nga dielli e të rrahura nga era, dhe uleshin të çlodheshin me plakën në mes.

Xhixhe Zakia e vinte re sa shumë ishin lodhur, por i bëhej zemra mal tek dëgjonte që nuk ankoreshin dhe i uronte me gjithë shpirt: «Më rrrofshi, bij!»

Pastaj nisnin nga bisedat:

— Xhixhe, na e le pa e mbaruar atë ngjarjen si u rrëmbye shtypshkronja «Gutenberg».

Djemtë e vajzat ushtare mund të kishin dëgjuar dhe gjetkë pér aksionet, mirëpo kallëzimet e xhixhe Zakisë megjithatë i linin me gojë hapur, sepse ajo dinte hollësira dhe i rikujtonte ato si t'i kishte jetuar një ditë më parë.

Plaka ishte e vuajtur në jetë. Ajo, siç thoshte vetë, e kishte pirë me plot kupën e vrerit të asaj jete të zezë që ka bërë vegjëlia në të kaluarën. Katër fëmijë, nga shkaku i mjerimit, i patën vdekur pa u ngritur në këmbë. Burri i kishte vdekur i ri dhe e kishte lënë me tre jetimë, dy djem e një vajzë. I rriti të tre duke punuar nëpër dyert e botës. Ismetin, atë që iu vra, njëzet e dy vjeç djalë, në ditën e çlirimtë të Tiranës, e kishte djalin e madh. Vrasja e tij që kupa e helmit më e madhja pér të. Djemtë e vajzat ushtare kishin dëgjuar edhe pér punën, jetën, luftën e vrasjen heroike të të birit, dinin pér xhixhenë vetë.

— Ku ishim e ku jemi! — u tha xhixhe Zakia të rinjve që ditën e parë, duke u treguar me kokë teknikën dhe armatimin që kishin ushtarët. — Kur shtinin në dorë pesë fishekë djemtë e çupat e Luftës, që ia rrëmbejn dashmanit, apo një bombë dore ose një revole, gëzonin sikur kishin fituar dynjanë. Pale, pale, ç'u bë një

natë, kur më erdhi Ismeti im me ca shokë e shoqe! Kishin rrëmbyer atë natë një mitraloz e disa arka me fisehekë, dhe më erdhën aq të gjëzuar, sikur të kishin prurë çlirimin, siç e prunë më 29 Nëntor. Me atë mitraloz më doli Ismeti partizan në male dhe m'u kthyte me të në krahë pas tre vjetësh. Edhe atëherë vetëm dy orë u takova me të. Tirana nuk qe çliruar akoma e tërë. Në mesnatë më erdhi Ismeti me katër shokë e shoqe; kishin ardhur të hetonin se ku ishin vendosur gjermanët, ku i kishin vënë armët etj... Dhe më iku... Më iku e s'e pashë më...

Një nga vajzat ushtare, tek e dëgjonte si tregonte nëna për të birin dëshmor me aq qetësi, me tërë ato hollësira, pa iu dredhur as një fije zëri, sikur të ishte ndarë dje me djalin, iu afroa, i qasi paksa buzët te veshi si pér të mos e dëgjuar të tjerët dhe diçka e pyeti me zë të ulët.

— Nënë jam edhe unë, bijë, si të gjitha, — foli plaka.  
— Nëna është nënë e s'bëhet tjetër.

I shikoi të tërë në sy sa e kishin rrethuar.  
— E keni dëgjuar, — tha, — atë këngën: **Sa vjet zi do të mbash pér mua, nënë, moj e zeza nënë? /Sa të zbardhet penda e korbit, o bir-o!**

— E kemi dëgjuar.  
— Eh, mirë, kur e paski dëgjuar. Ajo që këndon pulli, ajo është e vërteta. Edhe mua më mbushet shpirti nganjëherë. Po kur më vijnë lotët pér të, mbyll sytë, i gjelltit dhe qaj përbrenda. Jap e jap kështu dhe pastaj nuk duroj dot. Ruaj kur s'i kam në shtëpi as nusen as djalin, Hysenin, as fëmijët e tyre, mbyllem me kyç, marr fotografatë e Ismetit e ia numëroj të gjitha. Nuk qaj në sy të fëmijëve, se ata vijnë të lodhur nga puna. Djalin e kam inxhinier në kombinat. Kur ishte Ismeti në shtëpi, e këshillonte: «Të mësosh, të bëhesh i ndershëm»... Dhe ai mësoi, edhe në shkolla të larta. Kur i vijnë shokët e shoqet pér vizitë, bëjnë shaka me të. Ku je, shkencëtar, i thonë. Unë s'e di se ç'bën atje në kombinat, por këtë e di, që ai ka zëvendësuar me punën e tij tridhjetë vegla

të reja që i kemi pasë blerë jashtë gjer dje. Më vjen i loddhur djali, por edhe i gjëzuar. Edhe aty në shtëpi përmbyss mbi libra rri. Aq sa nganjëherë nuk më durohet dhe i kanosem: Po mjaft, o bir, se të rrodhën trutë! Nuk më zemërohet. Vë buzën në gaz, më vështron dhe ul kokën, punon. Edhe nusen e djalit e kam me shkollë të madhe. Edhe ajo është shumë punëtore. Kanë përpjekur të dy me djalin. Unë nuk dua t'i mërzit me lotët e mi. Nuk dua dua t'ua prish gjëzimin e punës, lumturinë. Nuk dua t'ua pres krahët.

Një nga të rinjtë që dëgjonte i mahnitur fjalët e menjura të plakës, ia ndërpreu bisedën:

— Xhixhe Zakie, — i tha, — po ti a ke shkollë?

Xhixhe Zakia hodhi vështrimin larg e thellë mbi kryet e atyre që e kishin vënë në mes.

— Kam, — iu përgjigj me tërë seriozitetin.

— Sa vjet? Filloren?

— Jo. Kam tridhjetë e ca vjet shkollë. Shkolla ime u hap që atë natë që hapa derën e më hyri në shtëpi ai komisari i Partisë që ju kam fjalosur.

Të gjithë qeshën. Ata që e kishin më pranë, e përqafuan xhixhenë e s'e lëshonin.

— Edhe në sy të shokëve e të shoqeve të Ismetit, — vazhdoi bisedën xhixhe Zakia, — nuk kam qarë kurë. Si mund të qaj! — tha duke i rënduar zërit. — Djali më ra dëshmor për Shqipërinë, për popullin, për Partinë. Partia, populli ma kanë derdhur në bust bronzi. Kanë shkruar gazetat për të. Kanë shkruar në libra. Në radio flasin. Në televizor shoh fotografitë e tij, vendet ku ka luftuar... shoh atë gërbë shtëpi ku e linda dhe e rritë, se tani jam në pallat... si mund të qaj, — i rëndoi edhe më shumë zërit, — kur djalin ma kanë bërë më të gjallë se të gjallët!? Ç'do të mendonin shoqet e shokët e tij për mua po të më shihnin të qaja? — Dhe u përgjigj po vetë: — Qenka qaramane! Do t'u prishej gjëzimi i zemrës edhe atyre, gjëzimi e lumturia e punës. Vetëm armikut do

t'i bëhej qejfi të më shihte ashtu të gërmuqur e me lot!

Një nga vajzat ushtare që i qe ulur fare përbri e nroku Xhixhe Zakien në qafë dhe e puthi.

— Ç'më puth, moj bijë, në këto faqe të rreshkura!

— Jo, jo! Do të të puth, — nguli këmbë vajza. — Babai im, — tha ajo, — këndon një këngë: *Çitjanezezat me pika,/ zemër-rrahurat me thika./ Çitjanezezat me tumba,/ zemër-rrahurat me plumba.* Ja, ti, xhixhe Zakie, je një nga, ato zemër-rrahurat me plumba që kurrë s'u dhatë, kurrë s'u përgjunjtët, por që qëndruat si shkëmbinj e gurë dhe rritët bij e bija heronj që qëndruan në shekuj. Siç këndohet edhe kënga: *Shqipëri, o shkëmb e gur, / Vritu, pritu për flamur,/ ata hiq e ti po vur!* Unë, — vazhdoi e reja, — që ditën e parë, sa të pashë, të njoha, xhixhe, se të kisha parë në fotografi në revistën «Shqiptarja e Re» dhe dëshiroja — ajo e tha me gjithë shpirt këtë fjalë, — të të njihja kështu, nga afër.

— Jo, moj bijë, jo! — e kundërshtoi plaکa me tërë çiltërsinë e saj. Unë jam si gjithë të tjerat.

Atë kohë shumë zëra djemsh e vajzash i thanë me një gojë:

— E kemi poete këtë shoqen, xhixhe Zakia.

Xhixhe Zakia rrudhi vetullat, e pa në sy ushtaren sikur përpinqej të gjente në fytyrën e saj diçka të vëçantë, që e dinte se e kishte, por nuk po ia shikon te dot atë çast, dhe tha plot humor:

— Nuk ma mbushka syrin kjo mua për të qenë ashtu... pojete.

— E kemi edhe këngëtare, — u dëgjua një zë. — Ia thotë bukur.

— Ashtuuu!? — u bë sikur u çudit xhixhe Zakia.

— Mundet, mundet. Sa për këngë, ma ha mendja. — Pastaj iu kthyesh ushtares: — Meqë ia thënke, atëherë mbama, pojete. Po kruaje mirë zërin, ama, se më prish këngën.

Gëzimi se do ta dëgjonin e kureshtja si do të këndonte i bëri të ngjishen të gjithë rrëth saj.

Xhixhe Zakia ia mori me atë zërin e saj gati si zë burri:

*Shqipëri, flamur direku,  
t'u mpi syri te dyfeku*

Në mbarim ra heshtja dhe atë e prishi po vetë xhixheja:

— Po, bij, — tha duke i përfshirë të gjithë sa kishte rrëth e qark me një vështrim të ndezur, sikur të kishte sytë e njëzetvjeçares, — kështu ka qenë mot e jetë Shqipëria, me syrim ngrirë në shënjestër. Edhe sot kështu jemi ne, — tundi gishtin sikur t'u kanosej që të mos e harronin, — kështu jemi e kështu duhet të jemi, se jemi trefish të rrëthuar. Të keqen do të na e marrin edhe këtej e tutje, veç t'i kemi në grykë të topit ama. Se, jo sikur të flemë, po sikur të dremitim një grimë, armiku...

Kopshti i Gimit u mbarua së rindërtuari. Erdhi koha që xhixhe Zakia nuk do të dilte më me të nipin nga fusha e stërvitjes. Ishte dita e fundit. Gimi, sikur ta kishte porositur njeri, atë ditë qe shend e verë, si nuk pati qenë kurrë. Mblidhë lule, i bënte kurorë, ia vinte gjyshes në krye dhe i lutej duke qeshur: «Mos i hiq, gjyshe!» Bënte tufa me lule dhe e pyeste: «Gjyshi, hë, thuaj, kujt t'ia jap?» Ai përditë kishte bërë të tilla tufa me lule që ua jepte djemve e vajzave ushtare. Xhixhe Zakies disa nga djemtë i shëmbëllinen me Ismetin e saj. Dikush i shëmbëllente nga balli, dikush nga flokët, nga buzët, nga qëndrimi apo mënyra e të vështruarit. Dhe kur e pyeste Gimi përlulet, ajo i thoshte t'ia jepte atij që i nxirrte mallin e djalit më shumë se të tjerët. Kështu bëri edhe ditën e fundit. «Jepja atij, atij që vështron nga ne e qesh», i tha.

1980

## Muharrem Dardha

### LETËR NGA NIPI

Selman Hodos i kishte dalë me kohë gjumi. Tëm-  
that i rëndonin. Ai kishte net që i bënte apo s'i bënte  
3-4 orë gjumë. Kurse mbrëmë i dukej sikur s'kishte  
fjetur asnjë orë. E si të flinte, kur në kokë i ishin  
pleksur një mori mendimesh! Ndjeu nevojë të ndizte  
një cigare. Zgjati dorën në errësirë dhe, nga karrigia  
që kishte aty pranë, ku kishte hedhur pa kujdes rro-  
bat, mori kutinë e duhanit, nxori prej saj një cigare  
të dredhur qysh në mbrëmje dhe ndezi çakmakun. Për  
një çast drita, e vogël e tij ra përreth dhomës dhe  
pastaj përsëri errësira mbuloi gjithçka. Koka e ciga-  
res ndriste si një xixëllonjë. Selmanit i vinte mirë  
kur shikonte t'i ndriste aq pranë cigarja. As vetë s'e  
kuptonte se nga i vinte ikjo ndjesi e mirë.

«Si do t'ia bëj më tej me dhentë dhe lopën, Larën  
time të urtë, si do t'ia bëj?» — Ky mendim i qe bërë  
kaq sëmbues sa, kur e sillte ndër mend, ndiente një  
therje në zemër.

«Po dreqoset kjo punë. Më duket se të gjithë më shohin shtrembër, që nga Mezani, sekretari i partisë, e deri këtu në shtëpi.» Ndjeu t'i pengohej frysëmarrja. U rrrotullua përsëri dhe u shtri më kurriz në shtratin e butë e të ngrohtë.

«Po ajo letër mbrëmë ç'qe, xhanëm? Kush ta ketë lajmëruar Nderimin që unë kundërshtoj të tufëzoj bëgëtitë me të fshatit?»

Thithi edhe një herë cigaren dhe e flaku me forcë nga dritarja. Veten e ndiente shumë ngushtë. Nderimin e donte me shpirt. Ishte djali i Nuriut, djalit të tij të **vetëm**, që para disa vitesh kishte vdekur. Edhe Nderimi i kishte ngjarë të atit, ishte i matur, punëtor dhe i sakrificës. Për të mburrej me të drejtë Selman Hodoja në gjithë fshatin.

— Nderimin e kemi brigadier edhe në shtëpi! — u thoshte ai shpeshherë njerëzve të familjes. Por edhe në ushtri nipi i kishte nderuar. Një herë Lamja, korrieri i fshatit, i la në dorë një zarf të mbyllur. Letra që mbante brenda kishte vulën e repartit ku djali kryente ushtrinë. Bënte fjalë për sjelljen shembullore dhe rezultatet e larta që kishte arritur ai në përgatitjen ushtarake. Kjo e kishte ngazëlyer plakun dhe pas disa ditësh që nisur për ta takuar. Në repart kishte mbërritur pasdite vonë. Edhe atëherë pranverë ishte, por e ardhur më shpejt, me më shumë lule e gjeth të njomë, me më shumë ngrohtësi.

Bashkë me Nderimin kishte takuar edhe komisarin e repartit, një oficer të moshuar, të qeshur në fytyrë dhe muhabetçi. Të tre kishin dalë edhe në qytet.

— Shiko, Nderim, komisarin e ke në këmbë time këtu. Dëgjoja fjalën, bir! Të mos harrosh ta sjellësh medoemos andej nga fshati. Ai ma dha fjalën edhe vetë, po ti kukoje herë pas here...

...Jashtë errësira po davaritej si pa u ndier. Plaku ndjeu se po agonte. U ngrit, veshi kilotat e leshta dhe xhaketën e trashë prej kadifeje të zezë dhe iu afrua dritares. Ajri i pastër dhe i ftohtë i asaj pranvere i mbu-

shi mushkëritë. Pastaj doli jashtë. Ai vinte i pakët nga trupi dhe hapat i kishte të lehtë, ndonëse po u afrohej të shtatëdhjetave. Kur kaloi pranë kasolles, ktheu kokën, por nuk ndali. I vinte keq ta shqetësonë gjënë e gjallë që pa gdhirë mirë. Vazhdoi ecjen gjersa iu afrua shtegut nga ku u fut në bahçë.

— Edhe ty do të të vijë radha të bashkohesh me shoqet, — pëshpëriti Selmani i menduar, — dhe atëherë s'do të ketë më gardhe e sinore. Për ty s'merakosem shumë, jooo, se s'ta kam parë edhe aq hairin, po ç'ti bëj Larës unë, asaj ç'ti bëj?

I mbështetur te gardhi, ndjeu që nga gryka e lumiit të frynte një erë e lehtë, e ftohtë, që tundte degët e lëngëzuara të qershive plot sythe gati në shpërthim. Ndjeu lodhje dhe u ul në trungun e një peme të prerë. Dhimbja e kokës i qe shtuar.

Dhe, tek rrinte ashtu, i vetmuar, në mendje i zienin një mori kujtimesh ngajeta e tij në fshat, ku kishte lindur, ishte rritur e burrëuar, qe martuar e pati bërë gjashtë vajza e një djalë të vetëm, Nuriun. Aty qe ndarë me të vëllanë, kur ai kishte marrë malin e dalë partizan, kurse vetë sa e sa herë qe ngjitur tek ata, me mushkën ngarkuar herë me armë e herë me veshmbathje e ushqime. Iu kujtuan vitet e pasçlirimt, ajo ditë kur hyri i pari në kooperativë. Ai, si gjithë fshatarët, ndiente qdo ditë gjëzimin dhe lumburinë e jetës kolektive.

— Eh, si ështëjeta! — mendoi. — Kush e pandehet se për kaq vite do të vinin kaq ndryshime!» Futi njëren dorë në xhep dhe kutia prej alumini e duhanit e kujtoi të ndizte një cigare.

«Po mirë, xhanëm, pse të mos i mbajmë vetë, rron fshatari pa një pikë dhallë, pa dëgjuar një blegërimë në shtëpi?...»

Këto mendime ia kishte thënë një ditë edhe Mëzanit, sekretarit të byrosë së partisë të kooperativës, aty në zyrën e tij, por ai ishte munduar t'i shpjegonte se «ato tonat kanë qenë, tonat do të mbeten», ve-

tëm se do të tufëzoheshin, për «pjësemarrje më të mëdhe» në punët e kooperativës, për «rritjen e rendimentit në kulturat bujqësore» etj. Biseda me sekretarin iu kujtua fije për pe dhë në vetvete ndjeu forcën e fjalëve të tij.

Një gjë të tillë i kishte shkruar edhe Nderimi në letrën që kishte marrë mbrëmë. Megjithëse, nuk di lte hapur, ai patjetër do të dinte diçka nga kjo. Ai është i zgjuar dhe di ta hedhë bukur llafin. Me sigrui do t'i ketë shkruar dikush, ndofta vetë Mezani. Bashkë ata kishin shoqëri të madhe, kishin qenë të dy brigadierët më të dalluar të kooperativës. Dhe në këto mendime e sipër ai nxori nga xhepi i brendshëm i xhaketës letrën që i kishte dërguar Nderimi.

«Ta lexoj edhe një herë», mendoi. E shpalosi dhe, me duart që i dridheshin, më shumë nga tronditja sesa nga pleqëria, filloi ta lexonte ashtu ngadalë, me aq sa kishte mësuar në kurset e luftës kundër analfabetizmit.

*I dashur baba, po të shkruaj unë, Nderimi yt. Me shëndet jam shumë mirë, kështu ma do zemra që edhe ju andej të jeni shëndoshë e mirë... Me komisar Foton të kujtojmë shpesh. «Ke një gjysh të mrekullueshëm», — më thotë sa herë që nis bisedën për ty. Para disa ditësh komisar Fotoja na foli për rëndësinë e tufëzimit të bagëtive. Ti e di mirë, baba Selman, se Partia jonë çdo gjë e bën për të mirën e popullit, për të mirën tonë. Këtë e kam mësuar nga ti që kur isha fëmijë. Prandaj, si gjithnjë, të jesh i pari, që ato shtatë kërthiqe që kemi e lopën t'i çosh në stallën e kooperativës. Edhe atje tonat do të jenë, madje do të marrim më shumë qumësht e mish...*

Tek lexonte këto radhë, diçka i dukej e pabesueshme. Sesi i dukej kjo letër...

— Hej, dreqi e mori, — tha plaku dhe u ngrit në këmbë. — Atij patjetër do t'i ketë shkruar dikush nga fshati. Thua ta ketë bërë këtë punë Mezani? — Në dorë shtrëngonte letrën. U kujtua se në të diçka shkruhej në fund:

*Po e mbyll letrën duke të puthur një mijë herë tu  
dhe pastaj gjithë të tjerët me radhë. Nga fundi i këtij  
muaji më prit bashkë me komisar Foton.*

I kredhur gjithnjë në mendime u nis ngadalë drejt shtëpisë. Era e ftohtë e mëngjesit tundte lehtë degët e holla të pemëve. Nga maja e kodrave, përkundruall fshatit, dielli po dilte i plotë. I tërë fshati, arat buzë lumi, kodrat me ullinj, avullonin lagështirën e mbledhur ditëve të shiut. Pranvera shfagej kudo. Një ndjenjë e ëmbël i valëzoi nëpër trup plakut.

Shoitoi hapin dhe u giend pranë derës së kasolles. Hapi derën dhe u fut brenda. Kaloi përmes dhenve dhe iu afroa lopës. Dora e tii e madhe e me damarë të dalë rrëshqiti lehtë në kurrizin e lëmuar të saj. Ajo e ndjeu dhe, sikur t'i vinte rëndë që i zoti e gjeti në gjumë. U ngrit ngadalë, duke ia afroar kokën e saj laramane. Plaku qeshi nën buzë.

— Gjumashe, — tha, — të kam mësuar nazelie, po tani si do t'ia bësh, tani që do të hashkohesh me shumë shoqe të tjera? — dhe me zë më të lartë, duke iu drejtuar edhe dhenve, shtoi:

— Tani bëhuni gati, se do t'ju çoj në stallat e kooperativës. Hë, si thoni, më mirë atje apo... Jo, jo, më mirë atie, për ju dhe për ne.

Dhentë, njëra pas tietrës, e pas tyre lopa, sikur ta kishin kuptuar, dolën nga dera e thurur e kasolles dhe morën rrugën drejt fshatit.

Me një ndjenjë lehtësimi në shoirt, me hapa të ngadalshëm, i ndoqi nga pas. Tërë dhimbja e kokës i është fashitur çuditërisht. Thellë në shpirt ndiente nevojë të fliste me dikë më gjatë, më shtruar, t'i hapte zemrën e t'i shkarkonte gjithë atë mllef që aq fort e kishte rënduar ato ditë.

Sapo kaloi shtëpinë e fundit të fshatit, ra erë bagëtish. Pak më tutje ishin stallat e tufës së përbashkët të bagëtive të kooperativistëve. Dy stalla të reja. Ndërtuar me tulla të kuqe, në buzë të lumi. Tringëllimat e këmborëve i vinin të plota në vesh. Nga dera

e njérës stallë doli një burrë i moshuar. Ishte Bimi, bariu më i vjetër i fshatit. Bimi i kishte sjellë i pari ba-gëtitë e tij këtu. Edhe atëherë, kur u krijua kooperativa, ndër të parët kishte qenë, por jo i pari. I pari kishte qenë Selman Hodoja.

— Të lumtë, Bim, të lumtë, vëlla, këtë radhë ma hodhë, më le prapa! — mërmëriti nëpër dhëmbë Selmanin.

Era, që vazhdonte të frynte e lehtë dhe e ftobtë, sillte me vete shushurimën e njobur të rrjedhës së lumenit. Në stalla ndihej lëvizja e gjësë së gjallë, që priste të dilte në kullotë. Lart, i tërë fshati ishte zgjuar dhe përgatitej për punët e reja të ditës.

1982

## Nasi Lera

### DITËN E TRETË TË LUFTIMIT

Mujo Halili u plagos në kokë ditën e tretë të luftimit. Nuk i vuri rëndësi plagës, por e lidhi shpejt e shpejt me mëngën e këmishës. Në pjesën lindore të atij qyteti të vogël, në Veri, pushtuesit gjermanë dhe reaksionarët rezistonin me një kokëfortësi të pashpresë. Frëngjité e shtëpive të rënda, si kulla, ngjanin me disa syste mavijosur nga lodhja e pagjumësia. Dhe villnin zjarr nga errësira e tyre; si qeniet e legjendave. Aty nga dreka skuadra, e Mujos mori urdhër të sulmonte rrugën kryesore. Luftuan pér dy orë në çdo portë e dhomë e, më në fund, edhe mbi atë rrugë ra qetësia e parë, pas tri ditësh e netësh luftë. Atëherë Mujo Halili ndjeu dhimbjen e kokës dhie iu errën sytë. Shkoi duke iu marrë këmbët deri te një pus, lëshoi kovën e shpuar nga plumbat dhe piu e piu si i babëzitur. Digjej i téri dhe uji sikur ia shtonte edhe më tepër etjen. Veshët i buçtin dhe nuk ambientohej dot me qetësinë e papritur. Gjaku i piksur dhe i përzier me pluhurin e rrugës dhe me tymin e barutit të djegur, dukej si plis i

tharë e i plasariit ur nga vapa. U hodhi ujë syve, por ko-ka nuk po i lehtësohej. Ishin ditët e para të nëntorit dhe Muios i dukej sikur mbante mbi kokë diellin, që, për çudi, kishte ende nxehësi.

Te këmbët e tii u afrua një pulë e trembur. Ajo, si pa rrëth e rrötull, futi sqepin në një gropë me ujë dhe piu. Pastai, si ngriti sytë indiferentë mbi Mujon. U largua rëndë-rëndë, duke çukitur barin e rrallë që kishte mbirë në të carat e pilloçave. Një dhimbje e mprehtë i përshkoi trupin Mujos. U çua me zor dhe, duke u mbajtur pas murit, doli në rrugë. Shikonte tur-bull, sikur sytë t'i kishin zënë perde. Aty pranë kërciti hekuri i një norte dhe Mujoia ndjeu dorën e dikujt. Pastaj erdhi dhe një i dvtë. Rrobat u mbanin erë barut e pluhur. E kuptoi se ishin partizanë. Njëri prej tyre e thirri me emër, po Mujoja nuk e njuh dot nga zëri. Ndaloj dhe tha:

- Turp, vërr nder, po nuk të njoh.
- Jam Sadiku! — tha partizani.
- Sadik Çobani?
- Po. Ti si ndihesh?
- Më janë errur sytë dhe nuk shoh dot.
- E ke nga plaga. Sa të ta pastrojë mjeku dhe do të bëhesh qiqër.
- Mujoja nuk foli më. E cuan në spitalin civil të qytetit. Mjeku ia zgjidhi plagën dhe ia pastroi. Mujoja u lehtësua menjëherë dhe u bë gati të ikte.
  - Mos lëvizni, ju lutem! — i tha mjeku.

Ai kishte një zë të butë e të hollë, gati si zë femre. «Një zë të tillë mund të ketë vetëm një njeri që i trembet luftës dhe do të rrijet larg sai», mendoi Mujoja. Dhe ai i urrente njerëzit që domin të rrinin larg luftës.

— Ju lutem, mos lëvizni, — tha mjeku me një zë edhe më të mekur, pasi e hutoi vështrimi i ashpër i Mujos.

«Ai e ka vështirë të sillet me mua, si me një pacient tjetër, — mendoi përsëri Mujoja. — Sepse unë jam një pacient që i sjell pranë luftën dhe ai do të rrijet larg saj.»

— È si të mri, si mumje? — tha Mujoja me inat.

— Jo, po... Mund t'ju infektohet plaga.

Mujoja ishte nga partizanët e parë, që kishin sjetë në spitalin civil të qytetit të vogël. Mjekut i kishte mbetur në buzë buzëqeshja e trembur. Mujoja u bind. Kur ia lidhën plagën, kérkoi pushkën.

— Ju duhet të rrini shtrirë, të paktën tri ditë, — tha mjeku me një zë të sigurt. Tek ai tani fliste guximi i profesionit, po Mujoja ia bëri me dorë se nuk ia kishte ngenë të bindej.

— Kështu ka urdhëruar komandanti. Të gjithë të plagosurit të shtrohen në spital, — tha Sadiku.

— Por nuk ka thënë edhe për gërvishtjet e lehta.

— E keni gabim, — ndërhyri mjeku. — Ju keni pasur fat që nuk ju është prekur sistemi nervor. Prapëseprapë plaga ka nevojë për kurim. Dhomën e keni gati. Shkojmë.

Mujoja qëndroi në mëdyshje.

— Mos u bëj qiliimi, — tha Sadiku dhe doli pas mjekut.

Korridori ishte i ngushtë. Dritaret shikonin nga perëndimi. Dita po thyhej ngadalë, sikur i vinte keq që po ikte. Vargmalet dukeshin të hirta, të largëta e të lehta. Mbi majat e tyre rriteshin retë si kërpudha gjigante. Mbi ato maja gjithmonë kishte re. Mujoja kështu i mbante mend. Poshtë, nën një arrë të madhe me degë si flokë të shpupurishur nga era, kishin hapur një varr të ri. Mujoja zgjati kokën nga dritarja. Mbi dheun e freskët diçkush kishte shkruar me gëzhojat e pushkës: «Partizani Kreshnik Korabi.» Dielli reflektohej mbi bakrin e ndritshëm të gëzhojave sikur donte të copëtohej në mijëra diej të tjerë të vegjël. Mujoja kapërceu pështymën.

— Pse nuk e shërove Kreshnikun, doktor? — tha tërë inat. Mjeku u drodh dhe nuk dinte si t'i përgjigjej. Kur e pa ashtu të trembur, Mujos iu shtua neveria.

— Cila është dhoma ime?

— Kjo përballë, — tha mjeku.

— Mirë, do të shtrihem, pasi të shikoj shokët.  
— Ai çeli derën fqinje. Në shtrat rrinin shtrirë dy partizanë. Njëri ishte plagosur në këmbë, kurse i dyti në kraharor. Përshëndetën Mujon.

— Për sa shërohen?

— Varet nga...

— S'ka varet në luftë! Për një javë t'i shërosh!  
Mjeku s'foli. Sadiku vuri buzën në gaz. Në dhomën e gjitur mjeku nuk i la të hynin.

— Eshtë rëndë dhe duhet të flejë.

— Si qulhet?

— Dale, se nuk e ka regjistruar. Shko merrë, të lutem, — i tha infermieres. — Deri më sot nuk më ka zënë syri burrë më të fortë se ky!

— C'ky, mor! — tha Mujoja tërë inat. — Ai ka emër! Zotëria jote futeshe vrimave, kur ai luftonte, dhe ti nuk i mbajtik mend as emrin! A, po, e di unë se q'domi ju, po nuk e kam në dorë.

Infermierja erdhi me një frymë. Mjeku shfletoi regjistrin, me duart që i dridheshin dhe tha:

— Pacienti e ka emrin Latif Dibra.

— Latifi?! Dëgjo, doktor! Latifin o ta shërosh, o gjej vrimë ku të futesh! Mbaje vëth më vesh dhe mos e harro! — tha Mujoja dhe eci përrpara. Hapi me forcë derën e fundit dhe mbeti në vend, si i ngrirë. U nxi në fytyrë dhe tundi kokën, si një kalë që nuk e duron dot zgjedhën. Përballë, në krevatin e vetëm të dhomës, e gjitur pas murit, ishte shtrirë një i plagosur, me këmishën tërë gjak. Edhe i plagosuri mbeti i habitur dhe nuk dinte ku t'i fuste duart. Po pastaj, sikur t'i vinte rëndë që e gjetën shtrirë, hovi përpjetë duke ngërdheshur fytyrën nga dhimbja. Sadiku u bë gati ta ndihmonte, po Mujoja e kapi përkrah dhe nuk e la t'i afrohej të plagosurit.

— Vetë u rrëzua dhe, po t'i ketë imbetur idonjë fije burrerie, le të ngrijhet vetë.

Këto fjalë duket që e prekën të plagosurin atje ku duhej, dhe ai, më një kokëfortusi karakteristike prej ma-

lësori, shtrëngoi nofullat, aq sa u dëgjua kërcitja e dhëmbëve. U mbështet pas murit dhe u çua në gjunjë. Mbi këmishë i doli një njollë e re gjaku. Qëndroi për një çast, ashtu i zbehtë, duke marrë frymë me vështirësi dhe, me një vrull të dëshpëruar, hovi përpjetë në këmbë. Mujoja e kishte ndjekur tërë ikëtë skenë me një gjakftohtësi të çuditshme.

— Omer Halili i lau gjynahet, vëlla, — tha i plagosuri dhe uli kokën, sikur ia preu njeri me sëpatë.

Mujoja ndjeu dorën e Sadiukut që u drodh dhe bëri një hap përpara. Dërrasat e vjetra të dyshemesë kërcitën tërë rënkim. Në dihomë po filkej drita e asaj dite, që dukej aq e qetë, aq e pafajshme. Mbi degët e arrës së madhe qëndroi një skifter, të cilin për tri ditë rresht e kishin zbuar nga foleja krismat e armëve. Ai mbërtheu thonjtë mbi një degë të hollë dhe përgjonte tërë frikë çatitë e shtëpive dhe dritaret e spitalit. I plagosuri çoi kokën dhe vështroi jashtë.

— Pse nuk më vështron në sy, Omer Halili? Dikur, kur bëja faj, unë t'i mbërtheja sytë, ashtu siç na mësonte babai.

I plagosuri ktheu kokën nga Mujoja dhe tërë trupi iu drodh, sikur t'ia kishte zënë korenti. Sytë iu çakërritën. S'duroi dot dhe ra mbi krevat. Sustat klithën çjerrë. Infermierja mori një kanë me ujë dhe ia hodhi në fytyrë.

— Bëji një gjilpërë për t'u forcuar zemrën, — tha mjeku.

I plagosuri erdhi në vete pas pak. Sytë i ishin shuar, pa jetë. Mujoja u trondit. Sa shumë i ngjaju në atë çast i vëllai me të atin. Dhe iu kujtua ajo ditë që i lidhi më shumë. Ishte palca e dimrit dhe babai qe nisur për në prefekturë për pak misër. Ata e priten në shtëpi tërë ditën, derisa u err dhe rrëth kullës u dëgjua ulërima e ujqve të uritur. Atë dimër ujxit u dobësuan, aq sa iu ngjit lëkura pas trupit, si t'i kishte zënë zgjebja. Mujoja me Omerin nuk vunë gjumë në sy. I hidhnin kërcunj zjarrit dhe shikonin përashta, mos dë-

gjohej zilja e mushkës. Por jashtë dëgjohej zhurma e dëborës, që binte e binte pa pushim, e ngrirë, e ftohtë, e padukshme. Në mëngjes i pari u çua Mujoja. Ai hapi portën e rëndë prej ahu dhe zbardhëllimi i dëborës i vau sytë e mësuar me errësirën e kullës. Kur iu mësuan sytë, dalloj përtej gërdhit diçka të zezë. Njohu mushkën e tyre dhe vrapiq drejt saj me zemër të ngrirë. Rreth mushkës dëbora skuqte. Në sytë e saj të qelqtë pasqyroheshin retë e bardha që i knin drejt përendimit. Në bark i nxinin plagët që kishte marrë. La mushkën dhe zuri të kërkonte të atin, i bindur se duhej të ishte diku aty pranë. E gjeti të mbështetur pas trungut të trashë të lisit. Dukej sikur ishte ulur aty për të pirë një cigare, siç bënte zakonisht, kur kthehej nga pazari. Mujoja i mori kokën në duar dhe gati sa nuk ia dha të qarit. Mbi dëborë ishin përhapur kokrrat e misrit si yje të këputura.

— S'erdha deri këtu të shikoj lot! — tha i ati me një zë të mekur. Në fytyrë nuk i kishte mbetur pilë gjaku. Mujoja ia lau sytë me dëborë, e cila zuri të avullonte menjëherë. Zemra i rrihte dobët, tamam si ajo gjuha e zbehtë e kandilit, kur do të fiket se i ka mbaruar vajti. — Mjaft, më lër tanë dhe më thirr Omerin! — tha i ati.

— Omeer! Omeer! — thirri me sa fuqi që kishte Mujoja.

Omeri doli nga kulla si i çmendur dhe u afroa duke e çarë dëborën me gjoks si ndonjë dem i tërbuar. E kapi të atin për këmbësh e shpatullash dhe u bë gati ta fuste brenda në kullë.

— Mos më lëviz, se nuk dua të më dalë xhani pa t'i thënë dy fjalë. Kam një plagë në bark, — dhe u mblodh kruspull.

— Kush të qëlloi? — e pyeti të atin Omeri.

— Isuf Mejdani, te Kroj i Bardhë. Të kesh kujdes Mujon dhe nënën.

Dha shpirt në dorë të Omerit. Kishte rrojtur për të lënë amanetin. E varrosën që atë ditë. Toka e ngrohtë

nën dëborë i mbeti në mendje Mujos për një kohë të gjatë. Dhe u rrit duke pasur si baba të vëllanë, Omerin. Nuk ia ktheu asnijëherë fjalën. Grindja e parë ngjau kur nisi lufta. Mujoja donte të dilitte partizan, por nuk e linte Omeri. Omeri i urrente partizanët vetëm e vetëm se me ta ishin edhe djemtë i Isuf Mejdanit. Dhe të dy vëllezërët u ndanë. Mujoja u hodh me partizanët, kurse Omeri u bashkua me forcat e bajraktarit. Njëherë i dërgoi haber se, po ta kapte të gjallë, do t'ia rripte lëkurën si shelegut. Mujoja ia ktheu përgjigjen se një plumb e mbante përherë me vete, për të mos rënë i gjallë. Para një viti, në përleshjen e Bridashit, gati sa nuk u kacafytën, por bajraktari dha shenjën për t'u tërhequr dhe Omeri i humbi nga sytë, hipur mbi makinat gjermane. Tani ishin përballë njëri-tjetrit, të dy të plagosur.

— Plumbi më fali, gjersa nuk më mori në të majtë, — tha Omeri.

— Ai që shtiu mbi ty, duket që nuk ka nishan, — tha Mujoja dhe shtoi: — Unë nuk do të gaboj!

— Mos harro se kush të ka mësuar, Mujo Halili!

— Për të zezën e tij, më ka mësuar Omer Halili!

— Mos harro se ai është yt vëlla!

— Ka, qenë! — tha prerë Mujoja.

Omer Halili nuk e priste këtë përgjigje nga i vëllai, prandaj nxori një rënkim të mbytur.

— Ai është keq, mos e shqetësoni, — tha infermierja. Edhe ajo deri atëherë mendonte si mijeku, se ishin larg luftës. Infermierja u bë gati ta ndihmonte Omerin, por ai u tërroq pas murit.

— Je bërë për të qarë hallin, Omer Halili, gjersa po të mëshirojnë edhe gratë, — tha Mujoja. — S'ma merrte mendja se do të katandiseshe deri këtu.

Kur dëgjoi këto fjalë, Omeri përplasi kokën pas hekurit të krevatit dhe hungëroi si një derr i plagosur.

— Jo, — tha dhe u çua në këmbë, — po dua të bisedojmë si burrat! Gjersa më fali plumbi, duhet të më falësh edhe ti.

Mujoja ziente përbrenda.

— Edhe sikur të të fal unë, nuk të fal ai që qëndron mbi mua, gjyqi partizan. — Dhe, si u mendua pak pyeti: — A ke vrarë partizanë me duart e tua?

Omeri ngurroi në fillim. Ajo pyetje e vriste më shumë se plaga.

— Kjo pyetje nuk bëhet në luftë.

— Ti a ke vrarë?

— Kam luftuar.

— Ç'të bëj që je i plagosur, po flisnim ndryshe.

Omeri shqeu këmishën dhe tregoi plagët e hapura në gjoksin leshtor. Pastaj iu prenë këmbët dhe u shkreh në ngashërim. Ishte një ngashërim i rëndë, sikur aty po shembej një kullë e lashtë.

— Të paktën më rri te koka kur të më dalë xhani,

— tha me një zë të këputur dhe lutës Omer Halili.

Atyre që ishin në atë dhomë, iu duk sikur foli një i huaj që kishte hyrë pa u parë. Të gjithë ia mbërthyen sytë Mujos. Flokët i ishin ngritur përpjetë dhe trupi i lëkundej si një lis, kur e frys era. Omeri nuk ia ndante sytë dhe i lutej pa zë. Mjeku ishte bërë meit në fytyrë. Lufta kishte hyrë në atë spital të vogël, të qetë\_ deri atëherë, me tërë ashpërsinë e saj. Ai u bë gati t'i lutej Mujos, që të paktën të mos tregohej aq i rreptë me të vëllanë tanë që ai po vdiste, por nuk e hapi dot gojën. Nofullat i ishin mbërthyer tamam si një njeriu që e ka zënë rrufeja. Infermierja nuk dinte ç'të bënte. Sadiku vështronte Omerin me neveri. Ishte ndodhur kushedi sa herë pranë rasteve të tillë. Në duart e tij kishin dhënë jetën disa shokë. Dhe kishin mbyllur sytë të qetë, sikur po binin të flinin.

Omeri mblodhi forcat e fundit që i kishin mbetur dhe u lut për herë të fundit:

— Eja!

Atëherë Mujo Halili gati sa nuk iu hodh përsipër:

— Omer Halili, linde si njeri, por po vdes më keq se një qen!

Dhe doli nga dhoma pa e lkthyer kokën pas. Në dhomë mbeti mjeku, që çdo gjë i dukej si ëndërr, infirmierja, që zuri të pëshpëriste diçka të errët, ogurzezë, dhe Omer Halili, që përpëlitez e përpëlitez vazhdimisht.

1977

# Nasho Jorgaqi

## FYTYRA E HEROIZMIT

1.

Kishim disa orë që udhëtonim dhe «Gazi» ynë ngjitej vazhdimesht në të përpjeta, duke lënë prapa male e hone, aq sa mua, që udhëtoja për herë të parë në këto anë, më dukej se, ashtu si e kishim risur, do të sosnim në Hënë. Kjo ndjenjë më mbetej e gjallë, madje edhe kur qëllonte të zbritnim nga makina. Në lartësinë e atyre maleve, yjet më ngjanin fare afër dhenata, kishte një ngjyrë të çuditshme. Ishte një natë prillli pa hënë. Flladi i lehtë, që hynte nga dritarja, mbushte herë pas here makinën me kundërmimin e pyjeve. Ne ishim aq të topitur nga rruga e gjatë, sa ajo erë e këndshme na lehtësonte dhe na bënte të merrnim frysë thellë. Megjithatë, tek vështronim jashtë, shpesh ngaterronim yjet që regëtinin nëpër qiel me dritëzat e fushave e luginave që shtriheshin nën këmbët tonë.

— E fundit, doktor, — tha Xhelaja, duke ndërruar marshet.

«Gazi» ngjiti të përpjetën e fundit, mori djathtas

dhe hyri në një rrugë pa rrugë duke dredhuar në të dyja anët. Kur u futëm në pyll, makina e uli shpejtësinë dhe atëherë unë fillova të shikoja jashtë me vë mendje.

Në errësirën e dendur të pyllit dritat e makinës u bënë edhe më të forta. Dukej sikur aty nata ishte e dyfishtë. Unë ndiqja lëvizjet e makinës dhe vështroja drurët e pyllit që vini drejt nesh si në një valle pa mbarim.

Kishim hyrë thellë në pyll, kur qëndruam në një korije të vëtmuar dhe aty zbritëm që të tre. Unë e Fahredini hodhëm plaçkat në krah dhe pritëm Xhelon sa mbylli makinën e na udhëhoqi përmes drurëve me një elektrik dore. Ne zumë të econim pas tij, nëpër disa shtigje të ngushta që, siç dukej, i njihte vetëm ai. Më ka mbetur ende në mendje ajo qetësi e thellë, që ndillte përqark nesh një atmosferë fshehtësie e të parpiturash. Hapat tanë jehonin me një kumbim të rëndë, kurse nga thellësia e pyllit dëgjoheshin disa zhurma të pakuptuara.

Në të dalë të pyllit, qëndruam në një shesh të mbuluar me bar të thatë. Aty pushuam disa minuta në këmbë dhe, pa folur, vazhduam rrugën për më tej. Xheloja shoi elektrikun e dorës dhe këtë e bëri, me sa kuptova, jo vetëm se tani kishim dritën e yjeve, por dhe për fshehtësi. Rruga këndejej kalonte prapë në të përpjeta. Në mbarim të pyllit ngriheshin disa shkëmbinj të paformë. Ne përpinqeshim t'i shkonim pas Xhelos, po shtigjet në të përpjeta ishin të vëشتira. Ai, si sorkadhe, hipte e zbriste nga një shkëmb në tjetrin, aq sa unë e Fahredini mezi e ndiqnim. Madje vendevende filluan të ngjiteshin këmbadoras duke pasur kujdes orë e çast sendet që kishim me vete.

Kur dolëm në krye të shkëmbit të dytë, (se ishin tre shkëmbinj njëri mbi tjetrin, siç kishin hipur kluar), aty na priste Xheloja.

Fahredini u mbush me frymë dhe tha me zë të ulët:

— Thirri!

Unë vështrova Xhelon. Ai vuri të dyja duart në buzë dhe, papritur, vendi jehoi nga disa klithma të thekshme, si të gjelit të egër. Vendit aty vinte gjysmë i mbyllur dhe jehona dukej si kur vërtitej mbi kokat tonë. Pas kësaj sundoi një heshtje e rëndë. Në qëndronim me sy të ngulur andej ku errësira ishte më e dendur. Nuk kaloi shumë dhe nga lart erdhi një fishkëlli-më e zgjatur që s'di të them se çfarë zëri imiton.

U bë një heshtje e shkurtër dhe në këtë kohë dy shokët e mi u morën vesh vëtëm me një të tundur të kokës. Unë shikoja shkëmbin që ngrivej pranë nesh dhe nuk e merrija dot me mend se nga do të ngjiteshim, kur vura re hijen e Xhelos që lëvizte me zigzage në gjysmën e tij. Për një çast ai më humbi nga sytë. Fahredini dukej shumë i qetë dhe, si një komandant në luftë, ndiqte me vëmendje të gjitha veprimet e Xhelos. Vëtëm kur hija e tij u zhduk nga sytë tanë dhe pas kësaj zbritën nga lart ca zëra të mbytur, atëherë Fahredini më dha shenjë ta ndiqja pas.

Tani çdo gjë po më dukej si një èndërr. Ngjitesha këmbadoras e, padashur, vështroja honin e enrët që hapëj poshtë nesh dhe pyllin që nxinte tej në horizontin e natës. Më bëhej se në këta shkrepëtë të braktisur, në mes të kësaj shkretëtire të errët, ishte e vështirë e ndoshta e pamundur të rronte njeri i gjallë. Po nuk pata kohë të arsyetoja më gjatë, mbasi atë çast kishim arritur në vend. Në gjirin e shkëmbit të lartë, fshehur pas disa drurëve të vëtmuar, hapej goja e një shpellë. Këtë mezi e dallova nëpër errësirë, kur dëgjova Fahredinin të më thoshte:

— Futu, doktor, po kujdes, ule kokën!

Unë përkula trupin dhe hyra në shpellë, pa ditur ku të shkelja. Pastaj ndjeva dörën e Xhelos që më kapi dhe leca më tutje nëpër errësirën e thellë. Pasi hyri dhe Fahredini, Xhelona ndezi dritën, e cila ndriçoi një pjesë të shpellës. Shpella ishte e ngushtë në krye e pastaj vinte e zgjerohej në thellësi. Në fillim nuk më zuri

syri asnijë tē huaj, por, kur Xheloja lëvizi dritën, m'u dulk sikur papritur doli nga thellësia e shkëmbit një njeri që hijet i jepnin përmasa, tē çuditshme. Madje, para se tē shikoja atë, më buçiti papritur në vesh një zë i fortë:

— Mirë se erdhët, burra!

Ne u hodhëm menjëherë në krahët e njëri-tjetrit dhe mbaj mënd që duart e tij më shtrënguan fort, sikur tē më kishte mbërthyer një darë e hekurt. Zéri i tij i fuqishëm plot gjëmim, në çastin e parë m'u duk sikur nuk i takonte atij njeriu tē gjatë e truphatë ftyrëhajthëm dhe me buzë tē holla. Vetëm sytë e mëdhenj e tē thellë, që shkreptinin paprerë, i shkonin zërit tē tij burrëror.

Pastaj ne u ulëm mbi ca, gurë tē lagur dhe ai na dha prapë dorën, thuaçse i kishim shkuar në shtëpi. Gjithë ftytyra i vetëtintë nga gazi, ndërsa gjoksi i ulej e i ngriuhej paprerë. Ai nuk dinte si tē gëzohej që i kishim ardhur. Matej tē fliste e s'fliste dot.

— Ju mundova, shokë, — tha më në fund.

— Ç'të munduar, a derëbardhë! — ia priti menjëherë Xheloja, që atë kohë po zbërtente çantën. — Ti na thuaj, sa ditë ke pa ngrënë?

Ai nuk foli, po vështroi nga ne tē tjerët.

— Mirë e ka Xheloja, — tha Fahredini. — Vërtet, sa ditë t'u bënë pa ngrënë, Martin?

— Lëre, mos pyet, — tha Martini dhe murmuriti diçka nëpër dhëmbë, që ne nuk e morëm vesh.

Pastaj Xheloja i vuri përpara çantën e hapur me ushqime. Ai zgjati dorën, mori një copë tē madhe bukë dhe filloi ta hante me nxitim. Kishë pothuaj një javë pa ngrënë dhe kjo kishte ndodhur jo nga pakujdesia joni, po ngaqë vendi i fshehtë ku linim ushqimet ishte kontrolluar ato ditë herë nga bandat, herë nga forcat tona, tē ndjekjes. Këtë ai nuk na e tha drejtërdrejt, por e morëm vesh në bisedë e sipër.

Ne u munduam tē mos e vinim re tek hante dhe,

ndërsa unë fillova të hapja çantën time sanitare, Fahredini, me vetulla të mbledhura dhe me vështrim të ngulur, zuri t'i thoshte direktivat e reja të qendrës.

2.

Para disa ditësh më pati thirrur në zyrë Fahredini.

— Ti e di, doktor, — tha ai me një seriozitet që ia diktonte detyra, — se lufta jonë vazhdon. Bile nga ndonjë pikëpamje, është bërë edhe më e vështirë. Bandat e kriminelëve sillen akoma nëpër male. Po i bien popullit më qafë. Detyra jonë është që t'i asgjësojmë sa më parë dhe për këtë nuk mjafton që të ndeshemi ballë për ballë, por edhe t'i shkatërrojmë nga brenda. Kjo është arsyaja që një shoku ynë, i ngarkuar të hyjë në bandat e tyre, ka disa kohë që ka dalë në mal, po deri sot kriminelët nuk i kanë zënë besë. Ai është i detyruar të lendet maleve fill i vetëm, i ndjekur herë nga bandat, herë nga forcat tona. Kuptohet që, sa më shumë kohë ikalon, aq më tepër rrezikohetjeta e tij dhe, si pasojë, edhe plani ynë për asgjësimin e kriminelëve. Tani kemi vendosur të bëjmë provën e fundit: t'i hapim shokut tonë një plagë fiktive në trup. Kjo është edhe arsyaja që të thirra. Ne e kuptojmë fare mirë se ç'do të thotë kjo për një mjek. E kuptojmë sa delikate dhe e ndërlíkuar paraqitet situata për ty, po ne jemi komunistë dhe Partia e kërkon këtë prej nesh.

Pa mbaruar ai, unë e ndjeva menjëherë barrën e rëndë që po merrja mbi vete. Të them të drejtën, u hutova. Qëndroja në heshtje para shokut tim dhe mundohesha t'i shpëtoja shikimit të përqendruar të tij. Ishte një çast që nuk mund të kapërcehej me një përgjigje sa për të kaluar radhën.

— Do të mendohem, — thashë në fund dhe u ngrita.

Ai e kuptoi gjendjen time dhe, pa e zgjatur, e mbyllëm me kaq takimin e parë.

Shkova në shtëpi dhe, më parë se të gjeja zgjidhjen praktike, nxora librat. Shfletova qindra faqe, konsultova disa atlase anatomiqe. Në ato çaste më dukej vetja student dhe jo mjek i kaq viteve, siç isha. Tërë ato që dija për trupin e njeriut, tani më ngatérrosheshin. Pas çdo idëje që më lindte, më dukej sikur fshihej një pikëpyetje tinëzare, që më lëkundte besimin. Thosha se, po të dështoja unë, do të rrezikohej puna e gjithë shokëve.

Me këto mendime kalova gjithë natën. Kur erdhi mëngjesi, mbylla librat dhe, si u qetësova ca, fillova rishtazi të mendoja. Ndoshëta këshilla e një kolegu do të më ndihmonte mjaft. Po kjo nuk më lejohëj kurrsesi. Çdo gjë duhej ta zgjidhja vetë. E pra, nga c'pjese e trupit të gjallë duhej të kalonte plumbi, që mundësishët të dëmtonte sa më pak? Duhej të qmësosheha me mënyrën e zakonshme të arsyetimit. Tani duhej të arsyetoja kështu: c'duhej të bëja, jo për ta mbyllur një plagë, po për ta hapur?

Detyra që m'u ngarkua nuk më lejonte të hyja në qorrssokakë që mund ta dëmtonin çështjen. Armiku duhej të thyhej me çdo kusht. Më shkonte mendja te njerëzit që po terrorizoheshin nga bandat, te shokët që po luftonin orë e çast me armiqëtë, e, mbi të gjitha, mendoja shokun tonë që endej maleve fill i vetëm. E c'ishte një plagë fiktive para gjithë këtyre? Po ky mendim, të them të drejtën, nuk m'u qartësua menjëherë. Nuk më limin të qetë ato dreq paragjykime profesionale: sikur më pëlqente t'u jepesha ndjenjave të vockla. Kisha arritur deri në atë shkallë, sa të mendoja se më takonte mua t'i mbroja parimet e humanizmit tonë, por harroja, për një çast, se shokët këto parime kishin vite të tëra që i mbronin me gjak e sakrifica.

E vërteta është pra se isha i pavendosur. Këtë e kuptova mirë të nesërmen, në takimin e dytë me Fahredinin. Ne të dy njiheshim prej kohësh, po në rrethanat

që bisedonim, më ngjante sikur po shiheshha për herë të parë me të. Megjithatë, përzemërsia, me të cilën më pri-ti kësaj here, më bëri ta ndieja veten më të qetë se në takimin e parë.

— Hë, Kristaq, ç'bëre? Të futa në telashe, — m'u drejtua me buzë në gaz, kur u ulëm krah njëri-tjetrit në një kolktuk të gjerë.

— Mendova, — i thashë, — bile mendova gjatë.

— Shumë mirë atëherë, — tha ai me një zë të ngrohtë dhe më la të vazhdoja.

— Mund t'ia hapim një plagë... them t'ia hapim... në pjesën gluteale... në të ndenjurat...

Dhe mora të ndizja një cigare, i bindur se me ato që thashë kisha gjetur të vetmen zgjidhje të mundshme. Tani ndiheshë i lehtësuar nga tërë ajo barrë që më kishte shtypur e sfilitur, prandaj prisja që ai ta miratonte menjëherë. Por ai, për çudinë time të madhe, nuk foli fare. Për më tepër, iu zhduk gazi nga fytyra, vetullat iu mblohdhën dhe thithi disa herë cigaren. Unë vazhdova:

— Nuk di si ju duket juve, por unë do të thosha se glutealet janë pjesa më e sigurt për të kryer atë që kërkoni ju... Në këtë pjesë ka pak enë gjaku dhe akoma më pak nerva. Pra, dhe rreziqet janë më të vogla dhe dhembja është më e paktë...

Po ndërsa mundohesha të shpjegoja atë që kisha menduar gjithë natën, nuk di sesi lexova papritur në fytyrën e tij pakënaqësi dhe një lloj shpotie për ato që po thosha.

— Jo, jo, doktor, — tha ai me një ton të prerë, gati të rreptë, — nuk e ke menduar mirë. Ke parë vetëm anën profesionale... Shoku ynë nuk do ta pranonte kurrë këtë zgjidhje.

— Si?! — u hodha unë i habitur e i prekur një-kohësisht. — E pse, ç'të keqe ka këtu??

— Kjo është menduar e tëra keq, — ma ktheu ai i vendosur, megjithëse u përpinq ta zbuste pak to-

nin. — Prit, mos u ngut, ta shpjegoj unë. Pa mendo njéherë se ç'telashe do t'i krijonte një plagë në një vend të tillë shokut tonë! Kjo do ta paraqiste si frikacak. Burri goditet ballë pér ballë me armikun dhe jo duke i kthyer kurrizin. E kuption, pra, se ç'pasoja të këqija mund të sillte?! Bile, mund të ngjallë edhe dyshime, kur ai ka kaq nevojë pér prestigj dhe besim. Pra, ai duhet të shkojë tek ata si njeri që është armiqësuar e gjakosur keqas me ne, me një plagë që ta mbush mendjen vërtet e jo në prapanica!

Fas këtyre arsyetimeve, unë e humba dhe pér një kohë kujtova se nuk do të kishte rrugëdalje. Të gjitha ato që thoshte Fahredini, ishin të drejta, po nuk e merrja dot me mend se, veç glutealeve, në ç'vend tjetër mund të hapej plagë pa rreziqe.

— Nuk di ç'të them, — ngrita supet duke u përpjekur të mposhtja nervozizmin që më kapi befas. Dhe, të them të drejtën, nuk di si do të isha sjellë, po të mos më qëndronte përballë aq e qetë dhe besimplotë ftyra e tij.

— Unë të kuptoj shumë mirë, doktor, — tha ai pas një heshtjeje. — E ke pasur të vështirë... Vështirë e kemi dhe n'e, s'do mend! Duhet që armiku të mos dyshojë pér asgjë dhe, njëkohësisht, shokun tonë ta lehtësojmë sa më shumë në detyrën e rëndë!

— E si mund ta lehtësojmë? — shpërtheva unë padashur. — Plaga mbetet plagë, kudo qoftë në trup.

Ai më buzëqeshi me pamjen e një njeriu që ka bindje në mendimin e vet dhe më tha me zë të qetë:

— E thamë, që në lojën që po bëjmë, ka shumë rëndësi se në ç'pjesë të trupit është plaga. Ja, pér shembull, një plagë në gjoks, do të ishte një ndihmë e madhe pér Martinin. Kjo do ta nderonte para armiqve, do të ngjallte besimin e tyre...

— Po kjo është krejtësisht e pamundur, — qesha unë, jo pa njëfarë triumfi. — Plaga në gjoks do të thotë ta vrasësh me dorën tënde!

Megjithatë entuziazmi im nuk e pati të gjatë. Fahre-

dini ndezi cigaren që i ishte shuar në mes të gishtë-rinjve dhe e thithi i menduar.

— Edhe ne jemi shqetësuar gjithë këto ditë, — foli ai ngadalë, — po shkuam më shpresë se mos gjeje ti ndonjë zgjidhje më të mirë. Jam i bindur se, po të të linim kohë, do ta gjeje këtë zgjidhje, por koha s'na prenton fare. Mendo që ai bredh nëpër male dhe pret përgjigjen tonë.

Fahredini lëshoi cigaren në tavëll dhe u ngrit në këmbë duke bërë ecejake nëpër dhomën e gjatë.

— Varianti ynë është ky — filloi ai të shpjegonte me kujdes, thuajse demonstronte ndonjë plan në hartë. — Mund ta kemi edhe gabim. Nuk është e thënë ta aprovosh medoemos. Ne, pa aproviimin tënd, nuk bëjmë asgjë. Ne themi kështu: të tertiqet lëkura 5-6 gishta nën sqetull dhe të qëllohet mbi të me kujdes, në mënyrë që, kur të lëshohet lëkura, njëra plagë të bjerë në gjoks e tjetra në shpatull. Natyrisht, kjo është një plagë lëkure dhe ti si mjek do t'i marrësh të gjitha masat, sidomos në kushtet që ndodhet ai si komit nëpër male. Si thua, a ka mundësi të bëhet?

Unë heshta dhe, sikur të isha vonuar edhe ca, ai me siguri do të kujtonte se isha prekur në sedër. Po në të vërtetë mua më kishte shtangur ideja e saktë dhe praktike që ai ma paraqiti aq thjesht e qartë.

— Ka mundësi... pos! — thashë unë më në fund, pas një heshtjeje të shkurtër. Fahredini shtoi menjëherë:

— Doktor, ti i di më mirë këto punë, prandaj thuaji të gjitha rezervat, që t'i kemi parasysh.

— Jo, jo, — nxitova unë, — zgjidhja juaj paraqit më pak rreziqe... Sigurisht, do kujdes dhe kuptohet se do ta bëjnë njerëz me përvojë dhe gjakftohtë...

— Përvojë për këto gjëra nuk kemi, — shpjegoi ati, — kjo është hera e parë...

— Përveç kësaj, — shtova unë, — që të kryhet kjo, kërkon disa kushte minimale.

Fahredini, që rrinte në këmbë para meje, mblo-

dhi buzët i pakënaqur dhe mua kjo m'u duk pak ta-llëse.

— Them, në rast se ka mundësi ta sillni këtu, ose të paktën të bëhet në qendrën më të afërt, që, sido që të vijë puna, ta kemi afër spitalin.

Ai u ul, mori një pamje serioze dhe tha:

— Rrethanat janë të atilla, doktor, që jo vetëm nuk mund ta sjellim këtu, por as në qendrën më të afërt nuk e shpiem dot.

— Po si i bëhet, atëherë?! — thirra i çuditur.

— Do të shkoni ta bëni në vend, në Malin e Kaçiles!

Ai foli në një mënyrë të prerë, duke më dhënë të kuptoja, se për këtë gjë nuk kishte si të diskutohej. Dhe, ndërsa unë heshta, ai u mundua të më vinte përparrë një argument tjetër:

— Kristaq, më thuaj, si do të veproje ti, sëkur kjo të ndodhë dje në luftë?

Unë tunda kokën dhe, në vend që t'i përgjigjesha, bluaja me vete. Në luftë, luftova si gjithë të tjerët, mjekova me dhjetëra partizanë, me aq sa dija, por asnjëherë nuk u ndodha para një situate të tillë. Shkoja e i mjekojë shokët atje ku ishte treziku më i madh, i mbaja në krahë, rrrija vetë i uritur e u jepja atyre kafshatën e gojës, hiqja rrobat e këpucët e mia, mëdje edhe qelbin u kisha thithur, kur e kishte dashur nevoja, po kështu si sot nuk më ishte shtruar asnë detyrë...

Është e tepërt të tregoj si vazhdoi më tej biseda jonë. Nëse u shkundë nga paragjykimet dhe u ngrita në lartësinë e detyrës, këtë ua kam borxh shokëve, e në radhë të parë Martinit. Them Martinit, se në qëndrimin e tij pashë se ç'fytyrë të madhërishme ka heroizmi i njeriut tonë në luftë.

Dhe tani që Fahredini i jepte direktivat e qendrës me atë zërin e tij të shtruar, unë s'ia ndaja sytë Martinit. Ai vazhdonte të hante, po jo me atë vrullin e parë. Dukej i qetë, thua jse nuk mendonte fare për atë që e priste. Po mua, që mendoja vetëm për këtë, me gjithë vendosmërinë, prapë, në atë çast, ndërsa vështroja nofullat e tij të dala, ballin e zbehtë, duart e thata, më kapte papritur një dyshim që më trondiste. Madje nuk di sesi u gjenda një hop bosh dhe ai vështroi ngultas, aq m'u bë sikur m'i bleu mendimet dhe i buzëqesha pa qenë nevoja.

— Nënën, — dhe vëllezërit i ke mirë, — tha Xhelajo kur mbaroi Fahredini.

Martini tundi kokën dhe nuk tha asnjë fjalë. Pastaj mbylli çantën e ushqimeve duke mbajtur sytë përdhe.

— Po ajo q'bën? — pyeti.

Kaloi një hop në heshtje dhe pastaj Fahredini tha:

— Është mërzitur, domosdo.

Martini bëri një gjest me dorë që unë nuk e mora vesh. Pas kësaj sikur u çel në fytyrë. Tani vështrimi i tij lëvizte lirisht.

— Keni ardhur tamam në kohë, — tha ai. — Situata nuk duron më. U përpoqa, siç e dini, po qe e pamundur. Prandaj ju shkrova. Pa dhënë provën e gjakut, ata nuk më pranojnë.

— Dakord, — tha Fahredini. — Qendra e aprovoi. Doktor Kristaqi për këtë qëllim ka ardhur. Çdo gjë do të bëhet me kujdes. Mos ki merak për asgjë, s'do të ketë telashe.

Shpella gjëmoi papritur nga gazi i Martinit.

— Telashi më i madh ka qenë ai që hoqa. Kjo që thoni ju, do të jetë shpëtim për mua. Doktori të mos ketë frikë që më shikon kështu të hollë. Kështu

jemi tërë familja, po jemi të fortë. Im vëlla kaloi gjithë Operacionin e Dimrit me plagë në trup dhe nuk e gjeti gjë. Apo s'ka të bëjë kjo, si thoni, doktor?

Kjo pyetje më zuri krejt në befasi dhe nuk arrita t'i përgjigjesha. Dëgjova Xhelon që tha:

— Doktorit s'po i dëgjohet zëri sonte!

— Kushedi ç'thotë me mendje: ku më sollën kështu këta shokë! — shtoi Martini.

— As në èndërr nuk e ka parë këtë shpellë, — tha Xheloa.

— Shpella ka parë plot, — shpjegoi Fahredini, — se në këto shpella ka mjekuar të sëmurët gjatë luftës.

— Mund të fillojmë nga puna? — ndërpresa bisedën unë. — Si thoni?

— Umë gati jam, kur të domi, — u hodh Martini.

Fahredini dhe Xheloa lëvizën dhe filluan të rrëgullonin vendin. Hoqën disa gurë dhe shtruan xhaketat në sheshin plot lagështirë.

Pastaj Xheloa, vendosi drithën më lart, në mënyrë që të ndriçonte sheshin e hapur. Unë nxora të gjitha sendet e nevojshme nga çanta sanitare. Martinit nuk i shpëtonte asgjë.

— Zhvishuni dhe shtrihuni, — thashë, me një zë që më tingëlloi i huaj.

Ai u zhvesh nga brezi e lart dhe unë i tregova se në ç'vend do t'ia hapnim plagën. Tani e kisha marrë veten mirë dhe këtë e ndieja nga mënyra se si flisja.

I bëra gjilpërën e parë dhe i kapa pastaj me dorë atë pjesë të lëkurës që bie nën sqetull. Ai ishte mjaff i lirë dhe dukej fare i qetë. Për më tepër, ndieja se kishte qejf të bisedonte. Ndoshta ngaqë kishte kohë pa biseduar me njeri.

— I çova fjalë kapobandës për të tretën herë, — tregonë ai, — po prapë nuk më besoi. Kishte thënë: «Le të shkojë te komunistët, se bukën e tyre ka ngrënë deri tashti.»

— Nuk i hanë kollaj djallëzitë ata, jo, — u hodh Xhelaja. — Ata janë djallëzia vetë.

Fahredini kishte nxjerrë revolverin e vogël që fekste nga drita dhe e fshinte me shami. Martini vahdonte të tregonte si pa të keq:

— Isha te Shpella e Lopës, kur ata ranë në përleshje me forcat tonë. I shikoja dhe luftoja me veten. E pra, nuk ma kishte marrë mendja që të rrija ashtu...

Kur ai fliste, unë vazhdoja punën time. Bëja pastrimin e vendit ku do të hapej plaga dhe provoja të térhiqja lëkurën. Fahredini kishte lënë revolverin mënnjanë dhe më ndihmonte mua. Xhelaja i rrinte Martinit te koka dhe e mbante me muhabet.

— Nuk e merrni me mend sa të poshtër janë, — thoshte ai gjithë mllef. — Unë i pashë me sy, kur i vunë zjarrin depos së bereqetit në Vril. Ishin po ata që vranë cucat në stan e i vunë thikat Ndoc Markut. Nuk di se ç'më është mbledhur këtu në gjoks.

— Ke të drejtë, — tha Xhelaja, — vërtet nuk durohen...

— Fillojmë atëherë! — fola unë.

— Gati, kur të doni! — tha ai me buzë në gaz.

Në këto fjalë nuk kishte asgjë të shtirë. Unë isha i bindur se në gjendjen që ndodhej ai, më mirë do të qe t'i nënshtrohej një sakrifice si kjo, sesa të bënte një jetë me sakrifica të pafund.

— Jo, jo, térhiqeni, se e duroj, — tha Martini kur zura t'i térhiqja lëkurën më pinca. Dhe fillova ta térhiqja fort, por e dija se, sado që e kisha mpirë vendin rrëth e qark, ajo me siguri dhimbte. Po fytyra, e tij nuk tregonte asnjë shenjë shqetësimi. Përkundrazi, e shihja se kishte dëshirë të fliste akoma. Deshi, madje, t'i tregonte prapë diçka Xhelos, por unë ndërhyrat:

— Shtrihuni në kurriz, asnjë lëvizje, ju lutem!

Ai nuk foli më. U shtri i téri mbi xhaketat e shtruara përdhe, ndërsa kokën e mbështeti në një gur, ku Xhelaja kishte vënë kapelen.

Para se të filloja nga operacioni, i mata pulsin dhe, t'ju them të drejtën, nuk besova se ishte dora e tij. Kjo gjë më dha edhe më shumë zemër.

— Mbaje këtu, — iu drejtova Xhelos, duke i dhënë pincat në dorë. — Tërhiqe tani, tërhiqe dhe pak... Mirë, lëshoje.

Pastaj vështrova nga shokët, duke u dhënë të kuptionin se po fillonte çasti më delikat.

— Prit, — u hodh Fahredini i menduar. — Kështu nuk është mirë, ka rrezik që flaika e plumbit të djegë lëkurën. Ata do ta kuptionjë dhe do t'i nxjerrin te-lashe. Të vëmë më mirë një shami para pincave.

Kjo që thoshte ai, ishte me vend.

Dëgjova zërim e Martinit:

— Ma jepni mua, doktor, të qëlloj.

Nuk e mora vesh pse i tha këto fjalë. Vërtet i qe mbushur mendja të qëllonte, apo donte të na nxiste ne që po vonoheshim? Nxora me të shpejtë nga çanta sanitare një copë garzë të gjérë dhe urdhërova me zë të prerë:

— Afrohu, Fahredin. Nëm revolverin. Ti, Xhelo, rri gati!

Unë i dhashë Fahredinit të mbante garzën dhe vëtë mora revolverin. Martini, edhe në këtë çast, nuk jepte asnjë shenjë shqetësimi. Madje nuk shtrëngonte asnjë muskul. Vetëm një damar i dridhej në cep të syrit.

Erdhi çasti që isha çliruar nga urdhrat dhe kujdesjet. Të gjithë pritnin që unë të filloja. Vështroja garzën dhe mundohesha ta matja largësinë me sy, po ndërkaq vërtitja revolverin në dorë për të dëbuar shqetësimet e fundit. Më ishte ngulur në mendje ideja që kurrë nuk isha shquar si qitës. Vërtet do të qëlloja në largësi të vogël, po rreziku ishte i madh. Për një qime mund të prekja në brinjë dhe kështu siituata do të ndërlikohej keq. Ç'mund të bëja unë atëherë, futur në këtë shpellë plot lagështi? Me siguri aksioni do të dështonte ose do të shtyhej për më vonë, me pasoja të rrrezikshme.

— Nuk është mirë t'ju zërë dita këtu, shoku doktor, — më gjëmoi zéri i Martinit në vesh.

Unë mbloatha forcat dhe, duke i shpëtuar vështrimit vetëtitës që më vinte nga poshtë, thashë:

— Asnjë lëvizje!

Ngrita dorën dhe mata për herë të fundit largësinë me njërin sy. Kishte ardhur ai çast që s'priste më. Si u ngopa me frymë, ngulita dorën në largësinë që m'u duk e përshtatshme dhe vura gishtin tregues në këmbëz. Ndjeva që isha shkarkuar krejt nga dridhjet dhe atëherë kuptova se sa gjë e madhe është të përbajturit në çaste të tillë. Mbaj mend se ajo copë garzë m'u zgjerua para syve sa një çarçaf, ndërsa unë mundo-hesha më kot të shquaja atë që fshihet pas saj. Nuk di sa zgjati ky çast që m'u duk pa mbarim. Po qe vështrimi vetëtitës i Martinit, ai që më dha sinjalin të shtija. Unë nuk dëgjova krismën, po gjëmir e shpellës. Pashë flakën e kuqe dhe ndjeva të më mbyste era e athët e barutit. Pastaj më kapi veshi mbytyrazi thirrjen «Të lumtë!». Pashë që Fahredini i kishte duart të lira dhe u ngrit e afroi dritën. Për mua nuk ekzistonte atë kohë asgjë në botë, veç atij rrëthi të vogël, ku skuqte si trëndafil plaga e hapur e shokut tonë. Plumbi në goditjen e parë kishte kaluar tejtej lëkurës, pikërisht nëpër ato pjesë që kishim parashikuar. Gjaku qe aq i paktë, sa unë nga gëzimi harrova të kujdesesa. Kjo erdhi edhe sepse Martini jo vetëm që nuk u ndje fare, por, edhe pasi kisha qëlluar, nuk tregoi asnjë kujdes për vete.

Xhelaja hapi pincat dhe lëkura e tërhequr u lëshua në vendin ku ishte më parë. Unë i dhashë dorën Martinit dhe ai u ngrit ndenjur. Përshtypja u bë e plotë. Plumbi kishte «hyrë» përpëra në gjoks dhe kishte «dalë» prapa në shpatull.

— Të dhembë? — e pyeta.

Pak.

— Do ta ndiesh më vonë, kur të ftohet, — tha Xhelaja.

Martini kishte ulur sytë në gjoks, sikur të shikonte aty një qëndisje e jo një plagë të hapur.

— Në shenjë i paske rënë, doktor! Të faleminderit! — tha dhe ma vuri dorën në qafë e më shtrëngoi fort pas vetes. Unë, që e kujtoja veten aq të përbajtur, ndjeva të më ngroheshin sytë. Por asnjeri nuk më vuri re, sepse të gjithë i kishte hutuar gëzimi dhe përaqfoheshin.

Kur unë zura të merresha me mjekimin e plagës, Fahredini dhe Xhelova, sipas planit, dolën në sheshin e vogël para shpellës dhe shkrehën armë në ajër. Për disa minuta u bë një betejë e vërtetë: gjithë vendi shungulloi nga krisma pushkësh e automatikësh, nga bomba të llojeve të ndryshme. Shpella jonë lëkundëj e buçiste, sa thamë se do të na zinte brenda nga gurët e vegjël që binin orë e çast. Por unë e vazhdova punën i qetë. Pasi i bëra gjilpërën e dytë, u kujdesa për plagën. Për fat të mirë, gjaku sa vinte i pakësohej dhe kjo s'kishte si të mos më qetësonte. Veç kësaj, Martini nuk jepte asnje shenjë loddjeje. Përkundrazi, sytë i xixëllonin dhe shikonte gjithë gaz nga hyrja e shpellës, nga vinte batareja e armëve.

— Dëgjo, Martin, — nisi t'i jepte këshillat e fundit Fahredini, ndërsa unë, pasi ia kisha mjekuar plagën, po e ndihmoja të vishej. — Plagën nuk do ta ngasësh, derisa të të jepet rasti ta lash me raki, ose me ujë tëzier. Kështu, doktor? Kur të vesh në mes të tyre, mundohu të kollitesh, gjoja se të ka kapur plumbi në mushkëri. Pështyj gjak, duke gërvishqur pak mishrat e dhëmbëve. Këmishën do ta mbash kështu të gjakosur.

Dola jashtë shpellës dhe nga era që më ra ndjeva se isha djersitur. Pas disa orësh, për herë të parë mora frymë me tërë qenien time. Tani më ishte zhdukur ai ankth që më kishte kapërthyer gjoksin.

Dëgjova zërin e Fehredinit që urdhëronte për nisje dhe hodha sytë përpëra. Turbull horizonti po zbardh-te në lindje.

Kur hyra brenda, ata qenë ngritur. Xhelova mbante drithën në dorë.

— Ma bëni hällall, shokë, — tha Martini. — Ju mundova gjer këtu dhe ju futa në merak të madh, sidomos doktorin, — dhe më shtrëngoi fort dorën.

— Moç fol kështu, — ia priti Xhelioja, — po thuaj, më dhatë plumbin dhe tani po ikni...

Na kapi të qeshurit të gjithë dhe unë nuk di të them a ishte gaz i vërtetë apo bënim ashtu për të fshehur pikëllimin që na rëndonte para ndarjes.

— Kjo qe një detyrë e vështirë, që e kryem me sukses bashkarisht, — tha Fahredini pas heshtjes që pasoi. — Po merita e parë të takon ty, Martin. Tani që do të ikim me, shtrihu dhe fli ca orë. Trupi yt ka nevojë pér pushim.

Kur morëm të iiknium, u përqafuam me radhë me shokun tonë, por kësaj here, ndryshe nga hera e parë, lëvizjet e tij ishin më të kujdeshme...

— Të fala, — i murmuriti ai Fahredinit me një zë që mua më tingëlloi në vesh drithërues. Kjo ishte e vetmja herë që atë e tradhtoi digka.

I fundit mbeti Xhelioja. Ai shoi dritën dhe shpella u zhyt e tëra në errësirë.

Ne filluam të zbritnim shkëmbinjtë ngadalë njëri pas tjetrit. Pylli poshtë këmbëve qëndronite si një egërsirë e fjetur. Unë çapitesha pas shokëve në heshtje. Më kishte kapluar një ndjenjë e fortë që s'di se pse më përtërinte kohën e luftës. Ndieja sikur po kthehesha në prapavijë nga një betejë e rrëptë, ndërsa shokët luftonin alkoma në vijën e parë të zjarrit.

Disa ditë më vonë Fahredini më njoftoi se Martinin e kishin pranuar në bandë dhe se ishte fare mirë nga shëndeti.

1969

## Naum Prifti

### SHEBIU

Sa erdhi në batalion ai partizan i ri e trupmadh, pyeti me zërin e vet si bubullimë:

— A ka ndonjë Shebi këtu, o shokë? — Sytë e vegjël i shëtitë mbi kokat e partizanëve që ishin ulur në një lirishtë dhe priste me padurim të shihte kush do të ngrihej në këmbë. Na vajti mendja se kërkonte ndonjë të njohur, ose dikush do t'i kishte dhënë ndonjë porosi për atë që quhej Shebi.

— Jo, i tha komandant Agushi, — s'kemi ndonjë Shebi këtu. — Pastaj pati një çast dyshimi dhe pyeti. — Apo kemi dhe unë s'e njoh akoma?

— Jo, jo, — u përgjigjën shumë zëra njëherësh.

— As këtu, hë?! — tha me hajbi partizani i sapardhur, sikur deri atë çast të kishte shpresuar se pikërisht aty do ta gjente atë që kërkonte. Me një zhgënjim të sinqertë shtoi:

— Ej, dreq o punë, çfarë emri më kanë vënë! Plasë dhe s'po gjej gjékundi një adash.

Në batalion plasi gazi. Ja, kështu u prezantua Shebi Guralumi në batalionin tonë, në vjeshtën e vitit 1943. Aty morëm vesh edhe merakun e tij të përhershëm: të gjente një adash. Ky merak, si pa ikuptuar, u bë edhe yni. Në qdo fshat që shkonim, apo qdo repart partizan që 'akonim, pyesnim në kishte njeri me këtë emër. Shpresonim se do ta gjenim të paktën një, dhe atëherë me gaz të madh do të rendnim t'ia jepnimi lajmin e miqë shokut tonë, po përgjigjet vimin gati gjithmonë të njëjtë.

— Shebi? Jo. As e kemi dëgjuar tjetër herë këtë emër.

Dhe Shebiu ynë kordohërë me një zemërim fëmije thoshte:

«Si s'kam gjetur një adash, xhanëm? Çudi e madhe! A thua vërtet të mos ketë tjetër Shebi? Nishan qenkat unë?»

Por edhe pa atë prezantim jo të zakontë ne do ta mbanim mend ardhjen e tij...

Qemë ulur në një shesh mes një pylli me pisha, në faqen lindore të Voskopojës, palk më poshtë manastirit dhe dëgjonim komisarin që po na lexonte një teimë politike për zhvillimin ekonomik. Herë pas here bënte edhe ndonjë koment të shkurtër. Të tëra nuk i meritnim vesh, po diçka na mbetej në kujtesë nga ato që dëgjoni.

Qe një ditë e bukur. S'bënte as ftohtë, as vase; mbi kokat toma ai qelli i pastër, me atë kaltëri të tej-pashme dihe i Iartë si kurri ndonjëherë, tregonte se do të kishim disa ditë të ngrohta. Hailhat e pishave, ato që ndodheshin në kundërdritë, dukeshin të bardha si prej argjendi. Kisha shkuar me dhjetëra herë në pyll, por atë pamje s'e kisha vënë re. Diçka mahnitëse! Pisha me kristale të gjata, si gjilpëra akulli. Rrëshira e ngrirë nëpër lëvore dukej një grumbull hujesh të bardha. Në ajër dëgjoheshin zukatje bletësh dihe gjithë atmosfera kishte aromën e ëmbël e vellëse të pishave.

Papritur, nga shtegu që zbriste prej manastirit, da-

lluam dy veta që vinin drejt nesh, një djalë të vogël e një tjetër, përkrah tij, trupmadh e të lartë. Në fillim na u dukën si atë e bir. Vetëm kur u afriuan, vumë re se ai që na qe dukur si djali i vogël qe Lipja, korrieri ynë, i cili përparrat atij kollosi na kishte ngjarë më i vogël se zakonisht. Të dy u drejtuant nga komandanti.

I sapoardhuri ngriti dorën, që iishte sa një tra, mbi kokë e na pëershëndeti «Vdekje fashizmit». Pastaj menjëherë na bëri atë pyetjen që ju tregova pak më parë. Korrieri i zgjati komandantit një copë letër, si dukej, ndonjë rekomandim nga shokët e qarkorit.

Shebiu i mbante krahët hapur dhe bërrylat pak të thyer. Kishte mbathur një palë opinga me lëkurë lope e ato, përgjithësisht, ta tregojnë këmbën të vogël, po këmbët e Shebiut duke shin që atje tej që ishin jashtë mase të mëdha. Në sup mbante një paticëkë të shkurtër, e cila, në trupin e tij, ngjante së lodër kalamajsh. Në brez i varej një bohçe. Me sa dukej atje kishte mbështjellë drekën ose rrrobat e veta.

Komandanti e caktoi në skuadrën tonë dhe kjo na gjëzoi të gjithë. Si të mos gjëzoheshe kur kishe në skuadër një kollos të tillë? Dukej sikur armiqtë do t'i përmblidhët me dorën e tij të madhe e do t'i flakët tej.

Kur mbaroi mbledhja, pyeti ku ishte skuadra e dytë dhe u ul mes nesh këmbëkryq duke lëshuar pas-thirrma kënaqësie. «Ooh, sa mirë!» Dhe menjëherë zgjidi bohçen që mbante në brez e shpalosi cepat e saj.

— Shokë, ejani të hamë rrush!

Bohçja na qe dukur e vogël në brezin e tij, po në të mund të kishte tre a katër kilogramë rrush. Vetë nuk pranoi të hante.

— Kam ardhur i ngrënë, — tha duke qeshur.

Kishte një mënyrë komunikimi kaq të lehtë e të natyrshme, sa të vinte të besoje se e kishe njojur diikur më përparrë. Kudo i dulcej vetja si midis miqsh dhe kjo buronte nga çiltërsia që kishte. Atij çdo ndjenjë i lexohej në fytyrë, njësoj si fëmijëve të vegjël, po gjendja e tij shpirtërore ishte e ekuilibruar dhe zemërimi,

ashtu edhe inati, i kalonin shpejt. I gatshëm për çdo shërbim e i papërtuar për çdo punë, ai na e fitoi zemrën të gjithëve.

Shebiu qe si i gdhendur nga një skulptor që s'e di mirë zanatin apo që s'e ka përfunduar veprën. Ballin të kërcyer, sytë të vegjël e të futur thellë në orbita, faqet të futura, hundën të madhe, veshët llapushë dhe nofullën të zgjatur e që i shkonte për mrekulli atij trupi kaba. Pale kur qeshte! Zëri i buçiste nga gjoksi, cepat e syve i rrudheshin dhe në faqet i krijheshin gropëza.

Pas kapiitullimit të Italisë, batalioni ynë u vesh e u mbath mjaft mirë, vetëm Shebiu na mbeti pa këpucë. Të gjitha i rrinin të vogla. Komandanti i batalionit, shoku Agush, e dërgoi njëherë në Lavdar, aty ku ishte intendenca e qarkut, më e madhja në zonën tonë. Edhe prej andej Shebiu u kthyte pa këpucë.

— Nuk gjete? — e pyeti komandanti.

— Nuk gjeta. I provova të gjitha me radhë. Asnjë palë nuk më bënë... Të thashë unë, s'ka kallëp për këmbën time...

Nuk i kishte ardhur keq, madje ndihej edhe disi krenar që për të s'po gjendeshin këpucë.

— Po shqyr, nuk dola bosh. Më dhanë këtë, — dhe që poshtë kapotës nxori një mitraloz shars.

I ra shpirti rehat që kur hoqi patickën e shkurtër. Tani dukej tamam luftëtar, se mitralozi ujdiste për bukurin me shpatullat dhe supet e tij. E mbante për merak, e fshinte, e vajoste dhe bisedonte me të sikur të ishte qenie e gjallë.

— Mos më turpëro, dëgjove? Se të marr e të përplas e të bëj katërqind copash, nemcja e dreqt!

Pastaj kthehej nga ne e, si të donte ta zbuste qortimin e rëndë që i kishte bërë, niste e lavdëronte:

— Këta mitrolozat shars janë me nam. E ke vënë re si këndoijnë gu-gu-gu!

Pas dy muajsh u bë komunist se qe jo vetëm i ndershëm, por edhe trim. Për t'i bërë nder, ia ndërruam

vendin, e nxorëm pas skuadërkomandantit. Tani i takonte edhe nga arma që mbante. Kur Xhevít Shtiza u transferua në një kompani tjetër si zëvendëskomisar, ne mbetëm pa skuadërkomandant. Shoku Agush na mblo-dhi e na tha të propozonim një shok tjetër. Ne të gjithë, sikur të ishim marrë vesh, propozuam Shebiun.

— Mirë, — tha Agushi, — ashtu qoftë. Shebiu e bën.

— Ore horra, — tha Shebiu duke u kthyer nga ne, — në më propozoni për trupin, gabim e keni.

Që kur u bë skuadërkomandant, kujdesej veçan-risht për municionin. Gjumi natën nuk e zinte. Dihej se ne ishim gjithmonë ngushtë për fishekë prandaj do të bënte çmos për t'i gjetur. Asgjë s'kërkonte, veç fishekë. Sa gëzohej kur arrinte të merrte diçka më shumë se shokët. Njëherë na erdhia me një arkë llamarine në krahhë.

— Ia shkula Agushit, — tha duke e lëshuar në tokë, — bëmë ca fjalë, por ato u harruan tani, fishekët i fituam. — Dhe na shkelte syrin po me gaz fëmijëror.

Dhe shikoni, ore, i harxhon me kujdes! — Pastaj një hop i shkurtër zemërimi. — Ama, ju ta plasni shpirtin, për nder, sa, bini në fishekë dhe bjeru t'u biem. Nuk kam për t'iu lutur më komandantit, më vjen turp. Ta dini.

— Hë, mor Shebi, se s'po i kërkon sheqerka, po plumba për të luftuar. Edhe Agushi ç'do t'i dojë? Sermajë për dimër do t'i vërë? Ja, për ne i ka, — i thashë unë.

— A e di që e the mirë? Gjejini vetë, thotë Agushi... Sikur ne s'i kemi dhënë kur kemi pasur. Po kur s'm'u kujtua t'ia thosha... — u pezmatua një çast dhe pastaj sërisht një mendim fëmijëror. — Dale prisni, do vete t'ia them tani.

— Tani s'ka nevojë, kur t'i kërkosh herën tjetër...

Po më duket se edhe komandanti i batalionit, Agushi, e donte dhe nuk ia prishte këtij njeriu. E ndiente veten të detyruar kundrejt tij apo i pëlqente të shikonte

atë gëzim fëmijëror në fytyrën e madhe të Shebiut, nuk e di me saktësi.

Atë dijtë na tha:

— Edhe në luftë fisheku harxhohet me kët, se s'kemi fabrika ne, oj kokë! Dhe ta dini, fisheku i fundit ruhet. Se arma pa fishekë është si furkë, more, më e keqe se furka, le që s'ka pikë lezeti, por është edhe turp. Po ja të rrëthoi armiku papritur? Komunisti nuk dorëzohet i gjallë. Plumbin e fundit e ruan për vete.

Megjithëse e thoshte shpesh dhe me sinqeritet këtë frazë, ai plumbin e fundit nuk e ruajti për vete. Ashtu e sollën rrëthanat.

Në Operacionin e Dimrit batalioni ynë u ndodh në kushte shumë të vështira. Gjermanët dhe ballistët na i ngushtuan krahët dhe po përpinqeshin të na rrëthonin. Dulhej të kapnim patjetër lartësitë e Shkëmbit të Bletës dhe të hidheshim në krahinën e Mokrës, e ndërkohë të shkëputnim kontaktin me armikun që kishim në shpinë.

Komandanti i batalionit, shoku Agush, i tha Shebiut:

— Shebi, o bir, do të të ngarkojë xhaxhai një detyrë të vështirë.

— Urdhëro, xhaxha!

— Ti me skuadrën tënde do të qëndroni praparojë. Do t'i mbani ata qafirë gjer në orën katër, domethënë sa të erret. Po s'i mbajtët, e morët më qafë batalionin.

U shpërndamë po jo aq sa të humbni lidhjet.

Zumë vend. Qe një zebel me fletë bojëkafe të çngjyrosura prej kohësh nga bryma dhe nga të ftotët. Gjermanët po përparonin me automatikë ndër duar. I lamë të afroheshin dhe pastaj mitralozi i Shebiut kusi. Gjermanët ranë në tokë e filluan të shanin. Dreqi e di se ç'toshin.

E thyem sulmin e tyre katër herë, po s'qe e vështirë të kuptohej se qemë pak. Gjermanët ndërruan takтикë. Filluan të sulmonin duke zgjeruar krahët. Ne, atëherë, u detyruam të ndërronim vend.

Po i ngjiteshim malit duke luftuar.

Gjermanët i trempte errësira dhe nata e maleve tonë.

Dhe Shebiu e dinte këtë, siç e dinim edhe ne të gjithë, prandaj po mundoheshim t'i mbanim sa më gjatë, gjersa të binte nata.

Erdhi edhe një kolonë tjetër gjermane nga krahut i perëndimit dhe, kur të futej edhe ajo në betejë, presioni mbi skuadrën tonë do të shtohej akoma më shumë.

Pas nesh ngrihej një kokojkë, e cila zotëronte të dyja anët e luginës, ku shkonte një monopat i ngushtë.

— Të kapim kokojkën, — tha Shebiu, — atje mund t'i mbajmë më gjatë dhe prej andej kemi rast të sulmojmë.

Edhe gjermanët këtë qëllim kishin. Ora po shkonte dy dhe nata qe ende larg. Në luftë ndonjëherë mezi shkojnë minutat dhe jo më orët.

Zumë kokojkën që kontrollonte luginën dhe hyrjen në grykën e pérroit, prej nga disa orë përparrë kishte kaluar batalioni.

A do ta mbanim vallë gjer në orën katër, sa t'i jepnim kohë batalionit të largohej disa kilometra? Shokët na kishin dhënë fishekë më tepër se çdo herë tjetër, por ne një pjesë të mirë e kishim harxhuar. Shkrehnim rrallë dhe mundoheshim të qëllonim në shenjë.

Kapotat e murme gjermane po afroheshin. Sharsi i Shebiut kishte heshtur me kohë, ngaqë fishekët i qenë mbaruar. Luftonte me pushkë si dhe ne.

Ora po vente tre dhe Shebiu dukej i menduar. Unë e kisha pranë dhe e pyta si do të bënim.

— Gjer në fund do të mbahemi, — më tha ai.

Gjermanët përpinqeshin të na sulmonin përballë e anash, po ne skishim ndër mend ta linim kokojkën.

— Kur t'ju mbetet edhe nga një fishek, bëni gati bombat, — tha Shebiu.

Sulmin e fundit të gjermanëve ne e thyem me bomba. Ato shungulluan fort dhe vendi u bë tym e flakë një copë hërë, po situata jonë, pas harxhimit të bombave, qe bërë vërtetë kritike.

Të gjashtë shokët, dhe Shebiu shtatë, kishim mbetur vetëm me nga një fishek.

— C'më shikon? — më pyeti ai.

— Fisheku i fundit ka mbetur, — i thashë.

— Eee! Jo, or, jo, se nuk vrasim veten ne, kur kemi mundësi të vrasim edhe shtatë armiq.

— Po pastaj? — i thashë unë.

— Pastaj, hidhemi mbi ta, me qytë e bajonetë, kapim edhe nga një për gryke, e u bëftë si të jetë e thënë! Kësaj i thonë: gjer në fund. A thamë se do të qëndrojmë gjer në fund?

Ai irregulloi bustinën mbi kokë, mori nishan dhë qëlloi. Njëzet metra larg nesh u dëgjua një klithmë e imprehtë.

Më tej u bë ashtu si tha Shebiu. Ne sulmuam, u hodhëm nga shkëmbimjtë sipër gjermanëve dhe u përleshëm me ta.

— Mbi ta, more, mbi ta, — thërriste Shebiu me atë zërin e tij të fortë që i dilte nga gjoksi si prej një guve. Kjo thiirje ishte e lashtë, sa edhe vetë malet, dhe ato kushedi sa herë e kishin dëgjuar. «E mbë ta!» dhe malet, lugina, përrenjtë ushtuan me forcë duke përsëritur, si të gjallë, jehonën «Mbi ta, more, mbi ta!».

Derisa ra mbi dëborë, e pashë Shebiun duke u përleshur me gjermanët. Me atë trup prej kolosi godiste sa nga një anë në tjetrën me duar, me këmbë, me qytë, ushtarët që kishte përpara. Dhe kështu ka mbetur në kujtesën time.

1982

## Resul Bedo

### «L A R A S K A»

Nëna e Skënderit zbriti nga autobusi dhe mori rrugën që të conte në aërodrom. Ishte një ditë e kthjellët vjeshte. Qielli shkëlqente. Nuk kishte bërë ndonjëherë rrugë aq të gjatë me makinë nëna e pilotit. I gufone zemra. Shqipëria paskësh qenë më e madhe sesa e kishte përfytyruar ajo. Ekte nëna drejt rrugës së asfaltuar dhe sodiste kaltërsinë e qilli.

Nënë Selvia i përshëndeste të gjithë njerëzit që kallonin në rrugën e aerodromit, si t'i njihet prej kohësh. Ishte e para herë që vente në repartin ushtarak ku shërbente i biri, Skënderi. Dhe, sa më shumë afrohej, aq më shumë habitej me ata avionët e bardhë e të shkëlqyeshëm, që qëndronin përkrah njëri-tjetrit.

«Mos nuk jam në rrugën që duhet?» — tha me vete nënë Selvia dhe pyeti një oficer që po vinte drejt saj.

— Me leje, more bir?

— Urdhëro, nënë! — tha oficeri.

- Kjo rrugë, a të nxjerr në sheshin e aeroplani? Oficeri qëndroi një çast i heshur para saj.  
 — Nga vjen, moj nënë?  
 — Nga Korça, kam djalin...  
 — Cilin ke djalë? — e pyeti oficeri, duke iu afruar buzagaz.

— Skënderin... pilot është, iu bëftë nëna, fluturon në qiell me ballonë, —dhe nëna vështroi nga qielli, si ta kërkonte të birin në hapësirën e kaltër.

- Edhe unë pilot jam, bashkë me Skënderin... Oficeri ia mori trastën nga dora.  
 — Të çoj unë ta takosh. Skënderi të pret.  
 — T'u bëftë nëna! — tha gruaja dhe ia hodhi dorën në qafë oficerit.

Ai vuri re se nëna nuk e lëvizte dot dorën e maje, por i erdhë zor ta pyeste.

Ecën drejt aerodromit, kaluan disa ndërtesa, një urë dhe dolën anës fushës, ku qëndronte i veçuar nga të tjerët një aeroplan gjuajtës. Nëna e shikonte me kureshtje. Ishte e para herë që shikonte aq afér një aeroplan. Ngjyra e tij ndërronte nga ngjyra e të tjerëve, të shkruarat mbi të qenë të tjera, flamuri ndryshe nga yni, yjet të shumta dhe në ngjyrë tjetër. Ai aeroplan. nuk i pëlqeu aq nënës, i kujtoi diçka të vjetër; një gjëmim të rëndë dhe pastaj...

- Po ky çështë? — pyeti oficerin.  
 — Gjuajtës amerikan. E kanë kapur në qiell disa vite më parë.

- Kusin?  
 — Pilotët tanë.  
 — Shqiponjat e nënës! — tha gruaja.

- ...  
 — Qenka i zi si ato «laraskat».  
 — Cilat laraska?! — pyeti i habitur oficeri.  
 — Aeroplanët me kryqe. Eh, bir i nënës, keni qenë të vegjël ju atëherë, tre vjeç e kisha Skënderin. Si e shpëtova djalin, as unë vetë s'e di. Na qëlluan. Mua më plagosën në krah. Dhe, po të mos isha futur nën

qemërin e urës, do të më kishin vrarë me gjithë djalë.

Oficeri ngadalësoi hapat. Nëna vazhdoi:

— Më ngjaka edhe ky me ata, po ngjyrën e paska tjetër. Ata, kishin ngjyrën e plumbit, dhe në krah mbabin kryqe si të varreve. Ashtu ishin...

— Të një marke janë, nënë.

— Atë ditë, kur aeroplanët vranë ç'gjetën, njerëz dhe kafshë, nuk i thirri më njeri me emrin e tyre, por me emrin e këtij shpendi.

Duke folur kështu e duke ecur, nëna herë pas here kthente vëshitrimin nga aeroplani i braktisur.

— Po ajo fushë atje? Ç'është aq e sheshë?

— Ajo? — oficeri vuri buzën në gaz. — Ajo quhet «pistë». Andej ngrihen aeroplanët në fluturim.

— A, aaa! — tha nëna. — Skënderi atje do të jetë. Po ku janë aeroplanët?

— Durim, nënoke, do ta gjejmë Skënderin.

Nëna sodit pistën. Tej qëndrojnë në radhë aeroplanët gjaujtës. Pastaj i drejtohet oficerit:

— Nuk ma merrte mendja, të kishim kaq shumë ballona. A ngrihen të gjitha në qiell?

— Kur e do puna, të gjithë.

Diçka si një buçimë e bëri nënën të qëndronte në vend.

— Ç'është kjo, o bir?

— Alarm, nënoke, alarm! Ne jemi gjithnjë në gatishmëri.

Nëna u vrenjt. Kur bëhej alarm në fshat, do të kishte ndodhur diçka e rëndësishme në kufi. Po këtu? Cfarë mund të ndodhë këtu? Nëna kishte bërë një ditë rrugë me makinë për të ardhur nga Gramozi gjer në këtë qytet, ku ishte me shërbim djali i saj.

Një rrapiellimë e fuqishme çau ajrin; në fushë lëvizën dy gjaujtës.

— Do të ngrihen në qiell?! — tha nëna e hutuar.

— Ata u ngritën, ja, i shikon?

— Ku? — mundohej t'i dallonte ajo. Kur i kaluan

sipër, nëna pa krahët e tyre të hekurt, bishtin me flamin murin kuqezi dhe nën krahë yjet e kuqe. Dy avionë të bardhë, që shkëlqen nga rrezet e diellit, fluturonin përkrah njëri-tjetrit dhe ngjiteshin gjithnjë më lart, duke lënë pas zhurmën rrëqethëse të turbinave. Aeroplanët humbën shpejt në qiellin e pafund.

Nëna dhe oficeri vazhduan të ecnin drejt pistës. Nëna nuk fliste. E shqetësonte mendimi se diçka kishte ndodhur. Pyeti edhe një herë oficerin:

- Mos ka ndodhur gjë?
- Diçka ka ndodhur, moj nënë, — tha oficeri, — duhet të qëndrojmë.
- Po Skënderin, ku e kam Skënderin?
- Skënderi u ngrit në fluturim.

Nëna picërrroi sytë, vështroi nga qielli. Qëndroi gjatë ashtu...

— Skënderi i nënës!

Sytë e nënës picërroheshin gjithnjë e më shumë. Zhurma kishte humbur në largësi. Pastaj, nga një aparat që ndodhej aty afér, në një tryezë, e cila ishte e rrëthuar nga disa oficerë, iu duk sikur dëgjoi zërin e të birit. Në të vërtetë u dëgjua papritur zhurma e aeroplanit dhe zëri i pilotit.

— Kush flet kështu? — pyeti nëna.

— ...

— Cilët, ku janë?

— Aeroplanët tanë i janë afruar «aeropanit armik» — foli si me vete oficeri.

Nëna u vrenjt në fytyrë, iu kujtuan aeroplanët me kryqe...

— Mos m'i ndodh gjë djalit! Larg qoftë! — tha me zë të ulët.

Dëgjoi përsëri të vinin nga qielli në tokë fjalë të tjera.

— E kapën, nënë, e kapën.

— Kë?

— «Armiikun» e kapën.

Nëna, e hutuar, dëgjon oficerin, dëgjon edhe zërin që vjen nga qielli i pafund në tokë:

— Po e sjellim në aerodrom, — iu duk se i folën nga qielli.

Oficeri, që gjer në atë çast kishte ngelur si i ngurosur, me vështrimin nga qielli, kur pa aeroplanët, thirri me zë të lartë:

— Erdhën, nënë, i shikon?

Nëna vuri dorën në ballë që t'i shquante më mirë.

— Ajo e zeza është «laraska e huaj», e shikon si e kanë futur në mes?

— Sa e madhe, virania! — pëshpëriti nëna.

Kur aeroplanët u ulën në tokë, një pilot vrapi dhe i raportoi me zë të lartë komandantit.

Oficeri, që e shoqëronte nënën e Skënderit, i tha diçka në vesh një shokut të tij aty pranë. Ai vrapi shpejt, iu afroa grupit të pilotëve që ishin mbledhur rreth komandantit dhe i pëshpëriti Skënderit:

— Të presin, Skënder!

Skënderit i qeshi fytyra. I shkoi mendja menjëherë tek e éma. Ai e priste të vinte.

Nëna, tanimë ishte e qetë. Sodiste me kureshtje ata dy avionët e bardhë që kishin çarë qiellin dhe kishin kapur «laraskën e zezë». Ajo i thoshte oficerit aty pranë:

— Tani e shikon nëna pse nuk vjen më në fshatin tonë laraska e zezë.

Oficeri vuri re atrimin e Skënderit.

— E, njeh atë, nënë?

— Nëna, e papërmbaritur, thirri:

— Skënder, biri i nënës!

Piloti vrapi drejt saj...

Sotir Andoni

DHËMBËZA E FUNDIT

Ichte një natë vjeshte, mbante erë fletë hardhie e aromë rrushi. Ne të dy me Xhevatin ishim shtrirë në mes të vreshtit, por s'kishim as kohë e as mend t'i ngjeronim kokrrat e ëmbla. Heshtje, qetësi, errësirë. Ndi-hej nata e thellë e më dukej sikur toka ishte shtrirë sa gjatë gjerë në shpinë dhe merrte frymë nëpër fletët e hardhive që shushuronin aq ëmbël, aq butë.

Mesnatë!

Këtë fjalë e pëshpërita unë pasi i hoqa xhamin sahatit të xhepit dhe përkita gishtérinjtë në akrepat e tij.

— Xhevat, — i fola shokut, — vajti ora, nisemi!...

Kur u quam, fërgulluam, por të ftohtët nuk e ndienim, sepse ishim djem të rinj, unë sintatëmbëdhjetë dhe ai tetëmbëdhjetë vjeç.

Dhe të dy ishim zbulues të batalionit. Detyra jonë ishte jo e zakonshme. Njoftimi që pati ardhur në shtabin e batalionit thoshte: *Kolona gjermane do të kalojë natën e ardhshme në sektorin tuaj...*

Batalioni ynë kishte zënë vend në kodrat shkëmbore përmbi qytetin e vogël, kurse shtabi ne na kishte dërguar pér zbulim. U zvarritëm një copë herë nëpër vresht, pastaj hymë në disa bâhçe me lakra të bardha, kaluam një tel me gjemba, disa ferra e driza. Ishim brenda në qytet. «Pas mëje, — më pëshpëriti Xhevati, — e gjeta...»

Zgjata, dorën e nëpër errësirë kapa pushkën e shokut tim dhe bëra pas tij. Ecnim të dy krah pér krah, ngadalë dhe në heshtje të plotë. Mbaja më dorë kondakun e pushkës së shokut dhe menjëherë m'u kujtua se Xhevati gjatë gjithë kohës, që kur pati dalë partizan dhe gjier atë ditë e kishte përdorur kondakun e pushkës si çetele. Pér çdo ditë që kalonte në luftë, ai shënonitë në kondak një shenjë duke prerë njëfarë dhëmbëzë me thikë.

— Këtu është kopshti i dajës, — më pëshpëriti edhe një herë Xhevati.

Trokiti ngadalë në një dritare të vogël nga ana e pasme e shtëpisë. Në herë, dy, tri. Mezi na u përgjigjën.

— Dajë, si jeni, mo?...

— Ti, Xhevati, je?

— Unë.

— Mirë jemi, mirë.

— Po ç'kemi këtej, o dajë? Ç'duket?

— Erdhën gjermanë të tjerë sot në drekë, thonë se po thyejnë qafën.

— I pe ti vetë? Dëgjove gjë të sigurt prej gojës së tyre?

— I pashë. Po pér të dëgjuar... ikim, kështu thonë të gjithë.

— Si duken nga surrati?

— Janë të mërzitur dhe të egër, u janë bërë turinjtë si të derrave, do të shporren.

— Po ç'keni një zhurmë atje brenda?

— E kemi gjënë e gjallë në ditë të hallit, nuk na

lénë t'i nxjerrim jashtë, u kemi shtënë ca lakra tē bardha pér tē ngrënë.

— O dajë, po andej nga fshati, nga shtëpia ime, si janë?

— Mirë, mirë, dje ishte këtu Inxhia.

— Po nuk më thua, ata gjermanët ku janë pérmbledhur?

— Sipér nga ana e fshatit nuk ka, janë mbledhur që nga Cezmat e Zonjave e poshtë, ka çadra shumë, sidomos rrëth bashkisë. Po ju ejani brenda!...

— Jo, jo, kam edhe një shok.

— Po eja me gjithë shok!

— Tjetër herë, dajë...

Dhe përsëri u nisëm nëpér bahçet me lakra tē bardha.

Pasi u zvarritëm ndonjë gjysmë ore, duke kaluar nën hundët e gjermanëve, arritëm në shtabin e batalionit dhe njoftuan.

Kur dolëm nga llogorja e shtabit, kishte filluar tē binte shi. Komandanti na tha:

— Ju, zbulues, shkoni në llogoret e kompanisë së dytë dhe mos u largoni që atje, mund tē niseni përsëri...

Hipëm mbi një majole. Tej shtrihej Devolli i tërë, por errësira ishte e thellë dhe shiu që binte dukej tē ishte i përzier me mjegull. Nuk shikoje sikur tē ta bënim xëc në sy.

Gjer këtu erdhi një zhurmë e papritur, një zhurmë e tèrbuar, e egër dhe me rrapëllimë. Nga gryka e Cangonjtit, që nën rrëzën e malit Ivan, po vinte këtej një kolonë gjermane.

— Ja, ky është bishti i gjermanit, — tha Xhevati me shaka.

Nëpér natën e thellë, autokolona gjermane hyri në Bilosht. Motorët nuk u fikën, u dëgjuan tē tjera zhurma, shpërthime, shkëndija, zjarr. Dukej sikur gjermani po hidhët në erë çka mundte.

Në këtë çast plasi lufta. Hynë në veprim edhe tē katër mortajat tonë tē rënda. Pastaj barazhet e mitra-

lozave mu në hyrje të qytetit. Tanët sulmuani. Por nuk kaluan as dy minuta, kur edhe gjermani na u përgjigji. Armiku e kuptoi menjëherë se po e qëllonim me mortaja gjermane. Filluan gjëmimet e artilerisë. Ne u ngulëm thellë në istikamet tona. Autokolona nisi të dilte nga qyteti, kaloi shpejt e shpejt nga dy kilometra, kur kompania jonë e tretë aty në xhade hapi zjarr.

Tani betején e shihje si në pëllëmbë të dorës. Krismaat dëgjoheshin të thata, herë-herë hynte ndonjë copë mjegulle në mes, flaçkët zhdukeshin ose dukeshin të zbehta e përsëri gjëmonte e buçiste gjithë Devolli.

Breshërítë e mitralozave gjermanë! Në çdo pesë plumb një dumdum. Të gjithë plumbat dukeshin si peshq të kuq, kurse çdo plumb i pestë dilte blu pérzier me të gjelbër. Dhe këto breshëri dilnin nga tanket e nga autoblindat.

Vija re se qitjet e armikut kalonin nganjëherë edhe kuturu, përpjetë qiellet, si ndonjë shatërvan i çrrégullt me ngjyra.

Edhe drejt nesh vinin gjyle, por ato iknin larg e tutje, malit përpjetë. Papritur dëgjuam që na thërritnin:

- Hej, shokë zbulues, Xhevati, Nure!
- Këtu jemi, këtu!
- Ejani shpejt!
- Urdhër, shoku komisar!

Ishte komisar Ndrekova. Por as dallohej fare. U takuam duke bërtitur nëpër përcëlliën e shiut. Ai na tha:

- Kemi pesë shokë të plagosur, duhet quan në Vërnik, e dini rrugën?
- E gjejmë, shoku komisar.
- Nisuni!
- Po këta gjermanët, shoku Nreko, sikur janë pirë sonte... si qëllojnë këshitu kuturu?
- Nuk janë pirë, — gjeti kohë e na tha ai, — por e kanë fajin topat e tyre, vollën e vollën zjarr dhe tani u janë ngrënë viaskat e u katandisën si gojë pa dhëmbë. Këtij i thonë zjarr i çakërdisur. Nisuni!

Kur zbritëm nga mali shkëmbor, vumë re se rrugen nuk po gjenim dot në atë terr të plotë.

— Xhevat! Rruga e pret malin si brez, oburra në zvarritje!

U kërrusëm nëpër errësirë duke ecur me duar e me këmbë, atëpjetë, me hundë pas nesh dheut. Pas nesh vinin sanitariët me barelat.

— Pas nesh, shokë!

— More, pas jush... po ku, se?

— E gjetët rrugën?

— Do ta gjejmë.

Pushkët na ngatérroheshin nëpër këmbë e nëpër shalë, kapela nuk e di nga më iku, kërrusu, kërce, hidhu herë majtas e herë djathtas me gishterinjtë nëpër gurë të thepisur, nëpër gjembaçë e ferra.

Te një vend kapa diçka të ngritur dhe të fortë. Bërtita:

— Hë! Hë! Xhevat, gjeta një gur që tregon kilometrat, këtej...

Shiu u dendësua, bataretë nisen të kuismin më fort e zhurmat i hynin grykës së Vërnikut. Një shkëpërderdhje e tërë gjëmimesh dhe shiu. Pastaj u bë edhe më keq. Natyra silkur nisi të luftonte me barazhet e topave gjermanë. Topat rrithnin qiellin, por edhe qielli nisi të qëllonte. Kjo na erdhi për hesap, sepse nëpër vetëtimat e rrufeve nisëm të dallonim rrugën. Në atë gjëmim të përgjithshëm, kur lufta kërciste në tokë e në qiell, sosëm në Vërnik. Ishim kthyer në trupa të qullur e të baltosur kokë e këmbë. Disa fshatarë kishin dalë te një korije e mbanin vesh. Kur njohën zërat tanë, na u afruan. Ishim aq të lodhur, sa nuk nxirnim dot fjalë nga goja. Nuk e di sesi hymë në një bazë. Të plagosurit i mori në dorëzim njësiti i fshatit. Mbaj mend një zjarr të mekur, të cilit iu hodhën shkarpa të thata, pastaj u dukën trarët e zinj të tavanit, disa çorape leshi varur nëpër ta, një magje, një hu ku ishte ndehur mish pastëрма. Nuk e di sesi i nxora rrobat aq shpejt, me ca lëvizje të vështira, mekanike, i

përgjumur dhe pastaj... Pastaj nuk mbaj mend asgjë.  
Dikush po më tundte nga supet.

— Ngrihuni! Çohuni! Fitore!

Të ngrihesha dhe të çohesha e kuptoja, por kjo fjala  
«fitore» pse hynte këtu!

Fitorja kishte ardhur!

Po. Ashtu kishte ndodhur.

— Ngrihuni, shokë, batalioni hyri në qytet!

Na u hapën sytë. Dhe me t'i hapur sytë, një letër  
nga komisari: sa hodha një vështrim në të, kuptova se  
për ne me Xhevatin nuk do të kishte as lule, as fjalime  
e as qytet të çliruar, as njerëz e as farefis që na pris-  
nin atje pér t'u takuar ditën e parë të fitores.

*Hymë në qytet, — na shkruante komisari, — gjermanët thyen qafën. Por ka disa orë që artileria gjermane po qëllon vazhdimishl kuturu dhe në hava që nga toka greke, matanë maleve të Viçit. Hidhuni andej, hetoni çka ndodh dhe kthehuni me njoftime të sakta. Komisar Ndrekaja.*

Korrierët që na sollën këtë letër, futën në çantat  
tona ushqime të kapura gjermanit dhe na uruan rrugë  
të mbarë.

Përsëri binte shi e kishte mjegull.

Sapo dolëm në majat e Vëmbellit dëgjuam gjithë  
atë rrrokopujë që po bënte gjermani. Gjylet vërviteshin  
e fishkëllenin nëpër qiell e nëpër mjegull, iknin nuk e  
di se ku, larg maleve të Moravës dhe fushës së Devo-  
llit.

Xhevati më foli:

— Na e mori të keqen gjermani, e fituam luftën,  
o Nure!

— E fituam, o Xhevo!

— Ama të fut njëherë këmbët dhe damalugun në  
tokën time, pa deti kos le të bëhet.

— Do t'i futim, Xhevat.

— Ore Nure!

— Hë!

— Po si t'ia bëj unë sot! Ti e di, gjatë gjithë

luftës kondakun e kam bërë çetele, kam shënuar në të  
me dhëmbëza çdo ditë partizane, po sot që mbaroi  
lufta?

— Sot duhet ta shënosh në çetelen e rindërtimit  
të vendit, Xhevat...

— Mirë e ke ti, ashtu duhet.

Dhe qeshëm të dy.

Rruja plot me gurë e shkrepë të kuq, driza bu-  
shi e driza dëllinje. Qiell i zi dhe mjegull e dendur  
dhe përmbi të gjitha fishkëllimë gjylesh.

Kur kapëm majën, anembanë nuk dukej asgjë.  
Rrallëherë zvarritej ndonjë mëngë e mjegullës dhe du-  
kej turbull ndonjë fshat, një përrua, një koriqe gjysma-  
ke. Pastaj përsëri mjegull e tym. Por veshët na u shur-  
duan më keq. Artileria gjermane qëllonte më me  
ngulm dhe malet dridheshin nga gjithë ato rrapiellima  
e dyndje të ajrit.

— Ku ndodhemi vallë?

— Kufirin duhet ta kemi kapërcyer me kohë, Xhev-  
at, këto janë fshatrat e grekut, ja, këtu duhet të jetë  
Smërdeshi.

— More, po ti i ditke më mirë se unë që kam qe-  
në...

— Të thashë një herë, kam dëgjuar shumë gjëra  
për këtej, këtyre maleve kanë luftuar kapedan Dellçevi  
e kapedan Çakallarofi kundër turkut.

— C'janë këta?

— Komitë maqedonas. Bile di se njëherë, këta ko-  
mitët e Maqedonisë ftuan në ndihmë edhe Themistokli  
Gërmjenin...

— U vajti?

— Posi, me gjithë çetën bile.

— Demek mbaroi lufta, Nure.

— Kjo që dëgjojmë, është e fundit.

— Atje në fshatin tim s'di se si do t'ia bëj me  
aga Sadushin.

— Po pse?

— Nuk e di derrin, nuk e di nga i rrabin barqet.

Po kokën kam për t'ia ngrënë, qenit! E di ç'na punoi?

— Hé...

— Mbetëm keq ca vjet më parë. I hyri tim eti dhe i bleu livadhin e vetëm që kishim. Babai nuk deshi, por e keqja, dhe agai e gjeti ditën. «Po me një konditë, o aga, — i tha babai. — Mos e bëj për fjalë, se më vjen turp pa, kur të vijë koha e korrjes së barit, do ta korr vetë e ta sjell barin gjer në shtëpi. «Dakord». Këtë fjalë e mbajti agai për tre vjet. Të katërtin na e ktheu. «Pse e ktheve, o aga?» «E ktheva se je bërë njësh me kuqalashët bashkë me tët bir dhe doni që të na hidhni me këmbë përpjetë.»

Hapëm çantat të hanim bukë, gjithnjë duke ecur përpjetë shkrepave me gurë. Kuti konservash gjermane, bukë e zezë gjermane prej thekre dhe ujë gjerman, ca si shishe të vogla me ujë e sodë.

— Këta gjermanët kanë erë tjetër.

— E, o Nure, e ke vënë re edhe ti?

— E kam vënë. Gjermanët dhe plaçkat e tyre mbajnë erë si temjan, si squfur, diçka si barut e naf-të të përziera bashkë...

— Po, po, ashtu. Kurse pipinot kishin erë tjetër. A, lëre c'më ka gjetur njëherë belaja mua!

— E... krerët e italianëve, oficerët, mbanin erë livando, sepse plaçkat e oficerëve ishin të lyera me lëng trëndafili. Kurse ushtarët mbajnë erë makarona e gjalpë margaritë a si i thonë.

Qeshëm të dy me Xhevatin.

— Lëre, o lëre, do të kemi se ç'tu tregojmë kala-majve pas lufte.

Rrugë e gjatë. Nisëm të vareshim tatëpjetë Maleve të Vicit. Gjithnjë shkëmb e gur, dëllinja, driza, mjegull, shi dhe mbi të gjitha bombardim i rëndë i artilerisë gjermane. Më tha Xhevati:

— E sheh gjithë këtë shkëmb e gur... Këtu është mbretëria e gjarpërinjve, në behar këtu të çan gjarpë... ri...

Një zhurmë përpara. Qëndruam në vend.

— Kujto qenin, rrëmbe stabin, — tha Xhevati, —  
pa nuhat edhe ti...

Nuhata e ngrita supet.

— A nuk të mban erë makarona?

— Jo, s'më mban asnjë erë.

Papritur, që nga mjegulla na doli një njeri. Ishte një italian i veshur mos më keq, duke tërhequr pas një mushkë.

E dinim se gjermanët i mbanin italianët pas si robër dhe hyzmeqarë. Sa na pa ne, ngriu në vend. Pastaj, kur ne po e shihnim pa të keq, na u lëshua sipër:

— Partixhani, mama mia! Gjermanët janë atje poshtë...

— Mirë, mirë, po ulu atje dhe na trego!

Ai ishte copë e trokë. Na lutej të mos e vritnim, na lutej ta merrnim me vete. Na hapi portofolin dhe na tregoi nënën, motrat, portokallet e Italisë dhe portin e Brindisit. Hoqi mënjanë xhaketën dhe na tregoi kë mishën.

— Nuk e kam të zezë, nuk jam fashist.

— Mirë, po pa na trego, c'bëjnë gjermanët aty poshtë, sa janë e përsë shtien?...

— Partizanët, — tha italianni, — kanë hedhur urat në erë e gjermanët nuk i tërheqin dot depot me municione. Prandaj kanë futur artilerinë në mes të depove me armë dhe bjeri t'i biem, qëllojnë si të tërbuar nga të mundin e si të mundin...

— Ashtu?

— Po. Nuk ju gënjej, do t'ju shërbej, vetëm merrmëni me vete në Shqipëri, atje ka njerëz të mirë dhe bulkë, unë jam djalë i ri, punoj dhe fitoj bukë... Më jepni fjalën...

U nisëm, ai përpara, ne pas tij.

Rrobat na kullonin ujë, flokët më ishin lëpirë e më ishin shtruar gjer mbi hundë. Ujërat më rrithnin në grykë e nëpër trup.

Më në fund dolëm në një cep të pylliit. Pritëm një

copë herë. Duhej sikur artileria po shkallimonte tokën. Tani topat i kishim fare pranë, kundërmonte barut, leckë e djegur dhe squfur. Erë gjermani. Fryu era dhe u hoq një copë mjegull, u bë sikur rripej ndonjë katalan përrallash e pastaj vështruam... Në një pllajë të pjerrët ishte një korije dushku me tokën gurishte, në mes të korijes nga njëqind e ca topa vendosur në formë gjysmërrethi e në mes të atij gjysmërrethi, ishte një depo e stërmadhe gjylesh. Ushtarët gjermanë, nëpër shi e nëpër të ftohtë (ata që ishin më afér topave), kishin hequr xhaketat, kurse shërbyesit e topave ec e jak me ca si tezga duarve duke afruar gjylet. Që nga gjysmërrethi qëllóhej drejt tokës sonë, drejt Maqedonisë e fshatrave të grekut. Predhat binin fushave, kadrave, fshatrave.

— Këtu duhet bërë një punë, — më tha Xhevati.

— Çfarë?

— Ta gjejmë mënyrën dhe t'i kallim zjarrin asaj depos me gjyle. Mbarojnë municionet dhe ata s'kanë me se të shtien më...

— Po si kallet ai zjarr se?...

— Shohim e bëjmë.

Xhevati kafshoi buzën e poshtme dhe zuri të men-dohej. Italiani dridhej nga të ftohtët dhe vazhdonte të na lutej:

— Mos më lini këtu, jam djalë i ri, do të punoj

...

Xhevati ngriti kryet e tha:

— Unë, o shoku Nure, do të bëj një punë, sa të bjerë nata... do t'u vete gjer atje... Ata qenër po përvëlojnë fshatrat... Kushedi sa të pafajshëm do të vriten në popull...

— Po të shkosh ti, do të vij edhe unë...

— Jo, jo, ti do të qëndrosh këtu... ka rregulla lufta.

Më vështroi në sy dhe ndoshta nuk deshi të më thoshte troç se ai ishte skuadërkomandant në kompani.

— E pastaj?

— Ti me italiianin më prisni këtu, po të jap dylbinë, ti më jep bombat e dorës që ke. Pa u kthyer unë mos u nis, në mos për një orë, aty nga mëngjesi unë jam këtu. Dakord?

«Dakord!»

Xhevati kontrolloi pushkën, e fshiu mirë, ia përkëdheli kondakun dhe unë edhe një herë i pashë shenjat në çetele. Ndoshta donte dhe dy sahat që të bëhej natë.

— Kështu, shoku Nure, më prit këtu... Artilleria e atyre kushedi sa dëme po bën nëpër fshatrat e pafajshme!...

— Këtu, Xhevati... Po hap sytë...

Më bëri një shenjë me dorë dhe humbi nëpërmjegull.

Italiani përsëri nisi të më çante kokën. Kishte hallin e vet, kurse mua, më dukej se kisha përmbi shpinë shokun tim, Xhevatin. Çfarë do të bënte ai, si do ta bënte, si do të kthehej, a do të kthehej!

Era fryu më me tërsellëm. U bë më e reptë dhe më e fortë. Mjegulla nisi të shpérndahet, artilleria gjermane nuk pushonte. Tytat e gjata të topave i njomte dhe i ftohte shiu dhe ata nuk kishin pushim. Vështrova edhe një herë andej. Arkat e mëdha me gjyle rrininë stiva tepër të larta. Topçinjtë gjermanë herë pas here futnin nëpër tytat ca paçavure të gjata e fshin zgjyrën. Pas çdo qitjeje dukeshin gëzhojat e verdha prej tunxhi, si dhelpra verdhashe, tek kërcenin prapa, lëshonin avull e tym e përplaseshin përtokë.

Vura dylbinë që të shihja më mirë. Nëpër Caisin me një sy e me një kryq shifrash në xham, dukeshin gjermanët fare afër. Njiheshin hundët e tyre si fëgka, çizmet prej lëkure gjer në mes të pulpëve. Trupa të shëndoshë, djem të gjatë. Në një çast sikur më erdhë gjer në vesh një urdhër i shqiptuar në gjermanisht me një zë të egër e të thekshëm. Pastaj ikisma e krisma gjithnjë. Trupat e zhveshura të gjermanëve herë pas here më dukeshin si të gjelbër e me ca ngjyra

blu. Pastaj e kuptova se kjo vinte prej lenteve të dylbisë.

Zuri të më brente përbrenda. Nga u zhduk Xhevati? Po sikur të përpigjet ballë për ballë me rojat? Edhe mundet, mbasë e qëllojnë dhe e vrasin dhe unë kurrë nuk kam për ta marrë vesh fundin e tij. E si mund të dëgjosh të shtëna pushkësh nëpër atë rroko-pujë?

Italiani nxori kapelen e tij (njëfarë republike prej alpinë), dhe deshi të ma vinte në kokë.

— Ik, dreq, nuk e dua, mos m'u lëpi kështu, ta dhamë fjalën e pilkë...

I thashë «ta dhamë fjalën», sepse kështu më dukej, sikur e kisha Xhevatin atje. Por...

Papritur mali u drodh, me gjithsej, sikur u përplasën atje kushedi sa rrufe! Nuk ishte dridhje topash, nuk ishte nga qitjet e artilerisë! Ajo buçimë dhe lëkundje ishte si një tërmët i fortë, i rëndë. Pastaj një krismë e jashtëzakonshme, një buçimë e lemerisur. Nën shtytjen e ajrit u përplasa përtokë, ndjeva sikur diçka më goditi mu në bark, pashë nëpër qiell disa fluturime e vërtitje trupash pa formë, tym, flakë, fshkëllima të frikshme nëpër qiell ...

Hodha sytë nga gjysmërrethi i artilerisë gjermane... Në vend të atyre që ishin disa çaste më parë, atje dukej tani njëfarë grope si humnerë, një truall i rrënuar, i çarë, i përbysur, copëra hekurishtesh e gryka topash të çapëluar, të hedhur këmbëpërpjetë... Nga fundi i asaj grope diçka përzihej e llokoçiste... po dilte ujë i zi, i turbullt, kurse anembanë pylli e korija kishin marrë zjarr e po digjeshin... Tym e flakë!

«Po Xhevati? Ç'u bë Xhevati?»

Ngela atje si gur varri. Italiani qe shtrirë përtokë dhe po dridhej, më shihte në sy. Por ai kishte qenë edhe alpin, edhe artiljer. E pyeta dhe m'u përgjigj. Por përgjigjen e tij unë nuk desha ta besoja. Zura kokën me duar.

Dhe në atë qetësi që u vendos, u dëgjuan disa

fishkëllima të quditshme. Italiani ngriu në vend dhe më shihte mua. Nuk kuptonte asgjë. Nëpër flakët e duashkerës fishkëlliunat shtoheshin.

— Ki mendjen, — i thashë alpinit, — ruhu!...

Ai buzëqeshi hidhur e ma ktheu:

— Tani s'kemi përse të ruhem, atje u bë kasaphanë, nuk mbeti njeri i gjallë...

— Jo, jo, — i thashë, — këta që fishkëllejnë janë gjarpërinj... Këtu vendi ka shumë të tillë, kanë qenë strehuar më tokë për dimërim, por zjarri po ua djeg lëkurën, i zgjoi nga dimri e po i përvëlon... dëgjo si përpëliten...

E lashë italianin të më priste aty dhe zbrita tatëpjetë, por ai m'u qep pas, kishte frikë se e lija atje. Më kishte marrë koka zjarr e nuk pyesja fare përrrezik e për armik. Nisa të thërritja: «Xhevati! Xhevati!... — por askush nuk më përgjigjej.

Mora rrugën tatëpjetë, fishkëlleva, bërtita, thirra përsëri emrin e Xhevavit. Asnjë përgjigje. Vetëm gjarpërinjtë po digjeshin e fishkëllenin. Prita derisa ra, natë, prita gjithë natën e gjithë ditën. Por qe një pritje e kotë. Xhevati nuk u duk më.

Dhe unë e kuptova të vërtetën e madhe, të rëndë e të zezë. Atë ditën e parë të çlirimt dhe atë ditën e fundit të luftës, ai në kondakun e pushkës dhe të jetës së tij kishte shënuar dhëmbëzën e tij të fundit.

1978

## **Shevqet Musaraj**

### **MAUZERI**

Edhe vdekjen e priste Breshan Lara, por që vajza e tij të dilte partizanë pikërisht atë ditë kur ai po përgatitej ta martonte, këtë nuk e kishte shkuar dot ndër mend. Ku e gjeti kohën, e mallkuara? Të kishte shkuar njëherë në shtëpi të saj, pa atje le të bënte si të donte. Turpi ose nderi atëherë nuk do të ishin vetëm të të atit, por edhe të të shoqit e të vjehrri. Fundi, shtëpia e krushqve shtëpi partizanësh ishte...

Kjo arratisje kaq e papritur e së bijës ishte një damlla tjetër për Breshan Larën, më e madhe nga ajo e dy netve të kaluara, kur u shkul nga korija përmbi fshat e ra mbi kasollen e tij të dhive, sikur e drejtoi vetë i paudhi, një alamet shkëmbi sa gjysma e shtëpisë, që zuri nën vete dy dhitë më të mira: Kabadhën, që bënte vit për vit nga dy keca, dhe Verdhën-shytë me ato dy rrrezhdat nën grykë, të cilën e donte të thuash njësoj si çupën.

Atë natë Breshani s'kishte lënë zot e shenjt pa

sharë pér fatkeqësinë që i kishte rënë, por aty afër të gdhiri, kur vuri re se edhe nëntë dhítë e tjera kishin shpëtuar kot, vetëm pér «gabimin» e tij, se kishte harruar hapur derën e kasolles, u zbut pak e filloi ta ndreqte gojën edhe me zotin e me shenjtorët. Mirépo pas cazë, kur u kthye të merrte një sy gjumë, iu kujtua mauzeri që mbante fshehur pér ditë të zezë, në atë strofkën e posaçme nën strehë të kasolles. Dhe ja, tan, gjithë ajo pjesë e kasolles, bashkë me mauzerin, ishte shkatërruar nën atë shkëmb të llahtarshëm, të cilit, edhe sikur i tërë fshati t'i përvishej me vare e me qysqi, nuk i bëhej dot dermani. Qe ngritur përsëri si i prishur mendsh e kishte vrapuar te kasollja, me shpresë se mos, kushedi, fati i tij kishte bërë ndonjë mrekulli, por vuri kujën kur pa me sy se ç'kishte ndodhur. Shkëmbi kishte shembur e bërë pluhur nën vete gjithë atë pjesë të kasolles ku ishte fshehur mauzeri.

E shoqja s'la kusur që t'ia largonte dëshpërimin pa guxuar dot t'i shfaqte një dyshim të saj që, sigurisht do ta tërbonte Breshanin, por do t'i ngjallte edhe shpresën se mauzeri mund të binte ndonjëherë në duart e tij. Dhe, vente nga vente, e sillte gjithnjë fjalën tek ai ngushëllimi që bëjnë gratë zakonisht në raste fatkeqësish të tillë: «Pastë marrë të keqen e të zot...»

Kështu i kishte punët Breshan Lara atë mbrëmje, kur mori lajmin që e bija kishte dalë partizane. Dhe, ngaqë s'kishte kujt t'i ankohej, nxihej e vrenjtej në fytyrë më keq se ajo, palltoja e shajaktë që mbante veshur dhe gjithë vrerin që i mbështillej në grykë ia pérplaste së shoqes:

— Ti i dhe udhët e ujqve çupës, ti... Ti ia bëre mendjen veri...

Ajo ulte kokën e s'ndihej, sikur donte t'i thoshte: «Bjermë! E bëra unë këtë faj.»

Dhe, ç'është e vërteta, edhe krejt e pafajshme në këtë punë nuk ishte Shanikò Lara. Nga frika e ballisteve, që vinin shpesh në fshat bashkë me gjermanët dhe

s'kishin punë tjetër veçse të nxirrin maná pér trahaná, sidomos kur u zinte syri ndonjë vajzë të bukur, e kishte dërguar të bijën te të vëllezërit që banonin rrëzë malit, në mes të ca shkëmbinjve, iku nuk shkelte lehtë këmba e gjermanit dhe e ballistik. Tani i kujtohej mirë Shanikos se si e bija, para se të nisej pér te dajat, i kishte ardhur disa herë rrrotull strehës së kasolles ku qe fshehur mauzeri. Mos vallë ajo kërcure e kishte pasur me kohë ndër mend të dilte partizane dhë, më qëllim, e rregulloi punën që të merrte edhe mauzerin e t'et me vete? Kështu duhej të kishte ndodhur, kështu. Zaten një dyshim i vogël pér këtë çështje i kishte lindur Shanikos që atë natë kur ndodhi fatkeqësia e shkëmbit që ra mbi kasollen e dhive, dyshim të cilin nuk guxoi t'ia shfaqë burrit.

— Po mua më quajnë Breshan Lara, — lëvizi edhe një herë nofullat më me inat i shoqi. — Dhe ja ku po ta them shqip: Ose më sill çupën gjer nesër në drekë, ose ngarko edhe vetë plaçkat e shporru nga sytë këmbët!

Shanikojë vuri duart në kokë. Si ishte e mundur që i shoqi të arrinte gjer në këtë pikë?! Kaq fajtore të ishte ajo, sa, të meritonte ndarjen nga burri pas njëzet e ca vjetësh?

— Ti bëj si të t'hotë mendja, po nuk e ke mirë kështu, — guxoi më në fund të hapte gojë.

— Jo, moj! — shtrembëroi buzët Breshani dhe iu vërsul: Po si thotë ajo koka jote, si? Të turpërohem unë me krushkun? Me Jaho Thanën, që fshati e çmon dhe e nderon si burrin më të mirë të vendit? Të vete t'i them që kështu ma punoi çupa? Dhe ai të më pështyjë në fytyrë e të më thotë: «Jazëk të qoftë që s'qe i zoti t'i vije fre një copë çupe?» Hë, de, fol! Kështu mendon ti?

Tërë atë natë shtëpia zjeu nga të thirrurat e sokëllimat e Breshanit dhe nga rënkimet e së shoqes, që kishte plot njëzet e dy vjet në atë derë dhe po ndahej

përgjithnjë vetëm me një bohçe plaçkash në krah, ashtu siç dilet nga mundimi.

Në mëngjes fshati u gdhi me potere. Gjermanët e ballistët kishin lënë një pирg me të vrarë në një pritë partizane gjatë natës, nja dy-tre kilometra përtëj fshatit, dhe ishin thyer keq. Por qe hapur fjala se do të ktheheshin përsëri me fuqi më të mëdha për të nxjerrë ujë të zi në fshat. Tërë fshati po merrnin masa, kurse Larajt s'dinin gjë.

Shanikoja më bohçen në krah kapérceu portën e oborrit e po ecte kokulur, sikur kishte bërë ndonjë turp dhe kaq shumë e kishte humbur mendjen nga gjithë ato që i kishin ndodhur natën me të shoqin, sa s'merrte vesh fare se ç'po ndodhët rreth e rreth saj. Tej-tëhu, duke u mbështetur në një shkop të dëlli-njtë gdhëra-gdhëra, i vrenjitur e me vetulla të ngrysura, sikur i ishin mbytur gjemité, po vinte në Laraj krushku i shtëpisë, Jaho Thana. Le, po kishte vënë në brez edhe një kobure të madhe sa gjysma e shkopit.

«Erdhi i nëmuri, — pshëretiu me vete Shanikoja. — Mezi paska pritur të gdhihet, që të kërkojë llogari.» Dhe i iku gjaku kur mendoi se, nga të grindurit me fjalë në mes të pleqve, mund të arrinte puna edhe në vrasje. Apo s'kishte edhe i shoqi një kobure më të madhe se atë të krushkut, të cilën s'e hiqte kurrë nga brezi. Shanikoja i mendoi të gjitha këto vetëtimthi, por meqë s'kishte ç'udhë t'i jepte çështjes, u shti sikur nuk e pa krushkun dhe e la të kalonte pa i folur.

— Po ti, moj zonja krushkë, ku shkon kështu? — i thirri ky si me romuz. — S'paske as aganë me vete, pale...

Gruaja ngriu në vend. Me sa dukej, krushku po ia niste sherrit që këtu.

— Në lumiin që më mori, — u përgjigj. — Ku të shkoj gjetkë? — dhe i shpëtuan lotët.

Jaho Thana e shikoi gjatë nën ato vetullat e ngrysura dhe tundi kokën në një mënyrë që gruas iu duk

sikur donte t'i thoshte: «S'ma mbush dot mendjen, jo, me ata lotët e tu. Po ç'të të bëj, që je grua, pa dija unë si të ta hiqja një plumb ballit mu këtu buzë udhës.»

— Po atë trimin tënd në shtëpi e ke, apo ka marrë malet edhe ai si të tjerët? — pyeti përsëri krushku. Këtë radhë romuzi i tij dukej sheshiut.

— Në shtëpi, — u vrënjt Shanikoja dhe diç murmuriti akoma, me vete. Ajo u zemërua aq shumë nga kjo sjellje e papëlqyer e krushkut, sa, e kishte si e kishte punën me të shoqin, vendosi të kthehej edhe një herë në shtëpi e t'i thoshte me zemër të hapur: «Ngre-hu t'i heqim së bashku një dru të mirë këtij krushku, që po vjen të na tundë këmbët sikur na ka shërbëtorë të tij, pa pastaj bëj ç'të duash. Vritmë fare, në qoftë se s'u ngope me boshamenë<sup>1)</sup> që më dhe.»

— Fol, moj! Pse përtypesh ashtu? Apo të ka vajtur frika në palcë? — kërkoi sqarime krushku, gjithnjë me fytyrë të vrazhdë.

— S'kam ç'flas. Urdhëro në shtëpi, në do që të kërkosh hesap. Ka baba çupa. Pse më drejtohesh mua, zotrote? — ia plasi me zemërim gruaja dhe, pa ia hedhur sytë krushkut, që ndryshoi përnjëherësh në fytyrë e diç u mat të thoshte, u sul me vrap për në shtëpi.

Breshan Lara e pa të shoqen tek hyri si furtunë dhe vuri re me bisht të syrit çdo lëvizje të saj. Ajo përplasi bohçen për sheshi dhe rrëmbeu sëpatën që ishte varur prapa derës.

— Ehë! — sokëlliu me përqmim Breshani. — Da-shke të ngresh edhe dorë, pale... — dhe brofi në këm-bë i hakërruar.

— Nuk e kam me ty, jo! Po nxirr koburen e dil,

---

1) (turq.) — me kanosjen

— i tha me inat gruaja. — Jaho Thana po vjen tē tē vrasë...

Breshani mbeti një hop i trullosur, me sytë ngrirë tek e shoqja.

— Jaho Thana, — the?... Vjen tē më vrasë mua?... — murmuriti pastaj nëpër dhëmbë duke përpjekur disa herë kapakët e syve. — Kështu do ta gjejë fjalën ai me Larajt? Jo, moj!

— Erdhi, tē thotë Shanikoja, po ngrehu, — ia pati gruaja, e zverdhur gjer në majë tē hundës.

Në kalldrëmin e oborrit u dëgjuan këpucët me gozhdë tē krushkut.

— Jo, moj! — thirri përsëri Breshani dhe, pa e bërë tē gjatë, nxori nga brezi koburen e u vërsul përjashta. U derdh prapa tij edhe gruaja me sëpatë në krah.

Krushku apo kishte hyrë në oborr. Kishte mbështetur shkopin prapa portës dhe po ecte ngadalë e me mendje tē humbur, duke tundur kokën, si kur pyeste vetveten: «Ç'pati ajo djall Shaniko që iku aq e zemëruar? Mos nuk ishte në terezi dhe i mori tjetër pér tjetër fjalët e mia?»

— Urdhéro e fol! — iu kacënuar Breshani, që katër a pesë hapa larg dhe i drejtoi koburen me gishtin në këmbëz, kurse Shanikoja ngriti sëpatën.

Krushku shtangu në vend. Me tē vërtetë Shanikoja s'paskësh qenë në vete dhe kushedi se ç'farë turpesh do t'i kishte përrallo sur tē shoqit.

— S'të marr vesh se ç'kérkon tē thuash, — iu kthyesh Breshanit, duke shikuar me bisht tē syrit edhe Shanikon.

— As unë s'të marr vesh se ku e ke hallin që më ardhke me kobure në brez që pa gdhirë, — u përgjigj tërë inat Breshani.

— Po vijnë gjermanët, more! Nuk e shihni? — uturiu si i ndërkryer krushku. — Fshati i gjithë po ikën më kuç e me maç, kurse ju... Ja ku e kam hallin.

Breshani hoqi gishtin nga këmbëza e kobures dhe, si e shikoi nga ko ka gjer te këmbët të shoqen, që kishte ulur sëpatën e po çapëlente sytë e hutuar, iu kthyesh kruashkut:

— Gjermanëve s'ua kam frikën unë, zoti kruashk. Por çupës qysh t'ia bëj, çupës!

— Çupës? — vrenjti vetullat me shqetësim të madh kruashku. — Pse çupës? Nuk e merr dot me vete?

Breshani uli kokën i turpëruar.

— Se më nxiu faqen me ty, o Jaho Thana. Doli në mal me partizanët pa më pyetur as mua as të emën.

I tha këto si me të përtypur dhe priti që kruashku të vërsulej. Po kruashku as u vërsul as u zemërua. Përkundrazi, hapi sytë i gjëzuar, sikur mori kushedi se çfarë sihariqi, dhe iu hodh në qafë Breshanit me të thirrura:

— Hallall e pastë!... Hallall e pastë!... Dhe ti s'i bën shqyr perëndisë, ë? Ah, Breshan, Breshan! Kurse mua aty më rrinte mendja, te çupa. «Zoti na ruajtë, — thosha, — sikur të vijnë gjermanët e ta gjejnë brenda»...

Atë çast u dëgjua prapa qafës, në të hyrë të fshatit, zhurma e autoblindave të para që po vinin.

— Shpejtoni! — briti kruashku duke tërhequr përdore Shanikon.

Breshani, përkundrazi, në vend që të gjëzohëj nga ai qëndrim i kruashkut përfundën e çupës, u err përnjëherësh në fytyrë dhe, pa lëvizur fare nga vendi, filloi ta shikonte kruashkun me një vështrim të hidhur e të menduar.

— Hajde, de. C'më shikon ashtu? — i tha ky me qortim.

Po Breshani, me atë vështrimin e tij të hidhur e të menduar, gjithnjë nga kruashka, dhë me mendjen gjetkë, zuri të murmuriste me vete: «Jazëk! Jazëk! Përkëtë ditë e kisha ruajtur të shkretin, përkëtë ditë. Ku

të mbytem unë pa të?» Dhe s'lua jti që s'lua jti nga vendi.

Jaho Thana puliti sytë duke shikuar i habitur herë Breshanin e herë të shoqen.

— E ka fjalën te mauzeri, — i pëshpëriti ajo në vesh.

— Ç'mauzer, more?! — ia pati Jaho Thana duke iu kthyer krushkut. — Mauzeri na mori të keqen. Do të bëjmë si të bëjmë tashti edhe me kobure. Merr vesh, apo jo, si është puna? Luaji këmbët, të thonë, se po na zënë të gjallë.

— Mauzeri... — vazhdonte akoma Breshani, pa ua vënë veshin fjalëve të krushkut.

Përtej në qafë u duk autoblinda e parë. Përmjëherësh, nga ana e sipërmje e rrugës, që prapa shkëmbinje ku kishte zënë pritë një njësit partizan, filloj zjarri.

— Tundu! — sokëlliu krushku.

Breshani përsëri s'u tund. Vetëm se tani nuk shikonte më as krushkun as të shoqen, por më sytë gjysmë të mbyllura zgjaste veshin e dëgjonate me vëmendje andej nga vinte zhurma e armëve, në mes të të cilave dallohej, me ndërprerje të shkurtra, krisma e një pu-shke që ndryshonte nga krismat e tjera.

— Do të vish, apo jo? — iu kanos për herë të fundit krushku dhe eci disa hapa tutje, duke tërhequr pas veti Shanikon, e cila matej të thoshte diçka, por s'kishte guxim.

— Pa ndaluni pak, ndaluni... — tha më një zë pak si të gëzuar Breshani, — Nuk dëgjoni gjë ju?

Dhe, pa pritur përgjigje, duke mbajtur gjithnjë veshin andej nga vinin krismat e armëve, thirri: — Ai është, ai! Ma prisni kokën më qoftë se nuk është ai. Po si të ketë ndodhur kjo punë, si?

Jaho Thana shkëmbive një vështrim të shqetësuar me Shanikon: Mos vallë po çmendej Breshani që po fliste ashtu si përcart?

— Ai është. S'më gënjen mua, jo! — vazhdoi du-

ke férkuar duart i gëzuar Breshani. — Mauzeri im! Mauzeri im. Cili tē jeté ky firaun që shtie me tē?

Shanikoja uli kokën e zuri tē qeshte nën hundë.

— Pse qesh, ti, moj? Apo... — iu hakërrua i shoqi.

— Ku ta dish? — u përgjigj me tē truar gruaja. — Ndofta çupa ka punuar ndonjë djallëzi. Vetëm ajo e dinte vendin ku qe fshehur mauzeri.

— Çupa! — hapi sytë Breshani dhe mbeti një hop si hu në këmbë, duke ndukur gishtin. Ah, në më rëntë dot në dorë! — psherëtiu pastaj si me shumë zemërim, por, nga sytë që i shkëlqenin, dukej që ishte gëzuar dhe nuk i kishte me gjithë mend, ato që thoshte.

Në këto e sipër, zjarri në pritën partizane filloj tē rrallohej dhe ca nga ca pushoi fare. Edhe zhurma e autoblindave s'dëgjohej më. U kuptua që nemcet nuk ia dolën dot planit në krye dhe Ja'ho Thana me kru-shqit s'e panë tē udhës tē largoheshin.

Pas pak, përmbi fshat, monopatit që gjarpëronte rrëzë korijes, kaluan në rresht njëri pas tjetrit, një shtatë a tetë partizanë. Breshan Lara njoju në mes tyre tē bijën me flokët që ia shpupuriste era; me një-rën dorë shtrëngonte nga tyta mauzerin, tē cilin e kishte vendosur horizontalisht mbi sup. Druri i lustruar i tabanit dhe pjesët e bardha metalike tē armës vetëtinin në rrezet e diellit.

— Qenka edhe merakçeshë, pale! Sa pastër që e paska mbajtur, shejtania! — hoqi në zemër i ati, duke shikuar buzagaz krushkun, që po matej tē largohej. — Po ti, moj, ç'pret? — iu kthye pastaj së shoqes. — Mos kérkon tē na e lësh krushkun tē ikë pa pirë as kafe?

— Unë s'jam më zonjë shtëpie, — bëri sikur kundërshtoi Shanikoja. — Po hajde... Të urdhërojë benda zoti krushk, pa aty e gjejmë fjalën.

Breshan Lara nduku buzët e, me një lëvizje tē syrit, i dha shenjë që tē mos e zgjaste.

# Teodor Laço

## FORTESA

U ul mbi një körcu shelgu, anës lumit. Ujérat kishin shtetur, sepse shirat e vjeshtës nuk kishin zënë ende dhe lumi rridhte si i përgjumur.

Ky ishte lumi i tij. Ai mund të përfytyronte kur të donte gjithë bërrylakët, gropat, vatë dhe shtjellat e ujérave. Gjithë fëmijëria e tij ishte këtu: larë nëpër pellgje, fshehur nën hijen e rakitave, shtrirë në barin e livadheve. Ujérat po merrnin ngjyrën dhe ftohtësinë e mugut. Pas kodrës, që nxinte nga dëllinjat, ishte fshati. Ai duhej ta kishte pritur errësirën në dushkajë, po lumi e kishte tërhequr me rrjedhën e tij që i vinte në vesh si një gurgullimë e fëmijërisë. Donte të besonte se e kishte mashtruar mugëtira e zakonshme e pyjeve të dendura dhe nuk e kishte kuptuar që ende s'ishte ngrysur. Megjithatë ai ishte i qetë sepse asgjë s'pijtintë. S'kishte asnjë lëvizje dhe qetësia ngjyrëkafë e pyllit ishte shtrirë si për gjumë në tërë hapësirën që i hante syri. Ishte hapësirë e gjerë, rrëthuar me kodra

të rrumbullakëta, skërfitur nga ara të pjerrëta dhe ngastra korijesh të vogla.

Babai rrëfente se dikur të gjitha kodrat ishin të veshura me koriqe dushku e lisi dhe se nëpër rraket e tyre mërzenin derra të egër. Baldosat venin natën nëpër misra dhe ata i ruanin misrat prej tyre duke fjetur arave, nëpër kasolle kashte. Pastaj baldosat u zhdukën, sepse pyjet u prenë. I prenë ushtri të huaja, që luftonin aty. Nga gjithë rrëfimet e fëmijërisë, ai mbante mend ato të babait për ushtritë e huaja që prenë pyjet dhe ende më lashtë, për kohën kur u vra gjyshi Dine. Historia e gjyshit Dine atij i ishte dukur përherë si një përrallë dhe fantazia e tij e vishte atë gjithnjë me ndodhi të reja e të çuditshme.

Sa vjet shkuan që kur e tret nën një dorë dhë pylli gjyshi Dine? Gjyshi Dine bridhte me martinië krahut. Babai me malihet. Ai kishte një patikë. Ai bridhte malit tanë bashkë me shokët e batalionit, kurse gjyshi Dine kishte bredhur i vetëm. Nëpër trojet dhe sinorët, si i çartur. Kur e kur, martina e tij qëllonte derra me dy dhe me katër këmbë. Me historinë e gjyshit, ai ishte përkundur që fëmijë, që atëherë kur fërkonte pas gurëve të mprehjes një jatagan të ndryshkur që e kishite gjetur në tavam. Ajo ishte si një përrallë e zymtë, ku lëviznin nëpër terr njerëz tinëzarë, hajdutë e pritarë që mbajnë erë këllirë, si qentë e staneve...

...Ishin pesë hajdutë dhe kapedan Shashoja gjashëtë. Jo komitë të mirë, po hajdutë të gjësë e të njerëzve. Kapedan Shashoja e hiqte këmbën osh, si kërcu. Heshtje. Pastaj, zëra të çuditshëm të pyjeve. Pastaj, fëshfëritje fletësh nëpër opinga. Heshtje. Qukitje të thata qukapikësh. Klithjet e kalit të qyqes. Kërcitje degësh. Fëshfëritje tinëzare. Pesë hajdutë. Dhe çalamani Shasho gjashtë. Mjekërshpupurishur nga era, si prift. Doe-mos me mjekëri si të papa Ndonit, se Shashoja ishte

njeri i pyjeve. Çalamani përgjon diçka me veshët bigë. Përgjon zërat e pyllit dhe të mbrëmjes. Qan një ulluvegë. Ullu-ullu! Si përherë. Dhe Shashoja ka frikë nga diçka. Trembet, sepse e ka mbushur kupën e zullumeve. «Punë e madhe se e kam mbushur», mendon ai. Ja kanë bërë benë të gjitha fshatrat. «Punë e madhe se ma kanë bërë benë», mendon ai. Sonte ai ka zënë një gjah të majmë. Një treskalliu<sup>1)</sup> që kthehet nga Mali i Shenjtë. Treskalliu ka dy mushka të zeza, po paratë nuk ia gjen dot. Ai thotë se s'ka para. «Jo, ke! — thotë Shashoja. — Diku i ke fshehur! Ku i ke fshehur, derr treskalliu? Ku? S'të dhimbset shpirti? Léri paratë te Shasho Gjergjova dne shpëto shpirtin! Nxirri! Ti ke paratë e tua one të kurbetqinjve të tjerë! Duarbosh s'kunehen kurre nga kurbeti! Ku i ke paratë, derr treskalliu?!»

Qan ulluvega. Pylli ka shumë shtigje... Shtigje të verbra, traga me bar të kalbur, udhishhta kuajsh. Nëpër cilën prej tyre zbriste gjyshi Dine? Ai i diinte të gjitha shtigjet. Ato që kishin krye dhe dilnin diku dhe ato që ishin të verbra dhe mbaronin në një burim. Ai zbriste nga një shteg i verbër. Mbajti vesh. Era solli fjalë. Fjalët i rënduan si gurë varur në qafë. «Ku i ke paratë?» — thoshte era. Gjyshi Dine fshihej prapa një trungu ahu. Hajdutët ishin në këmbë. Mushkat kullotnin bar në rrahun e pyllit. Samarët i kishin bërë copë-copë. Hejbet i kishin grirë. S'kishin gjetur asgjë. Mjekrat ua merrte era. Fjalët ua merrte era. Treskalliu dergjej mëkrahëzaj, syzgurdulluar. Shashoja i vinte vërdallë. Si ujku deles, kur do t'i hidhet. Por ai nuk i hidhet. Ai bërtet dihe tund jataganin. Të tjerët bëjnë sehir. Gjyshi vë martinën në sy. Një krismë dhe Shashoja këputet në arrëz të qafës. Po të tjerët, janë pesë

---

1) nga fshati Treskë

dhe s'bien lehtë në dorë. Përfytyrimi i tij s'i thotë më asgjë. Dicka ndodh me gjyshin Dine. Asnjeri nuk di se ç'ndodh. Shumë vjet më vonë, vijnë zëra nga larg, nga hajdutët që kanë shpëtar, që pëshpëritin: gjyshin Dine, treskallium dhe Shashon i kanë mbuluar bashkë, në një përrua. Njerin bri tjetrit. Nën një dorë dhé, nën një grumbull fletësh të kalbura. Dhe tumbat e tyre i kanë sheshuar dimri dhe ujërat e pranverës...

... Ai u përmend nga kujtimet e fëmijërisë. Këmbët i ndiente të nxeha valë nga të ecurit. Zbathi opingat dhe futi këmbët në ujë. Uji iu duk i vakët. Nëpër të vozitnin fletë të verdha kumbullash. Mbi mish iu ngjit një fletë. Ai e hoqi. Mendoi se kishte bërë mirë që kishte qëndruar te lumi. Lumi ishte gjithë fëmijëria e tij...

Kurse tani ai ishte në batalion. Dhe pardje ia kishin ndezur me Ballin në Radom. «Balli e ka lëshuar brezin për sherr, — kishte thënë komisar Josi. — E ka lëshuar për sherr dhe po na e bën borxh! Po ti duhet të mos biesh në sy! Të shpiresh këtë letër dhe të marrësh me vete dyllë blete për spangon e opingave! Pa dyllë, s'qepen opingat që na janë bërë copë!»

Mori përpjete një udhë të ngushtë. Hyri në shtëpitë e para. Ishte qetësi. I ra udhës têrthor nëpër kopshë, shtyu një lesë dhe u gjend në një lëndinë ku xha Janoja mbante bletët. Në prag të shtëpisë u duk figura e zezë e hallë Marës që kyçiti duart përmbi bark. Plaka vrapi drejt tij dhe e mbështolli me krahë, si përtat fshehur. Ai ndjeu erën e finjës dhe instinktivisht vrojtoi vendin.

— Si hyre deri këtu, ditëzi, — tha ajo. — Në fshat janë ballistët!

— Ku janë?

— Janë mbledhur në shtëpi të Semajve. Kanë nxjerrë edhe roja nëpër udhët dhe venë e vijnë si kaposhë.

— Kush ua ka shtruar te Semajt?

— S'ua ka shtruar njeri, jo. U shtruan vetë dhe

dërguan fjalë në fshat për pula dhe bakllava, që hëngër-shin këmbët e tyre, — mallkoi plaka.

— Do të më japësh ca pite dylli, se na duhen për spangon e opingave. Unë do të hidhem deri në shtëpi, të shoh njëherë, se kam edhe një porosi për babanë. Do të vij t'i marr afër mesnatës.

Plaka bëri kryqin. Ai u fut nën drurët e kopshteve, ku që tanë ishte errësirë. Kapërceu gardh më gardh dhe u gjend në lëmë. Kishte për të kapërcyer edhe një mur.

\* \* \*

«Ky Çalamani më vret sytë! Për atë allah, pikë e kam në zemër që e mbajnë të gjithë për të parë! Kush e vuri komandant atë shtrembo? I parë jam unë! Ndonjë natë do t'ia dërgoj një plumb pas shpine dhe do t'ia thërrmoj kafkën! Të vejë me të shumtët! Fisi ynë, i Daduçëve, është me nam! Jemi të parë në shtatë fshatra. Kurse ai është kërcu! E mbajnë të parë sepse ai e mbledhi getën! Punë e madhe! Edhe unë mund ta mbledhi getën por ata derrat tanë kanë shkuar me partizanët, se janë thellësira, vende për komitë ato anët tonë.»

Koka po i turbullohej dhe i vinte t'u këpuste një shqelm të mirë të gjitha shisheve që ishin mbledhur mbi sini.

Çalamani pinte ngadalë. Më shumë hante sesa pinte. Ishte njeri i heshtur dhe mërzitez nëpër ahengje. Po gjithë krerët e tjerë ishin të djegur, për aheng dhe ai s'ua prishte dot, se ata ishin shokët e tij të luftës. Një javë të shkuar, në përpjekjen mbi Radom, ua kishin mbathur këmbëve qenat. Vetëm Bezat Bregasi kishte luf-tuar si trim, me shpirët në dhëmbë dhe ishte vrarë.

Mortja do trima. Mos do të hajë mut, si ky Orhan Daduçi? Ky Orhani ia vriste syrin. Vishej e kapardi-sej si bej, me rroba angleze prerë te terziu dhe kali i tij pullali kishte takëmin më të mirë në çetë. I kishin thënë që Orhani mburrej e thoshte se gjoja kali i tij e linte një të shtënë larg Gjokun e komandantit. Kjo s'dihej. Edhe Gjoku ishte i mirë. Kurse ky nipi i Orhanit, Lulo Daduçi, është një qull ky që i trembet edhe hijes së vet. Vetëm Bezati ishte trim. Por edhe ai u vra.

I zoti i shtëpisë rrinte mbështetur pas murit, këmbë-prerë, si i varur. Çalamani bëri shenjë që të hiqnin rakinë e të sillnin bakllavanë.

— Për flamur, po të mos qëndrojë maliheri në këmbë në mes të thelave, do t'ua hedh maceve bakllavanë! Dëgjove, or ti? — tha Orhani.

— Dëgjova, dëgjova. Do të qëndrojë, — tha fshatari.

— Jo, nuk do t'ua hedh maceve. Do të ta dend ty në gojë, sa të të pëlcasin bulçitë! Ashtu do të ngjallësh! Ç'je ashtu i thatë, si i tharë në tym, o i zi?!

— Nga hallet, — tha fshatari.

— Mjaft, se na mërzite, — tha Çalamani. — Me të gjete të mbrihesh pér sherr? Ke ku ta rrëfesh trimërinë!

— Dhe e kam rrëfyer!

— E dimë! — tha Çalamani.

«Do të ta gjej natën, mos ki dert! Shtrembo! Dhe do të ta hap kafkën me një dum-dum, që të derdhen trutë! Do të ta gjej natën!» — mendoi Orhani.

Një ballist i moshuar, thyer më dysh nga pesha, solli një tepsi të madhe dhe e vuri në simi. Luloja zhvari maliherin nga gozhda dhe hoqi një thelë nga mesi.

— Mos na ndyj bakllavanë! — i tha Çalamani.

Luloja s'bëri zë. Ballisti i vjetër u përkul në vesh të Orhanit dhe i pëshpëriti diçka. Ky ishte një nga njerëzit që kishte sjellë me vete ai. Çalamani e pa vën-

gér, Orhanit i lëvizën gjithë muskujt. Ballisti u zbyth drejt derës.

— Ç'thotë? — tha Çalamani.

— Thotë se kanë diktuar një njeri të dyshimtë të armatosur që fshihej kopshteve.

— E zunë?

— Jo. Thotë se ka hyrë në një shtëpi.

— Të rrethohet shtëpia! — tha Çalamani.

— Lërma mua! Lërma! — tha Orhan Daduci. Në sytë e tij të kërcyer, Çalamani pa se si lëvrinte me vërtik sherri. U têrhoq. «Kokën hëngërt!» — mallkoi.

— Mirë! Shko! — tha ai. — Por e dua të gjallë!

— Gjallë do të ta sjell, — tha Orhani dhe doli.

Luloja e ndoqi pas, si kone. Çalamani u mbështet në jastékët e fortë mbushur me kashtë dhe iu hap goja.

— Një njeri i armatosur! — tha me qesëndi. — Vetëm një! Trimëri e madhe të kapësh vetëm një njeri, apo jo?!

Xhemil Vishti ia dha gazit.

— Le të vejë, që të ketë edhe ai me se ta rrahë gjoksin nesër! — tha Çalamani.

\* \* \*

Çako Dinoja, i ati i partizanit Jake, kishte që në mëngjes në mulli. Mullisi ishte plak dhe ai e ndihmon-te. Nuk deshi të rrinte në fshatin që ishte dinka me ballistë dhe vendosi ta kalonte edhe natën këtu.

Krismat e para nuk i dëgjoi. Gurët e mullirit vërtiteshin qetë me atë gurgurimën e tyre të njëjtë, që i ngjante si një këngë e vjetër, ardhur nga vitet e largëta, kur punonte nëpër sharrat e manastireve të malit Athos. Ujërat bënин potere nëpër ikadet dhe rrinjin e shkumëzoheshin pas fletëve të pendës. Mullisi plak

hyri brenda duke hequr pranë një barrë shkarpa të thata për zjarrin e natës.

— A i dëgjove pushkët, o Çako? — tha mullisi.

— Jo! Ku ranë?

— M'u bë se ranë në mëhallën tuaj.

Çakoja mori maliherin që e kishte lënë mbi dërrasat e shtratit të mullisit dhe doli jashtë. Mbajti vesh. Fshati, lart në kodër, nuk lëvizte, sikur ishte i téri prej guri. «Do t'i kenë bërë veshët plakut», mendoi. Por një krismë e vetme që shqeu qetësinë si një klithmë, e bëri të luante vendit e të përgjonte. Vetëtimthi syri i zuri figurën e një fëmije që vraponte nëpër tragën e jazit. Fëmija dukej e zhdukej nëpër degët e holla e të zhveshura të rakinave. Ishte një djale. Ai shtyu lesën e shtegut të mullirit dhe mezi mundi të thoshte dy fjalë, duke gëlçuar:

— Rrethuan Jaken!

Atij i flakérinë në tru si xixa prushi dhjetëra pyetje njéherësh, hamendje, dyshime e shqetësimë. «Jaken? Pse? Ku? Si? Ç'kérkon Jakja në fshat? Si do të dala nga rrëthimi Jakja?»

Nuk mundi e nuk deshi të pyeste më asgjësенд dhe ia mori një vrapi të shpejtë përpjetë kalldrëmit. Mullisi plak u drodh. Vuri duart si hinkë në gojë dhe thirri sa i hante në kokë:

— O Çaaako!! Jo andej, more, se rrugët janë plot ballistë! Merr udhë nëpër mezhdat e arave!

Çakoja u ndal si i prerë, pastaj u përkul sikur po e përgjonin shumë sy dhe u vodh nëpër hijet e manaferrave të mezhdave.

«E, or Jake! Në paç zënë pritë aty ku të kam thënë, do ta mbajmë ndezur gjatë, sa të gjëmojnë malet! Të kujtohet? Ta kam thënë që ky vend i ngushtë në mes tri plevicave është tamam për luftë. Tri anë janë me mure të trasha dhe përpëra shteg i ngushtë e i zhveshur, që mund ta korriresh me plumbë. Nëpër mure kam fshehir fishekë maliheri dhe bomba. Fishekët për vete, bombat për ty! Ta kam thënë! E, or Jake, në paç zënë aty pus!»

Atij iu bë se e kishte tē birin aty pérpara, ashtu tē parritur ende, siç e kishte pérçjellé dikur.

Silueta e gjatë e Çakos lëvizte tinëz, si hije, në sfondin e mugët. Hëpérhë askush s'e kishte mendjen tek ai, sepse tē gjithë zhezhitnin rrëth shtëpisë. Krisma tē rralla dhe britma pa kuptim i vinin në veshë. Në tē hyrë tē fshatit, ai u fsheh prapa trungut tē një arre dhe përgjoi rrugicën. Nuk lëvizte njeri. Shtëpitë ishin si tē shurdhra. Ai duhej tē kalonte tri rrugica tē tillë, pastaj lëmin, pastaj një avlli dhe më në fund do tē gjendej në fortësën e tij. Por prapa çdo kthëse mund tē ndeshte ballistë. Atij iu duk se po vonohej shumë duke menduar. Mori pushkën në dorë, i ngriti sigurësën dhe vrapi. Pastaj u fsheh prapa një avllie dhe priti. Thirrje tē pakuptueshme zbritnin e thërrmoheshin nëpër gurët e kalldrëmit. U têrroq në një qoshe tē murit dhe përgjoi rrugicën me një sy. Zbritën duke rendur katër ballistë, kurse nga poshtë vinte Xhemil Vishti. Xhemili i ndaloi.

— Ku veni, or u shofshi! — thirri ai.

— Na dérgoi Lulua, — tha njëri. — Orhani mbeni brenda shtëpisë, se i vrarë, se i plagosur. Merrni benzinë, na tha, t'i vëmë zjarrin shtëpisë që tē digjet brenda si miu ai komunisti!

— Kthehuni, hajvanë! Na urdhëroka edhe Lulo buzëqumështi tanë! Po xhaxhanë, edhe atë do ta djegë brenda? Kthehuni, se do ta zémë tē gjallë!

Çakoja priti sa u zhdukën matanë kthesës dhe unis. Në një qoshe i zuri syri prapë dy ballistë. Qëlloi në vrap e sipër. E dinte që asnje prej plumbave s'do tē zinte në mish, po tē paktën ai e spastroi rrugën e tij pér disa çaste. Qëlloi edhe një herë. Plumbi ciflosi një gur në murin e një shtëpie.

Kjo pushkë, që mbillte krisma nëpër udhën e ngushtë, u pa nga shumë pak veta. Edhe ata që e panë, s'arritën ta qëllonin sepse figura e tij e gjatë dredhon-te shpejt dhe u humbiste nga sytë. Kur kaloi nëpër lëmë, i fërshëllen dy-tre plumba pérreth. Mbështeti

shpinën në mur dhe përfshiu një hapësirë, sa mund të dukej me sy që aty. Kjo hapësirë ishte e ngushtë dhe nëpër të s'guxonte të lëvizte njeri sepse e hanin krismat që vinin nga shtëpia. U shtri barkas dhe futi një ballë fishekë në folenë e pushkës. Dy plumbë njeri pas tjetrit i vezulluan mbi kokë. Vrojtoi. Prapa trungut të një kumbulle nxinin këmbët e shtrira anash të një njeriu. Mori shenjë dhe shtrëngoi dhëmbët. Njeriu lëshoi një ulurimë dhe u tërhoq praptazi, deri në shkarëzimë. Ai u kacavor në mur dhe u gjend në hapësirën e ngushtë midis tri plevicave.

Aty s'kishte asnjeri. Jakja ishte brenda.

«Eh!... or Jake, kur s'të kam këtu», mendoi ai. U shtri dhe zuri pritë prapa murit me gurë të mëdhenj, të zinx, që kufizonte vendin e hapur nga ana e shtegut. Kishte goxha që s'dëgjohej më asnijë krismë. Nxinin dritaret e vogla të shtëpisë. Dëgjohej zëri i Lulo Dadugit:

— Shtyhuni në sulm, or qena, se ma latë xhaxha-në shtrirë te këmbët e atij komunistit!

— Hidhu vetë i pari, — bërtiti Xhemil Vishti.

Nja tre ballistë dolën me kujdes në krye të udhës, bënë dy-tre hapa dhe u shtrinë. Dy krisma, njëra nga shtëpia dhe tjetra nga plevicat, përshkenditën gurët rrëth tyre. Ballistët u zbythën dhe u fshehën pas qoshes.

\* \* \*

Jakja e kuptoi menjëherë që e patën dikuar, kur vuri re se si vidheshin kopshteve nëpër hijet e drurëve ca hije të errëta njerëzish që mundoheshin të afroheshin në heshtje. Hapi derën dhe shtyu jashtë pothuajse me zor nënën dhe dy motrat e vogla.

— Dilni shpejt! — tha ai. — Merrni nëpër kopshite dhe futuni në ndonjë shtëpi! Dhe dërgoini fjalë baba! në mulli: Jakja është rrrethuar, i thoni.

Ato dolën, me fytyra të trembura kthyer drejt tij. **Dera mbeti gjysmë e hapur, dhe ai i ndoqi me sy, që leviznin kopshteve e gradinave. Po e rrrethonin larg e larg, pa u ngutur, derisa ta ngushtenin darën. «Do të zë pozicion në dritaret e katit të dytë dhe do të mbrohem. Derisa të kem edhe një fishek, do të mbrohem! S'kam g'bëj më! — mendoi. — Dhe do ta mbaj flakën e pushkës derisa të bjerë natë e thellë! Pastaj ndofta tërhiqem! Ose ndofta dëgjohen krismat dhe ia ndez andej majave batalioni!»**

Ky mendim i fundit iu duk fare fëmijëror dhe ai qeshi me vete me shpresat, të tilla. Batalioni ishte larg, shumë larg. Të gjitha këto i shkuani nëpër mend në një çast aq të shkurtër, sa edhe krisma e një pushke, dhe ai u çudit se si njeriu mund të mendonte përnjehëresh aq shumë gjëra. Shtyu derën e madhe prej dërrase të trasha dhe mori llozin që ta mbështeste.

Një batare troshiti derën lart te kllapa. Plumbat u ngulën në tavani. Ranë copa suvaje dhe një cifël druri prej kllapës. Ai u mbështet pas murit.

Ishte gabuar. Nuk ia kishte marrë mendja se ata mund të qenë afruar deri te muri rrrethues i oborrit pa u vënë re. Një batare tjetër automatiku rrahu prapë lart, te kllapa. Ai s'kuptoi, përsë qëllonin aty.

— Mos u afro te dera, se të grimë me plumbë, — thirri një zë. Ishte e kotë të shtinte më tym nëpër dërrasat e derës, kur s'dihej se ku mund të ishin ata; prandaj ai mori shkallën përpjetë. S'kishte ngjitur as tri shkallë, kur kllapa e derës u hap dhe pesë veta hynë në korridordin e ngushtë. Bëri të ngjiste edhe një shkallë tjetër.

— Mos lëviz, qenush! — tha ballisti, që ishte në krye, duke u zgërdhë. — Mos lëviz, në të dhimbset lëkura, se të bëmë shoshë! Unë jam Orhan Daduç,

në do ta dish, dhe ti tani do ma dorëzosh mua pushkën!

— Njeriu që zgërdhihej ishte i pashëm i veshur me rroba kaki të prera bukur dhe në vend të qylafit mbante një kapelë lëkure me strehë të fortë. Jakja vuri re se në sytë e tij shkelente një ngazellim i madh. ~~Kështu duhet të gjithë fitimtarët~~, mendoi.

— Hidhe pushkën tani, hë këlysh i vogël! Hidhe, se, meqë je mustaqepadirsur, mund të të kursejme!

Katër tyta të zeza pushkësh dhe një grykë automatiku e shihnin në një pikë të vetme të gjoksit, ku diçka i përvëlononte. Por edhe tyta e pushkës së tij shihte diku, shihte gojëhapur nën kopsat e verdha të ndritshme të xhaketës së Orhan Daduçit.

— Nuk jepet pushka, — tha ai. — Po ta mbajti, eja merre!

— Do të vij, se ty nuk ta mban ta shkrehësh, — tha Orhani. — Nuk ta mban se, posa ta afrosh gjishtin te këmbëza, ata trima që janë pas meje do të të dërgojnë katër plumbë mu në kokë!

Orhani bëri dy hapa përrpara. Iu duk se pushka e atij çunakut dridhej. Ai duhej ta çarmatoste vetë. Gjithë krahina do ta merrte vesh që Orhan Daduci çarmatosi një partizan. E çarmatosi duke ia hequr vetë pushkën nga dora. Me rrëzik të jetës. Ia hoqi nga dora. Po, nga dora. Kush e ka bërë këtë? Mos vallë Çalamani?

Bëri edhe një hap. Jakja nuk u zmbibraps më. Orhani mbështeti pllazin e këmbës në shkallë, zgjati duart dhe e zuri pushkën nga tyta. Një gëzim i egër i shpërthieu në fytyrë, një gëzim që nuk e kishte provuar kurrë.

— Lëshoje tami, qenush! — tha Orhani.

— Merre! — bërtiti Jakja dhe rrëmbimthi u ul më gjunjë, tërhoqi pushkën drejt vetes dhe e shkrepi. Orhan Daduci u përgjunj. Vuri të dyja duart në bark, sikur deshi të mbante zorrët dhe u hoq praptazi deri

te muri. Sytë iu zbardhën dhe iu bënë të ujshëm, si xham. Një tym i bardhë vërtiitej nén tavan.

— Po më vrate, o qen! — tha me një fije zëri

Jakja e shkrepi prapë dhe plumbi iu ngul në pulpë. Dikush nga ballistët arriti të qëllonte dhe atij i ranë copa gëlgereje mbi krye. U zmbraps dhe vërtiti një bombë mu në derë. Krisma shurdhuese zhvendosi ajrin që u trazua jashtë me ulërima. Korridori u boshatis. Kapërceu me një të hedhur trupin e ballistit që kishte mbetur mëkrahëzaj te pragu dhe shkoi llozin e rëndë në derë. Krisma të çrregullta qëllonin dërrasat dhe muret. Jashtë klithi Lulo Daduci:

— Ku veni, more! Boo! Ma latë xhaxhanë shtrirë te këmbët e atij komunistët!

Orhan Daduci në regëtimat e fundit të jetës, që po i derdhej bashkë me gjakun, mundohej të shtrëngonte plagën e tmerrshme në bark, po duart nuk i bindeshin më. Jakja nuk i vështroi fare të dyja kufomat që ishin në korridor. Rrëmbeu automatikun e Orhanit, u ngjit në katin e dytë dhe zuri dritaren që shihte oborrin. Qëlloi një herë në ferreckat e hithrave që ishin xhumbë anës murit. Dy veta kaptuan murin. Pastaj nata ra, në qetësinë e saj të zakonshme. Të bëhej se s'po ndodhite asgjë, se asgjë nuk lëvizte dhe flinte si përherë, me shkujdesjen që sjell pas qetësia e natës. Askush nuk guxonë të dilte në orbitën e qitjeve të pushkës që përgjonte në dritaren e ngushtë. Pastaj u dëgjuan të shara. Ishte Xhemil Vishti që tallej me Lulon, i cili rrundi struktur pas murit. Zhurmat u shumuan dhe ai dëgjoi një zë tjetër të trashë e të vrazhdë, që s'e kishte dëgjuar më parë:

— Oburra, Lulo Daduci! Hidhu, që ta zësh të gjallë!

Por asnjeri nuk lëvizi.

Po atë çast u dëgjua një krismë e vetme. E njoju menjëherë. Ishte një krismë e thatë. — Shgér-dau!... sikur shqyheshin drurë nga bora. Ky ishte malipheri i vjetër i babait. Ai hyri në dhomën tjetër, dritarja e

së cilës shih te mbi çatitë e plevicave. Duhej vetëm një lëndinë e vogël me bar, po figura e babait nuk ishte aty. Siç dukej, ai kishte bërë pritë qoshen tjetër, ku ishte vendi më i mbuluar.

Nuk po lëvizte njeri dhe kjo e nervozoi. «Ata presin të dendësohet errësira dhe ta ngushtojnë rrëthimin derisa të vijnë te dera. Pastaj mund t'i vënë zjarrin katit poshtë. Jo, nuk do t'ia vënë zjarrin, sepse brenda është trupi i Orhanit. Po pse s'lëvizin? Pse s'lëviz askush?»

Ai ndjeu t'i mbinin qindra dyshime dhe prandaj u mbërthyen edhe më pas murit, nën dritare.

\* \* \*

Nata shtriu krahët e vet të errët dhe heshtja u bë më e kobshme. Dikush lëvizi nëpër dheun e shkri-fët të kopshteve, ku posa ishin nxjerrë patatet. Kur e kur, nga shtëpia dhe nga lëndina midis tri plevicave, shkrepnin dy pushkë dhe pastaj flakës së tyre i qepej një bre-shër i nxituar plumbash. Pastaj rivendosej pritja dhe qetë-sia. Jepeshin urdhra me zë të ulët dhe në krye të rru-gicës bënte të dilte ndonjë prej hijeve të rrëthuesve, po dy krisma të menjëherëshme ua prisnin rrugën. Atëherë rrëthuesit e kuptionin që bataretë e tyre kishin shkuar kot dhe ia nisin me zemërim një batareje tjetër.

Jakja vrojtoi edhe një herë në dritaren që shih te plevicat. S'dukej gjë.

«Unë tani duhet të dal nga shtëpia dhe të bashko-hem me babanë, — mendoi. — S'kam tjetër shpëtim. Pozicioni i babait është shumë i mirë dhe aty do t'ia mbajmë ndezur gjatë...»

Zbriti shkallët. Në korridor kufomat nxinin si kamina të shembura qomyri. Hoqi llozin dhe në heshtje të plotë doli jashtë e u zvarrit anës murit. Kur po

afrohej në qoshe, dëgjoi fëshfërítje fletësh dhe qëndroi. Dy hije u hodhën nga muri dhe mbështetën shpatullat te dera. Nëpër portën e rrugës vrapuan dy të tjera dhe zunë dritaren e vetme të katit të parë, që ishte zënë me hekura, por asnjeri nuk e zgjati kokën brenda hapësirës së dritares. Njëri nga, ata që ishte te dera thirri:

— Dorëzohu, se të erdhëm në derë! Dorëzohu, se ta vumë pishën!

Ai u zvarrit nëpër plloçat e ftohta të oborrit, hapi lesën e kopshtit dhe u hodh në lëmë. Një plumb i férshelleu pas veshit dhe ai e kuptoi që po qëllonte i ati. U platin pas dheut dhe thirri:

— Mos qëllo, se jam Jakja!

Ngjiti ledhin, kapérceu murin e ulët, prapa të cilat ishte i ati. Hija e tij e errët ishte shtrirë anës murit dhe nuk lëvizte. Ndjeu një frikë të paquptueshme dhe dridhërimë. Iu bë se babai ishte i vdekur.

— Eja, eja! — tha zëri i babait. — Zvarritu, se dukesh!

Ai u afroa. Babai zgjati dorën e majtë dhe i shtrëngoi krahun fort... Yjet e rralla bënë nje dritë të mekur, aq sa dalloheshin format e shtëpive, të drurëve dhe hijet e njerëzve.

— Ata hynë në shtëpi! — tha ai.

— E di! — tha babai.

Pastaj imbetën të dy, afér njëri-tjetrit. Çakoja ndiente frymëmarrjen e shpejt të të birit. Duart i digjinin dhe ftoma e gurëve i hynte nëpër to sikur prekte alkull.

— Po tani? — tha Jakja.

— Zër pozicion në mes të murit! Mos shko më tej, se aty të ha plumbi! Pastaj shtjer dy herë dhe lëre pushkën në vend. I kujt është automatiku?

— I Orhan Daduçit, — tha ai.

— Mirë. Qëllo dy herë, lëre pushkën dhe zvarritu anës murit!

— Pse ashtu?

— Bëj si të them! — tha rrëptë babai.

Shkrepën katër të shtëna që shpuan terrin dhe gëmushat e shtegut. Ata u zvarritën drejt njëri-tjetrit. Në pozicionet e para vezëllinë plumba.

— Kështu kam shpëtar, — tha babai. — Qëlloj dhe zvarritem. Ata shtien më flakët, po s'janë aq të shpejtë, se kanë frikë. E ke pushkën aty?

— E lashë!

— Mirë. Tani ata e dinë që ne jemi të dy. Ti merr me vete automațikun e Daduçit dhe hiku zvarrë, po mbaj anën e mezhdës, nën hithrat e thara. Nuk do të të diktojnë dot, jo se unë do të qëlloj nga të dyja pozicionet, një herë me njérën, një herë me pushkën tjetër. Ata do të pandehin se jemi përherë të dy. Hajde!

E afroi pranë vetes dhe mbështeti faqen e tij të parruar mbi faqen e nxehthë valë të të birit. Ishte një përqafim i ashpër. Jakja ndjeu t'i ngjitej një dridhje e ftohtë në gjithë gjymtyrët. Çakoja i rëndoi në sup.

— Jo! — tha Jakja. — Nuk dua! Nuk dua të të lë vetëm!

— S'ka sesi... — tha babai ngadalë. — Është e kotë. Tani ata do t'i vënë flakën shtëpisë dhe vendi do të bëhet ditë. Nata s'na mbron dot më...

Çakoja u zvarrit drejt vendit ku kishte mbetur pushka e Jakes. Jakja kaptoi avllinë dhe rrëshqiti nëpër pluhurin e hidhur të rrugicës. Mbi kokë i fërshëllenin plumbat, por ata përplaseshin më lart, te gurët e avllisë. Në një ndërkokë të rregullt, vazhdonin të shkrepnin edhe të dyja pushkët.

Kur hyri nën rakin e jazit, pa flakët që shpërthyen në çati. Reflekse të kuqe dritash rrëshqitnin mbi barërat e kalbura nga vjeshta të livadheve. Të dyja pushkët ndiheshin ende.

Flakët përpinë trarët dhe shtëpia e vjetër u dogj si një pishë e stërmadhe.

Çakoja s'lëvizte më. Kishte mbetur te pushka e

Jakes, mbërthyer pas murit me një plumb që i erdhë pas shpine, nga pullazet.

Pastaj zjanni shpërthieu përsëri. Çalamani iu afroa njeriut të shtrirë anës murit. Gishti i kishte mbetur në këmbëz të pushkës. Ishte burrë i thyer. Çalamani çakerriti sytë. Partizani ishte zhdukur.

— Lulo, or qen — tha ai nëpër dhëmbë, — ngarkoje xħaxhaq në mushkë dhe shpjere e varrose në fshatin e tij!

Po atë qast partizani Jake mori rrjedhën e lumit. Ky ishte lumi i tij dhe ai kishte lënë aty gjithë fëmi-jérinë.

1972

# Thoma Noti

## VENDROJA NUMËR TRE

Më në fund erdhi ora që duhej të lija shërbimin. Po e prisja këtë çast.

Rrallëherë kisha provuar një pëshëtjellim të tillë mendimesh e ndjenjash. Aty më dukej vetja e gëzuar, e lumtur, aty e humbisja, fare. Po fundja pse të më dukej ashtu? Asgjë e jashtëzakonshme s'kishte ngjarë. E megjithatë...

Po ç'kam kështu sot që më ngatërrohen gjërat? Më mirë të tregoj me radhë, ashtu siç ngjau. E di që këto janë krejt të zakonshme e në fund të fundit shumë nuk ngjau; ndoshta për të tjerët s'kanë dhe aq rëndësi. Dhe prapë kam dëshirë të flas, t'i tregoj dikujt:

Dje u mbushën plot tri javë që kemi ardhur këtu për stërvitje ushtarake. Sa zbritëm nga makinat, imbefëm të hutuara. Luginat shtriheshin si ca korridore të gjera e të gjelbra, kurse nga të dyja anët ngriheshin majëmalet. Një pyll i dendur vishte shkëmbinjtë e thepisur, një pyll me pisha të drejta, të larta, që ruante në gjirin e tij një

heshtje të thellë, të madhërishme. Vende-vende ato pisha plekseshin e kacavirreshin në shkëmbinj, sa të dukeshin se nga çasti në çast do të rrëzoheshin.

— Të pushtuar nga ndjenja të tilla, u zumë dorë për dore dhe u lëshuam me vrap lëndinave. Atë çast buçiti fajre pranë nesh një zë i fortë, urdhërues:

— Toga e parë, në dy rreshta mblidhu!

Ai zë na kujtoi se nuk kishim shkuar atje për të shëtitur e për të parë bukuritë e natyrës, po për t'u stërvitur. U mblodhëm në çast. Komandanti, një mesoburrë, me fytyrë të rrahur nga era e bjeshkëve, i lindur e i rritur në këto anë, na foli për detyrrën që na priste. Ai na tregoi në cilat çadra do të flinim, ku do të hanim, ku do të stërviteshim dhe nga ngarkoi menjëherë me punë. Sakaq u shpërndamë nëpër çadra dhe u morëm për një kohë me rregullimin e tyre. Na dukej e çuditshme kur mendonim që do të jetonim e do të flinim në një vend aq të ngushtë, ku nuk mund të drejoje as trupin. Po shpejt u mësuam me jetën e re. Gjithë ditën lodheshim në stërvitje, kurse në mbrëmje kthehem, ndiznim diku afër një zjarr të madh dhe tregonim... E çfarë s'tregonim! Zakonisht fliste komandanti, po shpesht viinin edhe pleq të moshuar të atyre anëve. Ne dëgjonim dhe na dukej e pabesueshme që tridhjetë vjet më parë në këto vende të bucura kishin qenë zotër bajraktarët. Një mbrëmje unë isha dhënë e tëra pas tregimit dhe vështroja e hutuar rrëth çadrave, anës pyllit. Më dukej sikur nga casti në çast do të dilnin andej ata njerëzit e parruar, të frikshëm e tinëzarë...

Një nga ngjarjet më interesante të ditëve të para ishte pa dyshim shërbimi i rojës natën, në vendrojën numër tre. Kjo qe pika më e futur e fushimit, një vend i veçuar rrëth një kilometër larg, në mes kacubave, ku qe vendosur depoja e armatimit. Natën e parë shërbimi i talkoi Gjergjit, një shokut tonë të klasës. Atë s'e mbante vendi. Kurse ne, para se të flinim, u mblodhëm grumbull, dolëm në mes të çadrave dhe vështronim andej nga duhej të ishte vendroja numër tre. Një e rrëqethur e lehtë

na e përshkoi trupin. Papritur aty afër dëgjuam një zë të fortë: «Ndal, kush kalon?» Njëra nga ne, Rina, brofi e trembur. Ndoshëta edhe unë do ta kisha humbur si ajo, po të mos kisha dëgjuar përgjigjen: «Jam oficeri i rrujës.» E dalluam në çast, ishte zëri i komandantit. Dhe ne u qetësuam.

Të nesërmen, kudo në çadrat e gjimnazistëve flitej për shërbimin e parë natën në bjeshkë. Dalengadalë sikur u mësuam me të. Po pas një kohe ngjau diçka e papritur. Njëra nga shoqet tona, Dalina, një vajzë nga Dukagjini, u ngrit në mbledhjen e organizatës së rintisë dhe foli për një «padrejtësi», siç thoshte ajo, që i bëhej asaj dhe të gjitha neve:

— E përsë shërbimin e rojës ta bëjnë vetëm djemtë?  
— pyeti. — A thua ne jemi më të dobëta se ata? Jo, aspak. Në këto male kanë luftuar si djemtë, edhe vajzat. Ja ku e ka lapidarë Eftalia katërmëdhjetëvjeçare nga Bregdeti, — dhe shtriu dorën përpëra. Ne shikonim andej dhe ia bënim me shenjë: «Të lumtë goja, moj Dalimë!»

— Në emër të të gjitha shoqeve, — vazhdoi Dalina, — unë propozoj që shërbimin njëzetkatërorësh këtë javë ta bëjnë vajzat e klasës sonë. — Pastaj shtoi me zë të prerë: — Po të jetë e mundur, mua më caktoni në vendrojën numër tre...

Dhe u ul.

Për disa çaste nuk lëvizi as gjethja. Pastaj u bë zhurmë. Flisnim të gjithë në një gojë. Rina e goditi aq fort me bërryl në ijë Dalinën, sa ajo hovi përpjetë. Të gjitha qeshën, edhe komandanti.

— Po mirë, oj burrneshë, — tha ai, — meqë shoqet janë zemëruar, le të bëhet ashtu.

Dhe aty për aty përgatiti listën e shërbimit. Pastaj lexoi. Ne dëgjonim. Unë prisja se kush do të caktotohej te treshi. Nuk di se si më erdhi, kur pas emrit të Dalinës dëgjova emrin tim. Shoqet u kthyen nga unë dhe po më vështronin ngultas.

Pas mbledhjes, meqenëse do të merrnim shërbimin,

filluam përgatitjet. Komandanti na foli gjatë për detyrat e veçanta në çdo vendrojë. Pastaj u shpérndamë dhe nisëm të pastronim këpucët e të rrëgullonim uniformën. Unë isha si në ëndërr. Shërbimi në vendrojën numër tre, natën, më dukej dicka e pazakonshme, gati-gati heroike. Çuditesha me Dalinën: si ishte aq e qetë? Po mbasë ajo kishte të drejtë. Megjithatë... Për një çast m'u duk se nuk isha përgatitur plotësisht për të marrë shërbimin atje. Një mendje më thoshte të shkoja drejt e te komandanti dhe t'i flisja hapur: «Shoku komandant. Mos ma merr për keq, por unë...» Dhe dy-tri herë u mata të shkoja tek ai. Por aty për aty ndërroja mendje. Sakaq m'u afrova Neta, shoqja ime e ngushë. «E di unë... — më tha. — Po hiç mos u bëj merak. Unë nuk të lë vetëm. Do të vij të rri me ty sonte... Ti hesht, mos i thuaj njeriu...», dhe më pushtoi në qafë. «Po pse, Neta, përsë ta bëjmë këtë?» «Hë, budallaqe, mua ma fsheh? E di unë, ke frikë.» «Frikë...?» Dhe nisa të mendohesha. A ishte vërtet frikë ajo që ndieja? E përsë të trembesha? Kurrën e kurres! Megjithatë Neta më hutoi fare me ato që më tha. Më në fund e mblohdha:

«Po mirë, Neta, mirë. Le të bëhet ashtu. Jo se kam frikë, por... fundja, këtu s'ka, gjë të keqe. Edhe kur të të bjerë ty treshi, bashkë do të rrimë.» Dhe filluam të kuvendonim të shkuidesura. Kështu koha kaloi pa u vënë re. Tani nuk bëhesha merak për asgjë. Madje më vinte mirë që do të qëndronim me Netën dy orë të tëra.

Orët ilkën me shpejtësi. **Cadrat** tonë, si ca shkëmbinj që ishin rrökullisur nga mali dhe kishin zënë vend në lëndinë, dalëngadalë i përpju nata. Ishte një natë e thellë pus. Të paktën kështu më dukej mua kur qëndroja me shoqet në çadrën e shërbimit. Ato flinin, kurse unë s'vura gjumë në sy. Hera-herës dilja te dera e çadrës dhe vështroja. Qetësi. Shoqet flinin të shkuidesura, kurse mua më dukej sikur bënин ashtu, kurse në të vërtetë i kishin myllur sytë përgjysmë e më përgjonin. «Dale, dale, pa ne i kemi marrë vesh të gjitha.» Kështu

më dukej se thoshin, duke qeshur nën buzë. Kjo më turbulloj fare. Po sikur ta merrte vesh njeri të fshehtën tonë dhe të na përgjonte? Si do t'u dilnim përpëra shokëve dhe shoqeve të nesërmen? Ata do të na merrnin përfnikacalke, dhe atëherë... Jo, jo. Kjo punë duhej menduar mirë. E përsë të tregojeshha unë ndryshe nga të tjerat? Ç'kishte më shumë se unë Dalina?

Dola përsëri jashtë. Neta priste aty. Sa më pa, zgjati krahët. E ndjeu se nuk isha e qetë.

— Po ti ç'ke kështu? — më pyeti.

Unë e vështrova drejt.

— E di, Neta. Ti je kaq e mirë. Të falem ndërnit shumë, po... shko fli! Unë do të qëndroj vetëm, — dhe nisa të flisja me nxitim, si të doja t'i mbushja mendjen jo asaj, po vetes.

— E përsë të mos qëndroj? Asgjë s'ka për të ngjarrë. Kështu do të jemi më të qeta, edhe unë, edhe ti.

Ajo m'u hodh në qafë, si pak më parë, kur më propozoi të vinte me mua në shërbim. Siç dukej, që penduar për ato që më kishte thënë.

— E bën dot këtë, Linka?

— E pse jo!

— Të lumtë! Ma ndillte zemra, se do të veproje kështu.

Qëndruam dhe ca, pastaj ajo shkoi të flinte, kurse mua më erdhi ora e shërbimit. Përgjegjësi i ndërrsesës na mblodhi në tresht. Si lamë shoqet rrugës, shkuam te depoja. Dalina priste. Ajo na ndali që larg. Kur iu afrova që të merrja shërbimin, ajo më pëshpëriti në vesh: «Të lumtë, Linka! E di sa mirë është këtu? Ke për të parë!» **Unë u çudita me zérin e saj. M'u duk se ai zë kishte një kumbim të vëçantë e shprehët një emocion të thelli. Vetëm kur erdhi koha të lija shërbimin dhe i pëshpërita shoqes thuajse të njëjtat fjalë më vesh, e kuptovat nga buronte ajo ndjenjë.**

Më më fund mbeta vetëm. Dajlengadalë zhurma e hapave të shoqeve u tret dhe vendi u platisht në heshtje. Ishte një heshtje e tillë, që të futej gjer më palcë. Unë

ngriva në vend atje ku isha. Ishte hera e parë në jetën time që qëndroja e vetme, ballë pér ballë me natën, me armë në dorë. Hera e pârë që të tjerët flinin dhe unë përgjoja. Mendime nga më të çuditshmet më pushtuan; m'u kujtua se, kur isha në shtëpi dhe binte nata, nganjëherë druhesha të zbritja edhe shkallët në errësirë. U përpoqa t'i flakja këto mendime dhe ta përqendroja vëmendjen diku tjetër, duke shikuar objektet që më rrethonin. Shpinën e kisha mbështetur në murin e depos. Me sytë e mendjes shikoja rrugën e ngushtë këmbësore që zbriste prej andej dhe të conte te çadrat. Ato qenë rreshtuar në dy radhë. E para vinte çadra e truprojës, pak e veguar nga të tjerat, thuajse nën pishën e lartë, që tani më shëmbëllente dhe ajo me një çadër gjigante. Pastaj me radhë të tjerat. E katërtë qe çadra ime. Atje flinin Neta, Nora, Valbona.

Diçka rrëshqiti anësh: fshshsht! Unë mbajta vesh. Ç'lëvizi ashtu? Përgjova përséri. Heshtje. Pastaj prapë: fshshsht! Nga pishat nisi të afrohej një fëshfëritje e mbytur, e pambaruar, si një bisedë e gjatë, e këndshme. Unë u përpoqa ta harroja atë dhe të shikoja malet. Në këtë natë ato vizatoheshin në horizont në format më të çuditshme. Dukeshin si ca krijesa madhështore, që kishin rendur e rendur gjatë gjithë ditës dhe tani dremitnin të lodhura pér të përtërirë forcat dhe pér ta nisur sërisht të nesërmën udhëtimin.

Fillova të mendoja: Po sikur ndërkëq dikush t'i afrohej depos e ta kërcënonte atë? A thua do të hutohesha e nuk do të bëja asnjë veprim? Po të qe kështu, nuk do të vleja asnjë grosh. Kot që mbaja armën në dorë dhe që kisha pranuar të dilja rojë. Më mirë të kisha thënë: nuk jam e zonja, dhe mbaroi.

E, ndërsa qortoja kështu veten, vështrova nga e majta. Diku më tutje, pranë njëri-tjetrit, ngriheshin tre lapidarë. Që të nesërmën e ardhjes ne shkuam atje dhe dëgjuam tregimin e një vendasi pér një vajzë nga Bregdeti. Nuk i kishte kaluar të ka-tërmë-bëdhjetat. Qe një vajzë e imët, e pakët nga trupi, po me një zemër të ma-

dhe, që kishte shkruar në ato majëmale një legjendë të bulkur trimërie. Njerëzit e këtyre anëve e kishin ngritur lapidarit e saj bri lapidarit të Dedë Gjo Lulit. Me këtë ata ndoshta kishin dashur të thoshin se edhe një jetë e shkurtër, kur i kushtohet një qëllimi të madh, është e denjë të qëndrojë krahas për krahas me trimat e maleve. Duke u përpjekur të përfytyroja vajzën nga Bregdeti, unë as vetë s'e kuptova se si fytyra e saj merrte herë tiparet e Zonja Çurres, herë të shoqeve të saj të luf-tës. Dhe kalova kështu një natë të paharruar me Zonjën, Faton, Nimeten... Më dukej sikur shikoja fytyrat e tyre, sikur dëgjoja zërat, hapat, krismat e armëve të tyre...

Mbaja vesh. Po, hapa. Shtrëngova armën dhe u shtriva barkas. I futa fishekun në gojë dhe isha e sigurt se, po të qe nevoja, do të mund ta shkrepja për bu-kuri. Dhe thirra me të gjithë forcën: «Ndal! Kush kalon?»

As vetë s'e njoha zërin tim. Sakaq dëgjova përgjigen.

Kishte ardhur koha që ta lija vendrojën.

Nuk e kuptova sa shpejt rrondhën të gjitha këto. Zemra më rrihte me rrëmbim.

Një gëzim e krenari të tillë nuk i kisha provuar herë tjetër. E dija se të nesërmen do të më rrëthonin shoqet dhe do të prisnin t'u kallëzoja.

Ja, këto desha, të thosha. Unë e di se kjo ngjarje është fare e thjeshtë dhe me gjithatë mua më duket kaq e bukur. Ishte nata e parë që u bëja rojë ëndrrave tona.

1975

## Zihni Sako

### NË VITET E LUFTËS

Pas martesës së vajzës, Fatushes, në shtëpinë e Beqo Shalësit ngjau një e papritur. Dhëndri i ri, pas nja dy muaj marteze, doli partizan. Beqo Shalësit kjo gjë i qëndroi rëndë se, si kishte marrë vesh, ai më pas do të merrte me vete partizane edhe atë, nusen.

— Dhëndri, Beqir, ta bëri me të pabesë, — i tha kunati, Xhezmiu, — kur kishte një mendje të tillë, më mirë të mos qe martuar. Se ç'mund të ngjasë s'e di dot njeriu, po Fatushja akoma me duvaçk në kokë, thuaj se të mbeti e kthyer.

— Ti je i mençur vetë, Beqir. Fatushja ështe e re, kush nuk ta merr ty Fatushen?

Beqo Shalësi e vështroi në sy Xhezmiun. S'i erdhën mirë këto fjalë.

— Vajza nuk është lopë që shitet e blihet sa herë të duash, Xhezmi.

— Ashtu është, po tani kanë ardhur kohëra të rënda, Beqir, e të dalin nga dora djali e vajza, jo dhën-

dri. S'është ndonjë turp ta marrësh vajzën, se nuk i dihet; luftë është e ai dhëndër me atë mendje mund të të ngatërrojë keq.

— Moj grua, — i thirri së shoqes, — pa eja dëgjoi edhe ti këto që thotë ky vëllai yt.

— I dëgjova, i dëgjova, more burrë. E si të vemi ta marrim vajzën, more Xhezmi? Punë është kjo? Atë fat pati; pér të mirë a pér të keq këtë nuk e dimë, po ma do mendja pér të mirë.

Të gjitha këto fjalë i tha si me të rrëmbyer. Duart i dridheshin, kur po u hidhte nga një raki.

— Turpi më zë edhe mua me ju bashkë, moj motër, se jam dajë.

— Po të mos isha gjallë unë, — ia priti Beqo Shalësi dhe, pa e përpjekur gotën e rakkisë me Xhezmiun, e hodhi me fund.

— Dhëndri ynë s'bëri ndonjë turp, Xhezmi, që të të bjerë edhe ty pér ta larë, — iu hodh Hania e Beqo Shalësit.

— Xhezmi, si shumë e ke ngritur bishtin dhe po fut hundët atje ku s'duhet. Si shumë po i merr njerëzit nëpër gojë. Ata italianët, miqtë e tu...

— Po ata e kanë «Shqipërinë në zemrën e tyre...»

— Ashtu është, por ama kanë Shqipërinë, me ty dhe me ata shokët e tu e prokopinë që ke bërë, dhe jo ne shqiptarët.

— Ta kisha ditur kështu të mos kisha ardhur fare...

— Do kishte bërë më mirë...

Këto fjalë në shtëpinë e Beqo Shalësit u bënë pak ditë pas ikjes së dhëndrit.

\* \* \*

Një mbrëmje, në bisht të korijes së fshatit, qe dukur një njësit partizan dhe, sipas fjalës së çobanit të bravareve, prej andej qe drejtuar në postëkomandën ita-

liane, që ishte në një mës vendi, si ndonjë orë larg. Të nesërmen u mor vesh se posta, afér mengjesit, kishte rënë dhe dy karabinierë ishin vrarë e të tjerët kishin iku, duke e lënë postën me ç'kishte brenda: armë, rroba, municion e të ngrëna.

Këto fjalë i kishte prurë prapë çobani i bravareve të fshatit, që e kishte parë luftën andej nga kullota mbi korije e që kishte parë se italianët, duke iku, kishin djegur dy shtëpi.

— Grua, bëmë gati mushkën të vete njëherë nga vajza e të marr vesh si janë punët andej e të dimë ç'të bëjmë.

— Burrë, me mend, — e porositi e shoqja kur po e përcillte.

Në të hyrë të fshatit, Beqo Shalësi, si u përshëndosh me ca fshatarë, ia zbriti mushkës e, duke e hequr për kapistre, arriti te porta e shtëpisë së vajzës.

— Baba, i foli Fatushja, iu hodh e e përqafoi me mall. — Pastaj i foli së vjehrrës, që po milte dhitë në vathën e vogël në krah të shtëpisë.

— Mëmë, erdhi babai.

Ajo e ndjeu gjëzimin e nuses dhe i la përgjysmë dhitë e erdhi u takua me krushkun.

— Erdha t'ju shikoj njëherë, krushkë. Kë kemi ne, ju ju kemi shtëpi, e fjalë e kuvend.

— Mirë bëre, të paça, — iu përgjigj ajo dhe i tha nuses ta conte në odë sa të milte edhe ato dhi që i kishin mbetur.

Vjehrra e së bijës së Beqo Shalësit, si vuri të dyja kusitë me qumësht në qilar e lau duart, erdhi u ul mbi minder, afér vatrës, e ndezi zjarrin.

— Bën ca si ftohtë, — dhe i foli nuses. — Sillna të bëjmë nga një kafe.

— Si i keni punët, moj krushkë?

— Si me luftë, o krushk.

— Po Cenua ç'bëhet?

— Si e ke dëgjuar, mori dyfekun e iku me shokët.

E, si na thanë, qe edhe ai në luftën që u bë në postën e komandës, po ne s'e pamë.

— Po aja italianët i dogjën nja dy shtëpi.

— Epo hasmi s'vjen për të mirë. Po gjene shpëtuam pa një dëm në njerëz.

Beqo Shalësi mbeti si i turpëruar përpara krushkës. Duke pirë kafen, ai mendonte se ato fjalë që tha ajo mund t'i thoshte vetëm një burrë. Por ai e dinte që ajo qe trime dhë iu kujtua vajtimi i saj për të shoqin, që qe vrarë në Italinë e parë. E kishte qarë e e kishte nderuar saqë i gjithë fshati e tregonin me gisht. Prandaj edhe atij nuk i qenë dukur me vend ato fjalët e Xhezmiut që të prishej me këtë shtëpi.

— Fatushe, bjeri rakinë babait!

Pas pak, Fatushja, në një tabaka të vogël, i solli t'et rakinë me pak meze, djathë, disa thelpinj hudhra e një vezë të zier. Pastaj i tha të përgatiste darkën.

— Po u vranë ca italianni.

— U vranë. Në darkë herët u vranë prapë e i vunë përpara sa s'e pa i pari të dytin gjersa u hipën automobilave; në të ikur e sipër i dogjën ato dy shtëpi.

\* \* \*

Në mëngjes, Beqo Shalësi, si piu kafen, i tha kru-shkës:

— Si thua, Gjule, — i foli në emër, — unë kam menduar t'ju marr me vete. Kanë ardhur kohë të rënda. Ju jeni vetëm dy gra e s'dihet se ç'mund të ndodhë. Te ne jemi tok e ç'të na ngjasë e heqim së bashku.

— Ti e di, krushk, se unë në këtë shtëpi erdha nuse e tanë jam grua e thyer. Këtu gëzova nusërinë, këtu qava tim shoq, këtu rr Rita atë fill të vetëm e kë-

tu gëzova nusen time, Fatushen tënde. Sa të jem unë, kësaj s'i thotë njeri dot as mashalla, jo...

E preu fjalën. Pastaj, sikur recitonte ndonjë këngë, vazhdoi:

— Merre pushkën e t'yt eti dhe uratën time, bir...

— i thashë e, kur u nda më nusen dhe me mua, më tha:

— Amanet ma ki Fatushen... Ja tek është Fatushja, le të thotë edhe ajo fjalën e saj. Dhe ai në pësoftë gjë, unë nusen time, Fatushen, do ta kem si djalë e vajzë, në këmbë të tij e me të bashkë do të rritim atë... atë që do të lindë... ç'të jetë, djalë o vajzë, njësoj është për mua...

Beqo Shalësi, duke vështruar prushet e zjarrit, duke shuar e ndezur njérën pas tjetrës cigaret, e ndjeu veten ngushtë përpara Gjules, krushkës së tij, që ia kallonte një burri e s'dinte çfarë përgjigje t'i jepte.

— Fatushe, moj bijë! Bëj një përshest babait, se edhe mbrëmë mbeti me atë çikë raki e atë çikë meze e ata dy lugë pilaf.

— Unë do të kthehem prapë Gjule.

\* \* \*

Kur u nis Beqo Shalësi, dielli kishte mbuluar dhenë. Hipur në mushkë, gjithë udhës fjalët e Gjules nuk i dilnin nga mendja. Atë natë e atë mëngjes ai kishte mbetur i turpëruar dhe kaq e kishte humbur, sa s'e kuptoi fare kur arriti te porta e shtëpisë së tij.

\* \* \*

Nëntori i vitit 1942 filloi me një të ftohtë të hidhur. Në male kishte rënë dëbora e parë. Po moti mbante

mirë. Dielli i ndritshëm fekste në qielin si xham. Në oborr Beqo Shalësi po çantë dru. Gjithë ato dijtë, pasi u kthye nga shtëpia e dhëndrit, merrej me punët e dimrit, me atë kazanin e vogël të rakisë, sa për shtëpinë e tij. Ai donte t'i dilte përpëra dimrit, që kishte nisur të vinte e s'dihej se si do të bënte. Me ato fjalë të krushkës së tij, Gjules, sikur e kishte fjetur mendjen për çdo të papritur që mund t'u ngjante. Pastaj luftë ishte, lufta edhe pa rreziqe nuk bëhej. Në fshatin e tij, në kohën e Luftës Italo-Greke, ca fshatarë ishin vrarë kot, e mu tek rrinin, nga bombardimet, jo tani që kjo luftë bëhej si në kohën e Luftës së Vlorës, edhe më shumë, për të mirën e gjithë popullit. Si kishte dëgjuar, në krye të luftës ishin komunistët, që s'kishin të bënин fare me të pasurit. Edhe për dhëndrrin e tij kishte dëgjuar që qe nga këta komunistët. Ai s'kishte llafosur ndonjëherë me të e me ndonjë nga shokët e tij. Por atyre fjalëve, që i kishte thënë Xhezmiu, tani u kishte rënë në të se ku e kishin qëllimin. Xhezmiu qe njeri i italiameve, që e kishin veshur marshall të milicëve.

Beqo Shalësi, tek rrinte në dritat, afër mbërëmjes, pa poshtë bishtit të korijes të vinin në drejtim të fshatit dy veta të armatosur, që pas pak u ndalën e u strukën në një shkurre të korijes. Në atë çast dikush trokiti në portë. E shoqja e Beqo Shalësit celi portën.

— U, mësuesi! — tha ajo, duke shprehur gëzim e habi. — Hajde, të keqen!

— Është brenda xha Beqiri? — pyeti ai.

— Brenda është, brenda, — dhe e çoi lart në odë, tek i shoqi.

— Hajde, hajde. Sa mirë bëre! Po ku je, o mësues? Ke ca kohë që sikur na ke humbur... — i tha Beqo Shalësi

— Epo ca me punë, ca kam vajtur edhe nga fshati...

— Si i ke njërinë, mësues?

— Mirë.

— Se atje afër te ju u bë edhe një luftë e u do gjën edhe dy shtëpi.

— E, dogjën edhe shtëpinë e vëllait tim e tani janë mbledhur andej nga unë, si në cëfle të arrës. Po ç'të bësh, o xha Beqir, kur të zë hasmi derën, sos ta zë për të mirë.

— Ashtu është, o mësues, ashtu është.

Mësuesi kishte nja dy vjet që punonte në shkollën e fshatit. Atje e kishin emëruar sapo pati mbaruar shkollën. Si djalë të krahasinës, fshati e donte shumë e herë-herë e merrnin për darkë. Fëmijët i mësonte mirë. Me moshatarët e tij të fshatit shkonte si me shokët e fshatarët e tij. Shpesh mblidheshin tek ai dhe rrinin me orë të tëra. Atje në dhomën e tij ai u lexonte vjersha nga të Naimit, Çajupit, Migjenit, u tregonte për ta. U tregonte për gjendjen e luftës. Disa i kishte afruar aq shumë, saqë u jepte edhe ndonjë komunikatë nga ato që i sillte millionai i fshatit. Ishte njeri i zakonshëm, si gjithë të tjerët, vetëm se shkruante me dorën e majtë. Edhe ai që i sillte millionait komunikatat i thoshte: «Jepja mëngjërashit.» Asnjëri, përveç millionait, s'e dinte këtë emër.

— Xha Beqir, do të na pranosh sonte me dy shokë?

— Grua, — i foli së shoqes, — sonte bëj darkë edhe për tre veta.

Mësuesi pa orën. Nata kishte rënë e fshatarët tani ishin rralluar rrugës.

— Po ku i ke këta dy shokët?

Ai kërkoi llambën. Me të në dorë u ngrit e doli tri herë te kreua i shkallës, në çardak.

— Pas pak do të vijnë, — i tha e iu lut që portën e oborrit ta linin gjysmë të hapur.

Për të mos i rënë në sy së shoqes, Beqir Shalësi zbriti vetë, tërroqi kanatin e portës dhe e la gjysmë të hapur, ashtu si i tha mësuesi. Pastaj në dhomë ra heshtja. Si pa orën, mësuesi doli te kreua i shkallëve të çardakut. Dy veta hynë në oborr e, si e shtynë portën, u ngjitet në shkallët e çardakut. Mësuesi i futi brenda në odë. Beqo Shalësi i kishte lëshuar tarabat e dritarëve e i priti miqtë afër mesit të odës.

- Vdekje fashizmit!
- Hajdeni, more djem. Uluni se jeni të lodhur.
- Pastaj Beqoja i foli së shoqes t'u bënte miqve nga një kafe e t'u nxirrte nga një raki.
- Zbërthehuni, more djem. Lirohuni nga ata gjerdanë. Rrini si në shtëpinë tuaj.
- Janë shokë të dhëndrit, xha Beqo, — i tha mësuesi.
- Ai na tha të vinim te ti, — u hodh njëri nga ata të dy, që dukej pak më i moçëm se shoku i tij e mësuesi.
- Po ç'thuhet gjë, more djem? Se si shpejt e zutë këtë punë e jeni të paktë. Se ka që flasin keq për ju.
- Janë më të shumtë ata që flasin mirë.
- Merrni nga një raki e pini këtë kafe, — u tha kur e shoqja hyri me një tabaka në dorë.
- Ata e lhoqën nga një herë rakinë e morën kafen.
- Kthejeni, kthejeni të gjithë gotën, se ju bën mirë. Rakia të çlodh.
- Ata nuk ia prishën. Me kafe në dorë, ai që dukej si më i moçmi, duke iu drejtuar Beqo Shalësit, tha:
- Duam të bëjmë një mbledhje në fshat e të flasim me fshatarët për luftën që ka nisur populli, për Partinë Komuniste Shqiptare, për Frontin e të ngremë këshillin e fshatit.
- Mirë, more djem, po ky krahu i vendit nga ne është ca i trazuar, se ka ca që kanë njerëz në punëra të qeverisë, ka edhe ca që janë veshur milicë e ai kunitati im, Xhezmiu, është edhe marshall.
- Do të përpinqemi edhe me ta. Do t'u tregojmë cila është udha e drejtë e cila është udha, e shtrembër, që të shpie kundër popullit. E populli është shumë herë më i fortë nga të gjithë.
- Po do t'ia dalim dot kësaj pune? Ne jemi edhe të paktë e këta italianët janë si fara e sinapit.
- Kaq kanë qenë kurdoherë, sa janë edhe sot, por ama të gjithëve u kemi treguar vendin. Mizë lisi ishin italianët në kohën e Luftës së Vlorës, por i hodhëm në det.

Bisedën e vazhduan deri vonë nga mesnata dhe shokëve nuk u shkonte në mend të hanin bukë. Edhe të zotit të shtëpisë nuk i vente mendja për të ngrënë, me gjithëse e shoqja vinte e i thoshte: «Léri të hanë njëherë bukë, pastaj pyeti, se i lodhe!»

\* \* \*

Pas mbledhjes që u bë me fshatarët, Beqo Shalësi nisi të priste e të përcillte shokë partizanë sa herë që vinin në fshat. Xhezmu tani, duke marrë pjesë hapur kundër Luftës Partizane, jo vetëm e kishte rralluar udhën për në fshat, por nga qyteti lëvizte vetëm kur kishte ndonjë njësi të madhe armësh rrötull.

Gjendja ishte ndërruar shumë. Çetat partizane po shtoheshin e përpjekjet bëheshin më të shpeshta. Pas luftës kundër postëkomandës, e gjithë krahina tani drejtotohej nga këshilli krahinor, që e kishte qendrën në fshatin e Beqo Shalësit. Njësitët e fshatrave ishin në këmbë natën e ditën, sa dëgjonin pesë pushkë e një bombë.

\* \* \*

Ishë viti 1944. Pas dëborës së shkurtit e të marsit, pranvera kishte filluar me fitoren kundër Operacionit të Dimrit. Po një natë, në këtë pranverë, ngjau për shtëpinë e dhëndrit një e papritur shumë e rëndë. Fatushen, tek vinte nga gurra me bucelë ngarkuar, dy veta e zunë dhe e morën me vete. Beqo Shalësi, sa e lajmëruan, u nis për të marrë vesh, Asnjeri s'dinte se ku e

kishin shpënë. Gjulja, me nipin e saj foshnjë, me emrin e bukur Agim, që u kishte thënë vetë i ati t'ia vinin, kur i treguan se i lindi djalë, rrinte te pragu i kasolles, pérpara shtëpisë, që ia kishte djegur një njësit gjermano-ballist në térheqje e sipër, në ato muajt e Operacionit. Ajo kishte parë me ta Xhezmiun, megjithëse nuk i kishte dhënë të njojur. Beqo Shalësi nuk ndenji shumë me krushkën.

— Krushkë, po shkoj njëherë andej nga «mëngjërashi», tek ai mësuesi ynë, që merret me punët e Partisë, — dhe u nis me të shpejtë andej nga mulliri i fshaitit, ku mësuesi kishte zakon të rrinte e të bënte edhe mbledhje.

Mëngjérashin e gjeti te dera e mullirit. Ai e kuptoi pse kishte ardhur.

— Po, mësues, siç më shikon, erdha të më thuash një fjalë, — i tha Beqo Shalësi.

— Ulu njëherë. — Dhe i dha të bënte një cigare.

— Unë e kuptova pse erdhe. Partia e di. Dhe organizata ka marrë vendim: Fatushen ta shpëtojë e Xhezmiun ta vrasë.

— Për këtë kam ardhur e, meqë ju e keni vendsur kështu, të më thuash ç'të bëj edhe unë.

— Siç të thashë, ne i kemi marrë masat.

— Për Xhezmiun më merrni edhe mua, jo se mua më ka bërë këtë, që bëri për Fatushen, po se gjithë krahun e vendit tonë e shkeli me këta italianët fashistë.

Mëngjérashi ia shpjegoi si do të bëhej. I dha një adresë e një letër për në qytet. U përshëndoshën, dhe Beqo Shalësi, afër mbrëmjes, arriti në qytet e u takua, pa humbur kohë, në atë adresë, me atë për të cilin ia kishte dhënë letrën.

Si ra nata mirë, njësiti gueril i qytetit iu afrua shtëpisë së Xhezmiut.

— Ma lini mua, — u tha shokëve Beqo Shalësi.

— Jo, — tha një nga shokët e njësitet. — Ti e bëre punën tënde. Kam unë nja dy fjalë tani me të, — dhe hyri brenda.

Xhezmiu sa e pa ngriu në vend.

— Si e shikon, Xhezmi, — i tha shoku i njësitit, — jemi gjallë për vatanin e për njerëzit tanë. Vdekje fashizmit! — Pastaj një krismë naganti e shtriu përdhë. Pas disa kohësh njësiti gueril i qytetit, pasi pati zbuluar ku e kishin burgosur Fatushen, e çiruan dhe e përcollën për në fshat.

\* \* \*

Që përpara Operacionit të Dimrit dhëndri i Beqo Shalësit, si komisar batalioni, kishte kaluar larg rrëthit të tij. Një ditë ai ra në përpjekje. Sa erdhi lajmi, e ëma, Gjulja, nuk vajtoi si në atë kohë që pati vajtuar për burrin. Ngriti në duar Agimin e vogël dhe i përshëndeti shokët: «Të na rrojë Partia!»

Pas pak Faftushja, pasi u pati nxjerrë miqve nga një gotë raki, i mori t'et gjerdanin dhe pushkën.

— Po i marr unë, baba! — dhe veshi gjerdanin e hodhi pushkën krahut.

Gjulja e kuptoi dhe i tha:

— Merri, jeto, se të kanë hije gjurmët e tyt shoqi, të kanë hije gjurmët e tyt eti.

\* \* \*

I pashë pas shumë vitesh Gjulen plakë të moçme e Beqir Shalësin plak, që një milë i tij e mbante nga krah, duke përshëndetur me grusht Agimin, me shaminë e brigadës në gushë, që parakalonte në 30-vjetorin e Brigadës në vend të t'et, krah për krah me të emën, Fatushen.

1973

## Zija Cela

### NJË JETE NË KUFI

Ishte pranverë dhe muret e bardha të postës shndritin në diell. Atje gjithçka ishte lyer me gëlqere, edhe elementët e këndit të kalitjes, edhe trungjet e akacieve të reja, edhe parmakët e lulishthes së vogël. Në atë dritë pastëritie, kushedi përse, dukeshin aq të reja e gazmore fytyrat e ushtarëve. Ndërsa kalonte përpara mureve të thata, që rrëthonin oborrin e postës, Visari ndjeu ta thërriste dikush:

— O doktor, të zura dhe nuk të lëshoj sot! — Ishte Beluli, komandanti i postës. Njëherë, në palcë të dimrit, mjeku veterinar e kishte gjetur ushtarakun në Krumë, të lagur e të qullur nga shiu. Me gjithë kundërshtimet e tjetrit, mjeku e kishte vënë përpara dhe e kishte mbajtur një copë herë në shtëpi me zjarr drush. Ai kishte qenë një takim i rastit, por, me sa duket, afrimet e sinqerta shpesh i kanë rrënjet te njojja e parë.

— Hë, si e ke punën? — e ngacmoi Beluli, duke u afruar. — Apo pandeh ti se oficerët e kufirit, ngaqë

bredhin si nomadët, nuk kanë shtëpi?! Çizmet dhe shtëpinë i marrin gjithkund me vete. Pa shikoje njëherë atë samarin e breshkës!

Oficeri i tregoi shtëpinë pak më tutje postës. Ishte një depo ushtarake e përshtatur. Kapriatat prej llamarine kishin qenë të lyera qysh më parë me bojë dhe ashtu, gjithë pulla-pulla e kuti-kuti, çatia vërtet dukej si samar breshke. Po muret edhe aty ishin sherbetosur me gëlqere të freskët; oborri i pastruar, rrugica e shtruar me rraša, me dy vija të bardha te fundet, lulet dhe një yll i madh, ngritur me plisa të skuqur me pluhur tullash të thërrmuara, të gjitha këto të kujtonin uniformën dhe oboret e reparteve ushtarake. Ndoshta, edhe ylli kishte qenë më parë, po s'e kishin luajtur; atë e mirëmbanin, dhe ylli dukej gjithnjë sikur ishte bërë dje dhe sikur do të ishte aty përgjithmonë.

— Po jam për udhë, more Belul, — i tha Visari. Ai kishte ardhur për vaksinimin e bagëtive të imëta dhe po kthehej në qendrën e punës, në një qytezë bujqësore në plajë, si nja dy orë me këmbë.

— Pikërisht se ke për të iku, duhet të vish... Fatiko! O Fatiko! — Një grua rrëth tridhjetë e dy-tri vjeçë, doli te pragu i derës.

— Ky doktori kujton se kemi ndonjë lopë të sëmurë e s'vjen. Pa thuaji se ne nuk mbajmë lopë.

— Ama, — ia bëri gruaja, — shkelës kufiri paske kapur sot. Hajde, doktor, hajde, se lopë nuk mbajmë, po një gotë qumësht mos na e kurse.

Visari hyri. Dhoma ishte ortahe, e suvatuar me rërë të trashë dhe në ballë kishte një derë, që me sa dukej komunikonte me dhomën tjetër. Nëpër mure kishte piktura oleografie e litografie. Kornizat prej kartoni ishin të vjetra, të nxira pak nga tymi i sobës. Me sa dukej, kur ishte i lirë, oficeri i kufirit pikturonë. Diku, në një kornizë të madhe, kishte vënë portretin e së shoqes. Në telajo dukej ende fusha me katrörë. Ndoshta, portretin e kishte zmadhuar prej një fotografie, po tiparet kishin humbur disi, duke e nxjerrë gruan më të moshuar.

— U vonova shumë derisa e bëra dhe m'u plak në duar, — qeshi Beluli. — I kam një shtatë vjet tepër Fatikos. Siç duket, ma ka gabuar dorën xhelozia e moshës. — Ai u ngrit dhe uli zërin e radios. Tirana transmetonte këngë popullore. — Nuk di të vizatoj, jo, — i tha Visarit.

— Ti gjithmonë kështu tha e prapë vizaton.

— Po njeriu gjithmonë bën diçka, moj Fatiko. Këtu nuk ka stadium që të vete, për peshk po s'shkoj dot, atëherë, në kohën që më mbetet, merrem me pikture. Edhe fytyrat e ushtarëve, kështu, sikur i mbaj mend më mirë, — i tha Visarit. — Kam vizatuar njëherë portretin e Ali Nezirit. E kam pasë diçkur ushtar në Kakavijë. Pah, çfarë kufitari që ishte! Apo s'i binte gérnetës, hollë e hollë, të prekte mu në shpirt dhe të vinte të qaje... U mundova mjaft, po s'më doli mirë. Nuk di të vizatoj, jo!

Ai hoqi kapelën dhe u shkoi flokëve dorën përsipër, si të donte të shkundte një si pah hiri të lehtë. Midis flokëve të zez e të dredhur, të shtruar nga kapela, i përshkoheshin ca thinja të rralla, si fije mëndafshi të bardhë e kleitës.

— Ah, sa, keq më vjen që s'di të pikturoj! Sinqerisht, doktor, — tha me një ndjenjë mërzie. Pastaj u kujtua papritur: — Po ku janë fëmijët, moj Fatiko?

— Ku di unë. Hëngrën dhe dolën. Nëpër fshat janë.

Gruaja kishte veshur një fustam të thjeshtë. Ishte një fanellatë e bardhë me figura arushash. Ato, arushat, ishin si të cirkut, luanin me topa të kuq plazhi dhe, në përgjithësi, coha dukej se ishte kompozuar për fëmijë. Por edhe ajo, Fatikoja, e vogël ishte, e shkurtër, e rrumbullaktë dhe me diçka prej fëmije në sytë as të kaltër as të bardhë. Por sepse ishte pakëz e lodhur, *sikur apo kishte kaluar një lëngatë të lehtë dhe tani po i kthehej shëndeti, duke i theksuar edhe më shumë gjallërinë dhe atë vëçanësinë e syve, me dritën lëngëzuese, të butë e me një nuancë qumështi.*

— A hamë? — pyeti Beluli.

Gruaja vuri në tryezë supë me malkarona dhe mish, që e kishte pjekur në tavë.

— Unë kam ngrënë, — tha Visari.

— Léri ato! Supë dhe patate paska mjaft, kurse pér mish ti s'e ke ditur se vjen Visari. O doktor, — tha Beluli, — po të bie rastësisht një shok pér drekë, Fatikoja gjithnjë do të bëjë sikur ka ngrënë.

Gruaja qeshi, vuri një pjatë para vetes dhe u ul në tryezë.

— Kishte plot edhe mish, po e hëngren fëmijët, — tha. — Kur e sheh se s'të mbetet më gjellë në tenxhere, prindi e kuptoka se janë rritur fëmijët.

— U rrnitën, pér dy sytë e ballit! — ia mbajti fjalën i shoqi. — Atij të madhit i vajti numri i këmbës tridhjetë e shtatë. — Beluli i hodhi një gotë birrë Visarit. Pastaj edhe Fatikos. — Do ta pija edhe unë një, gotë, po ashtu e kam punën.

— S'paska marrë fund ajo puna e mbrëmshme? — e pyeti Fatikoja me një ndjenjë pritjeje.

— E ku e di ti punën e mbrëmshme?

— Atë nuk e di, por as mbrëmë s'pive birrë.

— Mirë, mirë, e kam mbajtur racionin tim. Ky termosi, doktor, e ruan birrën mirë pér katër-pesë ditë. Çojmë dhe e mbushim në Krumë, nganjëherë. Tani, bëjemi gëzuar ju të dy. Hajt, mirë se na erdhe! — Ai i ra lehtë me lugë pjatës prej porcelani dhe filloj të hante.

Visari nuk hëngri me oreks. Ndihej i lodhur. Megjithatë, atmosfera në atë shtëpi, ku bashkëshortët fllasin sikur të ishin vetëm, pa e rënduar mysafirin dhe dulke e ngacmuar nga pak njëri-tjetrin, i dukej e ngrohtë. Madje, edhe sistemimi i dhomës, as si dhomë pritjeje dhe as si kuzhinë e vërtetë, i pëlqente. Ato perdët e shkurtra, prej rrjete, të vëna në gjysmën e poshtme të dritates dhe të punuara me grep, jastëkët e fortë të minderit, mbuluar me faqell të qendisur, përgjithësisht, përdorimi i kambrikut dhe qëndizmave, vazot me barborozë e karafila në parvaz, i sillnin ndër mend shtëpinë e nënës. Vetëm ai shtrati tek, me këmbë të larta prej

hekuri, e shtynte të mendonte për tjetër gjë. Aty pranë, pothuaj ngjitur me jastëkun, ishte telefon. Receptor i prej ebaniti të zi, harkuar paqëz nga të dyja anët dukej si një qen i vogël që, duke pritur të zotin të hynte në krevat dhe ai t'i bënte rojë, kishte dremitur një çast i kruspullosur mbi komodinë.

Një zë i hollë, si fishkëllimë shpendi, e bëri gruan të ulte lugën. Ajo përgjoi dhe, kur fishkëllima e pakuptueshme u përsërit, e zgjatur dhe e ngjirur, Fatikoja do li në dhomën tjetër.

Pas pak mbaruan së ngrëni. Visari priste të kthej gruaja dhe t'u kërkonte leje për të iku. Në katin e parë të tryezës ishte një album. Mjeku e hapi: kishte fotografi dhe riprodhime fotografish, punuar me ngjyra në format të vogël. Në faqe të parë ishte Beluli me Fatikon. I kishin vënë në mes një grup njerëzish. Anash lexohej një shënim i imët: «Dasma jonë, Lunxhëri 1960.» Fatikoja, ishte nuse, me një tufë lule në duar, me flokët të kreher gjithë bulkla, e shkurtër, e rrumbullakët, energjike, fare e re, me një si ndjenjë habie në fytyrë, sikur të quditej, pikërisht, nëse ishte ajo me të vërtetë dasma e saj. Nusen e kishin veshur me dimi dhe, nën gjatjanët e këmbëzave, i dukeshin këpucët e bardha me majë të hollë, me takë të rëndë e me tokëza false, të mëdha e të veshura me lëkurë anash. Visarit sepse i bënë përshtypje ato këpucë... Njëherë kishte vajtur me Munirin, një shokun e tij, në qendër të rrëthit, në një koncert. «A vëren diçka në sallë?» — e kishte pyetur shoku. «Çfarë?» — ishte bërë kureshtar Visari. «Të fundmet që e ndërrojnë modën janë gratë e ushtarakëve», — i kishte thënë Muniri...

Në dhomë erdhë prapë Fatikoja, me atë fustanin e saj me arusha cirku.

— Nuk flen, — tha.

— Po pse e prure, moj Fatiko... Na korite me doktorin, — qeshi Beluli. — A nuk e sheh, doktor, na erdhë një fëmijë, tash në pleqëri!...

Fatikoja e zbuloi foshnjën, e puthi në të dyja fa-

qet dhe zuri ta manuriste. Ajo drita e bardhë lëngë-zuese, me nuancën e qumështit, sikur i pikonte nga sytë përmbi kërthiun.

— Ah, more doktor, si ka vajtur dasma, jonë! — mërmëriti Beluli. — Ja, të betohem për sytë e ballit, ka kërcyer komisari sipër stolit, në një pëllëmbë vend. Dhëndri e djeg në dasmë, më tha. Edhe unë e djeg, i thashë dhe nxora pistoletën. Jo, dhëndri djeg shaminë e beqarit, më tha. Ma mori shaminë, i vuri flakën dhe kërceu me të, në një pëllëmbë vend, për sy të ballit... Apo s'kishim marrë nga Kaçavija edhe atë Ali Nezirin! I binte gërmnetës, tamam sikur ta kishte vënë atë dreq bilbili mu te zemra e tij. Ishte ditta e dasmës, po më ngashërehej shpirti dhe më vinte të qaja prej mallën-gjimit. Edhe Fatikoja e vogël i fshinte lotët me shami.

Visari ktheu faqen e albumit. Doli prapë Fatikoja. Ishte një portret në natyrë, piktuar me pastel; gruaja me flokët e lidhur me shami, me një bohçe përpara dhe me një kovë të madhe uji në dorë. Shënim i thoshte: «Fatikoja, stalliere në ekonominë ndihmëse. Posta e Belushit, 1964.» Pastaj vinin ca fotografi të farefisit dhe të ushtarëve: «Ali Neziri me gërmnetë.» «Komisari, shoku Jaho Muslia, në orën e punës politike.» «Shtëpia jonne. Posta e Omanovës, 1966.» «Fatikoja në provimet e korrespondencës. Viti i tretë i pedagogjikes. Moravë, 1970.» «Kufitar Sadri Anamali, dekoruar me Medaljen e Trimërisë.» «Autoportret.» «Fëmijët tanë: Jahoja, Tanushi, Peçi dhe Drita. Oborri i shkollës, Skalqin, 1972.» Pastaj dy fotografi të një viti, pranë e pranë: «Fatikoja edukatore kopshti, Skalqin, 1973», dhe «Fatikoja në ditën e festës së Forcave të Kufirit duke kënduar këngën «O mor pëllumb i shkruar, ngado që të shkosh, unë do të vij me ty», Posta e Vorinës, 197...». Shënimin e fundit Visari e lexoi me zë.

Gruaja ngriti kokën e vuri buzën në gaz e tur-përuar.

— Ashtu më, sa me thënë. Po ku di unë të këndo!...

— As unë s'di të vizatoj, as ti s'di të këndosh, moj Fatiko, — pranoi me kegardhje Beluli. — Po ja që, nganjëherë, edhe unë vizatoj, edhe ti këndon. Njeriu nuk rrnka dot pa bërë diçka... Ah, mor doktor, sa shpesh ia merrte Fatikoja me ato vajzat e Omanovës. Këndonin një këngë të vjetër kurbeti që ta këpuste shpirtin. Aty pranë ishte pylli i mështeknave, me mjegull e me mister. Kur ngrihej mjegulla, drurët dukeshin shumë të bardhë dhe vajzat ishin të gëzuara, po kënga ishte e trishtuar dhe ta këpuste shpirtin.

Visari shfletonte albumin dhe, sa herë ngrinte atë fletën e hollë, të bardhë, i dukej se ngrinte vellon dhe do t'i shfaqej prapë Fatikoja e vogël nuse. Jo, Fatikoja ishte rritur; e kishte filluar si stalliere dhe tanë ishte mësuese në shkollen tetëvjeçare të Zahanit. Ajo nuk ishte velloja, po mjegulla që ngrihej mal më mal dhe Visari i shfaqeshin ata të dy, burrë e grua, postë më postë, Jug e Veri, gjashtëmbëdhjetë vjet me radhë, kudo bashkë, nëpër vijën e kufirit... Albumi përfundonte me pikturën e një foshnjëje, të shtrirë lakuriq në pelena dhe me shënimin: «Fatikoja na gëzoi përsëri!»

— Kanë mbetur ca lajthi sipër raftit. Si nuk ia nxorëm doktorit! — u kujtua Beluli.

Ai u ngrit, u zgjat e mori një grusht lajthi. Dhe, kur deshi të mbledhët një grusht tjetër, rrëzoit padashur një kuti kartoni. Kapaku fluturoi dhe në dysheme u zbuluan një palë këpucë grash, të bardha, me takë. Beluli u përkul dhe i futi prapë një kuti. Visari nuk arriti t'i shihet mirë, po sepse iu duk sikur ishin po ato këpucë, me maja, me ca si tokëza false që dikur Fatikoja i kishte veshur në dasmën e saj. Vetëm ai lëmimi i faqeve prej boksi sikur kishte humbur disi dhe lëkura kishte marrë ca zhurba të lehta. Po a ishte e mundur që vërtet të ishin po ato këpucë? Visarit i erdhi rëndë të pyeste. Sigurisht, gruaja kishte blerë e kishte grisur kushedi sa palë këpucë të tjera, por ato, të bardhat me takë, ndoshta, rrönin ende. Malet me gurë e strall nga kishte brendhur Fatikoja, nuk duronin takë, ndërsa verës, kur

shkonin me pushime në Lunxheri apo nëpër plazhe, ajo mban te sandale...

Këngët popullore kishin mbaruar. Radioja transmetonte një emision dhe Visarit i bëhej sikur ai emision i radios duhet të ishte për Fatikon, kufitaren e përjetshme pa uniformë.

Mjeku u ngrit. Ata e përcollën deni te parmakët e oborrit të jashtëm. Oborri i pastruar dhe rrugica e ngushtë e shtruar me rrasa guri, kishin rënë në qetësi. Aty ishin vijat e bardha, të lyera me gëlqere, aty ishte edhe ylli, i mbushur me tulla të thërrmuara. Një lulevarëse kishte përdredhur bisqet, duke u përpjekur të ngjitej në kashen e derës.

Ushtaraku i zgjati dorën. Këndoi një shpend duke fluturuar. Visari ngriti kokën dhe pa telat e telefonit. Ata zgjateshin që nga posta si duar ushtarësh, për ta zgjuar në çdo çast, sa herë që duhej, komandantin e tyre...

— Mirë mbetshi, komandant! — mërmëriti Visari, — Lamtumirë, Fatiko! Të shkofftë mbarë me fëmijën e vogël!

Dhe ndërsa po largohej, e ndjeu se s'kishte për ta harruar lehtë atë grua. E shkurtër dhe energjike, me dritën e foshnjës te sytë, me atë fustanin e saj prej fanellate të bardhë, me topa e arusha, ajo do t'i kërcente si një ketër i shkathët nëpër degët e kujtesës.

Bashkëshortët ndenjën te dera, gjersa mjeku u humbi nga sytë, prapa shkëmbit të kroit.

1979

## PËRMBAJTJA

**ALI ABDIHOXHA**  
**ANASTAS KONDO**  
**BETIM MUÇO**  
**DRITËRO AGOLLI**  
  
**DHIMITËR S.**  
**SHUTERIQI**  
**FADIL ZEQIRI**  
**FAHRI BALLIU**  
**FAIK BALLANCA**  
**FATMIR GJATA**  
**FUAT ÇELIKU**  
**IDRIZ PONARI**  
**ISUF BAÇA**  
**KOÇO KOSTA**  
**LLAZAR ÇUÇI**  
**MOISI ZALOSHNA**  
**MUHARREM DARDHA**  
**NASI LERA**  
**NASHO JORGAQI**  
**NAUM PRIFTI**  
**RESUL BEDO**  
**SOTIR ANDONI**  
**SHEVQET MUSARAJ**  
**TEODOR LAÇO**  
**THOMA NOTI**  
**ZIHNI SAKO**  
**ZIJA ÇELA**

— Përbysja .....	3
— Të papriturat e qiellet .....	23
— Kapercimi i madh .....	30
— Fytyra e një ushtari të përjetshëm .....	41
— Natë shtatori .....	48
— Provimi .....	55
— Ushtari i liruar .....	65
— Ky zheg që përvëlon .....	72
— Zemër shqiptare .....	83
— Takim pas një ngjarjeje .....	90
— Çdo pëllëmbë e tokës sonë .....	96
— Një trim largohet nga radhët .....	105
— Dhembja e Guçe Gërbit .....	118
— Përballë erës .....	130
— Xhixheja jonë .....	145
— Letër nga nipi .....	151
— Ditën e tretë të luftimit .....	157
— Fytyra e heroizmit .....	166
— Shebiu .....	183
— «Laraska» .....	191
— Dhëmbëza e fundit .....	196
— Mauzeri .....	209
— Fortesa .....	218
— Vendroja numër tre .....	235
— Në vitet e luftës .....	242
— Një jetë në kufi .....	253